



Opinio Juris

Revistë shkencore juridike

Opinio Juris

Revistë shkencore juridike

Viti I, Nr 1/2015

Botues

Instituti Gjyqësor i Kosovës

ANËTARËT E REDAKSISË

Dr. Fejzullah Hasani – Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës

Laura Pula – Prokurore në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit

Dr. Osman Ismaili – Profesor në Fakultetin Juridik/Universiteti i Prishtinës
“Hasan Prishtina”

Dr. Haxhi Gashi – Profesor në Fakultetin Juridik/Universiteti i Prishtinës
“Hasan Prishtina”

Mr. Sc. Muhamet Rexha – Gjyqtar i Gjykatës Apelit

Mr. Sc. Afrim Shala – Gjyqtar i Gjykatës Themelore Gjilan

Mr. Sc. Lavdim Krasniqi - Drejtor në Institutin Gjyqësor të Kosovës

Redaktor teknik

Luljetë Hetemi, juriste e diplomuar

Dizajni dhe radhitja kompjuterike:

Instituti Gjyqësor i Kosovës

Publikuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës

© Instituti Gjyqësor i Kosovës, 2015

Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK).

Pikëpamjet e autorëve nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Lavdim Krasniqi	
Fjala hyrëse	4
Mr. Sc .Afrim Shala*	5
VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTAVE TË VOTIMIT.....	5
Mr.sc. Agim Maliqi*	19
NJË KOMENTIM I SHKURTËR I SHQYRTIMIT FILLESTAR DHE SHQYRTIMIT TË DYTË SIPAS DISPOZITAVE TË KODIT TË PROCEDURËS PENALE	19
Avni Puka*	51
PRANIMI I PËRGJEGJËSISË PENALE TË PERSONAVE JURIDIKË NË SISTEMIN “CIVIL LAW” – NJË VËSHTRIM I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS	51
Besnik Berisha jur. i dip.	77
INTERESI JURIDIK NË PROCEDURËN CIVILE	77
Mr.sc. Hajrullah Mustafa	85
NDËRMJETËSIMI NË SISTEMIN E DREJTËSISË SË REPUBLIKËS SE KOSOVËS DHE EFEKTSHMERIA POZITIVE E TIJ	85
Mr.sc. Isuf Sadiku*	97
LEGJISLACIONI LIDHUR ME MONITORIMIN DHE INSPEKTIMIN E INSTITUCIONEVE PENITENCIARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....	97
Ma Sc. Isa Shala	109
PËRMBARIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE DHE TË DOKUMENTEVE TJERA QE PËRMBAJNË DETYRIM	109
Mr. sc. Ramadan Gashi	127
TË QENIT I BARABARTË PARA LIGJIT DHE GARANCITË QË OFRON GJYQËSORI	127

Fjala hyrëse

Të nderuar lexues,

Me kënaqësi po u drejtohem përmes kësaj reviste juridike, publikimi i të cilës, në këtë format ka filluar për herë të parë, duke shpresuar të zë një vend të çmueshëm në literaturën juridike si dhe në publikimet e IGJK-së.

Revista “Opinio Juris” botohet për herë të parë këtë vit, me q ‘rast u është dhënë mundësia për publikim gjyqtarëve, prokurorëve, profesorëve universitar si dhe profesionistëve të tjerë ligjor në Kosovë. Temat e kësaj reviste janë përzgjedhur nga Këshilli i Redaksisë së IGJK-së, të cilin e përbëjnë profesionistë të shquar nga gjyqësori, prokuroria dhe sistemi i drejtësisë në vend.

Kjo revistë përmban punime nga autorë të ndryshëm si: gjyqtarë, prokurorë, profesor universitar, juristë etj., të cilët me punimet e tyre trajtojnë çështje të ndryshme ligjore të lidhura me praktikën gjyqësore dhe juridike kombëtare dhe ndërkombëtare.

Qëllimi i kësaj reviste është ofrimi i mbështetjes profesionale për gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët tjerë ligjor në Kosovë e më gjerë.

Nga leximi i punimeve në këtë revistë, vërehet se autorët kanë trajtuar çështje juridike të cilat ishin temë e ndryshimeve në legjislacion, si dhe institute juridike kryesisht të reja të cilat meritojnë edhe më tutje vëmendje nga shkenca juridike në Kosovë.

Temat e trajtuara në këtë numër të revistës “Opinio Juris” shpresojmë që do jenë një mundësi për të njohur perspektiva të ndryshme, pozitive dhe do të ofrojë ndihmesë në punën e komunitetit ligjor dhe lexuesve tjerë që janë në shërbim të sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Mr.Sc. Lavdim Krasniqi
Drejtor i Institutit Gjyqësor të Kosovës

*Mr. Sc .Afrim Shala**

VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTAVE TË VOTIMIT

ABSTRAKT

Veprat penale kundër të drejtave të votimit janë parashikuar në një kapitull të veçantë të pjesës së posaçme të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.¹ Veprave penale kundër të drejtave të votimit në Republikën e Kosovës, kohëve të fundit, i është kushtuar një vëmendje e posaçme nga institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare, për faktin janë inicuar një numër i konsiderueshëm i procedurave penale ndaj personave që dyshohet se kanë kryer vepra penale të kësaj natyre. Për shkak të natyrës së tyre, veprat penale kundër të drejtave të votimit kryhen me motive politike dhe janë të ndërlidhura me zgjedhjet që zhvillohen në Republikën e Kosovës.

Fjalët kyçe: e drejta e votimit; zgjedhjet; procesi i votimit; veprimi i kryerjes; pasoja e veprës penale; kryerësi i veprës penale.

1. Shqyrtime të përgjithshme

Veprat penale kundër të drejtave të votimit janë parashikuar në Kapitullin e XVIII-të të KPRK. Ky Kapitull është një kapitull i ri në KPRK dhe përveç që është një Kapitull i ri, aty gjenden edhe disa vepra të reja penale të cilat nuk kanë qenë të parashikuara si të tilla në legjislacionin e mëparshëm penal. Disa nga veprat penale të këtij Kapitulli, në Kodin e mëparshëm Penal të Kosovës (KPK)² kanë qenë të parashikuar në kuadër të Kapitullit të veprave penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut.

Për shkak të pasojave dhe rrezikshmërisë së tyre, veprat penale kundër të drejtave të votimit, sipas nenit 22 të Kodit të Procedurës Penale (KPP)³, konsiderohen krime të rënda dhe për gjykimin e tyre në shkallë të parë është kompetent Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatës Themelore.

Shumica e veprave penale të këtij Kapitulli kanë karakter blanket, sepse për të ekzistuar këto vepra penale duhet që veprimet e kryerjes të jenë në kundërshtim

* Autori i këtij punimi është gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda.

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), Nr.04/L-82, i datës 20.04.2012, ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

² Kodi i Penal i Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/25, e datës 06.07.2003.

³ Kodi i Procedurës Penale, Nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

me ligjet përkatëse të zgjedhjeve.

Disa nga veprat penale të këtij Kapitulli, kanë edhe format e rënda apo të cilësuar, të cilat konsiderohen se kryhen nëse format themelore të këtyre veprave penale janë kryer me përdorimin e forcës apo kanosjes serioze, apo këto vepra penale i ka kryer anëtari i komisionit zgjedhor ose ndonjë person tjetër gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare në lidhje me votimin.

Kryes i shumicës së veprave penale kundër të drejtave të votimit mund të jetë çdo person. Mirëpo, disa vepra penale të këtij Kapitulli mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë cilësi të caktuara, si p.sh. veprën penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve, nga neni 214 i KPRK mund ta kryejë vetëm personi zyrtar.⁴

Të gjitha veprat penale të këtij Kapitulli mund të kryhen vetëm me dashje dhe me motive të caktuara politike.

2. Cënimi i së drejtës për të kandiduar⁵

E drejta e votës përfshinë të drejtën aktive të votës dhe të drejtën pasive të votës. E drejta aktive e votës nënkupton të drejtën e qytetarëve që kanë arritur moshën madhore që të votojnë në zgjedhjet që mbahen në Republikën e Kosovës, kurse e drejta pasive e votës nënkupton të drejtën e qytetarëve që kandidohen për t'u zgjedhur në pozita të caktuara. E drejta e votës është e garantuar me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës⁶ dhe të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës,⁷ i cili është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.⁸ Duke u bazuar në këto dispozita ligjore, shfrytëzimi i të drejtës së votës është i garantuar edhe me dispozitat e legjislacionit penal të Republikës së Kosovës, përkatësisht me dispozitat e KPRK.⁹

⁴ Veprat e tilla penale, të cilat mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë cilësi të caktuara (p.sh. personi zyrtar), në të drejtën penale quhen "*delicta propria*". Shala, Afrim, *Hyrje në të drejtën penale*, Botimi i dytë, Gjilan, 2013, faqe 45.

⁵ Neni 210, KPRK.

⁶ Ligji Nr.03/L-072 Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, i datës 05.06.2008 (Në tekstin e mëtejshëm LZLRK).

⁷ Ligji Nr.03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i datës 05.06.2008 (Në tekstin e mëtejshëm LZPRK).

⁸ Ligji Nr.03/L-56 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i datës 29.10.2010.

⁹ Shala, Afrim, *Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore*, Gjilan, 2010, fq.128.

Vepra penale cenimi i së drejtës për të kandiduar është një vepër e re penale që është parashikuar në KPRK dhe përmes kryerjes së kësaj vepre penale cenohet e drejta pasive e votës.

Sipas paragrafit 1 të nenit 210 të KPRK, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që në mënyrë të kundërligjshme parandalon ose pengon ndonjë person nga kandidimi në zgjedhje.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në ndërmarrjen e veprimeve të atilla të kundërligjshme me anë të të cilave një person parandalohet ose pengohet nga kandidimi në zgjedhje.

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale është e drejta për tu kandiduar në zgjedhje.

Pasojë e kësaj vepre penale është parandalimi ose pengimi i një personi nga kandidimi në zgjedhje, përkatësisht pamundësia e një personi që të kandidojë në zgjedhje.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 210 të KPRK. Sipas kësaj dispozite ligjore, forma e rëndë e kësaj vepre penale ekziston në rastet kur forma themelore e kësaj vepre penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer me përdorim të forcës¹⁰ apo kanosjes serioze, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

3. Kanosja e kandidatit¹¹

Një vepër tjetër e re penale që është parashikuar në këtë Kapitull të KPRK është edhe kanosja e kandidatit. Sipas paragrafit 1 të nenit 211 të KPRK, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që në mënyrë të kundërligjshme detyron ndonjë kandidat që të tërheq kandidaturën e tij.

¹⁰ Sipas nenit 120 paragrafi 15 të KPRK, forcë, përveç tjerash konsiderohet edhe zbatimi i hipnozës ose të mjeteve të tjera dehëse me qëllim të vënies së personit kundër dëshirës së vet në gjendje të pavetëdijshme apo të paaftësohet për rezistencë.

¹¹ Neni 211 i KPRK.

Veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsiston në ndërmarrjen e veprimeve të atilla të kundërligjshme me anë të të cilave kryesi e detyron ndonjë kandidat që të tërheqë kandidaturën e tij. Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush në mënyrë të kundërligjshme e parandalon ose e pengon ndonjë kandidat nga ushtrimi i ndonjë veprimtarie gjatë fushatës elektorale.

Objekt mbrojtës i kësaj forme të kësaj vepre penale është ushtrimi i lirë dhe i papenguar i ndonjë veprimtarie elektorale të ndonjë kandidati gjatë fushatës elektorale.

Veprimi me të cilin kryhet kjo formë e kësaj vepre penale është parandalimi ose pengimi i ndonjë kandidati që të ushtrojë ndonjë veprimtari gjatë fushatës elektorale.¹²

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Ndërsa, formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur format e kësaj vepre penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhen me përdorim të forcës apo kanosjes serioze. Pra, kjo formë e rëndë e kësaj vepre penale konsiderohet se është kryer nëse kryesi në mënyrë të kundërligjshme me përdorimin e forcës ose të kanosjes serioze detyron ndonjë kandidat që të tërheq kandidaturën e tij ose me përdorimin e forcës ose të kanosjes serioze në mënyrë të kundërligjshme e parandalon ose e pengon ndonjë kandidat nga ushtrimi i ndonjë veprimtarie gjatë fushatës elektorale.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet. Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

4. Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar¹³

Formën themelore të veprës penale parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të

¹² Salihu Ismet, Zhitija Hilmi & Hasani Fejzullah, *Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar*, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq. 574.

¹³ Neni 212, KPRK.

votuar, sipas paragrafit 1 të nenit 212 të KPRK, e kryen kushdo që gjatë ushtrimit të detyrave të besuara lidhur me zgjedhjet, në mënyrë të kundërligjshme dhe me qëllim të pengimit të personit tjetër nga ushtrimi i së drejtës së tij për të votuar, nuk e regjistron personin e tillë në listën e regjistrimit të votuesve ose e heq personin e tillë nga lista e regjistrimit të votuesve.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në mos regjistrimin e personit në listën e regjistrimit të votuesve ose heqja e personit të tillë nga lista e regjistrimit të votuesve nga kryesi në mënyrë të kundërligjshme.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tre vjet.

Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje, e cila në vete përfshin edhe qëllimin e pengimit të personit tjetër nga ushtrimi i së drejtës së tij për të votuar.

Kryes i kësaj forme të veprës penale mund të jetë vetëm personi të cilit i janë besuar detyra të caktuara gjatë zgjedhjeve.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se është kryer në rastet kur kryesi gjatë votimit ose referendumit, në mënyrë të kundërligjshme parandalon, pengon ose ndikon në përcaktimin e lirë të votuesit ose në ndonjë mënyrë tjetër pengon personin tjetër në ushtrimin e së drejtës së tij për të votuar.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim deri në një vit.

Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe kryes i saj mund të jetë çdo person.

Ndërsa, forma e rëndë e kësaj vepre penale, e parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, ekziston në rastet kur veprën penale nga paragrafët 1 ose 2 të këtij neni, kryesi e kryen me përdorim të forcës apo kanosjes serioze.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

Duke u bazuar në këto dispozita ligjore, në nenin 213 të KPRK, është parashikuar edhe si vepër penale cenimi i përcaktimit të lirë të votuese. Sipas

kësaj dispozite ligjore, këtë vepër penale e kryen kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, ose me keqpërdorim të varësisë ekonomike dhe profesionale të votuesit ndikon ose detyron votuesin në Republikën e Kosovës që të votojë në mënyrë të caktuar ose të mos votojë në zgjedhje.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale konsistojnë në ndikimin mbi vullnetin e votuesit ose detyrimin e tij për të votuar në mënyrën e caktuar ose për të mos votuar në zgjedhje.

Mjete të kryerjes së kësaj vepre penale janë përdorimi i forcës, kanosjes serioze, keqpërdorimi i vartësisë ekonomike apo profesionale. Vepra penale konsiderohet se është kryer në rastet kur personi ndaj të cilit është ushtruar dhuna, kanosja serioze, keqpërdorimi i vartësisë ekonomike apo profesionale, nën ndikimin e këtyre mjeteve ka votuar në mënyrën e caktuar ose nuk ka votuar.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person dhe kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

6. Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve¹⁴

Sipas nenit 214 të KPRK, këtë vepër penale e kryen çdo person zyrtar të cilit i janë besuar detyra lidhur me zgjedhjet, i cili e keqpërdor pozitën, detyrën apo autoritetin e tij duke urdhëruar, këshilluar ose kryer ndonjë vepër të kundërligjshme me qëllim të ndryshimit apo ndikimit të listës së regjistrimit të votuesve ose votimit të cilitdo person ose në ndonjë mënyrë tjetër vepron me qëllim që të ndryshojë, ndikojë ose pengojë ndonjë person nga ushtrimi i të drejtës së tij për të votuar, për të mos votuar, për të hedhur një votë të pavlefshme ose për të votuar në favor apo kundër një personi ose propozimi të caktuar.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej dy deri në pesë vjet.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person zyrtar të cilit i janë besuar detyra lidhur me zgjedhjet në Republikën e Kosovës.

¹⁴ Neni 214, KPRK.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, e cila në vete përfshin edhe qëllimin e cekur më lartë.

7. Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin¹⁵

Sipas paragrafit 1 të nenit 215 të KPRK, veprën penale dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin e kryen kushdo që premtion, ofron ose jep ndonjë përfitim ose dhuratë të pamërituar ndonjë personi, me qëllim që të ndikojë atë person për të votuar, për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë premtimi, ofrimi ose dhënia e ndonjë përfitimi ose dhurate të pamërituar ndonjë personi.

Kjo formë e kësaj vepre penale konsiderohet se është në momentin e dhënies së premtimit, ofrimit ose dhënies së ndonjë përfitimi ose dhurate të pamërituar ndonjë personi.

Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe me qëllim të ndikimit tek personi tjetër për të votuar, për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 215 të KPRK. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se formën e dytë të kësaj vepre penale e kryen kushdo që kërkon ose pranon ndonjë përfitim ose dhuratë të pamërituar për vete ose për ndonjë person tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për përfitim apo dhuratë të tillë, për të votuar ose për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsistojnë në kërkimin ose pranimin e ndonjë përfitimi ose dhurate të pamërituar për vete ose për ndonjë person tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për përfitim apo dhuratë të tillë.

¹⁵ Neni 215, KPRK.

Kjo formë e kësaj vepre penale konsiderohet se kryhet në momentin e kërkimit ose pranimit të ndonjë përfitimi ose dhurate të pamërituar për vete ose për ndonjë person tjetër. Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe me qëllim për të votuar ose për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

Formë e veçantë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të nenit 215 të KPRK. Këtë formë të kësaj vepre penale e kryen personi i cili shërben si ndërmjetësues dhe shkel paragrafin 1 ose 2 të këtij neni.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

Ndërsa, forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 4 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston në rastet kur vepra penale nga paragrafët 1 deri 3 të këtij neni kryhet nga anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare në lidhje me votimin.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre deri në pesë vjet.

Në paragrafin 5 të këtij neni, është parashikuar se dhurata duhet të konfiskohet.

Formën e rëndë të kësaj vepre penale, mund ta kryejë vetëm anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër gjatë ushtrimit të detyrave në lidhje me votimin, kurse format tjera të kësaj vepre penale mund ti kryejë çdo person.

8. Keqpërdorimi i të drejtës së votimit¹⁶

Sipas legjislacionit në fuqi, qytetari i Republikës së Kosovës, ka të drejtë që të votojë vetëm një herë gjatë zgjedhjeve. Gjithashtu, ai ka të drejtë që të votojë vetëm në emër të tij dhe ta shfrytëzojë vetëm një listë të votimit. Kështu, mosrespektimi i këtyre rregullave konsiderohet vepër penale sipas nenit 216 të KPRK dhe emërtohet “Keqpërdorimi i të drejtës së votimit”. Sipas kësaj dispozite ligjore, këtë vepër penale e kryen kushdo që kryen një ose më shumë

¹⁶ Neni 216, KPRK.

nga veprat në vijim :

1. Voton ose tenton të voton në emër të personit tjetër;
2. Voton ose tenton të voton edhe pse ka votuar një herë ose
3. Shfrytëzon më shumë se një listë votimi.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në rastet kur kryesi voton në emër të personit tjetër ose tenton që të votojë në emër të personit; voton edhe pse ka votuar më parë (voton për herë të dytë) ose tenton të voton edhe pse ka votuar një herë më parë, ose shfrytëzon më shumë se një listë votimi.

Kryerës i formës themelore të kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

Forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 nenit 216 të KPRK, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur anëtari i Komisionit Zgjedhor i mundëson tjetrit të kryej ose të tentojë të kryej veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsistojnë në mundësimin nga ana e anëtarit të Komisionit Zgjedhor për të kryer formën themelore të kësaj vepre penale nga ana e personit tjetër.

Kryes i kësaj forme të veprës penale mund të jetë vetëm anëtari i Komisionit Zgjedhor.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre deri në pesë vjet.

9. Pengimi i procesit të votimit¹⁷

Formën themelore të veprës penale pengimi i procesit të votimit, sipas paragrafit 1 të nenit 217 të KPRK, e kryen kushdo që në mënyrë të kundërligjshme pengon ose ndërpre në procesin e votimit.

Veprimet e kësaj forme të veprës penale konsistojnë në ndërmarrjen e veprimeve

¹⁷ Neni 217, KPRK.

të kundërligjshme me anë të të cilave pengohet ose ndërprehet procesi i votimit.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në dy vjet.

Forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur kryesi me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, pengon votimin me nxitje të prishjes së rendit publik në qendrën e votimit, që rezulton me ndërprerje në procesin e votimit, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tre vjet.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

10. Cenimi i fshehtësisë së votimit¹⁸

Në paragrafin 2 të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është garantuar fshehtësia e votës. Ndërsa, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, cenimi i fshehtësisë së votimit në KPRK, është parashikuar si vepër penale. Kështu, sipas paragrafit 1 të nenit 218 të KPRK, këtë vepër penale e kryen kushdo që në zgjedhje ose në referendum cenon fshehtësinë e votimit.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale konsistojnë në cenimin e fshehtësisë së votimit në zgjedhje ose në referendum.

Për formën themelore të kësaj vepre penale të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, është parashikuar dënimi me burgim deri në gjashtë muaj.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush me përdorimin e forcës, kanosjes serioze ose në ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme kërkon nga personi të tregojë se si ka votuar.

Mjete të kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë përdorimi i forcës, kanosjes serioze ose ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme. Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim deri në një vit.

Në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar forma edhe më e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston nëse veprën penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni e kryen anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person

¹⁸ Neni 218, KPRK.

tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij në zgjedhje ose në votim.

Për këtë formë të rëndë është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, përveç formës më të rëndë të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, të cilën mund ta kryejnë anëtari i Komisionit Zgjedhor ose personi tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij në zgjedhje ose në votim.

11. Falsifikimi i rezultateve të votimit¹⁹

Sipas paragrafit 1 të nenit 219 të KPRK, formën themelore të veprës penale falsifikimi i rezultateve të votimit e kryen personi i cili shton, heq apo fshin votat apo nënshkrimet, regjistron në mënyrë të pasaktë votën apo rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore ose publikon votën apo rezultatet e zgjedhjeve apo të votimit që nuk i përgjigjen votimit të vërtetë, ose në ndonjë mënyrë tjetër falsifikon votën apo rezultatet e zgjedhjeve.

Siç po shihet veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe kjo formë e kësaj vepre penale konsiderohet se kryhet nëse ndërmerret ndonjëri nga veprimet e cekura më lartë. Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tre vjet.

Forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston në rastet kur veprën penale nga paragrafi 1 të këtij neni e kryen anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij lidhur me zgjedhjet. Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre deri në pesë vjet.

Formën themelore të kësaj vepre penale mund ta kryejë çdo preson, kurse formën e rëndë të kësaj vepre penale mund ta kryejë vetëm anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij lidhur me zgjedhjet.

¹⁹ Neni 219, KPRK.

12. Asgjësimi i dokumenteve të votimit²⁰

Formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të nenit 220 të KPRK, e kryen çdo person i cili i asgjëson, fsheh, dëmton apo e merr fletën e votimit ose ndonjë tjetër send apo dokument lidhur me zgjedhjet ose referendumin.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në asgjësimin, fshehjen, dëmtimin apo marrjen e fletëve të votimit ose të ndonjë sendi tjetër apo dokumenti lidhur me zgjedhjet ose referendumin. Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tre vjet dhe kryes i kësaj forme të veprës penale mund të jetë çdo person.

Forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 220 të KPRK. Kjo formë e rëndë e kësaj vepre penale konsiderohet se kryhet në rastet, kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij lidhur me zgjedhjet.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre deri në pesë vjet dhe kryes i kësaj forme të veprës penale mund të jetë anëtari i komisionit zgjedhor ose ndonjë person tjetër i cili e keqpërdor detyrën, pozitën apo autorizimet e tij lidhur me zgjedhjet.

13. Përfundimi

Kapitulli XVII në të cilin janë parashikuar veprat penale kundër të drejtave të votimit konsiderohet njëri ndër kapitujt më të rëndësishëm në pjesën e posaçme të KPRK. Një numër i konsiderueshëm i këtyre veprave penale të këtij Kapitulli, konsiderohen si vepra të reja penale, ngase nuk kanë qenë të parashikuara si të tilla në legjislacionin e mëparshëm penal.

Veprat penale kundër të drejtave të votimit kryhen me motive politike, ngase janë të ndërlidhura me zgjedhjet që zhvillohen në Republikën e Kosovës. Këto vepra penale mund të kryhen si gjatë zgjedhjeve lokale (duke përfshirë këtu edhe zgjedhjet për kryetar të komunave), ashtu edhe gjatë zgjedhjeve të përgjithshme.

Siç është cekur edhe më parë, këto vepra penale janë cilësuar si krime të rënda

²⁰ Neni 220, KPRK.

dhe për gjykimin e tyre në shkallë të parë është kompetent Departamenti i Krimeve të Rënda i gjykatave themelore, ndërsa në shkallë të dytë është kompetent Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

Kohëve të fundit, këtyre veprave penale i është kushtuar një vëmendje e posaçme nga institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare, për faktin se janë inicuar një numër i konsiderueshëm i procedurave penale ndaj personave që dyshohet se kanë kryer vepra penale të këtyre natyrave gjatë zgjedhjeve të fundit në Republikën e Kosovës.

Kryerës të këtyre veprave penale parimisht mund të jetë çdo person, mirëpo disa forma të këtyre vepra penale mund t'i kryejnë vetëm anëtarët e Komisioneve Zgjedhore ose personat tjerë në keqpërdorim të detyrave, pozitive apo autorizimeve të tyre në zgjedhje ose në votim.

Sa i përket kohës së kryerjes, këto vepra penale mund të kryhen si para, ashtu edhe gjatë zgjedhjeve (gjatë procesit të votimit dhe numërimit të votave).

BIBLIOGRAFIA

I. Literatura:

Elezi, Ismet; Kaçupi, Skender; Haxhia, Maksim : Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2001.

Elezi, Ismet : E drejta penale, Pjesa e posaçme, Tiranë, 2013. Hajdari, Azem : Procedura penale, Komentari, Prishtinë, 2009.

Luarasi, Aleks : Kodi penal me praktikë gjyqësore, Botimi i parë, Tiranë, 2003.

Muçi, Shefqet : E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2006.

Salihu, Ismet : E drejta penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2014. Salihu, Ismet : E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2014.

Salihu, Ismet; Zhitija, Hilmi; Hasani, Fejzullah : Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentari, Botimi I, Prishtinë, 2014.

Sahiti, Ejup : E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005.

Smibert, Jon : Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë, 2013.

Shala, Afrim : Ankesa kundër aktgjykimit në procedurë penale, Prishtinë, 2010.

Shala, Afrim : Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, Gjilan, 2010.

Shala, Afrim : Përmbledhje e ligjëratave nga "E drejta penale I", Gjilan, 2010.

Shala, Afrim : Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Moduli Trajnues, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2012 (bashkëautor).

Shala, Afrim : Hyrje në të drejtën penale, Botimi i dytë, Gjilan, 2013.

II. Akte juridike:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Kodi i Procedurës Penale.

Ligji Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

Ligji Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Ligji Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Ligji për Gjykatat.

III. Burime tjera:

www.kqz-ks.org (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve)

*Mr.sc. Agim Maliqi**

NJË KOMENTIM I SHKURTËR I SHQYRTIMIT FILLESTAR DHE SHQYRTIMIT TË DYTË SIPAS DISPOZITAVE TË KODIT TË PROCEDURËS PENALE

ABSTRAKT

Në këtë punim janë komentuar dispozitat që rregullojnë shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë sipas Kodi të Procedurës Penale (Kodi nr.04/L-123)¹, i cili ka hyrë në fuqi nga 1 janari i vitit 2013.

Komentimi i këtyre dispozitave është i rëndësishëm për faktin se jo rrallë herë mundësohet shmangia e një procesi të rregullt gjyqësor, përkatësisht rritet mundësia e përmbylljes së një faze të procedurës (shqiptimi i dënimit) qysh në këtë fazë, apo edhe mundësia e hedhjes së aktakuzës që po ashtu përmbyllet çështja konkrete. Këto dispozita u mundësojnë palëve në procedurë (prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe të dëmtuarit) të jenë aktivë e që gjithsesi edhe gjykatës i jep mundësinë që të ketë rolin e saj pro aktiv në kontrollin e aktakuzës.

Komentimi i dispozitave ligjore është bërë për çdo nen duke filluar nga shqyrtimi fillestar, për të vazhduar me pranimin e fajësisë dhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë, kundërshtimin e provave, kërkesën për hedhjen e aktakuzës.

Gjithashtu mjaft gjerësisht janë komentuar dispozitat ligjore duke specifikuar kushtet dhe rastet e hedhjes së aktakuzës, shqyrtimin e dytë, shqyrtimet për përcaktimin e vlefshmërisë së propozimeve për të përfunduar me paraqitjen e materialeve nga mbrojtja.

Po ashtu, punimi përmban përfundimin dhe literaturën e cila është përdorur për realizimin e këtij punimi.

Fjalët kyçe: KPP, shqyrtimi fillestar, shqyrtimi i dytë, pranimi i fajësisë, kundërshtimi i provave.

1. Shqyrtimi fillestar²

1. Gjatë shqyrtimit fillestar duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit.

* Autori i këtij punimi është gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, Departamenti i Krimeve të Rënda.

¹ Më tutje do të referohemi me termin Kod apo KPP.

² Neni 245, KPPK

Është e rëndësishme të potencohet se në shqyrtimin fillestar është paraparë prania e prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit, që është e natyrshme dhe që përmbushë standardin minimal për një shqyrtim fillestar.

Prania e prokurorit të shtetit³ është e pashmangshme dhe kushtëzohet me faktin se pa praninë e tij nuk mund të zhvillohet shqyrtimi fillestar, meqë pos faktit se është palë në procedurë⁴ ka kompetenca edhe në përfaqësimin e aktakuzës gjatë të gjitha fazave të procedurës penale para gjykatave.

Po ashtu gjatë shqyrtimit fillestar është e domosdoshme edhe prezenca e të pandehurit, e që cilësinë e të pandehurit në procedurë penale mund ta fitoj çdo person fizik i cili posedon aftësinë për të vepruar, gjegjësisht personi që ka moshën e caktuar dhe që është i përgjegjshëm⁵ meqë Kodi nuk lejon zhvillimin e shqyrtimit fillestar e as gjyqësor në mungesë të pandehurit “in absentia”. Mos gjykimi në mungesë i të pandehurit edhe pse nuk është shkruar në mënyrë eksplicite⁶, por bazuar në konceptin që është ndërtuar Kodi ka përjashtuar mundësinë e gjykimit në mungesë duke u bazuar në rolin aktiv që i ka dhënë të pandehurit në procedurë.⁷ Gjithsesi duhet theksuar se gjykimi në mungesë është një koncept i tejkualuar dhe tani pothuajse me disa përjashtime të vogla është braktisur nga shumica e legjislacioneve penale evropiane dhe për më tepër është në kundërshtim edhe me parimet e KEDLNJ⁸ e cila zbatohet drejtpërdrejt⁹ në legjislacionin tonë.

Por, prania e mbrojtësit nuk duhet kuptuar se duhet të jetë e domosdoshme pos rasteve të mbrojtjes së detyruar¹⁰ apo rasteve të mbrojtjes me shpenzime publike, atëherë kur mbrojtja nuk është e detyruar¹¹ por e cila sigurohet sipas kërkesës së të akuzuarit nën kushtet e përcaktuara. Kodi nuk ka paraparë mënyrën se si do të sigurohet prezenca e palëve të cilët marrin pjesë në shqyrtimin fillestar, por gjithsesi kjo duhet të nënkuptohet se duhet zbatuar dispozitat e thirrjes për shqyrtimin gjyqësor.

Një çështje e rëndësishme që duhet analizuar është fakti se në shqyrtimin fillestar nuk është e paraparë prezenca e të dëmtuarit. Kjo është interesante

³ Kompetencat e prokurorit të shtetit janë përkufizuar me nenin 7 të Ligjit të Prokurorit të Shtetit dhe neni 49 i KPP-së

⁴ Nenin 19 par.1.15 i KPP-së

⁵ Hajdari, Azem, *Procedura penale* – Komentar, Prishtinë, 2010, faqe 155

⁶ Kodi i Procedurës së Bosnjës dhe Hercegovinës ndalon me dispozitë të posaçme gjykimin në mungesë.

⁷ Neni 232, KPPK

⁸ Neni 6 pika 1 dhe 3 pika d, KEDNJ

⁹ Neni 22, Kushtetuta së Republikës së Kosovës

¹⁰ Neni 57, KPPK

¹¹ Neni 58, KPPK

sidomos duke pasur parasysh faktin se roli i të dëmtuarit është fuqizuar dukshëm me këtë Kod, se i dëmtuari ka rolin e palës,¹² për më tepër kjo dispozitë po të analizohet në aspektin sistematik, është në kundërshtim me nenin 248 par.2 të Kodit ku përcaktohet se “ në vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit”¹³ dhe kjo domosdo paraqet një pyetje të logjikshme se si mund të merret mendimi i të dëmtuarit pa qenë i pranishëm.

Andaj, për tu tejkaluar kjo situatë është e domosdoshme që i dëmtuari gjithsesi të thirret në shqyrtimin fillestar sidomos duke marrë parasysh faktin se nëse i pandehuri pranon fajësinë duhet ti jepet mundësia që i dëmtuari të deklarohet përkitazi me llojin dhe lartësinë e kërkesës pasurore-juridike.

Kurse mundësia e dytë do të ishte që të përfundohet shqyrtimi fillestar dhe të caktohet një seancë tjetër për vërtetimin e ndonjë fakti relevant për dënimin¹⁴. Pastaj në këtë seancë, i dëmtuari do të kishte mundësi të paraqiste propozimin e tij për kërkesën pasurore juridike, meqë edhe kërkesa pasurore juridike do të mund të paraqiste fakt relevant për dënimin për të përcaktuar llojin dhe lartësinë e dënimit.

Sidoqoftë nëse në këtë fazë bëhet shqiptimi i dënimit, atëherë domosdoshmërisht duhet të jetë prezent i dëmtuari meqë këtu edhe përfundon mundësia e tij të paraqes kërkesë pasurore juridike gjatë procedurës penale pos nëse i dëmtuar ka paraqitur deklaratë të dëmit.¹⁵

2. Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i jep kopjen e aktakuzës të pandehuri apo të pandehurve, nëse ata nuk i kanë pranuar këto kopje të aktakuzës më parë.

Ky paragraf është i karakterit mjaft teknik dhe nuk është aspak e preferueshme që kështu të ndodhë për arsye se: e domosdoshme do të ishte që dorëzimi i aktakuzës të bëhej para seancës fillestare dhe kjo me qëllim të faktit se pranimi i aktakuzës paraqet një parakusht të rëndësishëm që i pandehuri të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë e tij. Pra, do të ishte jo reale që të pritët nga i pandehuri që menjëherë pasi të pranoj aktakuzën të deklarohet lidhur me fajësinë siç parashihet në seancën fillestare, andaj do të ishte shumë e rëndësishme që së bashku me thirrje për shqyrtimin fillestar të bashkëngjitet

¹² Neni 19 par.1.15 dhe neni 62 par.1 nënpar.1.3, KPPK

¹³ Neni 248, par.2, KPPK.

¹⁴ Neni 248, par.4, KPPK.

¹⁵ Neni 218, KPPK.

edhe aktakuza ashtu siç është paraparë për shqyrtimin gjyqësor jo më vonë se tetë (8) ditë¹⁶ e cila do të krijonte parakushte të përshtatshme për procedim të suksesshëm të shqyrtimit fillestar.

3. Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues vendos për të gjitha propozimet për të vazhduar apo zbatuar masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit.

Kjo paraqet një fakt interesant dhe është në frymën e parimit se masat e sigurisë së pranisë së të pandehurit janë të nevojshme të trajtohen në çdo fazë të procedurës, meqë bazat dhe kushtet e masave mund të ndryshojnë pas ngritjes së aktakuzës. Arsyeshmëria e shqyrtimit të këtyre masave është e rëndësishme edhe për dy arsye:

- së pari është e rëndësishme për faktin se në shqyrtimin fillestar janë prezent palët dhe aty mund ti paraqesin pikëpamjet e tyre për këto masa dhe
- e dyta me përfundimin e fazës së hetimit fillon faza e ngritjes së akuzës dhe kjo mund të ndryshoj bazat por edhe kushtet për vazhdimin apo zbatimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit.

Gjithsesi është e rëndësishme të potencohet fakti se Kodi nuk ka paraparë ndarje të masave së sigurimit të pranisë së të pandehurit para dhe pas paraqitjes së aktakuzës, përkatësisht nëse një masë është caktuar para ngritjes së aktakuzës mbetet në fuqi edhe pas ngritjes së saj deri te skadimi i kësaj mase, pra me një fjalë është braktisur koncepti që çdo masë e caktuar apo e vazhduar gjatë procedurës hetimore të shqyrtohet obligativisht pas ngritjes së aktakuzës dhe ku vendosej të vazhdohet apo hiqet ajo masë (siç veprohej me ish KPPK), por tani më Kodi ka përcaktuar që sa u përket masave për vazhdimin apo zbatimin e sigurimit të pranisë së të pandehurit të vendoset në shqyrtimin fillestar dhe atë sipas propozimit të palëve në procedurë, por është i rëndësishëm fakti se detyrimi për marrje në pyetje të të arrestuarit- të paraburgosurit buron nga parimi i njohur Habeas Corpus, sipas të cilit personi i arrestuar- paraburgosur duhet të dëgjohet nga gjyqtari dhe ky është një rregull i njohur përgjithësisht nga legjislacionet e shteteve dhe i zbatuar edhe nga Gjykata Ndërkombëtare Penale.¹⁷

Por duhet të qartësohet fakti se përkitazi me masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit mund të vendoset edhe para fillimit të shqyrtimit fillestar dhe atë në dy raste: në rastin e parë kur masa e tillë skadon pas paraqitjes së aktakuzës dhe

¹⁶ Neni 287 par.3, KPPK.

¹⁷ Islami Halim, Hoxha Artan & Panda Ilir, Procedura Penale, Tiranë, 2012, fq. 352.

para mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe rasti i dytë është kur në aktakuzën¹⁸ e paraqitur nga ana e prokurorit të shtetit është paraqitur edhe propozimi për urdhërimin e paraburgimit (kur i pandehuri gjendet në liri) apo është propozuar që i pandehuri që gjendet në paraburgim të lirohet nga paraburgimi dhe në këto raste nuk duhet që për të vendosur për një masë të tillë të pritet shqyrtimi fillestar.

4. Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues siguron që prokurori i shtetit të ketë përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 i këtij Kodi.

Kjo paraqet një detyrë të gjykatës që të kujdeset që prokurori i shtetit të përmbushë detyrimet për zbulimin e provave, nga neni 244 dhe atë jo më vonë se ngritja e aktakuzës që mund të i dorëzohen edhe para kësaj përkatësisht gjatë hetimeve.

Edhe vet dispozita e nenit 244 është jo e qartë dhe deri sa titulli i saj përshkruan “materialet të cilat i jepen të pandehurit me ngritjen e aktakuzës”,¹⁹ kurse e gjithë dispozita i referohet mbrojtësit të të pandehurit (përjashtoj paragrafin 2 të këtij neni) sidoqoftë kjo mund të shkaktoj paqartësi se kujt duhet dorëzuar materialet e hetimeve të pandehurit apo mbrojtësit por kjo duhet lexuar në atë mënyrë që është obliguese që materialet hetimore ti jepen të pandehurit dhe kjo nënkupton se përmbushet detyrimi.

Po ashtu paqartësia tjetër që mund të shkakton konfuzion janë edhe vet shprehjet e përdorura deri sa titulli i saj përdorë shprehjen “materialet të cilat i jepen të pandehurit” që nënkuptohet se duhet ti epën të pandehurit, kurse në përshkrimin e dispozitës “Jo më vonë se nga ngritja e aktakuzës, prokurori i shtetit i siguron mbrojtësit apo mbrojtësit kryesor materialet e mëposhtme ose kopjen e tyre të cilat janë në posedim, në kontroll ose në mbrojtje të tij, nëse këto materiale nuk i janë dhënë mbrojtësit gjatë hetimit”,²⁰ ashtu që mbrojtësit i sigurohen këto materiale, e që nënkupton se këto materiale vetëm i sigurohen në kopje të mjaftueshme që nënkuptohet se i vihen në dispozicion dhe se me këtë edhe përfundon obligimi i prokurorit të shtetit dhe nëse mbrojtësi e sheh të nevojshme mund ti merr ato.

Nga kjo shtrohet një pyetje e logjikshme se çka do të ndodhë nëse të pandehurit nuk i janë dhënë provat kurse mbrojtësit nuk iu kanë siguruar provat sipas nenit 244 të KPP-së. Kjo situatë nuk është rregulluar me ndonjë dispozitë përkatëse, por atëherë sigurisht se gjykata duhet të obligoj prokurorin e shtetit dorëzimin e tyre brenda një afati të përcaktuar nga gjykata (afat gjyqësor) dhe ky afat

¹⁸ Neni 241, par.2, KPPK.

¹⁹ Neni 244, par.1, i KPPK.

²⁰ Neni 244, par.1, i KPPK.

duhet të jetë i arsyeshëm duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes si dhe sasinë e materialeve që duhet dorëzuar e që do të ishte e arsyeshme ndërprerja e seancës me qëllim që pas sigurimit të tyre të vazhdohet me këtë shqyrtim duhet potencuar se edhe kjo nuk është paraparë me dispozitë të veçantë por duhet përshtatshmërisht të aplikohen dispozitat e shqyrtimit gjyqësor.

5. Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar.

Në këtë dispozitë janë dy mundësi, e para në rastet kur në shqyrtimin fillestar nuk vie deri te pranimi i fajësisë, atëherë caktohet shqyrtimi i dytë brenda afateve të përcaktuara. Mundësia e dytë është që të mund të kërkohej paraqitja e propozimeve që nënkuptohet se propozimet duhet të bëhen nga të dy palët edhe prokurori edhe mbrojtësi apo i pandehuri jo më vonë se 30 ditë nga shqyrtimi fillestar dhe kjo shmang shqyrtimin e dytë. Pra mes këtyre shqyrtimeve janë përcaktuar afate strikte dhe kjo me qëllim të efikasitetit të procedurës.

Duhet qartësuar se këto mundësi përjashtojnë njëra-tjetrën dhe përkundër faktit se janë lënë në dispozicion dy mundësi është vështirë të përcaktohet se cila mundësi do të ishte më e mirë dhe më efikase, por sipas praktikës së deritashme gjyqësore vërehet se shumica e gjykatave kanë aplikuar mundësinë e parë përkatësisht kanë caktuar dhe mbajtur shqyrtimin e dytë, për të vendosur lidhur me kundërshtimet dhe kërkesat e paraqitura.²¹

Megjithatë konsideroj se afati jo më herët se 30 ditë për caktimin e shqyrtimit të dytë është afat tejet i gjatë dhe ky afat po të ishte më i shkurtër do të ishte në funksion të efikasitetit të procedurës.

6. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues njofton të pandehurin dhe mbrojtësin se para shqyrtimit të dytë, ata duhet që:

- 6.1. të paraqesin kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë;
- 6.2. të paraqesin kërkesat për hedhjen e aktakuzës nëse është e ndaluar ligjërisht; dhe
- 6.3. të paraqesin kërkesat për hedhjen e aktakuzës për shkak të mos përshtimit të veprës penale sipas ligjit.

²¹ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep, *E drejta e Procedurës Penale*, Prishtinë, 2013, fq. 346.

Kjo është e rëndësishme për faktin se para shqyrtimit të dytë këto kundërshtime dhe kërkesa duhet ti ketë në dispozicion prokurori i shtetit, me qëllim që të mund tu përgjigjet këtyre pretendimeve qoftë përmes formës së shkruar kur nuk ka shqyrtim të dytë, apo këtyre pretendimeve të përgjigjet në mënyrë gojore gjatë shqyrtimit të dytë. Por duhet të jetë e qartë se kundërshtimi mund të paraqitet për provat në aktakuzë dhe tek më vonë paraqiten provat nga mbrojtja apo i pandehuri që shqyrtohen gjatë shqyrtimit të dytë.

7. Asnjë dëshmitar apo ekspert nuk merret në pyetje dhe asnjë provë nuk paraqitet gjatë shqyrtimit fillestar, përveç nëse dëshmitari është i nevojshëm për marrjen e vendimit mbi vazhdimin ose zbatimin e masave për të siguruar praninë e të pandehurit nga paragrafi 3. të këtij neni.

Siç u tha edhe më lartë gjatë shqyrtimit fillestar parimisht nuk prezantohet asnjë provë, përkatësisht nuk dëgjohen dëshmitar apo ekspert, por përjashtimisht kjo mund të bëhet nëse kjo është e nevojshme për vazhdimin ose zbatimin e pranisë së të pandehurit dhe kjo paraqet mundësinë që përmes këtij dëgjimi të vazhdohen përkatësisht hiqen masat e sigurimit të pranisë së të pandehurit edhe pse nuk është specifikuar mendoj se do të ishte e justifikueshme të zbatohet vetëm për masën më të rëndë të sigurimit të prezencës përkatësisht masën e paraburgimit përkatësisht zbatimin të kësaj mase sipas nenit 194-203 të këtij Kodi.

2. Pranimi i fajësisë²²

1. Në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues e udhëzon të pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë; të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij; të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Është e pashpjegueshme se për çfarë arsye në këtë dispozitë fare nuk është paraparë që fillimisht të pandehurit ti merren të dhënat e tij personale,²³ meqë kjo është mjaft e rëndësishme edhe gjatë shqyrtimit fillestar dhe kjo për dy arsye:

- së pari se të dhënat personale janë mjaft të rëndësishme dhe nuk janë thjesht një çështje e karakterit teknik apo ceremonial apo vetëm për të vërtetuar identitetin e tij, por janë çështje mjaft fundamentale meqë përmes

²² Neni 246, KPPK

²³ Neni 321, par.1, KPPK.

këtyre të dhënave gjykata krijon një pasqyrë lidhur me personalitetin dhe karakterin e të pandehurit, gjendjen e tij ekonomike dhe sociale, shkallën e arsimimit dhe të cilat të dhëna janë mjaft të rëndësishme për vendosjen e çështjes;

- kurse rëndësia tjetër e sigurimit të plotë e të dhënave personale të të pandehurit është në rastet kur i pandehuri mund të pranoj fajësinë gjatë këtij shqyrtimi dhe të dhënat personale janë të rëndësishme për individualizimin e dënimit përkatësisht për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Me rastin e udhëzimeve për të drejtat që i jepen të pandehurit, është e rëndësishme që gjyqtari të jetë i kujdesshëm që i pandehuri ti kuptojë ato, meqë këto udhëzime duhet që të jepen në mënyrë të thjeshtë pa terma të tepruar të natyrës juridike dhe në tërësi duhet të përshtaten me nivelin e të akuzuarit si në aspektin e shkallës së arsimit, moshës dhe karakteristikave tjera. Rëndësia e këtyre udhëzimeve është edhe për faktin se të akuzuarit përmes këtyre udhëzimeve i bëhet me dije se është pjesë aktive e shqyrtimit fillestar dhe jo një person që është vetëm formalisht aty.

Është tejet e rëndësishme të potencohet posaçërisht që i pandehuri të udhëzohet përkitazi me të drejtën për të pasur mbrojtës, por në rast se bëhet fjalë për veprën penale ku parashihet mbrojtja e detyruar gjykata paraprakisht kur e vëren se i pandehuri nuk ka mbrojtës para shqyrtimit fillestar ka obligim që ta caktoj mbrojtësin dhe që ti siguron materialet e nevojshme meqë kjo paraqet parakusht për një seancë të suksesshme.

2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues pastaj çmon nëse e drejta e të pandehurit në mbrojtës është respektuar dhe nëse prokurori i shtetit ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 i këtij Kodi.

Kjo dispozitë ka përcaktuar dy detyrime të gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues, dhe atë detyrimi i parë është që të çmoj të drejtën e të pandehurit në mbrojtës, dhe në rastet kur i pandehuri nuk ka angazhuar mbrojtës apo ndërkohë për arsye të ndryshme ka mbetur pa mbrojtës, atëherë gjykata të pandehurit i cakton mbrojtës në rastet kur mbrojtja është e detyruar²⁴. Në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesë të të pandehurit²⁵ dhe gjithsesi është e rëndësishme që nëse gjykata është në dijeni se i pandehuri nuk ka mbrojtës, do të ishte e preferueshme që

²⁴ Neni 57, KPPK.

²⁵ Neni 58, KPPK.

mbrojtësi të caktohet paraprakisht, pra para shqyrtimit fillestar, e për më tepër edhe materialet e hetimeve duhet ti sigurohen mbrojtësit. Ngjashëm është edhe në rastet kur nuk janë përmbushur detyrimet nga neni 244 i KPP-së.

Në të dy këto situata duhet pasur kujdes, përndryshe nëse nuk janë plotësuar këto parakushte atëherë hapet mundësia që të ndër prehet shqyrtimi fillestar dhe të vazhdohet me shqyrtimin fillestar pas krijimit të parakushteve siç përcakton dispozita.

3. Pastaj prokurori i shtetit ia lexon aktakuzën të pandehurit.

Leximi i aktakuzës paraqet një moment të rëndësishëm të shqyrtimit fillestar nga fakti se është momenti kur të pranishmit (bëhet fjalë për publikun dhe personat tjerë) për herë të parë kuptojnë pretendimet e prokurorit të shtetit. Leximi i aktakuzës paraqet në fakt fillimin e shqyrtimit fillestar pasi që pjesa e mësipërme i referohet udhëzimeve të palëve.

4. Pasi që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, të pandehurit i ofron mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm. Nëse i pandehuri nuk e ka kuptuar aktakuzën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues thërret prokurorin e shtetit që t'ia shpjegojë aktakuzën të pandehurit në mënyrë që ai ta kuptojë pa vështirësi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron të bëjë ndonjë deklaram lidhur me fajësinë e tij, konsiderohet se ai nuk e pranon fajësinë.

Është i rëndësishëm të trajtohet momenti që i pandehuri duhet të deklarohet për fajësinë por paraprakisht është e nevojshme që i njëjti ta kuptoj drejt aktakuzën që rëndon mbi të. Kjo shpesh herë paraqet vështirësi të natyrave të ndryshme. Së pari aktakuza mund të jetë e pakuptueshme për të pandehurin dhe i njëjti mund të ketë vështirësi në kuptimin e saj edhe nga fakti se në aktakuzë mund të përdoret terminologji juridike, ashtu që nga kjo arsye pas leximit të aktakuzës duhet dhënë mundësia që prokurori i shtetit i cili ka rol aktiv gjatë shqyrtimit fillestar,²⁶ që ti sqaroj të pandehurit përmbajtjen e aktakuzës. Kjo duhet zbatuar në atë mënyrë që sqarimi ti përshtatet moshës, shkallës së arsimimit, njohurive të përgjithshme të të pandehurit sidomos përqendrimi duhet të jetë tek sqarimi i instituteve juridike siç janë pakujdesia, dashja, lajthimi juridik, lajthimi faktik, bashkëkryerja, shtytja, ndihma etj.

Po ashtu duhet sqaruar në mënyrë të drejtë, të qartë dhe të thjeshtë edhe elementet e veprës penale meqë shpesh herë edhe këtu krijohen shumë paqartësi për të

²⁶ Çollaku Hashim: *Roli i Prokurorit të Shtetit në Procedurën Penale*, Prishtinë, 2013, fq. 134.

pandehurin. Kurse rëndësia e kësaj duhet të ndërlihet me faktin se shpesh here i pandehuri mund të deklaroj edhe formalisht se e kupton aktakuzën por kjo ndodhë shpesh here të jetë deklarim jo i drejtë për arsye të ndryshme: qoftë nga fakti se po të mos kuptonte aktakuzën do ta ndiente veten keq e nganjëherë duhet ndërlihur edhe me faktin se ky deklarim paraqitet para deklarimit për fajësinë dhe për këtë mund të ndikoj edhe fakti se me pranimin e fajësisë do të mund të dënohet më butë, andaj konsideroj se ligjvënësi me të drejtë kërkon që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, të jetë i kujdesshëm me rastin e sqarimit të aktakuzës dhe shpesh here duhet të kërkoj nga prokurori i shtetit që të bëj një sqarim të thjeshtë pa terma të tepruar juridik deri sa të bindet se i pandehuri e kupton drejt dhe e ka të qartë se për çfarë akuzohet.

Mos kuptimi i drejtë dhe i plotë i aktakuzës ka për pasojë faktin se në rast të këtij mos kuptimi paraqet edhe arsye që mbrojtja të jetë e gabuar, gjithsesi duhet të jetë e qartë se mos qartësimi i aktakuzës përkatësisht mos kuptimi i plotë i saj paraqet bazë për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.²⁷

Kurse në rastet që i pandehuri të mos deklarohet për fajësinë dhe atëherë procedohet sikurse i pandehuri të deklarohej i pafajshëm.

3. Marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar²⁸

1. Nëse marrëveshja mbi pranimin e fajësisë nga neni 233 i këtij Kodi paraqitet së bashku me aktakuzën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues çmon marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe e pranon atë, e refuzon atë ose cakton shqyrtim të veçantë në pajtim me procedurat nga neni 248 dhe neni 233 të këtij Kodi.

Në këtë paragraf trajtohet marrëveshja për pranimin e fajësisë e cila është e mundur të paraqitet së bashku me aktakuzën dhe gjykata me këtë rast çmon marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe ka tri mundësi: të pranoj, të refuzoj marrëveshjen ose të caktoj shqyrtim të veçantë lidhur me marrëveshjen e fajësisë. Duhet theksuar faktin se instituti i marrëveshjes për pranimin e fajësisë është një institut relativisht i ri në legjislacionin tonë, kurse aplikimi i tij ka filluar nga viti 2004 dhe ka arritur që të zhvillohet hovshëm e që ka ndikuar mjaft shumë në rritjen e efikasitetit dhe zgjedhjen e një numri të madh të çështjeve penale e që ky institut origjinën e ka nga SHBA, por tani ka gjetur zbatim në shumë vende të rajonit, përkatësisht ky institut është i

²⁷ Neni 384 par.2, KPPK.

²⁸ Neni 247, KPPK.

njohur në KPP të Bosnjës dhe Hercegovinës, në KPP të Kroacisë dhe në KPP të Serbisë.²⁹ Duhet theksuar se Kodi Procedural i Shqipërisë nuk e parasheh një institut të tillë, por në dispozitat e tij ka të përcaktuar një institut të ngjashëm të ashtuquajtur “gjakimin e shkurtuar”, i cili ka disa ngjashmëri me institutin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, meqë iniciativa rrjedhë nga i pandehuri dhe nëse gjykata e pranon gjakimin e shkurtuar e ulë dënimin me gjobë apo me burgim me një të tretën.³⁰

2. Nëse i pandehuri deklarohet i pafajshëm, gjykata nuk mund ta dënojë të pandehurin, përveç nëse i pandehuri e ndryshon deklaratën e tij dhe pranon fajësinë, ose nëse gjykata e shpall fajtor të pandehurin pas shqyrtimit gjyqësor, pavarësisht nga marrëveshja mbi pranimin e fajësisë.

Ekziston mundësia që edhe pas arritjes së marrëveshjes për fajësinë, i pandehuri mund të deklarohet i pafajshëm në shqyrtimin fillestar dhe pas kësaj gjykata nuk mund ta dënojë të pandehurin, por ekziston mundësia që i pandehuri mund edhe më vonë ta pranojë fajësinë por logjikisht pas shqyrtimit gjyqësor mund të pandehurin ta shpall fajtor.

3. Shqyrtimet nga ky kapitull mund të mbahen nën masa të fshehta pas kërkesës së prokurorit të shtetit nga Kapitulli XIII të këtij Kodi.

Pranimi i fajësisë është i rregulluar me Kapitullin e XIII të këtij Kodi, meqë paraqet diçka specifike për të gjitha fazat kur rregullohet marrëveshja e fajësisë, kurse karakteristikë është fakti se shqyrtimet mund të mbahen nën masa të fshehta deri në arritjen e marrëveshjes.

4. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë nga neni 233 i këtij Kodi ose pranimi i fajësisë nga neni 248 i këtij Kodi mund të shqyrtohen nga gjykata në çdo kohë para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë mes palëve si dhe pranimi i fajësisë mund të shqyrtohet në çdo kohë para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Edhe pse kjo dispozitë është përfshirë tek shqyrtimi fillestar megjithatë ka karakter shumë më të gjerë dhe përfshinë fazën prej shqyrtimit fillestar e deri para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor që në fakt dispozita nuk e kufizon mundësinë që i pandehuri të pranojë fajësinë deri para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, por i mbetet gjykatës që këtë pranim ta shqyrtoj. Në praktikën gjyqësore raste të shpeshta të pranimit të fajësisë paraqiten në rastet

²⁹ Çollaku, Hashim, *Roli i Prokurorit të Shtetit në Procedurën Penale*, Prishtinë, 2013, fq. 134.

³⁰ Islami Halim & Hoxha Artan & Panda Ilir, *Procedura Penale*, Tiranë, 2012, fq. 547.

e ndryshimit të aktakuzës, kurse ndryshimi bëhet kur prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton se nga provat e shqyrtuara tregojnë se gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë është ndryshuar,³¹ por duhet theksuar se ndryshimi i aktakuzës shpesh herë rezulton me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, andaj është e nevojshme që pas këtij ndryshimi që i pandehuri edhe një herë të deklarohet lidhur me fajësinë.

4. Pranimi i fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar, neni 248

1. Kur i pandehuri pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës sipas nenit 246 ose 247 të këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton nëse:

1.1. i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit;

1.2. pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i pandehuri ka mbrojtës;

1.3. pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i pandehuri; dhe

1.4. aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Faza më e rëndësishme e shqyrtimit fillestar është momenti pas pranimi të fajësisë së të pandehurit dhe kjo është e rëndësishme për disa arsye dhe atë së pari nga fakti se kushtet e parapara duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe vetëm në këtë rast edhe mund të pranohet pranimi i fajësisë dhe assesi jo në rastet kur pranimi është i pjesërishëm, me dilema ose i paqartë.

Vlerësimi i pranimi të fajësisë është mjaft kompleks dhe shumëdimensional dhe aspak i lehtë për të përcaktuar se a janë apo nuk janë plotësuar kriteret meqë për deri sa disa kriteret janë të matshme kurse disa kriteret tjera janë më shumë të natyrës objektive dhe më vështirë përcaktuese.

Më e rëndësishmja është fakti se pranimi i fajësisë duhet bërë në atë mënyrë që i pandehuri duhet kuptuar natyrën dhe pasojën e pranimi të fajësisë dhe kjo është mjaft komplekse pikërisht nga fakti se i pandehuri duhet të kuptoj aktakuzën që rëndon mbi të, pastaj se me pranimin e fajësisë do të kemi shmangie nga një proces i rregullt gjyqësor përkatësisht se do të jetë një proces më i shkurtër

³¹ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep, *E drejta e Procedurës Penale*, Prishtinë, 2013, fq. 367.

se zakonisht, se privohet nga paraqitja e provave apo të kundërshtoj provat e paraqitura nga prokurori i shtetit se pas kësaj do ti shqiptohet menjëherë dënimi për veprimin e tij, se do të obligohet në përmbushjen e kërkesës pasurore-juridike të dëmtuarit (nëse ka të dëmtuar dhe ka propozim të personave të autorizuar për kërkesë pasurore-juridike), se pasuria e fituar si rezultat i veprës penale do të mund ti nënshtrohet konfiskimit (nëse ka propozim për konfiskim), kurse si pasojë e pranimit të fajësisë paraqet fakti se aktgjykimi nuk mund të atakohet për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike përkatësisht humb njëren bazë për ankesën e aktgjykimit.

Pranimi i fajësisë duhet të bëhet në mënyrë vullnetare, të plotë dhe pa asnjë dilemë për më tepër duhet të jetë i pandehuri i vetëdijshëm për këtë pranim dhe jo që pranimi të arrihet me anë të dhunës, kanosjes, detyrimit, mosdijes, pastaj nëse është i njohur fakti se i pandehuri vuan nga ndonjë sëmundje e përkohshme apo e përhershme mendore dhe preferohet që në shumicën e rasteve pjesëmarrës në të duhet të jetë edhe mbrojtësi i të pandehurit dhe se duhet çmuar edhe faktin se a ka pasur kohë të mjaftueshme për konsultime, pra të gjitha këto elemente janë tejet të rëndësishme në të kundërtën pranimi i fajit do të ishte jo i plotë.

Një pikë tjetër e rëndësishme është se pranimi i fajësisë duhet të mbështetet me prova konkrete edhe pse në fakt formalisht në këtë fazë nuk shqyrtohet asnjë provë megjithatë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, është i detyruar që të bëjë një shqyrtim dhe vlerësim të kuantitetit dhe kualitetit të provave që ka në shkresat e lëndës dhe kjo domosdoshmërisht gjykatën e obligon që të ketë të qartë se a ekziston përgjegjësi penale e të pandehurit, pastaj a ekzistojnë elemente të veprës penale të përshkruar në aktakuzë dhe shumë elemente tjera, e që gjithsesi duhet pasur parasysh edhe faktin se provat duhet çmuar edhe me faktin se a janë prova të pranueshme meqë edhe siç dihet aktgjykimi nuk mundet që të bazohet në prova të papranueshme,³² si dhe duhet ta ketë parasysh provat për përcaktimin e fajësisë,³³ përkatësisht pamjaftueshmërinë e provave për një vendim fajësie.

2. Në vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

Është i rëndësishëm fakti edhe pse jo obligativ i kërkimit të mendimit dhe se kjo mund të jetë e rëndësishme meqë palët nga këndvështrimi i tyre do të

³² Neni 257, par.3, KPPK.

³³ Neni 262, KPPK.

paraqesin argumentet e tyre e që nganjëherë edhe mund të jenë kundërthënëse. Pa dyshim se do të ishte e preferueshme kërkimi i mendimit nga palët meqë gjykata do të kishte një pasqyrë më qartë të ngjarjes dhe pastaj kjo i mbetet çmuarjes së gjykatës dhe duke e ndërlidhur me provat që i ka në dispozicion.

Marrja e mendimit është e rëndësishme edhe për një fakt tjetër se gjykata mund të merr të dhëna të rëndësishme që pastaj të vendosë në lidhje me pranimin apo jo të fajësisë e që në kontest të kësaj bazuar edhe në faktin tjetër se në këtë fazë nuk është paraparë fare fjala përfundimtare, atëherë palët në procedurë mund ti paraqesin pikëpamjet e tyre edhe në lidhje me këtë e që i mundësojnë gjykatës që të ketë një pasqyrë më të qartë për rrethanat e kryerjes së veprës penale, personalitetin e të pandehurit dhe shumë rrethana të tjera të rëndësishme për të individualizuar dënimin gjegjësisht për të përcaktuar llojin dhe lartësinë e dënimit, përkatësisht dënimi konkret që caktohet nga gjykata ndaj autorit të veprës penale.³⁴

3. Kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk bindet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1. i këtij neni, ai merr aktvendim me të cilin refuzon pranimin e fajësisë dhe procedon shqyrtimin fillestar sikur pranimi i fajësisë të mos ishte bërë.

Por përkundër këtyre vështrimeve të provave sipas paragrafit 1, megjithatë gjykata nuk ka ndonjë mundësi tjetër në këtë fazë pos faktit që nëse konstaton se nuk janë vërtetuar faktet e përcaktuara nga neni 248 par.1 i KPP-së apo konstaton ndonjë mangësi të provave, të refuzon pranimin e fajësisë me qëllim që ti hapë rrugë shqyrtimit të dytë apo shqyrtimit gjyqësor. Edhe pse nuk është potencuar specifikisht është e qartë se aktvendimi shënohet në procesverbalin e shqyrtimit fillestar.

4. Kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues bindet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1. i këtij neni, ai merr aktvendim me të cilin pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe vazhdon me shqiptimin e dënimit, caktimin e seancës për vërtetimin e ndonjë fakti relevant për dënimin ose pezullon dënimin deri në përfundimin e bashkëpunimit të të pandehurit me prokurorin e shtetit.

Po ashtu sikurse në paragrafin e mësipërm edhe në këtë rast aktvendimi për pranimin e fajësisë konstatohet në procesverbalin e shqyrtimit fillestar, po ashtu nuk është paraparë dispozitë e veçantë për përmbajtjen e procesverbalit të shqyrtimit fillestar e në mungesë të saj, përshtatshmërisht zbatohet procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, kurse procesverbali duhet të përpilohet me

³⁴ Muçi, Shefqet, *E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme*, Tiranë, 2007, fq. 265.

shkrim dhe të shënohet thelbi i rrjedhës së shqyrtimit.³⁵

Padyshim se pjesa e cila më së shumti ka shkaktuar debat me hyrjen në fuqi të këtij Kodi është momenti kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues pranon pranimin e fajësisë dhe atëherë mund të kemi tri situata të ndryshme.

E para se mund të vazhdohet me shqiptimin e dënimit e që kjo paraqet një shkurtim të procesit gjyqësor por këtu janë paraqitur dilema sidomos te rastet kur trajtohen nga ana e departamentit për krime të rënda dhe kjo ka shkaktuar konfuzion se pas pranimit të fajësisë a duhet kryetari i trupit gjykues të shqiptoj dënimin apo të plotësohet trupi gjykues. Gjithsesi në këtë aspekt duhet analizuar hollësisht dispozitat që rregullojnë kompetencat e gjykatës e posaçërisht “Në procedurën penale në kuadër të Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore, aktgjykimi merret nga tre (3) gjyqtarë profesional, njëri nga të cilët kryeson trupin gjykues”³⁶ dhe kjo nëse analizohet me vëmendje duhet kuptuar se aktgjykimi merret ekskluzivisht vetëm nga trupi gjykues që nënkupton se kjo duhet kështu të ndodhë në çdo fazë të procedurës përkatësisht edhe pas shqyrtimit fillestar, meqë edhe dispozita nuk ka specifikuar se në cilën fazë mund të ndodhë kjo pra e lë mundësinë që kjo të ndodhë në çdo faze, por në çdo rast kur merr aktgjykimin pra sipas kësaj dënimi duhet të merret pasi që të plotësohet trupi gjykues pa përjashtuar edhe shqyrtimin fillestar. Në këtë përfundim arrihet duke analizuar në mënyrë sistematike dispozitën tjetër që i përket vendimeve para shqyrtimit gjyqësor se “ Pas ngritjes së aktakuzës nga prokurori i shtetit në gjykatën themelore, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mban shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë, merr vendim mbi kërkesat për hedhje të aktakuzës, merr vendim mbi kërkesat për të përjashtuar dëshmitë, dhe merr vendim mbi kërkesën për caktim të paraburgimit apo masat tjera për të siguruar praninë e të pandehurit”,³⁷ që i jep kompetencë kryetarit të trupit gjykues për vendimmarrje për të gjitha këto situata pos për marrjen e aktgjykimit.

Megjithatë konsideroj se do të ishte e natyrshme dhe normale që shqiptimi i dënimit të bëhej nga ana e trupit gjykues dhe atë nga fakti se hipotetikisht do të mund të vinim në atë situatë që kryetari i trupit gjykues të shqipton edhe dënimin më të rëndë që parasheh Kodi Penal i Republikës së Kosovës përkatësisht dënimin me burgim të përjetshëm.

³⁵ Hajdari, Azem, *Procedura penale* – Komentar, Prishtinë, 2010, fq. 597.

³⁶ Neni 25, par.3, KPPK .

³⁷ Neni 26, par.1, KPPK.

Gjithsesi duhet pranuar faktin se me fillimin e aplikimit të këtyre dispozitave ka pasur mjaft paqartësi dhe huti mes gjykatave përkitazi me shqiptimin e dënimit në departamentin për krime të rënda të gjykatave themelore dhe në disa nga to shqiptimin e dënimit e ka bërë kryetari i trupit gjykues kurse në disa tjera duke plotësuar trupin gjykues vetëm për shqiptimin e dënimit, e për shkak se kjo dispozitë që nga fillimi është interpretuar në mënyra të ndryshme dhe ka shkaktuar huti në praktikën gjyqësore.³⁸

Por kjo dilemë është tejkaluar përmes mendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës³⁹ e cila ka përcaktuar se dënimi duhet të shqiptohet nga ana e kryetarit të trupit gjykues, meqë bëhet fjalë për situatë specifike gjatë shqyrtimit fillestar.

Situata tjetër përkatësisht situata e dytë paraqitet në rastet kur pas pranimit të fajësisë ekziston ndonjë fakt relevant i cili do të mund të ishte i rëndësishëm dhe i nevojshëm për shqiptimin e dënimit dhe në këto raste edhe pse nuk është decidivisht e përkufizuar do të ishte e nevojshme që të mbyllet shqyrtimi fillestar dhe të caktohet një seancë vetëm për vërtetimin e faktit në fjalë. Nuk është e qartë se cili do të ishte afati i caktimit dhe mbajtjes së kësaj seance, por padyshim se kjo varet nga rrethanat që duhet të vërtetohen e posaçërisht se për cilat fakte bëhet fjalë e padyshim se kjo paraqet një diskrecion të kryetarit të trupit gjykues. Po ashtu sa i përket fakteve relevante edhe ato mund të jenë të natyrave të ndryshme siç mund të jenë sigurimi i të dhënave nga evidenca e të dënuarve, ndonjë rrethanë e rëndësishme personale apo familjare e të pandehurit, nëse do të ishte i nevojshëm të vërtetohet fakti se a është kompensuar apo jo viktimat përkatësisht i dëmtuari po ashtu një rrethanë e tillë mund të ishte edhe vërtetimi i fakteve kur i pandehuri ka aftësi të zvogëluar mendore dhe do të ishte i rëndësishëm fakti se cila është shkalla e aftësisë së zvogëluar mendore. Por në të gjitha rastet që mund të jenë të natyrave të ndryshme duhet që ekskluzivisht të ndërlidhen me vërtetimin e ndonjë fakti apo rrethane përkitazi me shqiptimin e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe kjo nganjëherë edhe shpie deri tek shtyrja e shqyrtimit fillestar dhe pastaj caktimi i një seancë të veçantë ekskluzivisht për shqiptimin e dënimit.

Kurse situata e tretë paraqitet në rastet e bashkëpunimit mes të pandehurit dhe prokurorit të shtetit dhe se kjo mund të sjellë pezullimin e dënimit për një afat deri sa të përfundon ky bashkëpunim e që mund të paraqitet në situatat kur bëhet negociimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe në rastet kur kemi të bëjmë me dëshmitarin bashkëpunues. Kurse me rastin e pezullimit në këto situata gjykata duhet të përcaktoj afat gjyqësor me qëllim që këto çështje të mos prolongohen në afat të gjatë dhe këto afate gjithsesi do të duhej të caktoheshin

³⁸ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep, *E drejta e Procedurës Penale*, Prishtinë, 2013, fq 342.

³⁹ Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës, GJA. nr. 207/13 të datës 19.03.2013.

në ndërlidhje me komplikueshmërinë e çështjes por se ndoshta nëse do të stërzgjatej ky bashkëpunim, atëherë gjykata do të mund të shqiptonte dënimin meqë tani më është vendosur për pranimin e fajësisë.

Sa i përket kësaj dispozite është e nevojshme të analizohen edhe dy situata që mjaft shpesh na paraqiten në praktikë pas ngritjes së aktakuzës e që është e rëndësishme për shkak të parimit akuzator nemo iudex sine actore⁴⁰:

- situata e parë kur aktakuza paraqitet ndaj një të pandehuri për vepra të ndryshme penale dhe në këto raste logjikisht kemi edhe deklarim të të pandehurit për secilën vepër veç e veç dhe në disa pika të aktakuzës mund të deklarohet i fajshëm kurse në disa i pafajshëm, apo edhe situata kur për disa vepra pranimi i fajësisë është sipas kritereve të nenit 248 par.1 të këtij Kodi, e për disa të mos plotësohen këto kritere.

Në këto situata duhet që të përcaktohet saktë se për cilat vepra pranohet fajësia dhe për cilat refuzohet pranimi i fajësisë për cilat janë plotësuar kriteret dhe për cilat nuk janë plotësuar këto kritere. Gjithsesi e rëndësishme është që në këto raste duhet që të vazhdohet në shqyrtimin e dytë apo shqyrtimin gjyqësor vetëm për akuzat në të cilat nuk është pranuar fajësia apo nuk janë plotësuar kriteret, kurse për veprat për të cilat është pranuar fajësia duhet në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të shqiptohet dënimi.

- situata e dytë ekziston në rastet kur aktakuza ngritet ndaj disa të pandehurve dhe në këto raste ekziston mundësia që një apo disa të pandehur ta pranojnë fajësinë kurse një apo disa nga të pandehurit të deklarohen të pafajshëm. Në këto raste duhet që procedura të veçohet⁴¹ dhe me të pandehurit që pranojnë fajësinë të vazhdohet me shqyrtimin e dënimit kurse me të pandehurit tjerë të vazhdohet në shqyrtimin e dytë apo eventualisht edhe me shqyrtimin gjyqësor.

Veçimi i procedurës është i justifikueshëm posaçërisht në këto situata:

- situata e parë kur kemi të bëjmë me raste të komplikuar dhe kjo do të mund të merrte shumë kohë dhe i pandehuri i cili e pranon fajësinë do të ishte i detyruar të ishte prezent gjatë gjithë procesit gjyqësor edhe pse prezenca e tij do të ishte e panevojshme,
- situata e dytë është në rastet kur të pandehurit gjenden në paraburgim

⁴⁰ Sahiti, Ejup, *E drejta e Procedurës Penale*, Prishtinë, 1986, fq 173.

⁴¹ Neni 36, par.1 i KPP-së, lejon mundësinë e veçimit të procedurës penale, për shkaqe të rëndësishme ose për arsye të efikasitetit, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, që mundëson që veçimi të bëhet gjatë shqyrtimit fillesar.

dhe do të ishte tërësisht e panevojshme që të mbahen nën masën e paraburgimit.

Edhe një argument i fuqishëm pro veçimit të procedurës është edhe dispozita e paraparë në shqyrtimin gjyqësor “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shtyn shqiptimin e dënimit për të pandehurit të cilët pranojnë fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor”,⁴² që në fakt i mundëson të pandehurit që pranon fajësinë që të mos jetë prezent gjatë tërë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor deri në shqiptimin e dënimit.

Megjithatë, gjykata duhet të jetë e kujdesshme me rastin e vlerësimit të pranimit të fajësisë për faktin se nganjëherë të pandehurit mund të kenë marrëveshje të fshehtë mes vete për pranimin e fajësisë për arsye të ndryshme dhe nga kjo arsye nuk mund të themi se mund të jetë zgjidhje uniforme veçimi i procedurës por duhet vepruar prej rastit në rast.

Siç duket edhe praktika gjyqësore në këto raste nuk është uniforme meqë ka raste kur procedura është veçuar por ka gjithashtu raste kur procedura nuk është veçuar, megjithatë konsideroj se më oportune do të ishte veçimi i procedurës për arsyet e paraqitura më lartë.

5. I pandehuri i cili nuk pranon fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar mund të ndryshojë deklaratën e tij dhe të pranojë fajësinë në çdo kohë. Për cilindo të pandehur që dëshiron të pranojë fajësinë nga ky paragraf, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues zbaton përshtatshmërisht shqyrtimin nga ky nen.

Edhe pas përfundimit të shqyrtimit fillestar nuk shteret mundësia e pranimit të fajësisë përkatësisht ekziston mundësia që i pandehuri të pranojë fajësinë në çdo kohë pas shqyrtimit fillestar edhe pse kjo nuk është përcaktuar se në çfarë forme do të mund të bëhej ky deklaram gjithsesi kjo mund të bëhej përmes parashtrësës me shkrim dhe nga kjo rrjedhimisht mund të determinoj zhvillimin edhe të një shqyrtimi fillestar që në fakt mund kushtimisht të zhvillohen më tepër se një shqyrtim fillestar.

5. Kundërshtimi i provave⁴³

1. Para shqyrtimit të dytë, i pandehuri mund të paraqesë kundërshtim ndaj provave të caktuara në aktakuzë, bazuar në këto arsye:

⁴² Neni 326, par.5, KPPK.

⁴³ Neni 249, KPPK

1.1. provat nuk janë marrë në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit ose organi tjetër qeveritar;

1.2. provat janë në kundërshtim me rregullat nga Kapitulli XVI i këtij Kodi; ose

1.3. ka bazë të artikulueshme që gjykata të çmojë provën si thellësisht të pa mbështetshme.

Duhet theksuar se mes shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë është një mes fazë në të cilën zhvillohen një varg veprimesh procedurale mjaft të rëndësishme nga palët në procedurë të cilat iniciativa rrjedhin nga ana e të pandehurit përmes paraqitjes së kundërshtimit të provave të paraqitura nga ana e prokurorit të shtetit në aktakuzë dhe kjo paraqet fazën kur edhe i pandehuri përmes këtij instituti kundërshtimit të provave paraqet pretendimet e tij përkitazi me provat e propozuara nga ana e prokurorit të shtetit. Padyshim se kundërshtimi i provave është mjaft i rëndësishëm nga fakti se ekziston mundësia që në këtë fazë të procedurës që gjykata ti evidentoj dhe po ashtu edhe ti shpallë të papranueshme provat e caktuara dhe ky do të ishte një dekontaminim i lëndës nga provat e papranueshme, meqë në prova të tilla nuk mund të mbështetet vendimi gjyqësor.⁴⁴ Kundërshtimet mund të paraqiten vetëm në provat e caktuara dhe në rastet kur janë marrë në mënyrë jo të ligjshme nga organet që zhvillojnë hetime dhe kjo është e rëndësishme nga fakti se këto organe duhet të jenë të kujdesshme gjatë veprimeve të tyre dhe se tejkalimi i autorizimeve mund të shpie deri te fakti që provat janë marrë në mënyrë jo të ligjshme.

Sa i përket provave që janë në kundërshtim me Kapitullin XVI të Kodit, kjo në thelb paraqet ndryshe institutin e provave të papranueshme, për më tepër në këtë kapitull janë përshkruar edhe cilat janë provat e papranueshme.

Sa i përket bazës së tretë kur mund të paraqitet kërkesa për kundërshtimin e provës kur ka bazë të artikulueshme që gjykata të çmojë provën si thellësisht të pa mbështetshme e që në Kod është paraqitur edhe përkufizimi i provës thellësisht të pa mbështetshme.⁴⁵

2. Prokurorit të shtetit i jepet mundësia që t'i përgjigjet kundërshtimit gojarisht ose me shkrim. Është e zakonshme që në pretendimet e të pandehurit ti jepet mundësia që prokurori i shtetit të përgjigjet në këto pretendime. Kjo mund të realizohet në dy mënyra; gojarisht që është e zakonshme të bëhet gjatë shqyrtimit të dytë, kurse mënyra e dytë e përgjigjes është me shkrim e cila mund që të paraqitet mes shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë. Është e natyrshme që

⁴⁴ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2013, fq. 249.

⁴⁵ Nenin 19 par.1.29, KPPK.

paraprakisht gjykata në rastet kur i pandehuri paraqet kundërshtim me shkrim këtë parashtesë të ia dërgoj palës tjetër përkatësisht prokurorit të shtetit, kurse afatet e përgjegjës janë paraqitur në dispozitën e nenit 251 par.3 të këtij Kodi.

Çështja tjetër që është e nevojshme të trajtohet është se çka do të ndodhte nëse nuk paraqiten përgjigjet nga ana e prokurorit të shtetit brenda afatit të përcaktuar prej 7 ditëve, atëherë gjykata pas kalimit të këtij afati duhet të vendosë edhe pa përgjigjen e prokurorit të shtetit që të mos mbetet peng i kësaj përgjigje dhe të mos prolongohet çështja. Por parimisht për shkak të shumë arsyeve do të ishte më e preferueshme që përgjigjja e prokurorit të shtetit të ishte obligative meqë në konceptin si është aktualisht e ndërtuar norma kjo paraqet mundësi dhe jo obligim të prokurorit të shtetit.

3. Për të gjitha provat për të cilat është paraqitur kundërshtim, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim me shkrim të arsyetuar për lejimin ose përjashtimin e provës.

Në këtë dispozitë është përcaktuar se për të gjitha provat duhet të vendoset që të lejohet ose përjashtohet prova. Kjo në fakt paraqet një stopim të procedurës deri sa të vendoset lidhur me lejimin apo përjashtimin e provave, kurse sa i përket vendimet e saj mund të jenë të ndryshme pra ekziston mundësia që disa prova të lejohen dhe disa të përjashtohen, të gjitha provat të lejohen apo të gjitha provat të përjashtohen.

4. Provat e papranueshme ndahen nga shkresat dhe mbyllen. Provat e tilla mbahen nga gjykata të ndara nga shkresat dhe provat tjera. Provat e papranueshme nuk mund të shqyrtohen apo të shfrytëzohen në procedurë penale, përveç në rastin e ankesës kundër aktvendimit mbi pranueshmërinë.

Në këtë paragraf përshkruhen veprimet që merren kur konstatohen se në lëndë ekzistojnë prova të papranueshme. Kjo është një standard i zakonshëm që provat të ndahen nga shkresat tjera, të mbyllen dhe këto nuk lejohen që të shfrytëzohen deri sa të vendoset në lidhje me to. Pra, kjo paraqet një standard të zakonshëm bazuar në faktin se provat e shpallura si të papranueshme konsiderohen sikurse nuk ekzistojnë, edhe pse nuk ka ndonjë definicion përkitazi me provat e papranueshme. Ato janë prova të marra në kundërshtim me dispozitat ligjore, kjo konsiderohet provë e pavlefshme apo e papranueshme.⁴⁶

5. Të gjitha provat kundër të cilave nuk është paraqitur kundërshtim janë të pranueshme në shqyrtim gjyqësor, përveç nëse gjykata sipas detyrës zyrtare

⁴⁶ Çollaku, Hashim, Roli i Prokurorit të Shtetit në Procedurën Penale, Prishtinë, 2013, fq. 92.

përcakton se pranueshmëria e provës së caktuar do të cenonte të drejtat e të pandehurit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Dispozita e më sipërme vjen në shprehje në rastet kur palët nuk i kundërshtojnë provat, atëherë i ka dhënë autoritet gjykatës që edhe sipas detyrës zyrtare të përjashtoj provën në rastet kur pranueshmëria e provës së caktuar cenon të drejtat e të pandehurit e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky paraqet një koncept mjaft të gjerë dhe me të drejtë ky legjitimitet i është besuar gjykatës si autoritet i cili ka mundësi të përjashtoj provën meqë edhe në provat e papranueshme nuk mund të mbështetet një vendim fajësie apo pafajësie.

6. Secila palë mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit nga paragrafi 3. të këtij neni. Ankesa duhet të bëhet brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i aktvendimit me shkrim.

Ankesa mund të paraqitet nga secila palë dhe ankesa i paraqitet gjykatës së apelit.

6. Kërkesa për hedhjen e aktakuzës⁴⁷

1. Para shqyrtimit të dytë, i pandehuri mund të paraqesë kërkesë për hedhjen e aktakuzës, bazuar në këto arsye:

- 1.1. vepra për të cilën akuzohet nuk përbën veprë penale;
- 1.2. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
- 1.3. ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra penale është e përfshirë në falje ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose
- 1.4. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.

Mundësia e dytë e të pandehurit para shqyrtimit të dytë është të paraqesë kërkesë për hedhjen e aktakuzës dhe se këtë kërkesë mund ta paraqesë për bazat e përcaktuara dhe se këto situata janë identike me bazat për lirim nga aktakuza.

2. Prokurorit të shtetit duhet t'i jepet mundësia që të përgjigjet ndaj kërkesës gojarisht apo me shkrim.

⁴⁷ Neni 250, KPPK

Sikurse edhe në nenin e mësipërm prokurorit të shtetit i jepet mundësia që të përgjigjet gojarisht gjatë shqyrtimit të dytë apo me shkrim para shqyrtimit të dytë.

3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim me shkrim të arsyetuar me të cilin refuzon kërkesën ose hedh aktakuzën.

Pas përgjigjes nga ana e prokurorit të shtetit apo edhe pa përgjigje brenda afatit të përcaktuar me nenin 251 par.3 të këtij Kodi, gjykata ka dy mundësi ta refuzon kërkesën për hedhje të aktakuzës ose ta hedhë aktakuzën nëse vlerëson se ekziston ndonjë bazë nga paragrafi 1 i këtij Kodi. Është e rëndësishme të potencohet se në këtë rast ky vendim i gjykatës (me rastin e refuzimit të kërkesës për hedhjen e aktakuzës) paraqet një filtër të kontrollit gjyqësor të aktakuzës dhe shikuar në aspektin teorik pas përfundimit të procedurave rreth kontrollit të aktakuzës, aktakuza faktikisht e fiton formën e prerë.⁴⁸

4. Secila palë mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit nga paragrafi 3. të këtij neni Ankesa duhet të bëhet brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i aktvendimit me shkrim.

Ankesa mund të paraqitet nga secila palë dhe ankesa i paraqitet gjykatës së apelit, sipas afatit të përcaktuar.

7. Përgjigjet⁴⁹

1. Prokurorit të shtetit i jepet mundësia që të përgjigjet në kundërshtimin nga neni 249 ose në kërkesën nga neni 250 të këtij Kodi.

Është e natyrshme që në kundërshtim dhe kërkesë të mbrojtësit apo të pandehurit, atëherë prokurorit të shtetit i mundësohet paraqitja e përgjigjeve dhe kjo me qëllim që gjykata ti ketë parasysh argumentet e palëve me rastin e vendosjes.

2. Përgjigja nga paragrafi 1. i këtij neni mund të bëhet gojarisht gjatë shqyrtimit të dytë ose me shkrim.

Përgjigjet mund të paraqiten me shkrim përmes parashtresës me qëllim që gjykata të ketë vëmendje me rastin e vendosjes, kurse po ashtu ekziston

⁴⁸ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep, *E drejta e Procedurës Penale*, Prishtinë, 2013, fq. 347.

⁴⁹ Neni 251, KPPK.

mundësia edhe që argumentet të paraqiten me gojë gjatë shqyrtimit të dytë përkatësisht në procesverbalin e shqyrtimit të dytë. Konsideroj se gjithsesi më e preferueshme do të ishte që komunikimi të ishte literal pra me shkrim meqë nga shkakut se edhe prokurori i shtetit do të kishte kohë më të gjatë në dispozicion.

3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i jep prokurorit të shtetit kohë prej një

(1) javë për të paraqitur përgjigje me shkrim ndaj kundërshtimit nga neni 249 ose kërkesës nga neni 250 të këtij Kodi.

Ligjvënësi me të drejtë ka vendosur afat ligjor për përgjigje të prokurorit të shtetit por, megjithatë gjykatës pas kalimit të këtij afati menjëherë i krijohet mundësia që të vendosë lidhur me kërkesën apo kundërshtimin.

4. Në vend të përgjigjes ndaj kërkesës nga neni 250, prokurori i shtetit mund të paraqesë aktakuzë të ndryshuar nga neni 252 të këtij Kodi.

Në këtë paragraf është paraqitur një mundësi që prokurori i shtetit në vend të përgjigjes në pretendimet e të pandehurit të ketë mundësinë e riparimit të aktakuzës përkatësisht ndryshimit të saj, e që kjo paraqet risi në krahasim me Kodin e mëparshëm dhe se kjo po ashtu paraqet edhe mjaft paqartësi dhe dilema. Çështja elementare që duhet trajtuar është fakti se çka nënkuptohet me aktakuzë të ndryshuar, dhe se ky ndryshim në aktakuzë a nënkupton ndryshim substancial apo vetëm në aspektin e gabimeve teknike. A mund që ky ndryshim të përfshijë aspekte subjektive dhe objektive, a mund të ndryshohet edhe kualifikimi i veprës penale? Megjithatë ndryshimi duhet të nënkupton jo vetëm aspektin e gabimeve teknike por edhe përmbajtësore sidomos duke iu referuar nenit 252 par.3 të KPP, që është paraparë si bazë e veçantë e kundërshtimeve dhe kërkesave ekskluzivisht për këtë ndryshim të aktakuzës.

8. Aktakuza e ndryshuar⁵⁰

1. Nëse kërkesa e paraqitur nga i pandehuri për hedhjen e aktakuzës nga neni 250 të këtij Kodi mund të rregullohet me ndryshim të aktakuzës, prokurori i shtetit paraqet aktakuzë të ndryshuar në pajtim me nenin 241 të këtij Kodi brenda një (1) jave nga shqyrtimit i dytë.

Duke u përgjigjur në pretendimet e të pandehurit për hedhje të aktakuzës

⁵⁰ Neni 252, KPPK.

prokurori i shtetit ka mundësi që të ndryshoj aktakuzën dhe këtë aktakuzë të ndryshuar duhet ta paraqes brenda një jave nga shqyrtimi i dytë. Pra, ndryshimi mund të bëhet pas shqyrtimit të dytë, gjithashtu edhe ky ndryshim nuk është i qartë se në çka konsiston, në përmbajtje apo vetëm ndryshime të aspektit të gabimeve teknike. Por duke iu referuar paragrafit 3, është e qartë se bëhet fjalë për ndryshime të karakterit substancial.

2. Nëse aktakuza e ndryshuar paraqitet kundër një të pandehuri apo disa të pandehurve, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtim fillestar nga neni 245 i këtij Kodi sikurse aktakuza të ishte e re.

Kjo dispozitë është tejet e paqartë dhe nuk është qartësuar se a bëhet fjalë për të pandehur të njëjtë sikurse tek paraqitja fillestare e aktakuzës apo mund të paraqitet edhe ndaj të pandehurve tjerë. Mund të jetë edhe njëra edhe tjetra por se ka mundësi që aktakuza e ndryshuar të paraqitet edhe për të pandehur të tjerë dhe kjo nga fakti se me këtë aktakuzë veprohet sikurse aktakuza të ishte e re. E rëndësishme është të theksohet se përmes aktakuzës së ndryshuar kemi një riciklim përkatësisht një kthim në fazën e paraqitjes së aktakuzës.

3. I pandehuri mund të paraqesë kundërshtime të reja nga neni 249 ose kërkesa nga neni 250 i këtij Kodi por vetëm për ato pjesë të aktakuzës të cilat janë ndryshuar.

Kundërshtimet dhe kërkesat mund të paraqiten vetëm për pjesët që janë të ndryshuar nga aktakuza dhe jo edhe për pjesët e tjera meqë për ato pjesë është shterë mundësia e paraqitjes së tyre.

4. I pandehuri mund të paraqesë sërish kundërshtimet e mëparshme nga neni 249 ose kërkesat nga neni 250 i këtij Kodi. Nëse i pandehuri nuk i paraqet sërish kundërshtimet apo kërkesat e mëparshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendosë që ato kundërshtime apo kërkesa nuk janë relevante për aktakuzën e ndryshuar dhe nuk i shqyrtojnë më tej.

Pra siç u përshkrua më lartë tani kemi një mundësi të paraqitjes së serishme të kërkesave dhe kundërshtimeve të paraqitura më parë, por, atëherë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendosë për kërkesat dhe kundërshtimet përkatësisht vendosë se nuk janë relevante për aktakuzën e ndryshuar dhe nuk shqyrton më tej, pra vlerëson se kundërshtimet fillestare janë eliminuar me aktakuzën e ndryshuar.

5. Prokurori i shtetit mund të ndryshojë aktakuzën një herë, përveç në rastet kur siguron të dhëna të reja që bëjnë të nevojshme ndryshimin e aktakuzës.

Ekziston vetëm një mundësi e ndryshimit të aktakuzës pos rasteve kur sigurohen të dhëna që e bëjnë të nevojshme ndryshimin e aktakuzës, që edhe kjo dispozitë është mjaft komplekse meqë lejon që ndryshimi i aktakuzës të bëhet disa herë në rastet kur sigurohen të dhëna të reja, që bëjnë të nevojshme ndryshimin e aktakuzës siç e përkufizon ligjvënësi, e që kjo është mjaft e paqartë e kjo paqartësi është edhe më e madhe bazuar në faktin se nga do të sigurohen ato të dhëna, kur me paraqitjen e aktakuzës pushon çdo aktivitet i prokurorit të shtetit, përkatësisht përmbillet faza e hetimeve për atë çështje penale.

9. Hedhja e aktakuzës⁵¹

1. Për çdo kërkesë për hedhjen e aktakuzës nga neni 250 i këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim për hedhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale kur çmon se:

- 1.1. vepra me të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;
- 1.2. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
- 1.3. ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra është përfshirë me amnesti apo falje, ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose
- 1.4. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.

Me anë të kësaj dispozite është rregulluar hedhja e aktakuzës e cila ndërlidhet me nenin 250 dhe gjithsesi i rëndësishëm është fakti se hedhja e aktakuzës dhe pushimi i procedurës mund të bëhet sipas kërkesave të palëve. Pra, sipas kësaj dispozite është e përcaktuar se hedhja e aktakuzës dhe pushimi i procedurës penale bëhet vetëm pas kërkesës së palëve e që përjashton mundësinë që gjykata të veprojnë sipas detyrës zyrtare. Këtu gjithsesi duhet sqaruar dhe dalluar situatën kur gjykata e hedhë parashtrësën pasi që ia kthen paraqitësit të saj për korrigjim dhe plotësim, dhe si pasojë e mosveprimit.⁵² Gjithsesi dallimi mes këtyre situatave është substancial dhe atë nga fakti se tek hedhja e parashtrësës nuk pushohet procedura dhe nuk konsiderohet si çështje e gjykuar “ne bis in idem”, kurse me dispozitën e këtij paragrafi hidhet aktakuza dhe pushohet procedura, dhe në këto raste kur aktvendimi merr formën e prerë nuk mund të vazhdohet procedura ndaj të pandehurit për atë vepër penale. Pra ndërlidhet me identitetin subjektiv dhe objektiv të aktakuzës.⁵³

⁵¹ Neni 253, KPPK.

⁵² Neni 442 i KPP-së, si parashtrësë e përcakton edhe aktakuzën

⁵³ Neni 4, KPPK

Sa u përket bazave për hedhje këto janë të përcaktuara në mënyrë taksative dhe janë të ngjashme me bazat e përcaktuara te aktgjykimi lirues.

2. Me rastin e marrjes së aktvendimit nga ky nen, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk detyrohet me cilësimin juridik të veprës penale siç është parashtruar nga prokurori i shtetit në aktakuzë.

Gjykata nuk është e detyruar në cilësimin juridik sipas pretendimeve të prokurorit të shtetit por gjithsesi ndërlidhet me përshkrimin e fakteve në aktakuzë.

3. Në përgjigjen ndaj kërkesës nga neni 250, prokurori i shtetit mund të hedhë aktakuzën nëse kërkesa nga neni 250 të këtij Kodi është e bazuar.

Ky paragraf i jep mundësinë prokurorit të shtetit që në rastet e përgjigjes në pretendime të të pandehurit të bëj hedhjen e aktakuzës në rastet kur konsideron se kërkesa është e bazuar. Kjo dispozitë është tejet interesante dhe atë për dy arsye, së pari duket e palogjikshme që prokurori i shtetit të hedhë aktakuzën që paraprakisht vet e ka ngritur dhe së dyti si do të hidhet aktakuza e cila tani është dorëzuar në gjykatë.

10. Shqyrtimi i dytë dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor⁵⁴

1. Në shqyrtimin e dytë marrin pjesë prokurori i shtetit, i pandehuri ose të pandehurit dhe mbrojtësit, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues ka kërkuar vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e shqyrtimit të dytë.

Shqyrtimi i dytë paraqet një fazë tjetër mjaft të rëndësishme të procedurës ku gjykata zhvillon aktivitet mjaft të rëndësishëm dhe se nuk kufizohet vetëm me një seancë. Por mund të caktohen më shumë seanca, por gjithsesi duhet potencuar faktin se shqyrtimi i dytë ka mundësi edhe të mos mbahet fare siç është rasti kur hidhet aktakuza dhe çështja mbyllet në këtë fazë, apo refuzohet propozimi për hedhjen e aktakuzës, apo refuzohen propozimet, dhe me këtë rast menjëherë caktohet dhe mbahet shqyrtimi gjyqësor. Por karakteristikë është fakti se gjatë shqyrtimit të dytë nuk është e mundur të përfundohet procedura.

Është e rëndësishme të theksohet se edhe në shqyrtimin e dytë janë paraparë afate që ndërlidhen me shqyrtimin fillestar dhe në këtë shqyrtim marrin pjesë

⁵⁴ Neni 254, KPPK.

prokurori i shtetit, i pandehuri ose të pandehurit dhe mbrojtësit, kurse është kërkuar vetëm paraqitja e propozimeve deri në datën e shqyrtimit të dytë. Pra nëse paraqiten propozime atëherë nuk mbahet fare shqyrtimi i dytë.

2. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sigurohet që mbrojtësi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet lidhur me zbulimin e provave nga neni 256 i këtij Kodi.

Deri sa shqyrtimi fillestar shqyrtonte obligimet e prokurorit të shtetit ndaj të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, tani në shqyrtimin e dytë gjykata është e fokusuar në detyrimin e zbulimit të provave nga ana e mbrojtësit, e që është interesant fakti se këtu nuk përmendet fare i pandehuri dhe se kjo mund të interpretohet me faktin se ky obligim i atribuohet mbrojtësit si profesionist dhe jo të pandehurit, apo kjo ndodhë pasi që ligjvënësi si duket nuk ka paraparë situata kur i pandehuri do të mbrohet vet pa mbrojtës.

3. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shqyrton kundërshtimet nga neni 249 ose kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi. Ai mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të përgjigjet gojarisht gjatë shqyrtimit ose me shkrim, në pajtim me nenet 249-253 të këtij Kodi.

Nëse paraprakisht nuk janë shqyrtuar kërkesat apo kundërshtimet, këto shqyrtohen në shqyrtimin e dytë dhe kërkon nga ana e prokurorit të shtetit të përgjigjet në këto pretendime. Nëse ekziston gatishmëria për shkak edhe të ekonomizimit të procedurës kjo mund të bëhet gojarisht në procesverbal, por nëse nuk mund të paraqitet në formë gojore atëherë i jepet mundësia që këto të paraqiten me shkrim përmes parashtrësive.

4. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton seanca dëgjimore në pajtim me nenin 255 të këtij Kodi, nëse seancat e tilla janë të nevojshme.

Ky paragraf i paraprinë nenit 255 të këtij Kodi dhe i është lënë mundësia që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues të ketë mundësinë që për të shqyrtuar vlefshmërinë e propozimeve të caktoj dhe mbajë më shumë seanca. Kjo duhet kuptuar si seanca të veçanta dhe atë gjatë shqyrtimit të dytë. Është e qartë se këto nuk duhet nënkuptuar si vazhdimësi e shqyrtimit të dytë por si seanca të veçanta dhe për më tepër nuk është paraqitur ndonjë limit se sa mund të jetë numri i këtyre seancave. Gjithsesi këto janë lënë në diskrecion të gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues dhe nëse janë të nevojshme, por këto duhet të jenë të ndërlidhura me kompleksitetin e çështjes që trajtohet.

5. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i trupit

gjykues cakton shqyrtimin gjyqësor, përveç nëse ende nuk ka marr aktvendim mbi kundërshtimet e paraqitura nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi.

Në këtë paragraf është mundësuar që gjatë shqyrtimit të dytë të caktohet shqyrtimi gjyqësor dhe kjo në aspektin praktik është e rëndësishme sidomos te lëndët e natyrës më komplekse dhe me këtë rast edhe mund të planifikohet rrjedhja e shqyrtimit gjyqësor. Por, asnjëherë nuk ekziston mundësia që shqyrtimi gjyqësor të caktohet deri sa të mos vendoset për kërkesa dhe kundërshtime të paraqitura, përkatësisht është pengesë procedurale, për më tepër aktvendimet duhet të jenë të formës së prerë.

6. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ende nuk ka vendosur për kundërshtimet nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi, ai merr aktvendim me shkrim të arsyetuar për të gjitha propozimet e pazgjidhura pas shqyrtimit të dytë. Ai cakton shqyrtimin gjyqësor me urdhër me shkrim, të cilin e nxjerr në të njëjtën kohë me aktvendimin apo aktvendimet me shkrim për propozimet e lartpërmendura.

Pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë, duhet të vendoset për të gjitha propozimet dhe njëkohësisht vendosë përkitazi me propozimet si dhe cakton shqyrtimin gjyqësor që paraqet një mundësi të mirë që palët prezentë të mos ftohen edhe një herë përmes thirrjeve të rregullta, që shpesh herë krijon vështirësi të natyrave të ndryshme.

7. Asnjë dëshmitar apo ekspert nuk merret në pyetje dhe nuk paraqiten prova gjatë shqyrtimit të dytë.

Deri sa te shqyrtimi fillestar përjashtimisht dhe specifikisht lejohet që në rast të vendosjes përkitazi me vazhdimin ose zbatimin e masave për të siguruar praninë e të pandehurit të dëgjoheshin dëshmitarë, në shqyrtimin e dytë nuk është paraparë një mundësi e tillë. Gjithsesi kjo paraqet një situatë interesante që meriton një trajtim të shkurtër së paku për dy arsye dhe atë:

- së pari se gjykata gjithëherë është e obliguar që në të gjitha fazat të shqyrtoj këto masa të sigurimit të pranisë së të pandehurit sidomos masën më të rëndë paraburgimin dhe do të ishte e arsyeshme që për këto masa të vendosej në çdo fazë që nënkupton edhe këtë fazë;
- së dyti duke marrë parasysh faktin se pjesëmarrës në shqyrtimin e dytë janë prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij do të ishte e pritshme që të paraqiten kërkesa për vazhdimin apo zbatimin e masave dhe nga kjo arsye do të ishte e dobishme që të dëgjohen argumentet e palëve.

Gjithsesi është e paqartë se pse ligjvënësi nuk ka lejuar dëgjimin e palëve dhe paraqitjen e provave siç është paraparë në shqyrtimin fillestar, dhe atë vetëm

sa i përket masave për sigurimin e prezencës së të pandehurit e veçanërisht për rishikimin e masës më të rëndë përkatësisht paraburgimit.

11. Shqyrtimet për përcaktimin e vlefshmërisë së propozimeve⁵⁵

1. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues çmon se është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit për të vlerësuar kundërshtimet e të pandehurit nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi, ai cakton dhe zbaton shqyrtimin e tillë sa më parë që të jetë e mundur dhe jo më vonë se tre (3) javë nga dita e shqyrtimit të dytë.

Paragrafi në fjalë është shumë interesant të trajtohet dhe atë për disa arsye: së pari është e qartë se janë parashikuar që të mbahen nëse është e nevojshme disa shqyrtime për arsye që është përkrahur në dispozitë se këto shqyrtime kanë të bëjnë me përcaktimin e vlefshmërisë së propozimeve. Këto shqyrtime mbahen vetëm nëse nuk vendoset për këto propozime gjatë shqyrtimit të dytë përndryshe nuk do të kishte arsye të mbahet një shqyrtim nëse do të vendosej për këto gjatë shqyrtimit të dytë. Gjithsesi siç duket ligjvënësi ka pasur parasysh edhe situatën kur pas shqyrtimit të dytë edhe përkundër që gjykata ka në dispozicion kërkesat dhe kundërshtime por edhe përgjigjet lidhur me to megjithatë ekziston ndonjë pengesë që të vendosë lidhur me to, andaj për këtë arsye ka paraparë shqyrtimin e parashikuar, e që ka paraparë kufizimet kohore deri kur mund të zbaton këtë shqyrtim nga shqyrtimi i dytë.

2. Gjyqtari i vetëm gjykues, ose kryetari i trupit gjykues, nxjerr aktvendim me shkrim të arsyetuar sa më parë që të jetë e mundur pas shqyrtimit të mbajtur sipas këtij neni dhe jo më vonë se tre (3) javë nga dita e mbajtjes së shqyrtimit nga ky nen.

Është përcaktuar maksimumi i nxjerrjes së vendimit në afat prej 3 javë nga dita e mbajtjes së shqyrtimit, por më esenciale është fakti se aktvendimi duhet të jetë në formë të shkruar dhe i arsyetuar.

12. Paraqitja e materialeve nga mbrojtja⁵⁶

1. Në shqyrtim të dytë, mbrojtja i paraqet prokurorit të shtetit:

1.1. njoftimin për qëllimin e prezantimit të alibit, duke precizuar vendin ose vendet ku i pandehuri pohon të ketë qenë në kohën e kryerjes së veprës penale

⁵⁵ Neni 255

⁵⁶ Neni 256, KPPK

dhe emrat e dëshmitarëve dhe çdo provë tjetër që e mbështet alibinë;

1.2. njoftimin për qëllimin e prezantimit të arsyeve për përjashtim të përgjegjësisë penale, duke precizuar emrat e dëshmitarëve dhe çdo prove tjetër që e mbështet arsyen e tillë; dhe

1.3. njoftimin për emrat e dëshmitarëve të cilët mbrojtja synon t'i thërret për të dëshmuar.

Siç e potencuam edhe më lartë në shqyrtimin e dytë gjykata kujdeset që të përmbushen obligimet e mbrojtjes dhe të pandehurit ndaj prokurorit të shtetit sidomos përkitazi me pikat 1.1, 1.2 dhe 1.3 të përcaktuara në mënyrë taksative.

Është e rëndësishme që mbrojtja të paraqes prokurorit këto njoftime nga fakti se duhet që pastaj prokurori i shtetit të përgatitet për mundësinë e parashtrimit të çështjeve në shqyrtimin gjyqësor, për më tepër paraqitja e dëshmitarëve qysh në këtë fazë e ka rëndësinë e vet edhe për faktin se nëse nuk paraqiten në këtë fazë duhet që të arsyetohen se pse këto materiale nuk janë paraqitur në këtë fazë.

2. Në çdo kohë para shqyrtimit gjyqësor, mbrojtësi mund të plotësojë me shkrim informatat e dhëna sipas paragrafit 1. të këtij neni prokurorit të shtetit.

Me këtë paragraf është lejuar që informatat të plotësohen deri para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, por që informatat gjithsesi duhet që të paraqiten para shqyrtimit gjyqësor.

3. Nëse mbrojtësi nuk kryen detyrimin nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni ndërsa gjykata nuk gjen shkaqe të arsyeshme për një gjë të tillë, gjykata mund të shqiptojë gjobë deri në dyqindpesëdhjetë (250) Euro ndaj mbrojtësit dhe njofton Odën e Avokatëve për këtë.

Ky paragraf e lejon gjykatën që në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të disiplinon mbrojtësin përmes shqiptimit të gjobës dhe njoftimit të Odës së Avokatëve, kurse ligjvënësi me të drejtë këto masa i ka paraparë për mbrojtësin si profesionist dhe person i cili mund të jetë shkaktar i shtyrjeve dhe vonesave të panevojshme në dëm të efikasitetit të procedurës.

13. Përfundimi

Në përfundim të këtij punimit është e rëndësishme të theksohet se shqyrtimi fillestar, veprimet mes shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë dhe shqyrtimi i dytë paraqesin një ndër fazat më të rëndësishme të procedurës penale, e cila fillon me paraqitjen e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe mund të përfundoj pas shqyrtimit fillestar në rastet e hedhjes së aktakuzës apo mund

të përfundoj edhe me aktgjykim dënues në rastet e pranimit të fajësisë apo negocimit të suksesshëm të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Shqyrtimi fillestar paraqet fazën e rëndësishme të procedurës penale ku bëhet evidentimi i dëshmitëve, detektohen dhe eliminohen provat e papranueshme por se përmban edhe dispozita të karakterit teknik siç është dorëzimi i aktakuzës që konsideroj se është e tepërt dhe e panevojshme meqë aktakuza duhet të i dorëzohet paraprakisht të akuzuarit së bashku me ftesë me qëllim që të përgatitet për shqyrtimin fillestar.

Sigurohet se është respektuar e drejta e të akuzuarit për mbrojtës dhe se prokurori i shtetit ka përmbushur detyrimet për zbulimin e provave dhe të gjitha këto paraqesin një garanci dhe përgatitje për fazën kryesore përkatësisht shqyrtimin gjyqësor.

Gjatë shqyrtimit fillestar vendoset për masat e sigurimit të pranisë së të pandehurit që është e rëndësishme meqë palët mund që të paraqesin drejtpërdrejt gjatë këtij shqyrtimi pikëpamjet e tyre për vazhdimin apo zbatimin e këtyre masave dhe se përjashtimisht për këtë arsye lejohet dëgjimi i dëshmitarëve apo ekspertëve.

Gjatë shqyrtimit fillestar ekziston mundësia e palëve në paraqitjen e kundërshtimit të provave të caktuara e që kjo është një filtër gjyqësor i kontrollit të veprimeve të organeve që kanë zhvilluar procedurën hetimore dhe se në rast të evidentimit se ekzistojnë prova të tilla, atëherë gjykata mund ti evitoj këto prova nga lënda përmes shpalljes së tyre si prova të papranueshme. Gjithashtu gjatë shqyrtimit fillestar është e mundshme të përfundohet një çështje penale përmes hedhjes së aktakuzës e cila mund të bëhet ekskluzivisht me kërkesën e palëve në procedurë përkatësisht të akuzuarit dhe prokurorit të shtetit, por se nuk është paraparë mundësia që hedhja e aktakuzës të bëhet sipas detyrës zyrtare dhe nga kjo vlerësoj se do të duhej të ekzistonte mundësia që gjykata të vepronte ex officio dhe të mund të hidhte aktakuzën pa kërkesat e palëve me qëllim që të mos vazhdohet me fazat e tjera të procedurës.

Po aq e rëndësishme është fakti se palët në procedurë në këtë fazë kanë rol mjaft aktiv qoftë përmes kërkesës për hedhjen e aktakuzës apo kundërshtimit të provave dhe se mbi bazën e kërkesës së njëerës palë, atëherë ekziston mundësia e përgjigjes me shkrim para shqyrtimit të dytë apo edhe me gojë gjatë shqyrtimit të dytë e që bie në sy se këto afate janë të gjata (një javë për përgjigje), andaj konsideroj se këto afate mund të ishin më të shkurtra tri apo pesë ditë me qëllim të efikasitetit të procedurës. Kurse zgjidhje e mirë është fakti se është paraparë mundësia e vendosjes nga gjykata edhe pa marrjen e përgjigjes nga pala tjetër pas kalimit të afatit për përgjigje, e po ashtu risi paraqet fakti se ekziston mundësia që prokurori i shtetit të ndryshoj aktakuzën e vet brenda afatit prej

një javë e që sipas mendimit tim kjo është e panevojshme dhe e paarsyeshme.

Gjyqtari i vetëm apo kryetari i trupit gjykues drejton shqyrtimin fillestar duke e udhëzuar të pandehurin për të drejtat e tij dhe me rastin e pranimit të fajësisë apo arritjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë nëse plotësohen kushtet ligjore kanë kompetenca në shqiptimin e dënimit edhe pse kjo dispozitë është aplikuar në praktikë megjithatë në departamentin për krime të rënda ka ngjallur shumë debate dhe dilema se a mund që dënimi të shqiptohet nga kryetari i trupit gjykues, andaj vlerësoj se në rastet që trajtohen nga departamenti për krime të rënda do të ishte oportune që pas pranimit të fajësisë të plotësohet trupi gjykues edhe me dy gjyqtar tjerë për shqiptimin e dënimit.

Shqyrtimi i dytë është karakteristik se gjatë këtij shqyrtimi nuk është i mundur përfundimi i procedurës penale dhe mund të mos mbahet fare nëse për kërkesat e palëve në procedurë vendoset përmes vendimeve të gjyqtarit të vetëm apo kryetari të trupit gjykues dhe atë pas shqyrtimit fillestar.

Në shqyrtimin e dytë gjykata kujdeset që mbrojtësi ti ketë përmbushur detyrimet e paraqitjes së provave meqë dispozitë e ngjashme para shqyrtimit fillestar kërkohej nga prokurori i shtetit dhe kjo ka për qëllim të shpalosjes së provave nga të dy palët dhe realizimin e parimit të barazisë së armëve mes palëve në procedurë.

E veçantë e kësaj faze është fakti se përveç shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë është paraparë që mund të caktohen shqyrtime të posaçme me qëllim të përcaktimit të vlefshmërisë së propozimeve të palëve dhe këtu kemi të bëjmë me shqyrtimin e propozimeve sipas parimit të kontradiktoritetit në prezencë të palëve e që vërehet se maksimumi i marrjes së aktvendimeve janë shumë të gjata (jo më vonë se tri javë) e që do të ishte më oportune që ky afat të ishte më i shkurtër përkatësisht maksimumi një javë me qëllim të vazhdimit me fazën kryesore përkatësisht shqyrtimit gjyqësor.

Jam plotësisht i vetëdijshtë se komentimi i shkurtër i këtyre dispozitave mund të jetë i mangët dhe me ndonjë të metë eventuale, por mirëpres sugjerimet dhe vërejtjet nga lexuesit e këtij punimi.

BIBLIOGRAFIA

Hajdari, Azem, *Procedura penale – Komentar*, Prishtinë, 2010
Islami, Halim & HOXHA Artan & PANDA Ilir, *Procedura Penale*, Tiranë, 2012
Sahiti, Ejup & MURATI Rexhep, *E drejta e Procedurës Penale*, Prishtinë, 2013
Çollaku, Hashim Roli i Prokurorit të Shtetit në *Procedurën Penale*, Prishtinë, 2013
Muçi, Shefqet, *E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme*, Tiranë, 2007
Sahiti, Ejup, *E drejta e Procedurës Penale*, Prishtinë, 1986

*Avni Puka**

PRANIMI I PËRGJEGJËSISË PENALE TË PERSONAVE JURIDIKË NË SISTEMIN “CIVIL LAW” – NJË VËSHTRIM I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS

ABSTRAKT

Në ditët e sotme roli dhe ndikimi i personave juridik në jetën socio-ekonomike është shumë i madh dhe në rritje të vazhdueshme si në nivel të shteteve ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Kjo sigurisht se i vë personat juridikë në situata që të realizojnë me veprimet (mosveprimet) e tyre edhe fakte të dëmshme për shoqërinë, duke përfshirë edhe vepra penale. Ky realitet ka ndikuar që personat juridikë të jenë subjekte të trajtimit edhe nga e drejta penale.

Në këtë punim do të bëjmë një vëzhgim teorik mbi konceptimin e përgjegjësisë penale për personat juridikë, përkatësisht kalimin edhe të vendeve evropiane në parimin “societas delinquere e potest”. Ky trajtim teorik ka për qëllim që të elaborohën disa nga argumentet themelore të doktrinës për pranimin e këtij instituti, si bazë për interpretimin edhe të dispozitave ligjore nga kjo fushë. Me theks të veçantë do të trajtohen edhe disa nga aspektet kryesore të legjislacionit të Kosovës për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale.

Fjalët kyçe: përgjegjësi penale, person juridik, person fizik, compliance program.

1. Hyrje

Rritja e ndikimit të personave juridikë në jetën socio-ekonomike në nivel global dhe rritja e kriminalitetit të tyre, ka ndikuar që edhe personat juridikë të jenë subjekte të trajtimit nga e drejta penale.¹

Në të drejtën penale, rregullimi i përgjegjësive së personave juridikë është duke u bërë një nga temat me interes të veçantë, apo siç e konsideron doktrina botërore si një “strategic research site”.²

*Autori i këtij shkrimi, Mr. Sc Avni Puka është ligjërues i së Drejtës Penale në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Përfaqësues i AIDP-Albanian National Group and Collective Member of Kosovo (Grupi i penalistëve shqiptarë, AIDP/IAPL-Paris/Francë).

¹ Puka, A.: A theoretical observation on the liability of legal entities for criminal offences - an European perspective, *Riv. Archivio Penale*, 2015/2, fq.1

² Rodriguez, L.Z.: Corporate Criminal Liability: Responsibility of legal persons for offenses in the European context, *ISISC, Siracusa, 2008*, fq.315 dhe vazhdim.

Personat juridikë tani mbulojnë një pjesë të madhe të sektorëve industrial, komercial dhe sociologjik, andaj disiplinimi i tyre në kuadër të së drejtës penale konsiderohet si i domosdoshëm që të ketë një shoqëri të sigurt dhe me ekonomi të qëndrueshme.³ Në këtë realitet, përgjegjësia penale e personave juridikë, tashmë është një koncept që është ngritur në të gjithë botën, duke përfshirë edhe vendet e kontinentit evropian.

Përkundër mohimit për një kohë të gjatë, në vitet e fundit në shumicën e legjislacioneve të vendeve evropiane (pas një tradite të gjatë të aplikimit të masave penale kundrejt personave juridikë në kuadër të sistemit *Common Law*) është pranuar mundësia e aplikimit të përgjegjësisë penale edhe për personin juridik krahas personit fizik, duke kaluar në këtë mënyrë nga parimi “*societas delinqueri non potest*” në parimin “*societas delinqueri e potest*”.

Në këtë punim do të bëjmë një vështrim teorik mbi konceptimin e përgjegjësisë penale për personat juridikë, përkatësisht kalimin edhe të vendeve evropiane në parimin “*societas delinquere e potest*”. Ky trajtim teorik ka për qëllim që të elaborohen disa nga argumentet themelore të doktrinës për pranimin e këtij instituti, si bazë për interpretimin edhe të dispozitave ligjore nga kjo fushë. Gjithashtu, do të trajtohen edhe disa nga aspektet kryesore të legjislacionit të Kosovës për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale.

2. Pranimi i përgjegjësisë penale për personat juridikë në vendet e sistemit “Civil Law”

Doktrina e së drejtës penale në vendet evropiane nuk e ka njohur për një kohë të gjatë mundësinë që personi juridik të përgjigjet penalisht për veprat e kryera nga anëtarët apo përfaqësuesit e tij, duke u mbështetur në parimin se përgjegjësia penale është individuale dhe jo kolektive (*societas delinquere non potest*). Si rrjedhojë edhe legjislacionet e këtyre shteteve janë krijuar mbi këtë bazë dhe përgjegjësinë penale e kanë kufizuar vetëm për personat fizikë.⁴

Për me tepër, nocioni i fajit është konsideruar vetëm si koncept i natyrës personale që nënkupton ekzistimin e përgjegjësisë penale në varësi të faktorëve psikologjik, të cilët mund të provohen vetëm të personat fizikë. Sipas këtij konceptimi për përgjegjësinë penale kërkohet një lidhje psikologjike me qëllim të fajësimit, si përgjegjësi “personale” që derivon ekskluzivisht nga vetëdija subjektive.⁵

³ Mahajan, K.: Corporate Criminal Liability: Why Corporations are preferred and not the employees?, *Company Law Journal*, Vol. 4, 2008, fq.1

⁴ Puka, A.: *Ibidem*, fq.2.

⁵ De Maglie, C.; *Societas Delinquere Potest? The Italian Solution*. Ed.by Pieth, M. & Ivory, R. – Corporate Criminal Liability, *Ius Gentium: Comparative Perspectives on Law and Justice* 9, Basel, 2011, fq.256

Parimi *societas delinquere non potest* e ka zanafillën e vet në kontekstin kishtar, në fakt nga një dogmë e Papa Inocenti IV, e cila kishte për qëllimin ndalimin e shkishërimit për korporatat apo entitetet civile për mëkatet e bëra nga anëtarët e këtyre korporatave. Kjo dogmë u ruajt edhe në kontekstin e zhvillimit të së drejtës penale, duke vepruar deri në shekullin e XX-të⁶. Ky koncept në kudër të sistemit “*Civil Law*” është mbështetur në teorinë e juristit dhe historianit gjerman Friedrich Carl Von Savigny: se të drejta mund të posedojë vetëm personi fizik, ndërsa personi juridik për zhvillimin e aktivitetit të tij ka nevojë për përfaqësues, andaj nuk mund të jetë as kryerës i veprave penale, duke qenë thjesht një fiksion juridik.⁷ Ky qëndrim ka përfaqësuar qasjen tradicionale sipas teorisë së fiksionit apo romanistike. Teoria e fiksionit tani është zëvendësuar me teorinë e realitetit (teknike). Kjo teori, e cila njihet edhe si teoria organike, mbështet idenë se derisa personat juridikë janë pjesëmarrës të rëndësishëm në jetën socio-ekonomike, kjo duhet të ketë reperkusione edhe në të drejtën penale. Prandaj edhe kjo disiplinë duke u ballafaquar me fenomenin e krimit kolektiv nuk mund të mbështetet në fiksione dhe të ngelë në sferën e përgjegjësisë penale individuale.⁸ Teoria e realitetit e arsyeton përgjegjësinë penale të personave juridikë me ndërmarrjen e masave penale ndaj të gjitha subjekteve që shkaktojnë pasoja të rënda për shoqërinë, dhe në anën tjetër, derisa personi juridik ka zotësi për të vepruar, bartë përgjegjësi civile dhe administrative për veprimet e përfaqësuesve të tij, atëherë sipas një interpretimi logjik duhet të mbaj edhe përgjegjësi penale për veprat penale të kryera në emër dhe dobi të tij.

Pastaj duke u nisur nga një përkufizim mbi vetë kuptimin e normave juridike dhe parimi i përgjithshëm se nëse rregulla apo norma juridike e shkelur është e përcaktuar me dispozita penale, edhe pasoja juridike për shkelësin e saj është dënimi penal,⁹ duhet të vlejë edhe në rastet kur shkelësi është person juridik. Në këtë mënyrë edhe krijohen bazat e kalimit të koncepteve tradicionale se vetëm personat fizikë mund të mbajnë përgjegjësi penale.¹⁰

Ndryshe nga personi fizik, të cilit i kërkohet që të respektoj vlerat e shoqërisë të mbrojtura me norma juridiko-penale brenda kapacitetit të tij psikik, vetëdijes mbi rëndësinë e tyre, dhe sjellja në kundërshtim me këto norma paraqet bazën

⁶ Shih Zapatero, A. L. : Die strafrechtliche Verantwortlichkeit der juristischen Personen in Spanien. In: *Schulz et al. (eds) Festschrift für Imme Roxin. Muller, Heidelberg, 2012*, fq. 711.

⁷ Shih Savigny, C.v.F.: *Sistema del diritto romano attuale, Volume II, Bologna, 1900.*

⁸ Kambovski, V.: Korniza juridiko-penale e parandalimit të kriminalitetit të organizuar, *Kriminaliteti i organizuar – aspekte juridike, Tetovë, 2009*, fq.40-41.

⁹ Me shumë mbi këtë tematikë shih Ramacci, F.: *Corso di diritto penale, Torino, 2005*, fq.30 dhe vazhdim.

¹⁰ Puka, A.: *Ibidem.*

e fajësisë së tij, kjo nuk mund të gjej aplikim për personin juridik, për të cilin vlejné kriteret të tjera për ta provuar fajësinë. Të ky i fundit kërkohet ekzistimi i një kulture organizimi (*corporate culture*) që të sigurojë një ambient për ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë legale duke respektuar të mirat juridike të shoqërisë. Për me tepër për përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë së personit juridik për veprat që kryhen nga përfaqësuesit e tij, kërkohet ekzistimi i një modeli organizimi dhe kontrolli (*compliance program*¹¹) me qëllim të parandalimit të veprave penale. Në të kundërtën mungesa e një modeli të tillë paraqet edhe bazën e dyshimit për fajësinë e personit juridik.

Këtu nuk mund të bëhet fjalë për një dashje ose pakujdesi të personit juridik apo raport psikik me veprën penale siç përcaktohet të personi fizik, dhe as që mund të kemi një konceptim psikologjik të fajësisë për personin juridik. Kjo problematikë mund të tejkalohet nga ana e doktrinës përmes një konceptimi normativ të fajësisë duke përshtatur kriteret e saj me natyrën e personave juridikë dhe funksionimin e tyre. Aspekti subjektiv i përgjegjësisë penale të personave juridikë, bazohet pikërisht në vlerësimin e ekzistimit ose jo të një programi (masave) për parandalimin e veprave penale që mund të kryhen në emër dhe dobi të tyre. Aplikimi ose jo i në programi apo masave për parandalimin e veprave penale, është tregues edhe i orientimit (vullnetit) të personit juridik në raport me respektimin e vlerave të shoqërisë të mbrojtura me ligjet në fuqi.

Kështu “*mens rea*” që dikur është menduar se paraqet problem të pakalueshëm për aplikimin e një skeme të përgjegjësisë penale për personat juridikë, tani është tejkaluar duke e bazuar në veprimet e agjentëve¹² të cilët i kanë të deleguara kompetencat nga organet drejtuese të personit juridik, dhe veprimet e tyre identifikohen me vullnetin e vetë personit juridik. Ky parim tani është pranuar në doktrinën botërore, duke identifikuar përgjegjësinë penale të personit juridik me veprimet e agjentëve të tij, i njohur si parimi i identifikimit.¹³ Konceptimi i fajësisë së personave juridikë mund të thuhet se është rezultat edhe i asaj që Profesor Ramacci e quan orientim i doktrinës botërore në gjetjen e aspekteve sa më të favorshme për formulimin e parimit ideologjik “*nullum crimen, nulla poena sine culpa*” për vetë faktin se ekzistojné koncepte të ndryshme shkencore mbi nocionin e fajit,¹⁴ edhe si rezultat i një dinamike të

¹¹ “*Compliance program*” nënkupton programet e brendshme(masat) që aplikon një person juridik me qëllim të respektimit të ligjeve në fuqi dhe rregullave të tjera, si dhe një organ kontrolli për hartimin dhe zbatimin efektiv të këtyre programeve. Për evitimin e fajësisë së personit juridik për vepra penale, ky program duhet të përmbaj masa të qarta për parandalimin e veprave të tilla që potencialisht mund të kryhen nga përfaqësuesit e tij.

¹² Mohojan, K.: *Ibidem*.

¹³ Molan, M., Lanser, D.; Bloy, D.: *Principles of Criminal Law*, 4th ed. London, 2000, fq.138 dhe vazhdim.

¹⁴ Ramacci, F.: *Corso di diritto penale*, cit., fq.107.

vazhdueshme për përshtatjen e parimeve dhe rregullave të së drejtës penale me nevojat e realitetit shoqëror.

Siç dihet fillet e konceptimit normativ të fajësisë paraqitën që në shek. XX, me depërtimin e “*neokantizmit*” dhe me kthimin nga vlerat dhe kriteret etike në formulimin e instituteve penalo- juridike, duke pranuar nocionin etik të fajit si qortim¹⁵ për veprimet ose mosveprimet në kundërshtim me normat juridiko-penale në fuqi.

Në këtë mënyrë përmes kalimit nga konceptimi tradicional i fajësisë në konceptimin normativ, bëhet i mundur qortimi i çdo subjekti në qoftëse nuk i përshtatet vlerave sociale të pranuar nga shoqëria. Në këtë linjë mendimesh, fajësia nuk është më lidhje psikike (personale) individ- vepër penale, por një qortim që i bëhet të gjitha subjekteve, edhe personave juridikë si të pakujdesshëm në respektimin e ligjit.¹⁶ Si i tillë konceptimi normativ i fajësisë konsiderohet si “*çelësi*” i afirmimit të përgjegjësisë penale për personin juridik, që si kriter të fajësisë merr të provuarit nëse vepra e kryer në emër të tij është pasojë e interesit të personit juridik që të përfitoj (në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekte) nga vepra e tillë ose vepra është pasojë e neglizhencës së personit juridik që të ndërmarrë masat e nevojshme për parandalimin e dëmit, përkatësisht veprës penale. Mbi këtë bazë përcaktohet përgjegjësia penale e personave juridikë edhe në shumicën e vendeve evropiane që e kanë pranuar këtë institut.

2.1 Hezitimet për pranimin e përgjegjësisë penale për personat juridikë në sistemin evropian – tendencat e ruajtjes së traditave juridike

Përkundër pranimit të gjerë të përgjegjësisë penale për personat juridikë në të gjitha sistemet juridike në botë, akoma nuk mund të themi se është eliminuar në tërësi parimi “*societas delinquere non potest*”, në fushën e së drejtës penale, në veçanti në sistemin evropian i cili në vazhdimësi është përcjell me dyshime nga ky aspekt.

Nga qasjet e ndryshme në doktrinë dhe vlerësimi i jurisprudencës në vendet evropiane në lidhje me hezitimet për të pranuar përgjegjësinë penale për personat juridikë në kuadër të legjislacioneve të tyre, vërehen kryesisht dy pengesa apo justifikime. E para, qasja tradicionale e teoricienëve të së drejtës penale e lidhur me parimin “*societas delinquere non potest*”, ndërsa si pengesë e dytë, është konsideruar reforma legjislative që duhet të bëhet në shumë

¹⁵ Kambovski, V.: E drejta penale- pjesa e përgjithshme, *Shkup 2004*, fq.248 dhe vazhdim.

¹⁶ Bozheku, E., Elezi, I.: Përgjegjësia penale e personave juridikë, *Tiranë, 2012*, fq.44.

fusha (ambientit, biznesit, etj.) të cilat ndikohen nga pranimi i përgjegjësisë së personave juridikë në kuadër të legjislacionit penal.¹⁷

Këto aspekte kanë ndikuar që disa vende të gjejnë solucione normative specifike me qëllim të ruajtjes së parimeve kushtetuese dhe traditës juridike të tyre. Si përfaqësuese tipike të këtyre vendeve që kanë hezituar që ta pranojnë përgjegjësinë penale për personat juridikë janë zgjidhjet e përcaktuara nga ligjvënësi gjerman dhe italian.

Në sistemin *Civil Law* (për dallim nga ai *Common Law*) ka pasur një kundërshtim të vazhduar për të pranuar përgjegjësinë penale edhe kundrejt personit juridik, duke u bazuar në traditën e ruajtjes së parimit të përgjegjësisë penale personale, duke shkaktuar kështu vonesa në pranimin e koncepteve të pastra penale për personat juridikë¹⁸ edhe në vendet evropiane. Në anën tjetër edhe korniza ligjore aktuale e BE-së që kërkon rregullimin e përgjegjësisë së personave juridikë për vepra penale, nuk përcakton në mënyrë obligative një përgjegjësi penale. Edhe kjo ka ndikuar që shtetet si Gjermania dhe Italia të shfrytëzojnë edhe këtë mundësi në kuadër të kornizës ligjore të BE-së, që të shmangën nga një përcaktim i përgjegjësisë penale që do të aplikohet drejtpërdrejt ndaj personave juridikë.

Në këtë drejtim ligjvënësi italian ka bërë një nga kthesat me të mëdha në kuadër të sistemit juridik me ligjin Nr. 231 të dt.08.06.2001, ku bën një zgjidhje të tipit *sui generis*, duke përcaktuar përgjegjësinë administrative për personat juridikë që janë përgjegjës për veprat penale të kryera në interes apo avantazh të tyre. Kjo zgjidhje e kujdesshme e ligjvënësit italian bëhet me qëllim që të shmangët shkëlja e nenit 27, *parag.1* i Kushtetutës italiane, i cili përcakton parimin e fajësisë dhe përgjegjësisë penale personale. Aspekti *sui generis* i ligjit në fjalë shihet në faktin se përkundër shmangies së nocionit “*përgjegjësi penale*” dhe kufizimit të sanksioneve me natyrë penale, si mënyrë e ruajtjes së pajtueshmërisë së akteve juridike, procedura që zhvillohet ndaj personit juridik është tipike penale dhe bazohet në dispozitat e Kodit të procedurës penale italiane dhe është në kompetencë të gjykatës penale.¹⁹

Trendin e pranimit të përgjegjësisë penale në vendet evropiane nuk e ka ndjekur as Gjermania, sepse problemet dogmatike në sistemin ekzistues konsiderohen

¹⁷ Puka, A.: *Ibidem*.

¹⁸ Manduchi, C.: The introduction of corporate “criminal” liability in Italy, *Riv.Diritto&Diritti*, 2010, www.diritto.it/docs/30795

¹⁹ Për këto arsye, solucioni i dhënë nga ligjvënësi italian, konsiderohet si një model “*parapenal*” ose “*gjysmë penal*” për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale.

të pazgjidhura për pranimin e një lloj përgjegjësie të tillë.²⁰ Madje ligjvënësi gjerman parasheh një zgjidhje edhe me restriktive, duke përcaktuar vetëm përgjegjësinë administrative për personat juridikë, për veprat penale të kryera nga subjektet që i përfaqësojnë ata. Duke respektuar kështu nenin 19 të Kodit penal gjerman i cili përcakton se “*vetëm personat fizikë mund të kryejnë vepra penale*”. Në sistemin gjerman, zhvillimi i procedurës gjyqësore ndaj personave juridikë është në kompetencë të gjykatës administrative.

Natyrshëm se edhe vendet që kanë qenë të ndikuara nga sistemi juridik gjerman dhe italian, kanë hezituar një kohë të gjatë për të pranuar përgjegjësinë penale për personat juridikë, si p.sh.: Hungaria²¹ dhe vende të tjera. Por deri tani, pothuajse të gjitha vendet evropiane kanë përcaktuar në kuadër të legjislacioneve të tyre përgjegjësinë penale për personat juridikë, për veprat penale që kryhen në emër dhe dobi të tyre (Holanda, Franca, Belgjika, Finlanda, Norvegjia, Zvicra, Danimarka, etj.).

Në dekadën e fundit, një orientim i përcaktimit të përgjegjësive penale të personave juridikë është shënuar edhe në vendet e Ballkanit ku në dispozitat e kodeve penale (Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina) apo me ligje të posaçme (Shqipëria, Kosova, Kroacia, Mali i Zi, Serbia) kanë përcaktuar kushtet e përgjegjësisë së personave juridikë për vepra penale, aspektet procedurale dhe sanksionet që mund të aplikohen ndaj tyre. Në vendet e Ballkanit një nga problemet aktuale shihet zbatimi në praktikë i ligjeve nga kjo fushë.

3. Përgjegjësia penale e personave juridikë sipas legjislacionit të Kosovës

Si shumë vende të tjera, edhe Republika e Kosovës ka aderuar në parimin “*societas delinquere potest*” duke e normuar përgjegjësinë penale të personave juridikë. Konceptimi i përgjegjësisë penale edhe në Kosovë është rezultat i nevojës për të krijuar bazën ligjore për një luftë efikase ndaj kriminalitetit të personave juridikë, dhe në anën tjetër një përgjigje ndaj kërkesave të mekanizmave ndërkombëtar për rregullimin e kësaj fushe.

²⁰ Bohlander, M.: Principles of German Criminal Law, *Studies in International & Comparative Criminal Law*, Oxford, 2009, fq. 23 dhe vazhdim. Böse, M.: Corporate Criminal Liability in Germany – Corporate Criminal Liability. Ed.Rodha, I. & Pieth, M., *Basel 2011*, fq.227-228.; Weigent, Th.: Societas delinquere non potest? – A German Perspective, *Oxford University Press*, 2008, ICJ 65 (927).

²¹ Santha, F.: Criminal responsibility of legal persons in Hungary – theory an (a lack of) practice, fq. 198 dhe vazhdim. (<http://www.upm.ro/proiecte/EEE/Conferences/papers/S1A38.pdf>) {02.03.2014}.

Përgjegjësia penale e personave juridikë si koncept në Kosovë është pranuar për herë të parë në Kodin Penal të vitit 2003,²² ku në nenin 106 në mënyrë parimore përcaktohej se: “*Veprat penale për të cilat personi juridik mund të jetë penalisht përgjegjës, përgjegjësia penale e personit juridik, sanksionet penale të cilat mund të zbatohen ndaj personit juridik dhe dispozitat e posaçme që e rregullojnë procedurën penale të zbatueshme ndaj personit juridik parashihen veçantë me ligj*”.

Në nivel të njohjes vetëm formale, përgjegjësia penale e personave juridikë është përcaktuar edhe në Kodin Penal të vitit 2012²³.

Rregullimi i plotë i këtij instituti në Kosovë është bërë me miratimin e ligjit 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale (tutje ligji 04/L-030),²⁴ duke zbatuar kështu edhe dispozitat parimore të Kodit penal, që parashikonin rregullimin e këtij instituti.

Me hyrjen në fuqi të ligjit 04/L-030 është abroguar edhe Ligji mbi deliktet ekonomike (1986)²⁵, i cili deri në këtë kohë ka normuar fushën e përgjegjësisë së personave juridikë.

Ligji 04/L-030 rregullon përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, përcakton sanksionet penale që mund të shqiptohen, si dhe përmban dispozitat e posaçme mbi procedurën penale që mund të zbatohet ndaj tyre (neni 1). Në vazhdim do të provojmë të prezantojmë disa nga aspektet themelore të përgjegjësisë penale për personat juridikë në Kosovë, në veçanti afirmimet në ligjin 04/L-030 dhe problematikat kryesore që konsiderojmë se do të përbejnë sfidë për sistemin e drejtësisë në Kosovë me rastin e gjyqimit të personave juridikë.

Në ligj jepet përkufizimi se “**person përgjegjës**” është: “*personi fizik që në kuadër të personit juridik ka besimin për kryerjen e detyrave të caktuara, ose autorizimin për të vepruar në emër të personit juridik si dhe ekziston*

²² Ky kod i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2003/25, ka hyrë në fuqi me 6 prill të vitit 2004.

²³ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2013. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* /Nr.19/13 Korrik 2012.

²⁴ Ligji 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale është miratuar me dt.31.08.2011 dhe ka hyrë në fuqi me dt.01.01.2013. Autori i këtij punimi ka qenë anëtar i Komisionit të Ministrisë së Drejtësisë për hartimin e draftit të parë të këtij ligji. Duhet theksuar se në procedurën e mëtejshme në komisionet e Kuvendit të Kosovës, me tepër ka dominuar një debat mbi nevojën e plotësimit të standardeve të BE-së nga kjo fushë, dhe kështu nuk janë përfshirë shume propozime të ekspertëve për nxjerrjen e një ligji funksional. Kjo ka bërë që të miratohet një ligj me mangësi dhe disa dispozita jo të qarta, që konsiderojmë se do ta sfidojë sistemin e drejtësisë penale në Kosovë. Në anën tjetër, kjo edhe provon kritikën mbi legjislacionin penal të vendeve të Ballkanit, se shumë ligje në këto vende janë miratuar sa për të plotësuar disa kritere në raport me BE-në, pa marrë në konsideratë aq sa duhet aspektin funksional të tyre dhe rrethanat ku duhet të zbatohen.

²⁵ “Gazeta Zyrtare” e ish-Jugosllavisë, nr. 10/86.

bazueshmëria e lartë se është i autorizuar të veproj në emër të personit juridik”(neni 2, *parag.1, nënparag.1.1*). Një përcaktim i tillë për personin përgjegjës është mjaft i plotë, sidomos në lidhje me pjesën “...ekziston bazueshmëria e lartë...” që jep mundësi që gjykata të aplikoj përgjegjësinë penale kundrejt personit juridik vetëm kur provohet se përveç autorizimit ka edhe një bazueshmëri se personi përgjegjës ka përfaqësuar “*interesat*” e personit juridik, ka shprehur vullnetin e tij, dhe jo vetëm pse thjesht ka qenë punonjës i personit juridik..

Derisa përgjegjësia penale e personit juridik derivon nga vepra penale e personit fizik, atëherë një nga kushtet për të konceptuar këtë përgjegjësi, është identifikimi i personave fizikë që mund të veprojnë në emër të personit juridikë, dhe në cilat kushte vepra penale e kryer nga ata mund të jetë bazë e përgjegjësisë penale edhe për personin juridik.

Varësisht nga modelet që ndjekin legjislacionet e vendeve të ndryshme, baza e përgjegjësisë së personit juridik në raport me veprën e personave fizikë, përcaktohet në disa mënyra, siç mund të jenë : përcaktimi në mënyrë shprehimore i personave që janë në strukturën e personit juridik, të cilët mund të kryejnë vepra penale në emër të tij; duke identifikuar përgjegjësinë e personit juridik vetëm me veprimet e organeve të larta të tij dhe duke u bazuar në sistemin joadekuat të organizimit dhe mungesën e masave për parandalimin e veprave penale (*Compliance programe*);²⁶ose duke mos specifikuar subjektet që sipas pozitës hierarkike në personin juridik, mund të kryejnë vepër penale në emër të tij, por duke përcaktuar në mënyrë të përgjithshme se përgjegjësia penale e personit juridik derivon nga vepra penale e personit fizik (përgjegjës) pavarësisht pozicionit në strukturën e personit juridik, por që ka autorizim për të vepruar në emër të tij dhe me veprën e kryer i ka sjell edhe dobi personit juridik. Ky model aplikohet edhe në Kosovë²⁷

Pra, përgjegjësia penale e personit juridik, mund të lind vetëm nga veprat penale që kryhen nga personat fizikë që kanë cilësi të caktuara²⁸ dhe mund të provohet se kanë vepruar në emër dhe dobi të personit juridik,²⁹ në secilin

²⁶ Pieth, M. & Ivory, R., *Emergence and Convergence: Corporate Criminal Liability Principles in Overview – Corporate Criminal Liability*, Ius Gentium: *Comparative Perspectives on Law and Justice* 9, Basel, 2011, fq.22 dhe vazhdim.

²⁷ Këtë model e ka ndjekur edhe ligjvënësi në Kosovë, ku në nenin 5, *parag.1* të ligjit 04/L-030, që përcakton bazën e përgjegjësisë penale për personin juridik, nuk specifikon pozitën hierarkike të personave fizikë që mund të kryejnë vepër penale në emër të personit juridik. Në këtë cilësi janë ato subjekte që janë persona përgjegjës, që mund të veprojnë në emër të personit juridik dhe me veprën penale i sjellin dobi këtij të fundit ose në emër të tij shkaktojnë dëme.

²⁸ Për përcaktimin e personave fizikë që mund të kryejnë vepër penale në emër të personit juridik, sipas legjislacionit të Kosovës, duhet referuar nenit 2 të Ligjit 04/L-030 mbi përkufizimin e nocionit “*person përgjegjës*”.

²⁹ Shih Bozheku, E., Elezi, I.: cit., fq.22 dhe vazhdim.

rast konkret të procedimit penal kundrejt personit juridik. I takon prokurorisë që të provojë këtë raport të personit fizik me personin juridik, duke u bazuar në pozicionin formal që personi fizik ka pasur në bazë të aktit të punësimit (kontratës apo marrëveshjes për punësim) apo akteve të tjera të dhënies së autorizimeve ligjore për të përfaqësuar personin juridik. Pastaj aspekti i dytë, konsiston në të provuarit nëse vepra penale ka qenë edhe vullnet (qëllim) i personit juridik, ose të paktën se personi juridik nuk ka ndërmarrë masa për parandalimin e një veprë të tillë (aspekti subjektiv i përgjegjesisë penale të personit juridik).

Sa i përket definimit të nocionit të personit juridik, ligji përmban vetëm një përcaktim të përgjithshëm, se person juridik cilësohet subjekti juridik i vendit ose i huaj, i cili sipas legjislacionit në fuqi konsiderohet si person juridik (Neni 2, *parag.1, nënparag.1.2*). I njëjti përkufizim është edhe në Kodin Penal të Kosovës (2012).

Nga kjo del se edhe ligjvënësi kosovar i është shmangur përcaktimit definitiv të nocionit “*person juridik*” në kuptim të aplikimit të përgjegjesisë së tij për vepra penale, duke lënë këtë si detyrë për doktrinën dhe praktikën gjyqësore që përmes interpretimit të legjislacionit të Kosovës në përgjithësi, të përcaktojnë se cilët janë subjektet e së drejtës që konsiderohen persona juridikë. Një definim me i plotë sa i përket legjislacionit të Kosovës është në Ligjin Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare ku thuhet se: “*Person Juridik*” është shprehje e përgjithshme që nënkupton një shoqëri, duke përfshirë shoqërinë tregtare, që ka një identitet juridik të veçantë dhe të ndarë nga ai i anëtarëve ose aksionarëve të saj.”³⁰ Me qëllim të identifikimit të personave juridikë ndaj të cilëve mund të aplikohet përgjegjësia penale, ka rëndësi të posaçme edhe dallimi ndërmjet personave juridikë publik dhe atyre privat. Kjo për faktin se jo ndaj të gjithë personave juridikë mund të aplikohen sanksionet penale për veprat e kryera në emër dhe dobi të tyre, siç mund të jenë p.sh.: Personat juridikë me interes publik. Një dallim të tillë ligji 04/L-030 e bën në nenin 4, *parag.3*. ku parashihet se: “*Republika e Kosovës, organet e administratës shtetërore dhe të vetëqeverisjes lokale dhe organizatat e huaja qeveritare që veprojnë në Republikën e Kosovës nuk mund të jenë përgjegjëse për veprë penale, por personi përgjegjës mban përgjegjësi penale*”. Ky përcaktim njëherit shpreh edhe orientimin se ligji 04/

³⁰ Ligji Nr.02/L-123 për shoqëritë tregtare, si person juridik i cilëson: shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare, ndërsa ndërmarrjet individuale, shoqëritë kolektive dhe shoqëritë komandite, nuk e kanë statusin e personit juridik. Përgjithësisht, për personin juridik nuk ka një përkufizim përfundimtar të nocionit të tij, duke e cilësuar si shoqatë e njerëzve ose fond me qëllim të veçantë (p.sh. fondacion), që sipas ligjit ka personalitet juridik. Ai ndryshon nga shoqatat e tjera të njerëzve me atë që posedon personalitet juridik dhe mund të paraqitet para gjykatave si paditës ose i paditur (“*Parteifähigkeit*” - kapacitet për të qenë palë në gjykatë). (<http://www.eurofound.europa.eu/emire/GERMANY/LEGALPERSON-DE.htm>, (15.12.2014)).

L-030 ka si qëllim themelor disiplinimin e personave juridikë privat.

Në lidhje me veprat penale për të cilat personi juridik mund të përgjigjet penalisht, ligjvënësi kosovar është përcaktuar për një zgjidhje me pak të kufizuar, duke parashikuar mundësinë që personi juridik mund të përgjigjet për vepra penale nga pjesa e posaçme e Kodit Penal të Kosovës dhe për vepra të tjera, kurdo që janë plotësuar kushtet për përgjegjësinë e personit juridik (neni 3, *parag.2*), duke akceptuar kështu modelin e “*all-crimes approach*”, siç është rasti edhe me legjislacionin e Holandës³¹, Kroacisë³², etj. Jemi të mendimit se një zgjidhje e tillë me e gjerë, duke u kufizuar vetëm në kushtin që vepra penale t’i përshtatet natyrës së personit juridik dhe të plotësohen kushtet për përgjegjësi penale është praktikisht me e drejtë, se sa listimi i veprave penale për të cilat personi juridik mund të mbahet përgjegjës (*list-based approach*), siç është rasti me legjislacionin italian,³³ spanjoll,³⁴ estonez,³⁵ etj., që në mënyrë taksative përcaktojnë veprat penale për të cilat mund të përgjigjet personi juridik. Përparësia e modelit të parë argumentohet edhe me faktin se kriter themelor për përgjegjësinë e personit juridik është të provuarit se a ka përfituar personi juridik nga vepra penale që është kryer në emër të tij dhe a ka faj (gjithmonë kemi parasysh konceptimin normativ të fajësisë).

Vlefshmëria territoriale e ligjit 04/L-030 është përcaktuar në nenin 4 të tij, ku parashihet se ky ligj aplikohet ndaj të gjithë personave juridikë (të vendit dhe të huaj) që janë përgjegjës për vepra penale të kryer në territorin e Republikës së Kosovës, duke afirmuar kështu parimin e territorialitetit. Gjithashtu ky ligj aplikohet edhe ndaj personit juridik të huaj i cili është përgjegjës për vepra penale të kryer jashtë shtetit në dëm të Republikës së Kosovës, shtetasit të saj apo personit juridik të vendit (Parimi real-mbrojtës), si dhe ndaj personit juridik të vendit (vendor) i cili është përgjegjës për vepra penale të kryer jashtë territorit (Parimi i personalitetit aktiv). Ligjvënësi kosovar parasheh përjashtimin e përgjegjësisë penale për personin juridik, për veprën penale e cila është kryer gjatë ushtrimit të autorizimeve që atij i janë besuar me ligj (neni 4, *parag.4*).

³¹ Shih Dutch Penal Code (*Wetboek van Strafrecht*) (DPC), 1976, neni 51.

³² Shih Act on the Responsibility of Legal Persons for the Criminal Offences, *Croatia, Official Gazette no. 151/2003*, neni 2.

³³ Pas miratimit të ligjit 231/2011 mbi përgjegjësinë administrative të personave juridikë për vepra penale, ligjvënësi italian me reformat e vitit 2002, 2003, 2005, 2006 dhe 2007 ka përfshirë përmes ligjeve të posaçme edhe disa forma të reja të veprave penale për të cilat personi juridik mund të jetë përgjegjës, si : terrorizmi dhe skllavëria, abuzimi i tregut, mbajtja e gjerave të vjedhura dhe pastrimi i parave, etj. Me shumë shih De Maglie, C.: *Societas Delinquere Potest? The Italian Solution*, Ed.by Pieth, M. & Ivory, R. – *Corporate Criminal Liability, Ius Gentium: Comparative Perspectives on Law and Justice 9*, Basel, 2011, fq.260 dhe vazhdim.

³⁴ Për një njohje me të thelluar mbi përgjegjësinë penale të personave juridikë në sistemin spanjoll, në veçanti shih De La Questa, J.L.: *Criminal Responsibility of Legal Persons in Spanish Law, International Review of Penal Law, AIDP/IAPL*, 84,1/2, 2013, fq.143-179.

³⁵ Ginter, J.: *Criminal Liability of Legal Persons in Estonia, Juridica International, XVI/2009*, fq.151.

3.1 Baza dhe kufiri i përgjegjesisë penale për personat juridikë sipas ligjit 04/L-030

Baza dhe kufiri i përgjegjesisë penale për personat juridikë në Kosovë është përcaktuar në nenin 5 të ligjit 04/L-030, që përmban dispozitat fundamentale mbi këtë disiplinë por njëherit është edhe pjesa më e diskutueshme dhe problematike e ligjit në fjalë.

Përgjegjësia penale e personit juridik buron nga vepra penale e kryer nga personi fizik i cili ka vepruar në emër dhe dobi të tij. Kështu në nenin 5, *parag.1* përcaktohet se: *“Personi juridik është përgjegjës për vepër penale të personit përgjegjës i cili duke vepruar në emër të personit juridik në kuadër të autorizimeve ka kryer vepër penale me qëllim që për atë personi juridik të realizoj ndonjë dobi ose ka shkaktuar dëme. Përgjegjësia e personit juridik ekziston edhe atëherë kur veprimi i atij personi juridik ka qenë në kundërshtim me politikën afariste apo urdhrat e personit juridik.”*

Përcaktimi se vepra penale duhet të kryhet përveç *“në emër”* por edhe *“në kuadër të autorizimeve”*, është një formulim i drejtë i ligjvënësit që nënkupton se për një përgjegjësi penale kundrejt personit juridik nuk mjafton që vepra penale të jetë kryer nga personi përgjegjës vetëm duke e përfaqësuar personin juridik (*në emër*) por duhet të ketë vepruar edhe në kuadër të autorizimeve të dhëna nga vetë personi juridik. Ndërsa pjesa tjetër *“...me qëllim që për atë personi juridik të realizoj ndonjë dobi...”* mund të paraqesë problem me rastin e interpretimin në praktikë, sepse parasheh një dashje specifike të personit përgjegjës, çka është e vështirë të provohet në praktikë. Në këtë pikë gjykatat në Kosovë duhet të jenë të kujdesshme në interpretimin e kësaj pjese të dispozitës në fjalë, sepse qëllimi i një personi përgjegjës nuk përputhet gjithmonë me qëllimin e vetë personit juridik (madje nuk mund të ketë një identifikim të tillë).³⁶ Prandaj gjykata duhet që pavarësisht nga dashje e personit përgjegjës të provoj nëse personi juridik e ka dashur ose lejuar veprën e tillë përmes sjelljes së tij dhe politikës që ka zbatuar.

Siç është e njohur në të drejtën penale, parimi i përgjegjesisë penale personale paraqet një nga parimet themelore të saj, që nënkupton se çdo individ përgjigjet vetëm për pasojat, përkatësisht faktet (që me ligj përcaktohen si vepër penale) që ai personalisht i ka shkaktuar me veprimin ose mosveprimin e tij (aspekti

³⁶ Më shumë mbi aspektin subjektiv të përgjegjesisë së personit juridik në raport me interesin apo dashjen e personit fizik, dhe argumentimin se për një fajësi të personit juridik, duhet të përputhet interesi i tij me atë të personit fizik, shih Lattanzi, G.: *Reati e reponsabilità degli enti*, Milano, 2005.

objektiv)³⁷ dhe janë rezultat i dashjes ose pakujdesisë së tij (aspekti subjektiv)³⁸. Sipas këtij parimi, një person nuk mund të përgjigjet për veprën penale të kryer nga personi tjetër, por vetëm për veprën që ai e ka kryer personalisht dhe me fajin e tij.

Bazuar në postulatet e këtij parimi, disa nga teoricienët kanë insistuar se përgjegjësia penale e personit juridik nuk është e mundur, sepse do të nënkuptonte që ky i fundit të fajësohet për një vepër penale që është kryer nga një person tjetër (personi fizik).³⁹ Këtë parim si pengesë për pranimin e përgjegjësive penale të personave juridikë e kemi trajtuar edhe me herët kur kemi bërë fjalë për hezitimet e disa vendeve që të pranojnë këtë përgjegjësi, siç është rasti me Italinë ku ligjvënësi i është shmangur nocionit të përgjegjësive penale për të respektuar nenin 27 të Kushtetutës italiane ku stimulohet pikërisht parimi i përgjegjësive penale personale,⁴⁰ i cili në planin doktrinar është tejkalluar përmes konceptimit normativ të përgjegjësive penale të personit juridik, dhe kjo duhet të përbej bazën e çdo interpretimi nga praktika gjyqësore.

Përcaktimi i fajësisë së personave juridikë, përveç në dispozitat e ligjit që rregullon këtë institut, bazohet edhe në parimet dhe rregullat e parashikuara në kodin penal dhe kodin e procedurës penale, për aq sa mund të përshtatën me natyrën e personit juridik. Në këtë frymë edhe ligji i Kosovës 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, në nenin 3 parag.1 parasheh se: “ *Në qoftë se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe, ndaj personave juridikë aplikohen dispozitat e Kodit Penal të Kosovës dhe të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës*”. Prandaj kërkohet një interpretim koherent i dispozitave në kuadër të legjislacionit penal pozitiv në tërësi, përmes një studimi me të thelluar për të sqaruar kriteret që e përbejnë bazën e përgjegjësive penale për personin juridik. Ndryshe, edhe nga aspekti praktik mund të jetë problematike arsyetimi i vendimeve gjyqësore kundrejt personave juridikë si përgjegjës për vepra penale të kryera në emër dhe dobi të tyre.

Në harmoni me këtë, për të konsideruar një person juridik si të fajshëm, duhet

³⁷ Nga aspekti objektiv, vepra penale është personale e individit kur ekziston lidhja shkakore midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojës, në të kundërtën personi nuk mund të jetë penalisht përgjegjës. KPK në nenin 20 përcakton se: “*Personi nuk është penalisht përgjegjës kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojës mungon lidhja shkakore*”.

³⁸ Nga aspekti subjektiv, vepra penale është personale e individit kur ai është mendërisht i aftë (ose ka aftësi të zvogëluar mendore por ekziston një nivel i aftësisë) dhe veprën e ka kryer me faj (dashje ose pakujdesi). Pra, nga ky aspekt parimi personal identifikohet me vetë konceptin e përgjegjësive penale.

³⁹ Me shumë mbi këtë parim në raport me përgjegjësinë penale të personit juridik shih edhe: Bozheku, E., Elezi, I.: cit. fq 40 dhe vazhdim.

⁴⁰ Për një njohje më të thellë të këtij parimi në të drejtën pozitive italiane shih Ramacci, F. cit. fq. 107 dhe vazhdim.

që vepra penale e kryer në emër dhe dobi të tij, të provohet nga ana objektive dhe subjektive.

Derisa si kushte themelore të përgjegjësisë së personit juridik janë se vepra duhet të jetë kryer “në emër” dhe “në dobi” të tij, në planin praktik për të provuar fajësinë e personit juridik, detyra themelore e gjykatës është interpretimi i drejtë i këtyre dy kushteve (aspekti objektiv i përgjegjësisë penale të personit juridik). E para, që vepra penale të jetë kryer “në emër” të personit juridik nuk mjafton vetëm të provuarit se një person fizik nga struktura e personit juridik ka kryer veprën penale, por duhet të provohet se në rastin konkret ka vepruar në emër të tij dhe ka pasur autorizim për një veprim të tillë. Në të kundërtën personi juridik nuk mund të shpallet fajtor. Aspekti i dytë, duhet të provohet nëse personi juridik ka pasur dobi përkatësisht interes ekskluziv nga vepra e tillë. Dobia e personit juridik mund të jetë e drejtpërdrejtë dhe indirekte.⁴¹ Përveç kriterëve të tjera, këto dy kushte duhet të provohen në mënyrë komulative që të sajohet përgjegjësia penale e personit juridik. Bazë tjetër e fajësisë së personit juridik sipas ligjit 04/L-030 është edhe shkaktimi i dëmit.⁴² Personi juridik mund të shpallet i fajshëm nëse provohet se dëmi është rezultat i ndonjë interesi të personit juridik ose nuk i është përmbajtur standardeve të nevojshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

P.sh.: Mund të shpallet fajtorë një ndërmarrje ndërtimore nëse dëmi ka ardhur si pasojë e mosndërmarrjes së masave mbrojtëse, dhe arsyetimi i përgjegjësisë penale bazohet në këtë interes që ndërmarrja ka përfituar duke mos shpenzuar në blerjen e pajisjeve për siguri në punë. Gjithashtu një ndërmarrje e tillë mund të shpallet fajtorë nëse nuk ka aplikuar masat mbrojtëse në pajtim me standardët që kërkohen për siguri gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, dhe si pasojë e kësaj është shkaktuar dëmi.

Pra në të dy këto raste dëmi i shkaktuar ka lidhje me sjelljen e personit juridik dhe identifikohet me interesin dhe përgjegjësinë e tij për faktet që ka mundur

⁴¹ Dobia e drejtpërdrejt e personit juridik nga kryerja e veprës penale mund të jetë në rastet kur organet drejtuese të personit juridik favorizojnë kryerjen e veprave penale nga personat fizikë me qëllim të përfitimit në mënyrë të kundërligjshme, p.sh.: nxisin veprimet korruptive të përfaqësuesve me qëllim të fitimit të tenderëve publik, etj. Ndërsa si përfitim indirekt personi juridik mund të ketë në rastet kur nuk investon në masat e nevojshme për parandalimin e veprave penale me qëllim që të kursej buxhetin e tij, p.sh.: një ndërmarrje ndërtimore nuk investon në masat e sigurisë që të mos shpenzoj dhe për pasojë shkaktin dëme, ose një kompani për prodhimin e produkteve ushqimore nuk investon në pajisjet teknologjike që kërkohen sipas standardeve dhe me këtë rrezikon jetën dhe shëndetin e njerëzve, etj.

⁴² Kryerja e veprave (shkaktimi i dëmit) si pasojë e neglizhencës së personit mund të jetë ndotja e ambientit ose shkaktimi i dëmit tjetër nga një ndërmarrje ndërtimi që i ka blerë të gjitha pajisjet sipas standardeve për evitimin e ndotjes apo pasojave të tjera në punë por ato nuk i vë në funksion ose nuk i mbikëqyrë dhe për këtë neglizhencë shkaktohet pasoja e dëmshme. Pra, shkaktimi i dëmit duhet të jetë rezultat i një interesi të personit juridik ose i neglizhencës së tij që të veproj në harmoni me obligimet ligjore.

t'i parashoh. Andaj aplikimi i përgjegjesisë penale për këto raste është në pajtim me frymën e ligjit 04/L-030 (*ratio legis*) dhe parimin e fajësisë që një subjekt përgjigjet për faktet që ka mundur t'i parashoh. Në anën tjetër nëse nuk mund të provohet një lidhje e tillë e personit juridik me dëmin e shkaktuar nuk mund të ketë përgjegjësi penale. P.sh.: nuk mund të ketë përgjegjësi penale një ndërmarrje ndërtimore nëse arrin të provoj se ka ndërmarrë të gjitha masat mbrojtëse në pajtim me standardet e kërkuara, por dëmi i shkaktuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë ose në lidhje me të është pasojë e "*vis major*".

Në pajtim me këtë, shkaktimi i dëmit si bazë e përgjegjesisë penale ka kuptim vetëm nëse provohet se ka lidhje me një interes ose neglizhencë të personit juridik në raport me detyrimet ligjore të tij.

Kështu për të provuar veprën penale edhe nga aspekti subjektiv, fajësia e personit juridik duhet të bazohet në mënyrën e organizimit të brendshëm të tij, ekzistimit dhe zbatimit të një modeli për parandalimin e veprave penale ose jo, apo edhe ndonjë akti tjetër për këtë qëllim.

Në praktikë veprat penale që kryhen në emër dhe dobi të personit juridik në shumë raste janë pasojë e drejtpërdrejt e një organizimi të dobët të personit juridik për të evituar veprat e tilla.⁴³ Mbi këtë bazë edhe arsyetohet fajësia e personit juridik dhe ndëshkimi i tij nëse provohet se vepra penale e caktuar është pasojë e organizimit të dobët të personit juridik për të shmangur atë,⁴⁴ derisa edhe vetë personi juridik nuk mund të provoj të kundërtën në procedurë penale.

Në këtë mënyrë përmes konceptimit normativ, arsyetohet fajësia e personit juridik si dashje dhe pakujdesi. Dashja ekziston kur vepra shpreh vullnetin e personit juridik (p.sh.: veprimet korruptive të nxituara nga vetë personi juridik), ndërsa vepra konsiderohet se është kryer nga pakujdesia në rastet kur e njëjta ka ardhur si pasojë e një organizimi të dobët dhe të pamjaftueshëm të personit juridik për të evituar veprën e tillë (*culpa in vigilando*)⁴⁵ dhe kjo duhet të jetë baza e fajësimit të personave juridikë për vepra penale edhe sipas dispozitave të ligjit 04/L-030.

⁴³ Shih. Manna, A.: La responsabilità amministrativa delle persone-il punto vista del penalista, *Cassazione penale* 2003, fq.1101.

⁴⁴ Manduchi, C.: *cit.*, fq.2

⁴⁵ Shih Bozheku, E.: Kriteret për përgjegjësinë penale të personave juridikë nën profilin subjektiv, *Avokatia*, 2012, fq.37 dhe vazhdim.

Autonomia e përgjegjësisë penale të personit juridik në Kosovë (në kuptimin e një përgjegjësie penale paralele⁴⁶ në raport me atë të personit fizik) shprehet në nenin 5, parag.2, ku parashihet se personi juridik është përgjegjës për veprë penale edhe nëse personi përgjegjës që ka kryer veprën penale nuk është dënuar për atë veprë.⁴⁷

Mirëpo, në kontradiktë të thellë me përcaktimin paraprak është dispozita tjetër (*parag.3*) ku parashihet se përgjegjësia e personit juridik bazohet në fajësinë e personit përgjegjës. Gjithashtu ligji përcakton se elementët subjektive të veprës penale të cilat ekzistojnë vetëm të personi përgjegjës do të çmohen në raport me personin juridik (*parag.4*).

Ky përcaktim i ligjvënësit në Kosovë, krijon paqartësi dhe bie në kundërshtim me parimin themelor mbi përgjegjësinë penale të personit juridikë, sepse fajësia e tij kuptohet dhe afirmohet vetëm në aspektin normativ (që konsiderohet edhe “çelësi” i pranimit të përgjegjësisë penale për personin juridik), dhe nuk mund të kushtëzohet me dashjen apo pakujdesinë e personit fizik, sipas kriterit psikologjik të fajësisë (koncepti tradicional).⁴⁸ Kjo zgjidhje kontradiktore e ligjit 04/L-030, e vështirëson provimin e fajësisë së personit juridik, sidomos në raste kur personi përgjegjës nuk ndëshkohet, sepse me fajësinë e tij ligjvënësi e ka lidhur edhe përgjegjësinë penale të personit juridik. Në anën tjetër, kjo e vë edhe personin juridik në pozitë të pafavorshme para gjykatës në rastet e tjera, kur duhet të ndëshkohet personi fizik, që sipas zgjidhjes së dhënë nënkupton fajësinë automatike të personit juridik për arsye të thjeshtë se vepra penale është kryer në emër të tij, pavarësisht qëndrimit apo raportit të personit juridik me veprën e tillë, duke i pamundësuar që të provoj pafajësinë.⁴⁹

Nga dispozitat e ligjit 04/L-030, del se problematika themelore e tij është përcaktimi jo i qartë i bazës së përgjegjësisë penale për personin juridik. Në këtë drejtim problem fundamental e shohim mungesën e përcaktimit kriterive të qarta formale, përmes parashikimit të një modeli organizues dhe te kontrollit efektiv (*compliance program*) për personin juridik, si kriter kryesor i provimit të fajësisë apo pafajësisë së personit juridik. Kjo do të ishte zgjidhje adekuat

⁴⁶ Kambovski, V.: E drejta penale, (*Pjesa e Përgjithshme*), Shkup, 2010;

⁴⁷ Në praktikë mund të paraqiten situata kur për arsye të ndryshme personi përgjegjës nuk mund të ndëshkohet për veprën penale të kryer në emër dhe dobi të personit , si p.sh kur pas kryerjes së veprës penale e humb aftësinë për të qenë i përgjegjshëm, arratiset, vdes, etj. Në situata të tilla përgjegjësia penale e personit juridik nuk mund të përjashtohet , andaj edhe përcaktimi i ligjvënësit në këtë rast është i drejtë.

⁴⁸ Për një analizë edhe me të thellë mbi këtë aspekt shih edhe: Bozheku, E., Elezi, I. cit. fq. 296 dhe vazhdim, Bozheku, E.: Fajësia – disa aspekte teorike, metodologjike, funksionale dhe praktike të elementit të dytë të veprës penale, E Drejta/Law, Prishtinë, n.2/2010; Ramacci,F.: Corso di diritto penale, II ed., Torino, 2011; etj.

⁴⁹ Puka, A.: Considerazioni sulla responsabilità degli enti in Kosovo, Riv. *Collona Roma, Sapienza*, 2015, fq.137.

në pajtim me parimin e konceptimit normativ të fajësisë dhe do të ishte në harmoni me qëllimin e ndëshkimit të personave juridikë për vepra penale.

Ekzistimi i një kulture organizimi (që në sistemin anglosakson është njohur me termin “*corporate culture*”) si sistem i vlerave, mënyrë e organizimit dhe kontrollit, mbi bazën e të cilave duhet të ushtroj veprimtarinë e tij personi juridik, në vazhdimësi ka qenë temë e diskutimit në doktrinën botërore në raport me aplikimin e përgjegjësisë penale.⁵⁰ Mundësia e jetësimit të një “*corporate culture*” të personat juridikë është kuptuar edhe si shmangie e presionit që drejtuesit e personit juridik mund të bëjnë ndaj punonjësve të nivelit me të ulët me qëllim që këta të fundit të realizojnë edhe veprime të kundërligjshme për ti sjelle dobi personit juridik.⁵¹ Por në këtë drejtim gjithmonë duhet të jemi të kujdesshëm sepse rregullat e përgjithshme të organizimit (*corporate culture*⁵²) që mund të ketë një person juridik, nuk mund të jenë zëvendësim i një “modeli organizimi dhe kontrolli efektiv” (Compliance programe) që dedikohet ekskluzivisht për parandalimin e veprave penale.

Në këtë drejtim, mungesa e kriterëve ligjore për provimin e pafajësisë nga personi juridik, që do të detyronte ata që të miratojnë një “*compliance program*” për këtë qëllim (në pajtim me ligjin), është edhe mangësia kryesore e ligjit 04L-030 dhe e ligjeve të miratuara në shumë vende mbi përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, me përjashtim të disa vendeve, si p.sh. Italia, ku ligji⁵³ përcakton në mënyrë taksative se personi juridik nuk do të përgjigjet për veprën penale nëse mund të provojë para gjykatës pafajësinë e tij në bazë të kriterëve të ligjit.

⁵⁰ Ibidem.

⁵¹ Henning, P.J.: Corporate criminal liability and the potential for rehabilitation, *Wayne State University Law School, Legal Studies Paper Series no.09-21, 2009*, fq.15

⁵² Një “*corporate culture*” të personat juridikë në kuptim të parandalimit të veprave penale mund të funksionoj dhe të jetë bazë për evitimin e fajësisë, vetëm nëse personi juridik ka një model organizimi dhe kontrolli efektiv (*compliance program*) të dedikuar për këtë qëllim, që në mënyrë taksative përcakton masat që ndërmer në vazhdimësi për të parandaluar punonjësit e tij nga kryerja e veprave penale, si dhe të ketë një organ kontrolli mbi efektshmërinë e këtyre masave. Një model i tillë duhet që të jetë i zbatueshëm dhe të mund të provohet si i mjaftueshëm për parandalimin e veprave penale, në mënyrë që personi juridik të mund të provojë pafajësinë e tij në gjykatë, ose të paktën të ketë zbutje të dënimit. Në rast të procedimit penal, nga personi juridik që pretendon pafajësinë kërkohet që të provoj se ka marrë masa adekuate që vepra penale të mos ndodh, dhe se ajo është kryer me fajin e personit përgjegjës duke mos zbatuar vendimet dhe rregullat e personit juridik. Nuk mund të jetë bazë e mjaftueshme për evitimin e përgjegjësisë penale, një “*corporate culture*” e përgjithësuar e personit juridik, i cili me akte të caktuara përcakton rregulla të përgjithshme për sjelljen e punonjësve të tij.

⁵³ Ligji italian nr. 231/2001 mbi përgjegjësinë administrative të personave juridikë për vepra penale. Për një njohje me të thellë të modelit Italian, shih Fiorella, A. & Lancellotti, G.: La responsabilità dell’impresa per i fatti da reato, *Torino, 2004*; Vinciguerra, S. & Gastaldo, C.M. & Rossi, A.: La responsabilità dell’ente per il reato commesso in suo interesse, *Padova, 2004.*; Manduchi, C.: The introduction of corporate “criminal” liability in Italy, *Diritto&Diritti* (<http://www.diritto.it>) 2010; Lattanzi, G: Reati e responsabilità degli enti, *Milano, 2005.*; etj.

Në përgjithësi ligjet mbi përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, parashohin mundësinë që gjykata të bëjë zbutjen e dënimeve kur provohet se personi juridik ka pasur një “compliance program” në kohën e kryerjes së veprës penale,⁵⁴ apo duke u bazuar në vetë raportimin e shkeljes ose pranimin e fajësisë⁵⁵, si tregues se ka “vullnetin” që në të ardhmen të mos veproj në kundërshtim me normat që janë në fuqi, dhe të shmanget nga veprimtaria e kundërligjshme e subjekteve që e përfaqësojnë. Edhe në sistemin italian, ekzistimi dhe efikasiteti i një modeli organizimi dhe organi mbikëqyrës mundëson evitimin e përgjegjësisë për vepra penale ose të paktën një reduktim i sanksionit.⁵⁶

Ngjashëm me modelin italian, edhe ligjvënësi i Kosovës me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit duhet të parashoh kritere formale mbi të cilat personi juridik mund të provoj se është i pafajshëm për veprën penale që është kryer në emër dhe dobi të tij, nëse arrin të provoj se ka ndërmarrë të gjitha masat që vepra penale e tillë të mos ndodh dhe se në asnjë mënyrë nuk ka kontribuar (në mënyrë aktive ose pasive) që ajo vepër të kryhet.⁵⁷ Si pjesë përbërëse të një “compliance program” të personit juridik në Kosovë do të duhej të jenë: a) Modeli (Programi) i organizimit, *ku të paktën, duhet të përcaktohet saktë mënyra e funksionimit të personit juridik, mënyra e marrjes së vendimeve dhe masat që aplikohen për parandalimin e veprave penale*, dhe b) Organi mbikëqyrës (i kontrollit), *i cili duhet të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm mbi subjektet e personit juridik që duhet të zbatojnë modelin dhe të kujdeset që ky model të ndryshohet dhe plotësohet në vazhdimësi, që të jetë efikas për parandalimin e veprave penale*.

Jemi të mendimit, se edhe me legjislacionin aktual të Kosovës, në rastet kur personi juridik arrin të provoj se ka ndërmarrë masa për parandalimin e veprës penale, se ka një kod ose rregullore të brendshme për këtë qëllim, kjo duhet të ketë për efekt mundësinë e përjashtimit të fajësisë ose zbutjes së dënimit, ose edhe efektin e shqiptimit të masave siguroese me të lehta kundrejt personit juridik. Kjo do të ishte edhe një mënyrë që do të minimizonte rrezikun e interpretimit jo të drejtë të dispozitave aktuale të nenit 5 të ligjit 04/L-030.

⁵⁴ Pieth, M., Ivory, R.: cit. fq.44.

⁵⁵ Nanda, V. P.: Corporate Criminal Liability in the United States: Is a New Approach Warranted?, *Ius Gentium*, cit. fq.71.

⁵⁶ Manduchi, C.: *cit.*, fq. 3

⁵⁷ Në lidhje me kriteret e një kontrolli të brendshëm për personat juridikë, detyrimin e tyre që të kenë një etikë dhe të miratojnë një “compliance program”, rëndësi të posaçme në kuadrin e dokumenteve ndërkombëtare ka edhe Udhëzuesi i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) me titull: “*Good Practice Guidance on Internal Controls, Ethics and Compliance*”.

3.2 Dënimet dhe sanksionet e tjera penalo-juridike ndaj personit juridik sipas ligjit 04/L- 030

Përveç problematikës së konceptimit të fajësisë për personat juridikë, teoricienët që kanë aderuar në teorinë e fiksionit (e mbështetur në parimin “*societas delinquere non potest*”) si pengesë për zbatimin e përgjegjësisë ndaj etniteteve juridike e kanë konsideruar edhe pamundësinë apo vështirësinë e aplikimit të sanksioneve penale ndaj tyre.

Një nga argumentet themelore të këtyre teoricienëve kundër përgjegjësisë penale për personin juridikë, është bazuar në pamundësinë që ndaj tyre të aplikohet dënimi me burgim (si sanksion tipik penal) dhe disa masa të tjera të natyrës penale, dhe përgjithësisht është konsideruar e vështirë përshtatja e masave penale për personat juridikë.⁵⁸ Një qëndrim i tillë mbahet edhe sot nga shtetet që nuk kanë pranuar institutin e përgjegjësisë penale për personat juridikë, dhe që kryesisht bazohen në ekonominë e kontrolluar nga shteti.⁵⁹

Mirëpo, sot me rregullimin e përgjegjësisë së personave juridikë për vepra penale nga shumica e legjislacioneve botërore, nuk paraqitet si problem sistemi i sanksioneve penale ndaj tyre, madje edhe sanksionet penale justifikohen si masa subsidiare në raport me sanksionet civile⁶⁰ që nuk kanë qenë të mjaftueshme për parandalimin e kriminalitetit të personave juridikë.

Varësisht nga modeli i konceptimit të përgjegjësisë së personave juridikë për të cilin janë përcaktuar vendet e ndryshme, mund të bëjmë një ndarje të sistemit të sanksioneve kundrejt personave juridikë në:

⁵⁸ Wagner, M.: Corporate Criminal Liability – National and International Responses, *International Society for the Reform of Criminal Law 13th International Conference Commercial and Financial Fraud: A Comparative Perspective Malta, 8-12 July 1999*, fq.2

⁵⁹ Shih Cheng Yang, V.: Developments in Criminal Law and Criminal Justice: Corporate Crime-State-Owned Enterprises in China, *Crim.L.F.14*, fq.1 dhe vazhdim. Derisa përgjegjësia penale e personave juridikë është imponuar nga fuqizimi i korporatave në sistemet kapitaliste, është e natyrshme që në vendet me ekonomi të kontrolluar nuk është aplikuar ky institut. Konsiderojmë se ky ka qenë edhe një nga faktorët pse vendet e ish bllokut socialist (Shqipëria, vendet e ish-Jugosllavisë, etj.) kanë heziturur një kohë të gjatë për të pranuar përgjegjësinë penale të personave juridikë.

⁶⁰ Neumann Vu, S.: Corporate Criminal Liability: Patchwork verdicts and the problem of locating a guilty agent, *Columbia Law Review (104 Colim.L.Rew.459) 2004*, fq.11

- *Sanksione të natyrës administrative* (p.sh. Gjermania, e cila nuk ka aderuar në modelin e përcaktimit të përgjegjësisë penale për personat juridikë, siç kanë vepruar pjesa më e madhe e shteteve evropiane, të cilat kanë pranuar modelin e vendeve të sistemit “*Common law*”⁶¹);
- *Sanksione gjysmë penale apo administrative-penale* (Italia);
- *Sanksione penale* (vendet që kanë pranuar përgjegjësinë penale të personave juridikë).

Si sanksione që mund të shqiptohen ndaj personit juridik në Kosovë sipas ligjit 04/L-030 janë: dënimet, dënimi me kusht dhe masat e sigurisë. Si dënime parashihen dënimi me gjobë dhe pushimi i personit juridik (neni 8).

Dënimi me gjobë është dënimi me i aplikueshëm kundrejt personave juridikë dhe më i përshtatshëm për të ndikuar në parandalimin e kriminalitetit të personave juridikë⁶² i cili parashihet si zëvendësim i dënimit me burgim që aplikohet ndaj personave fizikë për vepra penale të caktuara dhe ekuivalentohet me të. Sa për ilustrim p.sh: në nenin 9, (*parag.2, nënparag.2.1*) të ligjit 04/L-030 përcaktohet se: “*për veprat penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim nga pesëmbëdhjetë (15) ditë deri në tri (3) vite, Gjykata mund të shqiptoj dënim me gjobë, nga një mijë (1.000) gjer në pesë mijë (5.000) Euro.* Një model i tillë i ekuivalentimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë për personin juridik është edhe në vendet e tjera, si p.sh në Kroaci ku për dënimin me burgim mbi 15 vite që parashihet për personin fizik, për të njëjtën veprë personi juridik mund të dënohet me dënim me gjobë prej 2800 deri 685.000 euro (afërsisht sepse dënimi me gjobë në ligjin kroat është përcaktuar me valutën vendore).⁶³

Në ligjin 04/L-030 dënimi me gjobë përcaktohet në nenin 9, ku në *parag.1* parashihet se: “*Për veprat penale të personave juridikë dënimi i paraparë me gjobë nuk mund të jetë më i vogël se një mijë (1.000) Euro dhe më i lartë se njëqind mijë (100.000) Euro.*” Kur kemi parasysh se për nga natyra e tij, dënimi me gjobë është më i përshtatshëm dhe me shpesh zbatohet kundrejt personave juridikë, konsiderojmë se kufiri i lartë i këtij dënimi në Kosovë (100.000 euro) është shumë i ulët për personin juridik. Madje kjo dispozitë nuk ka marrë në konsideratë edhe përcaktimin e Kodit Penal të Kosovës, i cili për vepra penale

⁶¹ Për një studim me të thellë krahasues midis sanksioneve administrative që aplikohen në sistemin gjerman për personat juridikë dhe sanksionet penale në sistemin amerikan, shih Diskant, E.B.: Comparative Corporate Criminal Liability: Exploring the Uniquely American Doctrine Through Comparative Procedure, *The Yale Law Journal*, 2008, fq. 128-172.

⁶² Jefferson, M.: Corporate Criminal Liability: The problem of sanctions, *Journal of Criminal Law (JCL65(235))*, 2001, fq. 2 dhe vazhdim.

⁶³ Kučić, V., Crnković, A.: Criminal Liability of Companies in Croatia, *Lex Mundi*, 2008, fq.1-2.

të personave fizikë që kryhen në lidhje me terrorizmin, trafikimin me njerëz, krim të organizuar ose veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, parasheh se dënimi me gjobë mund të jetë deri në pesëqind mijë (500.000) euro (neni 46 i KPK). Në anën tjetër, edhe nga analiza e legjislacionit të vendeve tjera (Shqipëri, Maqedoni, etj.) shihet se maksimumi i dënimit me gjobë për personat juridikë është afërsisht 500.000 euro. Për me tepër kur merret në konsideratë natyra e veprave penale që kryejnë personat juridikë (kryesisht ekonomike) del se ky përcaktim i dënimit me gjobë në Kosovë nuk është i menduar mirë nga ana e ligjvënësit, përveç se tregon një mungesë të harmonizimit me përcaktimet e Kodit Penal. Ndryshimi i kësaj dispozite ka qenë në mesin e disa propozimeve gjatë fazës së miratimit të ligjit 04/L-030.

Sipas nenit 10, me rastin e matjes së dënimit me gjobë, gjykata duhet të marrë në konsideratë edhe rrethanat si: pasojat që kanë lindur ose kanë mundur të lindin; rrethanat në të cilat është kryer vepra penale; fuqinë ekonomike dhe madhësinë e personit juridik; sjelljen e personit juridik pas kryerjes së veprës penale, etj.

Sikurse në shumicën e legjislacioneve në botë edhe në ligjin e Kosovës parashihet dënimi i pushimit të personit juridik (neni 11). Shqiptimi i këtij dënimi kufizohet vetëm për rastet kur personi juridik është themeluar me qëllim të kryerjes së veprave penale apo veprimtarinë e ka shfrytëzuar kryesisht për kryerjen e veprave penale (*parag.1.*). Ky dënim që në doktrinë krahasohet me dënimin me vdekje që është aplikuar për personat fizikë, paraqet dënimin me të rëndë në kuadër të sistemit të dënimeve për personat juridikë. Si i tillë ky dënim mund të jetë i domosdoshëm në rastet e veprave penale të rënda, siç janë ato në lidhje me terrorizmin, format e ndryshme të krimit të organizuar, dhe në të gjitha rastet kur dënimi me gjobë dhe masat e tjera konsiderohen si të pamjaftueshme për të parandaluar kriminalitetin e personit juridik konkret.

Ligji 04/L-030 në nenin 12 e përcakton dënimin me kusht. Me dënimin me kusht gjykata mund t'i përcaktojë personit juridik dënimin deri në pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, por që ky dënim mos të ekzekutohet në qoftë se personi juridik i dënuar për kohën në të cilën e cakton gjykata, e që nuk mund të jetë më e shkurtër se një dhe as më e gjatë se dy (2) vjet (koha e verifikimit), nuk kryen ndonjë vepër të re penale që ka elementet e veprës penale në kuptim të nenit 5 të ligjit në fjalë.

Në nenin 13 janë paraparë këto lloje të masave siguruese: *ndalimi i kryerjes së veprimtarive dhe punëve të caktuara; marrja e sendit; konfiskimi i dobisë pasurore dhe shpallja publikisht e aktgjykitimit.*

Në Kreun IV të ligjit 04/L-030 është përcaktuar procedura që duhet të zbatohet gjatë gjykimit të personave juridikë.

Në ligj parashihet se për veprën penale të personit juridik dhe të personit përgjegjës ngritët dhe zbatohet procedura unike dhe nxirret një aktgjykim (neni 18, *parag.1*). Ndërsa në paragrafin vijues shprehet pavarësia e personit juridik në raport me personin përgjegjës edhe në aspektin procedural, ku thuhet se në rastet kur për shkaqe ligjore dhe shkaqe tjera nuk mund të ngritët apo zbatohet procedura penale kundër personit përgjegjës, procedura do të filloj dhe zbatohet vetëm kundër personit juridik. (*parag.2*). Në vazhdim në nenet 19-30 të ligjit 04/L-030 rregullohen aspektet tjera procedurale si: kompetenca territoriale, përfaqësimi i personit juridik të pandehur, dërgimi i vendimeve dhe shkresave personit juridik, zhvillimi i seancave gjyqësore, përmbajtja e aktgjykimit, etj.

Një përcaktim i veçantë i ligjit 04/L-030 është edhe parashikimi i masave të kujdesit që gjykata mund ti shqiptojë ndaj personit juridik në qoftë se rrethanat e veçanta arsyetojnë frikën se personi juridik i pandehur do të përsëritë veprën penale apo do të përfundoj veprën penale të tentuar, ose do të kryej vepër penale me të cilën kërcënon. Si masa të tilla parashihen: *ndalimi i kryerjes së veprimtarive dhe punëve të caktuara; ndalimi i afarizmit me llogaritë shtetërore dhe lokale; si dhe ndalimi i fitimit të lejeve, autorizimeve, koncesioneve dhe subvencioneve (neni 31)*.

4. Përfundim

Përgjegjësia penale e personave juridikë është normuar në legjislacionet e shumicës së vendeve, por vazhdon të jetë një ndër temat me të debatueshme në kuadër të sistemeve juridike, me tendencë të harmonizimit me parimet e së drejtës penale.

Pas një tradite të gjatë në sistemin “Common law”, në dekadat e fundit përgjegjësia penale për personat juridikë është pranuar edhe në vendet që janë pjesë e sistemit “Civil law” (me përjashtim të Gjermanisë që aplikon përgjegjësinë administrative, dhe Italisë që është përcaktuar për një model të masave gjysmë penale), si një përgjigje ndaj nevojës për t’u mbrojtur nga kriminaliteti i personave juridikë. Arsyetimi i aplikimit të përgjegjësisë penale drejtpërdrejt në personin juridik, qëndron në vetë ndikimin e fuqishëm dhe pozicionin që personat juridikë (privat) kanë në shoqëri.

Sfidë e shteteve që e kanë pranuar përgjegjësinë penale për personin juridik, mbetet që të përcaktojnë kritere ligjore sa me të sakta për aplikimin e kësaj përgjegjësie. Një nevojë e tillë mbetet aktuale edhe edhe për ligjvënësin e

Kosovës, që me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit 04/L-030, të rregulloj ato aspekte që paraqesin problem për një zbatim të arsyeshëm të përgjegjësisë penale për personat juridikë.

Një nga aspektet themelore që kërkon sqarim nga ana teorike dhe praktike mbetet vetë konceptimi i fajësisë së personave juridikë. Për një definim të saktë të kësaj problematike si zgjidhje është konceptimi normativ i fajësisë së personit juridik, për dallim nga konceptimi psikologjik apo psikologjik-normativ i fajësisë për personin fizik. I takon prokurorisë dhe gjykatës që përgjegjësinë penale të personave juridikë ta provoj në mënyrë paralele me përgjegjësinë e personit fizik, si një përgjegjësi autonome edhe pse derivon nga vepra penale e kryer nga personi fizik(përgjegjës). Kjo nënkupton se fajësia e personit juridik bazohet në sjelljen e tij, politikën afariste që ka zbatuar, dhe masat që ka ndërmarrë me qëllim të parandalimit të veprave penale.

Me qëllim të krijimit të një baze juridike me të qartë mbi përgjegjësinë e personave juridikë në Kosovë, është e nevojshme që me ligj të përcaktohet detyrimi i personave juridikë që të miratojnë modele organizimi dhe kontrolli efikas (compliance program) dhe kjo të jetë baza e provimit të fajësisë apo pafajësisë së tyre.

Megjithatë, edhe me legjislacionin aktual, ekziston një kornizë ligjore që mundëson ndjekjen dhe gjykimin e personave juridikë, për veprat penale që mund të kryhen në emër dhe dobi të tyre. Disa nga aspektet të cilat mund të jenë të paqarta në ligjin për përgjegjësinë e personave juridikë, mund të tejkalohe nga një interpretim i legjislacionit penal në fuqi, në radhë të parë duke u bazuar në dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

BIBLIOGRAFIA

I. Literatura:

Bohlander, M.: Principles of German Criminal Law, *Studies in International & Comparative Criminal Law*, Oxford, 2009.

Bozheku, E.: Fajësia – disa aspekte teorike, metodologjike, funksionale dhe praktike të elementit të dytë të veprës penale, *E Drejta/Law*, Prishtinë, n.2/2010.

Bozheku, E.: Kriteret për përgjegjësinë penale të personave juridikë nën profilin subjektiv, *Avokatia*, 2012.

Böse, M.: Corporate Criminal Liability in Germany – Corporate Criminal

Liability. Ed.Rodha, I. & Pieth, M., *Basel 2011*.

Cheng Yang, V.: Developments in Criminal Law and Criminal Justice: Corporate Crime-State- Owned Enterprises in China, *Crim.L.F.14*

De La Questa, J.L.: Criminal Responsibility of Legal Persons in Spanish Law, *International Review of Penal Law, AIDP/IAPL*, 84,1/2, 2013.

De Maglie, C.: L'etica e il mercato. La responsabilità penale delle società, *Giuffrè, 2002*

De Maglie, C.:; Societas Delinquere Potest? The Italian Solution. Ed.by Pieth,M. & Ivory, R. – Corporate Criminal Liability, *Ius Gentium: Comparative Perspectives on Law and Justice 9, Basel, 2011*.

Diskant, E.B.: Comparative Corporate Criminal Liability:Exploring the Uniquely American Doctrine Through Comparative Procedure, *The Yale Law Journal, 2008*.

Fiorella, A., Lancelloti, G.: La responsabilità dell'impresa per i fatti da reato, *Torino, 2004*.

Galli, M.: Incidenza pratica dell'art. 25 quater d.lgs. 231/2001 e prospettive future in materia di applicazione dello stesso, *in Riv. La resp. amm. soc. ent., n. 2, 2008*.

Ginter, J.: Criminal Liability of Legal Persons in Estonia, *Juridica International, XVI/2009*.

Henning, P.J.: Corporate criminal liability and the potential for rehabilitation, Wayne State University Law School, *Legal Studies Paper Series no.09-21, 2009*.

Jefferson, M.: Corporate Criminal Liability: The problem of sanctions, *Journal of Criminal Law (JCL65(235)), 2001*.

Kambovski, V.: E drejta penale- pjesa e përgjithshme, *Shkup 2010*.

Kambovski, V.: Korniza juridiko-penale e parandalimit të kriminalitetit të organizuar, *Kriminaliteti i organizuar – aspekte juridike, Tetovë, 2009*.

Kučić, V., Crnković, A.: Criminal Liability of Companies in Croatia, *Lex*

Mundi, 2008.

Lattanzi, G.: Reati e reponsabilità degli enti, *Milano, 2005.*

Mahajan, K. : Corporate Criminal Liability: Why Corporations are preferred and not the employees?, *Company Law Journal, Vol. 4, 2008.*

Manduchi, C.: The introduction of corporate “criminal” liability in Italy, *Riv. Diritto&Diritti, 2010, www.diritto.it/docs/30795*

Manna, A.: La responsabilità amministrativa delle persone-il punto vista del penalista, *Cassazione penale 2003.*

Molan, M., Lanser, D.; Bloy, D.: Principles of Criminal Law, *4th ed. London, 2000.*

Nanda, V. P.: Corporate Criminal Liability in the United States: Is a New Approach Warranted?, *Ius Gentium: Comparative Perspectives on Law and Justice 9, Basel, 2011.*

Neumann Vu, S.: Corporate Criminal Liability: Patchwork verdicts and the problem of locating a guilty agent, *Columbia Law Review (104 Colim.L.Rew.459) 2004.*

Pieth, M. & Ivory, R., Emergence and Convergence: Corporate Criminal Liability Principles in Overview – Corporate Criminal Liability, *Ius Gentium: Comparative Perspectives on Law and Justice 9, Basel, 2011.*

Puka, A.: A theoretical observation on the liability of legal entities for criminal offences - an European perspective, *Riv. Archivio Penale, 2015/2.*

Puka, A.: Considerazioni sulla responasabilità degli enti in Kosovo, *Riv. Collona Roma, Sapienza, 2015.*

Ramacci, F.: Corso di diritto penale, Torino, 2005. Ramacci,F.: Corso di diritto penale, II ed., *Torino, 2011.*

Rodriguez, L.Z.: Corporate Criminal Liability : Responsibility of legal persons for offenses in the European context, ISISC, *Siracusa, 2008.*

Santha, F.: Criminal responsibility of legal persons in Hungary – theory an (a lack of) practice, (<http://www.upm.ro/proiecte/EEE/Conferences/papers/>

SIA38.pdf{02.03.2014}.

Savigny, C.v.F: Sistema del diritto romano attuale, Volume II, Bologna, 1900.
Tiedman, G.: La responsabilità penale delle persone giuridiche, in *Riv. it. Dir. Proc. pen.* 1993.

Vinciguerra, S., Gastaldo, C.M., Rossi, A.: La responsabilità dell'ente per il reato commesso in suo interesse, *Padova*, 2004.

Wagner, M.: Corporate Criminal Liability – National and International Responses, *International Society for the Reform of Criminal Law 13th International Conference Commercial and Financial Fraud: A Comparative Perspective Malta, 8-12 July 1999*.

Weigent, Th.: *Societas delinquere non potest? – A German Perspective*, *Oxford University Press*, 2008, *ICJ* 65 (927).

Zapatero, A. L. : Die strafrechtliche Verantwortlichkeit der juristischen Personen in Spanien. In: *Schulz et al. (eds) Festschrift für Imme Roxin. Muller, Heidelberg*, 2012.

II. Aktet juridike:

Act on the Responsibility of Legal Persons for the Criminal Offences, *Croatia, Official Gazette no. 151/2003*.

Dutch Penal Code (*Wetboek van Strafrecht*) (*DPC*), 1976.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* /Nr.19/13 Korrik 2012.

Kodi Përkohshëm Penal i Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/25. Ligji i Kosovës nr.02/L-123 për shoqëritë tregtare.

Ligji i Kosovës nr.04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale Ligji mbi deliktet ekonomike, “Gazeta Zyrtare” e ish-Jugosllavisë, nr. 10/86.

The OECD Good Practice Guidance on Internal Controls, Ethics & Compliance, 2010.

Besnik Berisha jur. i dip.

INTERESI JURIDIK NË PROCEDURËN CIVILE

ABSTRAKT

Në jetën e përditshme të drejtat e përcaktuara në të drejtën materiale, shpesh mund të cenohen nga subjektet e së drejtës. Në praktikë, palët të cilëve iu është cenuar e drejta, e kanë një interes juridik për të kërkuar mbrojtjen gjyqësore.

Në artikullin “Interesi juridik në procedurën civile”, shpjegohet fillimisht nocioni “interes juridik”, me vështrim të veçantë në procedurën civile. Për të vazhduar me shtjellimin e interesit juridik në kontestet me vlerë të vogël, ndërlihdhet e interesit juridik karshi llojeve të padive si dhe ndërhyrësit e tretë në procedurën civile.

Dhe në fund kemi konkluzionin e artikullit në të cilin paraqitet një përmbledhje e gjithë punimit dhe mendimet rreth dilemave dhe çështjeve të ngritura, si rezultat i punimit.

Fjalët kyqe: interes juridik, mbrojtje gjyqësore, e drejta, padi, ligj, ndërhyrës, mbrojtjes.

1. Interesi juridik në procedurën civile

Me interes juridik nënkuptojmë dobinë personale të një subjekti procedural për të kërkuar mbrojtjen gjyqësore, për të drejtën e tij subjektive. Interesin juridik për padi dhe kërkesëpadi duhet kuptuar si interes të veçantë të paditësit për të mbrojtur të drejtën e tij subjektive, të cënuar ose të rrezikuar për t’u cenuar në të ardhmen. Sipas nenit 2 pikës 4 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të Republikës së Kosovës, çdo palë në procedurën civile duhet të ketë interes juridik për padinë, si mjet juridik, dhe për veprimet tjera procedurale që kryhen gjatë procedurës, pra, siç shihet, LPK-ja i ka kushtuar një rëndësi të veçantë interesit juridik, duke e ranguar atë në nenet e para të ligjit, si një ndër premisat e para që duhet pasur parasysh para fillimit të procedurës civile. Interesi juridik, si nocion proceduralo-juridik, është i ndërlidhur ngushtë me subjektet e së drejtës dhe mjetet juridike (padinë). Për të plotësuar më mirë kuptimin e termit interes juridik i referohemi edhe nenit 254.2 LPK.¹

Në praktikë, të drejtat subjektive mund të cenohen nga vetë subjektet e së

* Autori i këtij shkrimi është jurist i diplomuar dhe master në process në drejtimin juridiko civil.

¹ Shih Ligjin për procedurën kontestimore, neni 254.2 i Republikës së Kosovës, Pjesa e dytë, Kreu XV

drejtës. Rrjedhimisht, paraqitet nevoja për mbrojtjen gjyqësore të këtyre të drejtave (ultimate ratio), përkatësisht paraqitet interesi i njëmend juridik për mbrojtjen gjyqësore të atyre të drejtave. Pasi që parimisht, sistemi juridik i vendit tonë nuk lejon vetëgjyqësinë si formë për mbrojtjen e të drejtës subjektive (përveç në disa raste të caktuara), atëherë, duhet kërkuar mbrojtja gjyqësore për të mbrojtur të drejtën e cenuar apo që rrezikohet të cenohet në të ardhmen, nëse gjykata nuk lëshon një aktgjykim në favor të paditësit.

Mbrojtja juridike nga gjykata duhet dhënë vetëm në ato raste në të cilat pa intervenimin e saj, subjekti i së drejtës nuk mund ta realizoj interesin për mbrojtje juridike që i është pranuar me ligj.² Nga kjo rrjedh se në të drejtën formale, interesi juridik apo interesi për mbrojtje juridike si nocion proceduralo–juridik, është i ndryshëm nga e drejta materiale sepse në të drejtën formale interesi juridik paraqet interesin e veçantë të subjektit të së drejtës për të kërkuar mbrojtjen gjyqësore të së drejtës së tij, ndërsa në të drejtën materiale interesi juridik konsiderohet se është i mbrojtur me ligj. Pra në të drejtën formale, interesi juridik, paraqet premisë fillestare për inicimin e procedurës civile, ndërsa, në të drejtën materiale interesi juridik është i mbrojtur me ligj, siç mund të jetë edhe interesi ekonomik, politik apo i ndonjë natyre tjetër shoqërore.

Çdo individ që pretendon se i është cenuar e drejta e tij mund të kërkojë mbrojtje juridike të saj, pra me padi, mirëpo jo edhe çdo individ Gjykata do i'a pranoj padinë si të lejueshme po që se në kërkesëpadinë e tij nuk paraqitet interesi juridik i caktuar, në raport më të drejtën e rrezikuar/ cenuar.

2. Interesi juridik në çështjet juridike me vlerë të vogël sociale

Parimisht, siç u cek më lartë, gjykata kompetente, ex–officio ka për detyrë të ofrojë mbrojtje ligjore, për subjektin i cili pretendon se i është shkelur e drejta e tij. Mirëpo, përjashtimisht paraqitet dilema gjykata duhet të ofroj mbrojtje ligjore edhe nëse interesi juridik i palës paraqet vlerë të vogël apo të madhe sociale të kontestit. Lidhur me këtë çështje ekzistojnë mendime të ndryshme, disa mendojnë se gjykata nuk duhet ofruar mbrojtjen gjyqësore për arsye se vlera e vogël sociale nuk paraqet interes të njëmendtë juridik, gjë që nënkupton se nuk paraqet bazë të mjaftueshme për aprovimin e padisë si të lejueshme, ndërsa një grup tjetër i studiuesve, mendojnë se pavarësisht vlerës sociale, gjykata duhet të ofrojë mbrojtje ligjore edhe kur vlera sociale të jetë e vogël me kusht që kjo të mos konsiderohet si keqpërdorim i të drejtave procedurale.

² Brestovci, Faik: “E drejta procedurale civile I”, Prishtinë, Botimi 2006, faqe 161

Pavarësisht, vlerës sociale, nëse është e madhe apo e vogël, interesi juridik në raport me palën ka të njëjtin kuptim, pra është interes i veçantë i subjektit, për të kërkuar mbrojtjen gjyqësore të së drejtës së tij subjektive. Këtu, zakonisht dilema qëndron në faktin nëse, gjykata kompetente duhet t'i ofroj mbrojtjen juridike palës pretenduese apo jo për shkak të vlerës së vogël sociale të kontestit.

3. Padia dhe interesi juridik në procedurën civile

Padia si mjet i rregullt juridik i mundëson subjektit të së drejtës, që të drejtën e garantuar me ligj, ta mbroj përmes rrugës gjyqësore dhe atë duke iniciuar procedurën për mbrojtjen gjyqësore të së drejtës së tij të cenuar. Pra, padia, respektivisht dorëzimi i padisë në gjykatë, paraqet hapin e parë për fillimin e procedurës civile dhe njëherit shpreh interesin juridik të subjektit për të kërkuar mbrojtje gjyqësore të së drejtës së cenuar nga gjykata. Gjykimi i një çështje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadiisë me shkrim (padi detyrimi, vërtetimi dhe ndryshimi).³

Padia dhe interesi juridik kanë një lidhshmëri të ndërvarur, kjo për faktin se padia si mjet juridik lindë nga interesi juridik i palës për të ushtruar padi e po ashtu, interesi juridik paraqet bazë të mjaftueshme ose jo për lejimin e padisë, si padi e rregullt. Padia mund të ngritët për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur.⁴ Gjykata pas pranimit të padisë, përveç tjerave, shqyrton edhe nëse pala, e cila përmes kërkesëpadiisë pretendon se i është shkelur e drejta, ka një interes të caktuar dhe konkret juridik. Në këtë rast interesi juridik mund të jetë civil, penal, administrativ apo kushtetues. Nëse Gjykata konstaton se nuk ka një interes të njëmendtë të caktuar juridik për ofrimin e mbrojtjes gjyqësore mund ta hedh padinë poshtë për shkak të mungesës së interesit të caktuar juridik. Në këtë rast, si rrjedhojë, pala mund të ketë një interes të caktuar të natyrës politike apo ekonomike, mirëpo ky interes nuk paraqet bazë të mjaftueshme për fillimin e procedurës civile, respektivisht aprovimin e padisë si të bazuar dhe në këtë rast padia hidhet, si e palejueshme.

Interesi juridik, gjatë aplikimit në padi dhe kërkesëpadi të ndryshme, është i shprehur dhe duhet argumentuar tek disa derisa tek të tjerat nuk ka nevojë për argumentimin e interesit juridik, për arsye se ai nënkuptohet, pra ekziston supozimi juridik se pala ka një interes të caktuar juridik. Çështja e interesit juridik nuk paraqitet në mënyrë dhe masë të njëjtë tek të gjitha llojet e padive. Në vazhdim do të flasim për tri lloje të padive dhe interesin juridik në raport

³ Shih Ligjin për procedurën kontestimore, neni 252 i Republikës së Kosovës, Pjesa e dytë, Kreu XV

⁴ Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, neni 32 (ndryshuar me ligjin nr.17.05.2001 neni 5)

me to. Gjykata ex-officio ka për detyrë që të marrë në shqyrtim çdo kërkesë për mbrojtje juridike, edhe atëherë kur objektivist, parashtruesit të saj ndoshta as nuk i është rrezikuar e as nuk i është shkelur e drejta subjektive.⁵

4. Interesi juridik krahas llojit të padisë

Padia e detyrimit është padi me anë të së cilës paditësi kërkon nga gjykata që më aktgjykim të urdhëroj të paditurin që në dobi të paditësit të përmbushë një prestim të caktuar që buron nga ndonjë punë juridike. Interesin juridik për këtë lloj të padisë e ka çdo kreditor ndaj të cilit debitori nuk e përmbush vullnetarisht detyrimin.⁶ Tek ky lloj i padisë, gjykata nisët nga ajo se paditësi ka një interes të caktuar juridik (interes ky që dëshmohet përmes punës juridike ose vetë ligjit) me vetë faktin se po të njëjtit i duhet ta fitoj titullin ekzekutiv për realizimin e detyrueshëm të së drejtës së tij subjektive, pra me anë të padisë së detyrimit, paditësi (kreditori) kërkon nga gjykata që me Aktgjykim, ta urdhëroj, të paditurin, që në dobi të paditësit ta përmbush një prestim të caktuar (të kthej borxhin, të dorëztoj sendin etj.). Me anë të këtij aktgjykimi, kreditori e fiton dokumentin ekzekutiv (titulus executionis) me anë të së cilit, prapëseprapë, në procedurën përbarimore me ndihmën e gjykatës e realizon të drejtën e tij subjektive. Pra, në këtë rast interesi juridik (dobia juridike) e kreditorit është e pamohueshme dhe kjo paraqet fazën finale për realizimin e dobisë juridike të paditësit (kreditorit). Tek ky lloj i padisë, gjykata nuk kërkon që të dëshmohet interesi juridik i caktuar për arsye se ekziston supozimi juridik, siç edhe u cek me lartë.

Padia e vërtetimit paraqet mjetin juridik me anë të së cilit, paditësi i propozon gjykatës që të konstatohet një raport juridik.⁷ Si kusht elementar për paraqitjen e një padie vërtetimi është interesi juridik i palës paditëse.⁸ Pra, për dallim nga padia e detyrimit, që u cek më lartë, padia e vërtetimit nuk kërkon nga gjykata që të sjell aktgjykim për realizimin e ndonjë prestimi të caktuar, mirëpo kërkohet nga gjykata që të konstatoj, respektivisht me aktgjykim të vërtetojë, që ekziston apo jo një raport i caktuar juridik. Padia e këtillë mund të ngrihet kur është përcaktuar me dispozita të veçanta, por edhe në rastet kur paditësi ka interes juridik që gjykata të vërtetojë ekzistimin ose jo të ndonjë të drejte apo të ndonjë raporti juridik; po ashtu, edhe në rastet kur kërkohet vërtetësia e ndonjë dokumenti para se të bëhet e nevojshme kërkesa për prestim nga raporti

⁵ Brestovci, Faik, *E drejta procedurale civile I*, Prishtinë, Botimi 2006, fq. 161.

⁶ Brestovci, Faik, *E drejta procedurale civile I*, Prishtinë, Botimi 2006, fq. 162.

⁷ Pozniq Borivoje, *E drejta e procedurës civile*, Botimi i dytë 1981, fq. 233.

⁸ Morina, Iset & Nikqi, Selim, *Komentari i Ligjit për procedurën kontestimore*, Botim i parë 2012, fq. 463.

i njëjtë.⁹ Për dallim nga llojet e tjera të padisë, tek padia e vërtetimit gjykata nga pala kërkon që të provohet se ekziston interesi juridik.

Padia e ndryshimit si mjet juridik, dallon në thelb nga dy llojet e lartcekura të padisë. Me padi të ndryshimit nënkuptojmë kërkesën e paditësi për ndryshimin e një raporti të caktuar juridik. Parimisht, me anë të aktgjykimit nuk mund të krijohen, të ndryshohen apo të shuhen marrëdhëniet juridike civile, por as të drejtat e subjekteve civile. Krahas kësaj, përjashtimisht në disa raste të caktuar, për ndryshimin e raporteve juridike duhet të ekzistojë një aktgjykim i lëshuar nga gjykata. Kjo ndodhë më shumë në kategorinë e të drejtave statusore dhe në disa lloje të të drejtave reale (absolute). Me anë të padisë së ndryshimit, paditësi nuk ka nevojë ta provojë ekzistimin e interesit juridik pasi që në këtë rast gjykata supozon se paditësi ka një interes të caktuar juridik.

Pra, nga sa u tha më lartë, mund të konkludojmë se me ushtrimin e padisë së vërtetimit, paditësi duhet të argumentojë edhe ekzistimin e interesit juridik (për ta bërë të besueshëm) para gjykatës derisa gjatë ushtrimit të padisë së detyrimit dhe asaj të ndryshimit paditësi nuk ka nevojë për provimin e ekzistimit të interesit juridik për faktin se gjykata supozon se ekziston një interes i caktuar juridik.

5. Interesi juridik dhe ndërhyrësit e tretë në një procedurë civile

Përveç palëve të cilat fillojnë një procedurë kontestimore me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të tyre subjektive, në praktikë shpesh herë paraqiten edhe ndërhyrësit e tretë të cilët kanë një interes të caktuar juridik që procedura kontestimore të përfundojë në favor të njëres ose palës tjetër. Përveç kësaj, edhe vetë palët e përfshira në një kontest kanë të drejtën që të ftojnë personin e tretë, nëse personi në fjalë ka një interes të caktuar juridik në kontest. Kushdo mund të ndërhyjë në një proces kontestimor që zhvillohet ndërmjet personave të tjerë, kur ka interes juridik për të mbështetur njëren ose tjetrën palë ndërgjyqëse, me të cilën bashkohet në procesin e gjykimit për ta ndihmuar të njëjtën.¹⁰ Interesin juridik të personave të tretë, Ligji i procedurës kontestimore i Republikës së Kosovës dhe Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë, e rregullojnë pothuajse në mënyrë të përafërt. (Shih nenin 271 dhe 276 të LPK-së të Kosovës dhe nenin 189 dhe 192 të KPC-ës të Shqipërisë).

Personi i tretë ndërhyrë në një proces civil apo ka interes juridik që të ndërhyjë

⁹ Shih Ligjin për procedurën kontestimore, neni 254.2 i Republikës së Kosovës, Pjesa e dytë, Kreu XV

¹⁰ Shih Ligjin për procedurën kontestimore, neni 271.1 i Republikës së Kosovës, Pjesa e dytë, Kreu XVII

në qoftë se ndonjë e drejtë apo detyrim i tij varet nga aktgjykimi përfundimtar në këtë kontest. Si ndërhyrës i tretë, ndërhyrës me qëllim të ofrimit të ndihmës njëerës palë apo tjetrës, varësisht nga interesi juridik që ka. Ndërhyrësi si dhe palët tjera duhet të plotësoj kushtet e përgjithshme për të qenë palë dhe ai mund të kryej të njëjtat veprime procedurale si edhe vetë pala të cilës ndërhyrësi pretendon ti ndihmojë. Në lidhje me interesin juridik të ndërhyrësit të tretë kujdeset gjykata ex-officio gjatë tërë procedurës. Pala të cilës ndërhyrësi nuk i ofron ndihmë mund ta kundërshtoj përfshirjen e ndërhyrësit në kontest duke pretenduar se nuk ka interes juridik në lidhje me atë çështje civile si dhe mund të pretendoj në mos respektimin e afatit si dhe fazës së gjykimit. Ndërhyrësi i tretë në kontest ka karakter ndihmës, përveç kësaj me pëlqimin e palëve ai mund të bëhet palë në kontest. Përveç ndërhyrësve të zakonshëm, ekzistojnë edhe ndërhyrësit e veçantë (sui generis) të cilët ndërhyjnë me qëllim që gjykata të mos miratojë veprimet disponibile të palëve, veprime këto që mund të jenë në kundërshtim me dispozitat ligjore të detyrueshme dhe me moralin e shoqërisë. Pra, si ndërhyrës i llojit të veçantë është prokurori publik. Interesi juridik i prokurorit është t'i mbrojë dispozitat ligjore të detyrueshme si dhe moralin e shoqërisë nga keqpërdoruesit eventual.

Ndërhyrësi i veçantë në procedurën civile nuk është paraparë me Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe kjo mund të konsiderohet mangësi e madhe e këtij Ligji meqë lejon keqpërdorimin e palëve, të dispozitave ligjore si dhe moralin e shoqërisë, me veprime disponibile të cilat janë në favor të tyre, por në dëm të interesit publik dhe moralit shoqëror.

6. Përfundimi

Nga e gjithë ajo që u trajtua në përmbajtjen e këtij punimi mund të konkludojmë se interesi juridik në procedurën civile paraqet një premisë bazë për fillimin e një procedure civile, për arsye se pa një interes të caktuar juridik pala nuk është e interesuar të inicioj procedurën civile për mbrojtjen ose sigurimin e të drejtës subjektive të saj. Pavarësisht, nëse interesi juridik provohet para gjykatës apo gjykata supozon se ekziston interesi i njëmendtë juridik, ai duhet të ekzistojë, në të kundërtën padia konsiderohet si e palejueshme. Është mjaft e diskutueshme dilema si të veprohet kur subjekti nuk ka një interes të njëmendtë juridik, e megjithatë kërkon mbrojtjen gjyqësore, pra, a duhet ti ofrohet ndihma gjyqësore ose jo. Në këso raste, parimisht gjykata ex-officio, ka për detyrë të shqyrtoj paditë që i bëjnë subjektet, mirëpo përjashtimisht, gjykata për aprovimin e padisë si të lejueshme duhet të sigurohet nëse interesi juridik i saj është i kundërligjshëm. Kur u shpjegua më lartë kuptimi i interesit juridik, u tha që duhet të jetë i ligjshëm (pra, me ligj të jenë parashikuar pasojat

juridike) për të nisur një proces civil. Kujtojmë këtu se me legjitimitet aktiv të një kërkuesi do të kuptojmë verifikimin e ligjshmërisë së kërkimeve të tij. Nga bashkimi i këtyre dy nocioneve juridike rrjedh që nëse një kërkues kërkon iniciimin e një procesi për një interes të paparashikuar me ligj, pra, kur atij i mungon interesi juridik, atëherë në momentin kur të verifikohet ligjshmëria e kërkimeve të tij (pra, në momentin e legjitimit) ai nuk do të legjitimohet dhe padia e tij do të konsiderohet, si jo e lejueshme.

Çështja ndërlikohet edhe më tej për faktin se çfarë vendimi do të marrë gjykata kur të konstatojë mungesën e legjitimitetit aktiv të paditësit, ku paraqiten dy zgjidhje: pushimi i gjykimit të çështjes dhe rrëzimi i kërkesës që në fillim. Në lidhje me këto dy zgjidhje në praktikë ekzistojnë dy pikëpamje, sipas të parës, gjykata pasi që të konstatojë mungesën e legjitimitetit të paditësit, duhet ta refuzojë padinë si jo të lejueshme, pra që në fillim, ndërsa pikëpamja e dytë konsideron se gjykata edhe pse konstaton që në fillim, mungesën e legjitimitetit të paditësit (me insistimin e paditësit), duhet fillojë procedurën me kusht që në fund të refuzohet kërkesa e paditësit si jo e lejueshme, për arsye të mungesës së legjitimitetit të paditësit. Pra, përfundimi i çështjes civile (causa civiles) është i njëjtë, vetëm se në rastin e dytë paditësit i jepet një mundësi më shumë.

Interesi juridik detyrimisht duhet të jetë i ligjshëm. Nëse një interes juridik është i paparaparë me ligj (pa pasoja juridike) ose i kundërligjshëm, ai nuk konsiderohet i pranueshëm për iniciimin e një procesi civil. P.sh. nuk mund të ngrihet një padi për të detyruar një subjekt me një detyrim periodik në të holla, pa pasur një bazë ligjore, ose të detyrohet një subjekt që të të shes substanca narkotike. Kjo, sepse në rastin e parë nuk është paparaparë me ligj, ndërsa në rastin e dytë kemi kundërligjshmëri, pra në të dy këto raste pamundësohet realizimi i kërkesës së paditësit. Pra, siç dihet rrëzimi i kërkesës ose padisë vendoset për shkak të pabazueshmërisë në ligj (shkaku ligjor) ose për mungesë të provave (shkaku faktik).

Si përfundim, interesi juridik duhet të jetë i paparaparë me ligj dhe të mos jetë i kundërligjshëm, kushte këto që e validojnë ngritjen e padisë. Po ashtu, konsiderohet se nuk ka interes të njëmendtë juridik edhe në rastin kur në një çështje civile, objekti i kërkesës së paditësit është vendosur më herët përmes ndonjë rruge tjetër p.sh. rrugës administrative. Pra, nuk mund të quhet interes juridik civil, derisa ai mund të realizohet përmes ndonjë rrugë tjetër administrative ose gjyqësore. Ndërhyrësit e zakonshëm, si dhe ndërhyrësit e veçantë duhet të kenë një interes të caktuar juridik në mënyrë që të jenë pjesëmarrës në procedurë civile. Si konkludim, mendoj që mosparashikimi i ndërhyrësve të veçantë (prokurorisë themelore), në Ligjin për Procedurën Kontestimore (Kreu XVII) paraqet një mangësi të këtij ligji, për arsye se

kjo zbrazëtire ligjore krijon mundësinë e manipulimit të palëve me veprimet disponibile të tyre, me interesin publik si dhe dispozitat ligjore detyrimore duke mos përjashtuar as moralin e shoqërisë dhe dëmtimin e pasurisë publike.

BIBLIOGRAFIA:

I. Literatura:

Prof. Dr. Brestovci Faik, “E drejta procedurale civile I”, Prishtinë Botimi 2006;
Prof. Ord. Pozniq Borivoje, E drejta e procedurës civile, Botimi i dytë 1981;
Doracaku për Përgaditjen e Provimit të Jurisprudencës, Botimi i tretë, 2008

II. Aktet juridike:

Ligjin për procedurën kontestimore i Republikës së Kosovës; Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë.

Mr.sc. Hajrullah Mustafa

NDËRMJETËSIMI NË SISTEMIN E DREJTËSISË SË REPUBLIKËS SE KOSOVËS DHE EFEKTSHMERIA POZITIVE E TIJ

ABSTRAKT

Në kuptim të përgjithshëm mund të themi se konflikti përkufizohet si situatë në të cilën individët nuk pajtohen apo kanë, nevoja, interesa apo vlera të ndryshme, të cilat rezultojnë me mospajtim, mosbesim dhe tensione në mes tyre. Në situata të tilla, shpesh njerëzit mendojnë se forma më e zakonshme e zgjedhjes së konfliktit është përmes procedurës formale gjyqësore.

Megjithatë, gjykimi nuk është mjete i vetëm i zgjedhjes efektive të kontesteve në mes palëve të ndryshme.

Forma më themelore e zgjedhjes së kontestit është ajo e negociimit, që kryesisht përfshinë diskutimet në mes të palëve të interesuara me qëllim të pajtimit të mendimeve të ndryshme, apo së paku të kuptojnë qëndrimet e ndryshme të cilat ata i kanë.

Kështu, në një kuptim të përgjithshëm, *ndërmjetësimi* mund të përkufizohet si “*negocim i kryer me ndihmën e palës së tretë*”. Me fjalë tjera, *ndërmjetësimi është një veprimtari jashtëgjyqësore që realizohet nga një person i tretë (ndërmjetësi) për zgjedhje të mosmarrëveshjeve ndër mjete subjekteve të së drejtës në pajtim me kushtet e parashikuara me ligj.*

Fjalët kyçe: Palët, konflikti, kontesti, negociimi, ligji, gjykata, prokuroria, ndërmjetësimi, komunikimi, marrëveshja.

1. Vështrim i Përgjithshëm mbi Ndërmjetësimin

Dinamika e shpejt e zhvillimit ekonomik dhe ndryshimeve shoqërore, në botën bashkëkohore, e edhe në vendin tonë, në këto vitet e fundit është e karakterizuar me rritjen e numrit të madhë të mos marrëveshjeve dhe konflikteve të shumta ndër njerëzore. Pjesa më e madhe e tyre janë të determinuara nga rrjedhat impulsive të jetës të shkaktuara pas ndryshimeve të mëdha në shoqërinë bashkëkohore, sidomos nga dhjetëvjetëshi i fundit të shekullit të kaluar e tutje. Gjithashtu interferimet që shkakton zhvillimi shoqëror i bazuar në një ekonomi tregu ku duhet domosdo të bashkëjetojnë dhe veprojnë interesa të shumta edhe private edhe publike.

* Autori i këtij shkrimi, Mr.sc Hajrullah Mustafa është mësimitdhënës i shkencave juridike administrative

Padyshim, zhvillimi i këtyre rrjedhave shoqërore, shkakton edhe mospajtime, konteste dhe konflikte në mes të palëve të ndryshme. Në një kuptim të përgjithshëm mund të themi se *konflikti* përkufizohet si situatë në të cilën individët nuk pajtohen apo kanë nevoja, interesa apo vlera të ndryshme, të cilat rezultojnë me mospajtim, mosbesim dhe tensione në mes tyre. Më konkretisht “konflikti është fakti, ajo që ndodh dhe që nuk perceptohet njësoj nga të dyja palët. Është e kuptueshme që perceptimi varet nga shumë faktor. Të tillë janë makro dhe mikro mjedisi në të cilin ai person është rritur, edukuar, stereotipat dhe paragjykimet të caktuara, të formuara nga ajo përvojë vetjake, ose e jetës së të tjerëve, të tillë si prindërit, motrat vëllezërit, të afërmit madje ndonjëherë edhe nga ata që duken pa ndikim në një moment të caktuar, por mund të kenë dhënë ndikimin e tyre në një deformim të caktuar”¹¹.

Ne situata të tilla konfliktuale, shpesh njerëzit mendojnë se forma më e zakonshme e zgjidhjes së konfliktit është përmes *procedurës formale gjyqësore*.

Shteti posedon me monopolin e përdorimit të forcës, dhe venë në dispozicion gjykatat të cilat aplikojnë procedurat e përcaktuara me ligj për të zgjidhur kontestet në mes të personave, dhe zbatuesmerinë e vendimeve të marra nga gjykatat, gjithsesi e siguron shteti përmes aparatit të tij administrativ. Megjithatë, gjykimi nuk është mjeti i vetëm i zgjidhjes efektive të kontesteve në mes palëve të ndryshme.

Forma më themelore e zgjidhjes së kontestit është ajo negociimit, që kryesisht përfshinë diskutimet në mes të palëve të interesuara me qëllim të pajtimit të vendimeve të ndryshme, apo së paku të kuptojnë qëndrimet e ndryshme të cilat ata i kanë.

Kështu, në një kuptim të përgjithshëm, *ndërmjetësimi* mund të përkufizohet si “*negocim i kryer me ndihmën e palës së tretë*”, apo “*një formë e ndihmës nga pala e tretë për të zgjidhur një kontest*”. Me fjalë tjera, “*ndërmjetësimi është një veprimtari jashtëgjyqësore që realizohet nga një person i tretë (ndërmjetësi) për zgjidhje të mosmarrëveshjeve ndërmjet subjekteve të së drejtës në pajtim me kushtet e parashikuara me ligj*”¹²

Nga kjo mund të theksojmë se ndërmjetësimi në esence, është vetëm një negociim ku përfshihet një palë e tretë e njohur në procedurën efektive të

¹¹ Drejtësia Restauruese dhe Ndërmjetësimi në Zgjidhjen e Konflikteve Penale, *Manual Për Gjyqtar dhe Prokuror*: Botim nga UNICEF, Komisioni Evropian dhe Sida Tirane, 2007 fq.44.

¹² Ligji numër 03/L- 57 Për Ndërmjetësimin: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.41 e date: 1 Nëntor 2008

negocimit, dhe që ka për qëllim të ndihmoj personat në konflikt, të koordinojnë aktivitetet e tyre dhe të jenë sa më efektiv në arritjen e marrëveshjes në mes tyre. Në këtë procedurë dhe në këtë veprimtari del në pah roli i palës së tretë përkatësisht i ndërmjetësit nga edhe kjo veprimtari emërtohet si ndërmjetësim apo veprimtari ndërmjetësimi.

Roli dhe rëndësia e tij gjithsesi mbetet vetëm që të lehtësoj zgjidhjen e kontestit dhe arritjen e marrëveshjes në mes të palëve në kontest. Autoriteti i ndërmjetësit nuk guxon të reflektoj fuqinë e imponimit për vendimin tek palët, por vetëm ushtron një formë të zgjatur të një negociimi në mes tyre, sepse të drejtën në vendimmarrje, e kanë vetëm palët në kontest, që finalizohet me aktin final të nënshkrimit të marrëveshjes. Pikërisht për këtë, ndërmjetësi duhet të jetë palë neutrale përkatësisht, person që lehtëson negociimin në mes palëve në konflikt, duke begatuar mungesën në komunikim, duke shtruar një perspektive dhe një dimension tjetër të kontestit por edhe duke pasuruar atë me ofrimin e ideve të reja, gjithherë të fokusuar në drejtim që palët të jenë sa më afër një marrëveshje miqësore të kontestit të tyre.

Esenca, kuptimi dhe filozofia e ndërmjetësimit qëndron në faktin se mosmarrëveshjet në mes njerëzve, janë gjithherë pjesë e pa ndarë e zhvillimit të jetës normale. Mos marrëveshjet, burojnë si pasoje e keqkuptimeve. Prandaj, me rëndësi është si duhet t'i qasemi dhe të trajtojmë ato. Çdo trajtim konstruktiv dhe përmbajtësor, ofron mundësinë për përparim, zgjidhje të konfliktit, dhe arritjen marrëveshjeve në mes palëve. Në të kundërtën ato mundën që të shndërrohen në konflikt që pastaj të jetë i rrezikshëm dhe i dëmshëm për jetën normale të palëve.

Bazuar në këtë mund të konstatohet se palët, gati gjithherë janë të interesuara për arritje të marrëveshjeve. Megjithatë, për të arritur këtë, nevojitet një person që ndërmjetëson, pra ndërmjetësuesi i cili padyshim bëhet si ideator në zgjidhjen e konflikteve në mes tyre.

Katalizatori kryesor në suksesin e ndërmjetësimit si veprimtari, gjithsesi mbetet zhvillimi dhe perfeksionimi i aftësive të larta komunikuese. Aftësitë e mira të komunikimit padyshim janë mjeti më me ndikim në ndërmjetësim. Nëse ndërmjetësuesi gjate seancës së ndërmjetësimit komunikon me profesionalizëm të lartë, vetëbesim, sinqeritet dhe ndjeshmëri, gjithsesi krijohen mundësitë shume reale për arritjen e marrëveshjeve në mes palëve. Ndërmjetësimi nuk është asgjë tjetër por ne thelb është vetëm dialogu ose negociimi me përfshirjen e një të treti, ku përmes qëndrimeve dhe komunikimit të barabartë por të qartë u tregon palëve se marrëveshja është e tyre dhe se ata vetë janë "zot" në zgjidhjen e konfliktit në mes tyre. Ndërmjetësimi realizohet përmes disa fazave dhe me të drejtë kjo veprimtari shpesh herë përshkruhet si *"rruga e krijimit shkallë-*

shkallë e rendit dhe bashkëpunimit midise palëve”¹³..

Prandaj, mund të konstatojmë se kur të gjitha çështjet që janë pjesë e konfliktit do të zgjidhen përmes ndërmjetësimit, krijohen gjasa shume reale se sukcesi i arritur do të rezistoj testit të kohës, duke u cilësuar si një avantazh të cilin e ka ky proces, më tepër se sa zgjidhjet gjyqësore.

2. Përcaktimi dhe Definimi Juridik i Ndërmjetësimit në Republikën e Kosovës

2.1.Ligji Për Ndërmjetësim

Duke u bazuar ne rolin dhe rëndësinë që ka procedura e ndërmjetësimit në sistemin e drejtësisë, shume vende sot në botën bashkëkohore, kane aplikuar këtë formë të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve ne mes palëve, jashtë procedurave gjyqësore, duke miratuar ligje që decdivisht përcaktojnë dhe definojnë këtë veprimtari përmes akteve ligjore. Është një shembull i mirë në Norvegji, ku ndjekja me ndërmjetësues e çështjeve familjare është edhe e detyruar.

*“Origjina e Ndërmjetësimit për zgjidhjen e konflikteve në mënyre paqësore në Kosovë është një institut i ri juridik, ndërsa në të kaluarën është praktikuar edhe në të drejtën Zakonore shqiptare si në Kanunin e Leke Dukagjinit, Kanunin e Arbrit (Kanuni i Skënderbeut) Kanunin e Labit dhe në të drejtën Zakonore Islame” (Sheriatit).*¹⁴.. Ndonëse ka një lidhje të fortë gjenetike midis ndërmjetësimit tradicional dhe atij modern, prapë ka mjaft karakteristika që bëjnë të mundur dallimin ndërmjet tyre. Ndër të tjera mjafton të analizohet pozicioni i palës së tretë në këtë proces. Në qoftë se në ndërmjetësimin “modern”, pronësia e procesit lidhet me palët në konflikt, çka do të thotë se palët janë “zot” i procesit dhe ndërmjetësi thjesht asiston palën që të zhvillojnë zgjidhjet e tyre, në atë tradicional ndihet roli zotërues i palës së tretë, sugjerimet e të cilit kanë autoritet të madh mbi palët. Pra, ekzistojnë dallime të dukshme në mes formës tradicionale dhe asaj moderne të veprimtarisë së ndërmjetësimit. Megjithatë, marrë në përgjithësi ndërmjetësimi sot në botën bashkëkohore, posedon më shumë përparësinë e zgjidhjes së kontesteve të ndryshme në mes të palëve, krahasuar me rrugët dhe mënyrat tjera nga të cilat do të potencoj disa nga ato:

¹³ Gulliver.P.H. Disputes and Negotiation- AcrossCultural Prospective

¹⁴ [http://www.md.ks.net/Ndërmjetësimi si Alternative e Zgjedhjes së Kontesteve në Kosovë](http://www.md.ks.net/Ndërmjetësimi%20si%20Alternative%20e%20Zgjedhjes%20së%20Kontesteve%20në%20Kosovë) :Tryezë Shkencore, Prishtine, 9 mars 2011.

- Zgjidhja arrihet shpejt dhe pa humbur shumë kohë;
- Për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit duhet të ekzistoj vullnet i plotë i palëve dhe procedura fillon në momentin kur palët pajtohen për fillimin e saj;
- Kosto e shpenzimeve procedurale është shume e vogël krahasuar me mënyrat e tjera;
- Çështja gjithëherë mbahet nën kontroll, ngase palët nën ndërmjetësim kanë plotësisht nën kontroll rezultatin;
- Gjatë ndërmjetësimit, palët edukohen me situatën reale dhe ligjore;
- Zhvillohet komunikim aktiv dhe shume negociata gjate një procesi;
- Procedura e Ndërmjetësimit zgjate deri në 90 dite¹⁵
- Procedura e ndërmjetësimit është e natyrës konfidenciale, pasi që deklaratat dhe të gjitha informacionet tjera lidhur me procedurën e ndërmjetësimit nuk mund të përdoren si dëshmi në ndonjë procedure tjetër, pa miratimin e palëve.

Ashtu sikurse shume vende të tjera, edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, me qëllim që të krijoj mundësi sa do pak për avancimin e sistemit juridik, por edhe “me qëllim të rregullimit, organizimit, funksionimit si dhe zgjidhjes së kontesteve në mënyre sa me efektive me ndërmjetësim, si dhe duke respektuar historinë tradicionale të ndërmjetësimit në Kosove, *miraton Ligjin mbi Ndërmjetësimin - Ligji Nr.03/L-057, të shpallur me Dekretin Nr.DL-048 -- 2008, date: 03.10.2008*. Miratimi i këtij ligji, edhe pse pak me vonesë, nxiti avancimin e sistemit juridik në Republikën e Kosovës, duke krijuar mundësi të mira në afirmimin e mënyrave, alternative të zgjidhjes së kontesteve në mes të subjekteve juridike edhe jashtë procedurave gjyqësore, pasi që në realitetin aktual të Kosovës, procedurat në gjykatat janë shumë të stërzgjatura, të kushtueshme, të ngarkuara dhe mjaft komplekse. Ky ligj, i cili tani rregullon në përgjithësi procedurën e ndërmjetësimit, themelimin, organizimin, funksionimin e Komisionit të Ndërmjetësimit si dhe të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit e ndërmjetësuesve në nivel të shtetit, gjithsesi shënon një hap me rëndësi në sistemin e drejtësisë së Republikës së Kosovës.

Pa hyre në analizën dhe interpretimin e detajuar të këtij ligji, do të ndalem vetëm në disa çështje me rëndësi. Kështu, *Neni 15- Konflikti i interesit ku Ligji në mënyrë shumë konkrete përcakton se "Ne rast se paraqitet konflikt i interesave, ndërmjetësuesi përjashtohet nga procedura e ndërmjetësimit, përveç nëse palët, pasi të jenë të informuar për ekzistimin e rrethanave të tilla, janë pajtuar që ai të zhvilloj procedurën"*¹⁶.

¹⁵ Ligji Nr.03/L-057- Ligji Mbi Ndërmjetësimin, Neni-13

¹⁶ Po aty, fq.107.

Në vazhdimësi, në ligj përcaktohet, Themelimi i Komisionit për Ndërmjetësim dhe kompetencat e tij, (Kreu i IV- neni 17) Komisioni i Ndërmjetësimit themelohet nga Ministria e Drejtësisë (Neni 17.1.) dhe përbehet nga Kryetari dhe katër (4) anëtarë (Neni 17.2.i këtij ligji). Ndërsa anëtarët e Komisionit për Ndërmjetësim, përkatësisht subjektet që përfaqësohen në Komision janë:

- a) Ministria e Drejtësisë;
- b) Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- c) Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- d) Oda e Avokateve të Kosovës;
- e) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale(Neni-18.1.)

Po kështu, një vend të veçantë në këtë ligj, zen edhe përcaktimi kushteve të kërkuara për ndërmjetësit të përfshira në *Kreun e V- neni 22.1 – 22.5*.

Prandaj, në kuptim të plotë të fjalës, miratimi i këtij ligji, por edhe akteve tjera nënligjore të cilat janë të domosdoshme për të materializuar në mënyrë sa me pozitive, gjithsesi janë suksese dhe nisma për një reformim të sistemit juridik në Kosovë

Gjithherë mbetet fakt i pamohuar *se dhënia e mundësisë palëve për të zgjidhur mosmarrëveshjet brenda ndërmjetësimit është një alternative e dobishme. Kjo kërkon jo vetëm kontributin e ndërmjetësve si të tillë, por të të gjithë komunitetit të juristëve dhe të atyre që e kuptojnë mirë se qasja të drejtësia qëndron gjithashtu tek realizimi në kohë i së drejtës, sepse “drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar”¹⁷.*

Çështje me rëndësi nga i cili më së tepërmi varet suksesi i ndërmjetësimit, janë aftësitë komunikuese të ndërmjetësit, pa të cilat nuk mund që të paramendohet efikasiteti dhe suksesi në këtë proces. Komunikimi në mes të njerëzve gjithherë përmban mesazhe jo verbale (mimika, lëvizje trupore etj.) por edhe mesazhe verbale të shprehura përmes fjalëve. Megjithatë në këtë dimension, shpesh ka dhe hasen edhe keq kuptime, dhe pikërisht kjo e venë në rend të parë rëndësinë që kanë aftësitë komunikuese e sidomos të ndërmjetësuesit. *Aftësitë komunikuese që kërkohen nga ndërmjetësi, i cili ndërhyjnë në një situatë konflikti në mënyrë të suksesshme janë këto në vijim:*

- Qëndrim profesional;
- Aftësi të forta verbale dhe jo verbale;
- Aftësi të forta dëgjimi¹⁸.

¹⁷ Drejtësia Restauruese edhe Ndërmjetësimi në Zgjidhjen e Konflikteve Penale, *Manual Për Gjyqtar dhe Prokuror*, Botim nga UNICEF, Komisioni Evropian dhe Sida, Tirane, 2007, fq.51.

¹⁸ Po aty, fq.46.

Zbatimi dhe respektimi i këtyre parimeve gjatë një procesi të ndërmjetësimit padyshim që paraqiten edhe si indikatorët kryesor për suksesin dhe efikasitetin e ndërmjetësimit.

2.2.Efektët Pozitive te Ndërmjetësimit në Republikën e Kosovës

Sipas analizave dhe raporteve të marra, miratimi i Ligjit mbi Ndërmjetësimin në Republikën e Kosovës dha efekte pozitive në realitetin e Kosovës. Ky ligj qytetarëve iu dha një mundësi dhe një mekanizëm të zgjidhjes së mos marrëveshjeve përmes instrumenteve jashtë gjyqësore, mundësoi uljen e numrit potencial të lëndëve nëpër gjykatat e rregullta të Kosovës, nxiti qasjen më të madhe në drejtësi si dhe mundësinë për një sundim dhe funksionim më efikas të ligjit. Efektet dhe përfitimet e ndërmjetësimit në mes tjerash janë :

- Efienca, (Shumica e rasteve janë zgjidhur brenda disa seancave)
- Qëndrueshmëria, (Ndërmjetësimi ofron zgjidhje të qëndrueshme)
- Konfidencialiteti, (Palët dhe ndërmjetësuesit ruajnë konfidencialitetin e procesit) dhe
- Suksesi (Përqindja e rasteve të suksesshme është shumë e lartë dhe në ngritje e sipër)

Në zhvillimin, afirmimin dhe avancimin sa më të mirë të procesit të ndërmjetësimit e kanë Qendrat e Ndërmjetësimit në Republikën e Kosovës. Këto Qendra të konsoliduara pas miratimit të Ligjit, të koordinuara në harmoni me Komisionin për Ndërmjetësim dhe të mbështetura nga Ministria e Drejtësisë së Kosovës por edhe partner tjerë ndërkombëtar funksionojnë në 6 qytetet të Kosovës. Fokusi i veprimtarisë së tyre përqendrohet në implementimin e këtyre objektivave në nivelin e territorit të tyre siç janë:

- Bëjnë pranimin, planifikimin dhe menaxhimin e rasteve;
- Japin mbështetje për ndërmjetësuesit në koordinimin dhe implementimin e aktiviteteve përmes:
 - Krijimit dhe menaxhimit të bazës së të dhënave për çështjet e ndërmjetësuesve në ndërmjetësim;
 - Promovimit të inovacionit dhe efektivitetit në ndërmjetësim;
- Mban konfidencialitet të të gjitha aktiviteteve të rastit dhe informimit të klientit;
- Promovon ndërmjetësimin si zgjidhje alternative të kontesteve;
- Zhvillon dhe zbaton trajnime për ndërmjetësues;
- Lehtëson marrëdhënien e punës me gjyqtarët, avokatet, punëtorët social, ofruesit e shërbimeve dhe profesioniste të tjerë dhe individët e përfshirë

në procesin e ndërmjetësimit;

- Organizon dhe koordinon aktivitetet e Qendrës për Ndërmjetësim në përputhje me protokollet e ndërmjetësimit, rregullave dhe rregulloreve sipas Ligjit për Ndërmjetësim.

Efektet e veprimtarisë së Qendrave për Ndërmjetësim, pasqyrohen me të dhënat në vazhdim.

Tabela1.- Të dhënat për rastet e referuara për ndërmjetësim në nivel të vendit për vitin 2013*.

2013	Prishtinë	Ferizaj	Gjakovë	Pejë	Gjilan	Mitrovicë	Total
Raste të referuara nga Gjykata	86	139	57	75	70	4	431
Raste të referuara nga Prokuroria	74	/	6	/	/	/	80
Raste me vet Referim	2	7	3	/	/	7	19
Të referuara gjithsej për Ndërmjetësim	162	146	66	75	70	11	530
Të zgjidhura gjithsej	145	40	34	28	45	11	303
Të pazgjidhura gjithsej	3	21	24	19	17	/	84
Në proces (shifra e totalit varion)	/	2	4	48	9	/	63

*<http://www.md-ks.net>

Tabela 2. – Paraqitja grafike e të dhënave në nivel të vendit për vitin 2013





Tabela 3. Praqitja grafike e të dhënave për rastet e pa zgjidhura të ndërmjetësimit ne nivel vendi për vitin 2013



Analiza e të dhënave, konform raportit nga gjashtë Qendra të Ndërmjetësimit në Kosovë për vitin 2013, argumenton mes tjerash faktin se:

- Ka një ngritje të përgjithshme të interesimit të palëve për ndërmjetësim nga se janë referuar **530** raste, nga te cilat me suksese janë zgjedhur **303 ose 57.16%**, duke treguar efekt pozitiv por edhe avantazh, krahasuar me **84 ose 15.84%**, të rasteve të pa zgjidhura.
- Këto të dhëna tregojnë se përkundër efekteve pozitive që janë në ngritje e sipër, ende është interesim i vogël i rasteve të paraqitura me **vete referim**, (pra ende dominojnë rastet e referuara vetëm nga gjykatat dhe prokuroritë) sepse përmes kësaj forme në nivel të vendit për vitin 2013, ishin vetëm **19 ose 3.58 %**, nga numri total i tyre;
- Bazuar në këto të dhëna dhe duke u shërbyer me metodën krahasimore, bie në sy, Prishtina dhe Ferizaj. Këto qytete, ndonëse kanë ndryshime të mëdha në mes veti për kah numri i banoreve, rastet e referuara për ndërmjetësim janë shume të afërta. Në Ferizaj kemi vetëm **16 apo 3.01%** me pak raste të referuara për ndërmjetësim, edhe pse Prishtina ka për disa herë numër më të madh të banorëve.
- Megjithatë, në aspektin e zgjidhjeve me sukses të rasteve, shihet dallim shume i madh në mes këtyre qyteteve. Prishtina nga **162 raste**, me sukses janë zgjidhur **145 ose 89.50%** që vërtet është një sukses shume i mire, ndërsa në Ferizaj nga **146 raste** të referuara, janë zgjidhur vetëm **40 ose 27.39 %**, që është përqindje shumë e vogël. Tek rastet me vetë referim, në mes këtyre dy qyteteve kishte prapë dallime. Në Prishtine kishim **2 raste** ndërsa në Ferizaj **7 raste**, aq sa kishte edhe Mitrovica.
- Një karakteristike tjetër shihet tek qyteti i Mitrovicës, që në realitetin e ri të Kosovës, dallohet me shume rrjedha të veçanta socio politike. Ne

procesin e ndërmjetësimit kishim **11 raste** të referuara, nga te cilat 7 ishin përmes vetë referimit, dhe te gjitha te zgjidhura. Ky rezultat tregon edhe për një punë të suksesshme të Qendrës për Ndërmjetësim të Mitrovicës.

- Një efektivitet akoma i vogël i rasteve të ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve pozitive të kontesteve sipas këtyre të dhënave shihet tek qyteti i Pejës. Numri total i rasteve të referuara është **75**, nga te cilat janë zgjidhur vetëm **28 ose 37.33%** ndërsa nuk janë zgjidhur **19 apo 25.33%** të rasteve, ndonëse në proces të zgjedhjes ishin edhe **48 raste**.
- Në Gjakovë dhe Gjiilan, rastet e zgjidhura me sukses, tregojnë index pozitiv sepse më tepër se gjysma e rasteve të referuara kanë arritur marrëveshje, ndonëse ende ka nevojë për një sensibilizim më të madh të opinionit për ngritje të performances së më tutjeme të ndërmjetësimit në këto qytete.

3. Përfundim

Ndërmjetësimi është veprimtari dhe alternativë e rëndësishme për zgjedhjen e konflikteve në mes palëve. Megjithatë procesi i ndërmjetësimit ka qëllime shumë më të mëdha se sa thjesht vetëm nxitjen e zgjedhjeve konsensuale, ndonëse kjo përmban edhe objektiven dhe qëllimin final. Duke elaboruar procesin e ndërmjetësimit, mundemi të shohim shume avantazhe, nga te cilat do të përmendim vetëm disa nga ato:

- Ndërmjetësimi nuk ofron vetëm një pajtim të thjesht të palëve. Ndërmjetësimi ka për qëllim të ndihmoj palët që të arrijnë një zgjedhje funksionale, e cila do të jetë në favorin e tyre, të përmirësoj komunikimin midis tyre, dhe të nxisë ndarjen e drejtë dhe racionale të përgjegjësive aktuale dhe në perspektive.

- Ndërmjetësimi u ofron palëve të përfshira në konflikt zgjedhje afatgjatë dhe përmes një afati të shkurtër kohor. Zgjedhja e konflikteve në mes palëve, përmes procesit të ndërmjetësimit, mundësohet që të zgjidhet në një afat kohor të shkurtër dhe të shpejt, duke u dalluar nga çdo procedurë tjetër. Ky proces padyshim, mundëson shmangiet nga zvarritjet e gjata pranë organeve të drejtësisë, duke minimizuar dukshëm kohen dhe kostot financiare. Për çështjet e referuara nga gjykatat dhe prokuroria, procedura e ndërmjetësimit në Republikën e Kosovës zgjate deri në '90 dite.

- Procesi i ndërmjetësimit është proces me një kosto modeste financiare krahasuar me procedurat tjera të drejtësisë.

- Ndërmjetësimi mundëson që palët që kane mosmarrëveshje të kenë pozita

te barabarta. Gjatë të procesit të ndërmjetësimit palët luajnë rol aktiv dhe të barabartë, duke i edukuar me ndjenjën e tolerancës dhe mirëkuptimit. Në këtë proces, palët shmangin pasigurinë që shpesh përjetohen në gjykatë, si rezultat edhe i vendimeve “arbitrare” në gjykimin e tyre.

- Procesi i ndërmjetësimit u jepe mundësi palëve, të njohin opsionet e njëra tjetrës, me transparence. Komunikimi dhe gjuha e përdorur gjate seancës së ndërmjetësimit, është e thjeshte dhe e afërt ku palët kuptojnë dhe zhvillojnë dialogun ne favor të një zgjedhje efektive dhe te dobishëm për të dy palët.

Duke u bazuar në këto dhe shume avantazhe tjera qe karakterizohet procesi i ndërmjetësimit, sot aplikohet ne shume vende sot në boten bashkëkohore, prandaj edhe ne Republikën e Kosovës, e cila ne vitin 2008, ka miratuar Ligjin dhe aktet tjera nënligjore. Kontribut dhe avancim të kësaj sfere janë duke treguar, konstituimi dhe funksionimi i Qendrave për Ndërmjetësim në gjashtë qytete e mëdha të Kosovës, duke organizuar dhe koordinuar aktivitetet e tyre ne harmoni me Ligjin për Ndërmjetësim si dhe duke sensibilizuar opinionin publik, për mundësitë që ofron ndërmjetësimi në zgjedhjen e konflikteve, qëndrueshmërinë, dhe përfitimet afatgjatë te palëve dhe duke krijuar impakt thelbësor në cilësinë e zhvillimit te jetës se tyre.

BIBLIOGRAFIA:

I. Literatura:

Drejtesia Restauruese dhe Ndërmjetësimi në Zgjidhjen e Konflikteve Penale: Manual Për Gjyqtar dhe Prokuror: Botim nga UNICEF, Komisioni Evropian dhe SidaTirane 2007, Gullive.P.H.:Disputes and Negotiation- Across Cultural Prospective.

II. Aktet juridike:

Ligji numër 03/L- 57 Për Ndërmjetësimin: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.41 e datës:1 Nëntor 2008.

III. Faqet elektronike:

[http://www.md.ks.net//Ndermjetesimi si Alternative e Zgjedhjes se Kontestevet ne Kosove:Tryeze Shkencore, Prishtine, 9 mars 2011.](http://www.md.ks.net//Ndermjetesimi%20si%20Alternative%20e%20Zgjedhjes%20se%20Kontestevet%20ne%20Kosove:Tryeze%20Shkencore,%20Prishtine,%209%20mars%202011.)

[http://www.md.ks.net//Ndermjetesimi/Evidenca e rasteve për 2013](http://www.md.ks.net//Ndermjetesimi/Evidenca%20e%20rasteve%20per%202013)
www.mediation-mitrovica.or

Mr.sc. Isuf Sadiku*

LEGJISLACIONI LIDHUR ME MONITORIMIN DHE INSPEKTIMIN E INSTITUCIONEVE PENITENCIARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

ABSTRAKT

Institucionet penitenciare janë vende ku ekzekutohen sanksionet penale, ose masat e trajtimit të detyrueshëm, ku kryerësit të veprës penale i kufizohen të drejtat e caktuara vetëm deri në atë masë e cila i përgjigjet natyrës dhe përmbajtjes së sanksionit penal, ose masës dhe vetëm në mënyrën me të cilën sigurohet respektimi i dinjitetit njerëzor. Andaj, që të mos ketë tejkalime të kompetencave ose keqpërdorim të autorizimeve nga zyrtarët shtetërorë gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare në “emër të shtetit apo për interesa të tjera të kundërligjshme” dhe që ankesat e personave të privuar nga liria që gjenden në institucionet penitenciare të trajtohen sipas ligjit dhe akteve nënligjore, dy procedurat -institutet e lartpërmendura, monitorimi dhe inspektimi janë të domosdoshme dhe shërbejnë si barometër për matjen- sundimin e së drejtës në një shtet demokratik dhe shprehjen e kulturës së atij populli ndaj një gjendjeje të caktuar – të drejtave të personave të privuar nga liria. Për më tepër, legjislacioni aktual përcakton që qëllimi i dënimit, ndër të tjera është edhe rehabilitimi, zhvillimi i duhur personal, edukimi i specializuar, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit etj. të kryerësit të veprës penale.

Fjalët kyçe: person i privuar nga liria, monitorimi, inspektimi, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore ose Poshtëruese (KPT), Avokati i Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT).

Procesi i monitorimit dhe inspektimit të vendeve ku mbahen personat e privuar nga liria, kudo qofshin ato: qendra të ndalimit (në polici), qendra të paraburgimit apo burgje, qendra psikiatrike, qendra të shëndetit mental, qendra të azileve, qendra të mbajtjes së të miturve, janë me rëndësi të veçantë për faktin se, përveç që parashihen në legjislacion, këto procese ndikojnë drejtpërdrejt në jetën dhe sigurinë e këtyre personave gjatë qëndrimit në institucionet e lartpërmendura. Nëse i referohemi legjislacionit vendor, vërejmë se Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP) Nr. 04/L-149, i shpallur me Dekretin Nr. DL-035-2013, i datës 16 gusht 2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës, përcakton qartë në kreun XXIV institutin e inspektimit, konkretisht përcakton krijimin

*Autori i këtij shkrimi, Mr.sc. Isuf Sadiku, është Prokuror i Shtetit në Prokurorinë Themelore në Gjilan.

dhe funksionalizimin e Inspektoratit në Shërbimin Korrektues të Kosovës, respektivisht në nenet 242 deri në nenin 247 rregullohen më në detaje mandati dhe është veprimtaria e këtij Inspektorati. Më parë edhe ish- LESP i vitit 2010 dhe ish- Rregullorja Nr. 2004/46 për LESP i vitit 2005, përcaktonte qartë inspektimin e institucioneve korrektuese ndër të tjera, nëse veprimet brenda sistemit korrektues nga resurset njerëzore janë kryer në mënyrë efektive, në veçanti ato lidhur me procedurat e pranimit, zbatimin e dënimeve disiplinore, çështjet e sigurisë, sigurimit të shërbimeve shëndetësore dhe mjekësore dhe sigurimit të ndihmës edukative dhe shoqërore por kishte ngecur krijimi dhe funksionalizimi i inspektoratit brenda Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, ka përcaktuar edhe ndërhyrjet që mund t'i bëjë Institucioni i Avokatit të Popullit (Ombudspersoni) në sistemin korrektues duke përcaktuar se letrat dhe dërgesat tjera postare që i dërgohen Zyrës së Avokatit të Popullit të Kosovës nga personat e privuar nga liria nuk duhen të kontrollohen në asnjë mënyrë (neni 58 paragrafi 8) dhe në asnjë mënyrë nuk mund t'i ndalohet Avokatit të Popullit, dokumentacioni, dosjet dhe informacionet konfidenciale nga puna e Shërbimit Korrektues të Kosovës (neni 232 paragrafi 8), si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Drejtësisë.

Kodi i Procedurës Penale, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, përcakton që Avokati i Popullit ose zëvendësi i tij mund të vizitojë të paraburgosurit dhe të korrespondojë me ta pa paralajmërim paraprak ose pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake apo personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Zyrës së Avokatit të Popullit të Kosovës¹ nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe zëvendësi i tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit. Komunikimi ndërmjet të pandehurit dhe Avokatit të Popullit ose zëvendësit të tij mund të shikohet nga oficeri policor, por jo të dëgjohet. Kufizimi ose ndalimi i vizitës a i korrespondencës nuk zbatohet ndaj vizitave ose korrespondencës me Avokatin e Popullit.

Ligji për Avokatin e Popullit Nr. 03/L195, i shpallur me Dekretin Nr. DL-046-2010, i datës 22 korrik 2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, autorizon zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit në çdo kohë dhe pa paralajmërim mund të hyjnë dhe të inspektojnë çdo vend ku personat janë të privuar nga liria si dhe në institucionet tjera me liri të lëvizjes së kufizuar dhe mund të jenë të pranishëm në mbledhje apo seanca dëgjimore ku përfshihen personat e tillë. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit mund të mbajnë edhe

¹ Kodi i Procedurës Penale, neni 200 paragrafi 8.

takime me personat e tillë pa praninë e zyrtareve të institucionit përkatës. Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Institucionin e Avokatit të Popullit nuk pengohet apo kontrollohet. Ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe autoriteteve kompetente përkatëse zhvillohen procedura të veçanta për të lehtësuar ushtrimin e dy procedurave të lartpërmendura, veçanërisht qasja e menjëhershme dhe pa paralajmërim të zyrtarëve të Institucionit të Avokatit të Popullit në çdo vend ku personat janë të privuar nga liria. Ngjashëm këtë situatë e kishte rregulluar edhe ish- Rregullorja Nr. 2006/6 Mbi Avokatin e Popullit në Kosovë, e datës 16 shkurt 2006.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 27 parasheh” Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerezor ose poshtërues”

Nëse i referohemi dhe analizojmë legjislacionin vendor, bazë ligjore e proceseve – instituteve të monitorimit dhe inspektimit, është legjislacioni i lartpërmendur si: Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Kodi i Procedurës Penale, Ligji mbi Avokatin e Popullit si dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Drejtësisë.

I gjithë legjislacioni i lartpërmendur është relativisht i ri për sistemin e drejtësisë penale - sistemin korrektues në Kosovë, sepse më parë nuk ka ekzistuar legjislacioni ku është përcaktuar qartë baza ligjore për proceset e lartpërmendura dhe për mekanizmat për zbatimin e këtyre proceseve.

Veçmas, nëse i referohemi kushteve dhe trajtimit të personave të privuar nga liria, para viteve 1990, ku në pjesën më të madhe të kontinentit evropian sundonte sistemi monist edhe nëse ishin të paraparë me ligj këto institute, më shumë ishin për “dekor juridik” sesa kishte materializim të këtyre instituteve në praktikë dhe rol aktiv në sistemin penitenciar. Andaj, ky legjislacion, duke qenë relativisht i ri ka hasur vështirësi në zbatimin apo jetësimin e tij, veçanërisht krijimi dhe mandati i Avokatit të Popullit, (Ombudspersonit) për herë të parë është shfaqur në legjislacionin e Republikës së Kosovës duke u përcaktuar me ligjet e lartpërmendura.

Përveç legjislacionit të lartpërmendur, bazë ligjore e funksionimit të mekanizmave për monitorim dhe inspektim janë edhe aktet nënligjore² dhe Rregullat e brendshme të punës të Shërbimit Korrektues të Kosovës³, ku përveç Avokatit të Popullit përcaktohen edhe mekanizma të tjerë që janë të përfshira në fushën e drejtësisë penale si Kryqi i Kuq Ndërkombëtar (KKN), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim të Evropës (OSBE), UNICEF dhe UNHCR.

² Janë të njohura si Udhëzime administrative, si: për korrespondenca, vizita, kalimin e kohës në lokale të veçanta, për lejimin dhe zbatimin e gjysmë lirisë, etj., të nxjerra nga Ministri i Ministrisë së Drejtësisë.

³ Rregullat e brendshme të punës, janë nxjerr dhe miratuar nga Komisari i Shërbimit Korrektues, me 1 tetor 2007.

Për më tepër, krijimin dhe funksionimin e mekanizmave monitorues dhe inspektues e fuqizojnë edhe aktet juridike ndërkombëtare të njohura si standarde ndërkombëtare për të drejtat e njeriut apo standarde për administrimin e drejtësisë.

Disa nga aktet juridike ndërkombëtare janë të zbatueshme drejtpërdrejt në sistemin juridik të vendit të tonë, sipas nenit 22 të Kushtetutës ndër të tjera janë:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj,
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike,
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.
- Përveç, këtyre akteve ndërkombëtare të lartpërmendura në fushën e drejtësisë ndërkombëtare, kemi edhe të ashtuquajturin “legjislacionin e butë” ku hyjnë: parimet, udhëzimet, rregullat standarde dhe rekomandimet, ndër më të njohura janë:
- Rregullat Minimale Standarde për Trajtimin e të Burgosurve, 1977;
- Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur, 1985, të njohura si “Rregullat e PEKINIT”;
- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat Alternative (jo burgosëse), 14 dhjetor 1990, të njohura si “Rregullat e TOKIOS”;
- Rregullat Evropiane të Burgjeve, sipas Rekomandimit nr. 2006/2, etj.

Nga legjislacioni i lartpërmendur si ai vendor po ashtu edhe ai ndërkombëtar, krijimi i mekanizmave monitorues dhe inspektues përcaktohet si një nevojë e domosdoshme, me qëllim që të ketë një “sy vrojtues nga jashtë” lidhur me praktikën, kushtet e ofruara dhe trajtimin e personave të privuar nga liria nga autoritetet publike shtetërore – zyrtarët qofshin ata personel korrektues dhe civil (gardian, mbikëqyrës, drejtor, mjek, pedagog, etj.) në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria.

Nga akte juridike ndërkombëtare të lartpërmendura janë përcaktuar edhe mekanizma ndërkombëtarë për monitorimin dhe inspektimin e vendeve ku mbahen personat e privuar nga liria siç janë:

- Këshilli për të Drejtat e Njeriut, (OKB);
- Komiteti Kundër Torturës, (OKB) me seli në Gjenevë,
- Raportuesi Special për Torturën, (OKB);
- Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁴,
- Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore ose Poshtëruese (KPT); vizita e parë në Kosovë e këtij mekanizmi ishte më 21 deri më 29 mars 2007, ndërsa vizita e dytë nga 8 deri me 15 qershor 2010⁵, pas vizitave të bëra nga KPT, i njëjti ka publikuar raporte me të gjetura të cilat i janë dorëzuar institucioneve relevante të Republikës së Kosovës.
- Nën komisioni i KB për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore ose Degraduese,
- Nën komisioni i KB për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore ose Degraduese

Si mekanizëm është veçanërisht i ri Nën komisioni i KB për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore ose Degraduese në nivelin ndërkombëtar, i cili përcaktohet sipas Protokollit Opcional (2006) të Konventës KB kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. Ky Protokoll përcakton edhe krijimit dhe funksionalizmin e një Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës në nivel shteti.

Vlen të theksohet se Shqipëria si një ndër vendet e para në botë pas ratifikimit të këtij Protokollit ka krijuar dhe ka funksionalizuar këtë lloj mekanizmi monitorues dhe inspektues.

Ngjashëm ka vepruar edhe Republika e Maqedonisë duke e krijuar dhe funksionalizuar Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës në nivel shteti.

Ndërsa sa i përket Republikës së Kosovës, krijimi dhe funksionalizimi i këtij mekanizmi është ende në nivel të diskutimeve publike, ku për herë të parë nevojën e krijimit të këtij mekanizmi e ka theksuar Avokati i Popullit, ndërsa në këtë angazhim për sensibilizimin e aktorëve të drejtësisë penale dhe

⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka nxjerr qindra vendime lidhur me trajtimin e personave të privuar nga liria dhe kushtet në institucionet penitenciare, për më tepër shih Peers kundër Greqisë, kërkesa nr.28524/95 e datës 19 prill 2001, Kalashnikov kundër Rusisë, kërkesa nr.47095/99 , e datës 15 korrik 2002, Mamedova kundër Rusisë, kërkesa nr.7061/05 , e datës 23 tetor 2006, Dybeku kundër Shqipërisë, ankimi nr.41153/06, i datës 18 dhjetor 2007, Gromi kundër Shqipërisë, ankimi nr. 25336/04, i datës 7 korrik 2009, etj.

⁵ [www.cpt.coe.int/CPT/Inf\(2009\)4](http://www.cpt.coe.int/CPT/Inf(2009)4), me gjerësisht referojuni raporteve të publikuara CPT/Inf (2009) 4 dhe CPT/Inf(2011) 26, pas vitit 2010 deri në punim e këtij shkrimi nuk ka pasur më tej vizita nga KPT. Marrëveshja mes Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut) dhe Këshillit të Evropës për rregullimin teknik në lidhje me Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin e Dënimit Çnjerëzor dhe Degradues, është arritur me 23 gusht 2004.

opinionit me të gjerë janë për t'u vlerësuar lartë përpjekjet e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) në Prishtinë. Çështja e krijimit të këtij mekanizmi është diskutuar më 26 qershor 2009 në “ Ditën Ndërkombëtare Kundër Torturës” si dhe më 24 shtator 2009 në kuadër të një diskutimi të organizuar nga (QKRMT) në Prishtinë.

Megjithatë, në maj të vitit 2011, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve nga Tortura (QKRMT), kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi dhe është krijuar një “Task Force” që luan rolin e mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës (MKP), i cili mekanizëm ka filluar të veprojë derisa të gjendet një zgjidhje ligjore më e avancuar dhe në përputhje me standardet evropiane, e veçmas konform rekomandimeve të Këshillit të Evropës dhe të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës.

Nëse ju referohemi akteve juridike ndërkombëtare, ***Rregullave Evropiane të Burgjeve (2006/2)***, përcaktojnë që të gjitha burgjet duhet të jenë subjekte të inspektimit të rregullt qeveritar dhe të monitorimit të pavarur si dhe burgjet duhet të inspektohen rregullisht nga një agjenci qeveritare në mënyrë që të vlerësohet nëse ato administrohen në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar dhe me parashikimet e këtyre rregullave, po ashtu edhe gjatë monitorimit të pavarur që duhet bërë kushteve të ndalimit dhe të trajtimit të të burgosurve, që duhet monitoruar nga një organ ose nga disa organe të pavarura, gjetjet e të cilëve do të bëhen publike.

Protokolli Opcional i Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese (2002), përcakton që qëllimi i këtij protokollit është të krijojë një sistem të vizitave të rregullta në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria të ndërmarrë nga organet e pavarura kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim të parandalimit të torturës dhe formave të tjera të trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor apo degradues dhe që çdo shtet palë do të themelojë, krijojë ose mbajë në nivel vendi një ose disa organe vizituese për parandalimin e torturës dhe formave tjera të trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor apo degradues.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (1966), përcakton që shtetet palë të garantojnë se çdo personi të cilit i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura nga ky pakt, do të ketë të drejtën në mjete juridike efektive edhe nëse shkelja është bërë nga persona që veprojnë në cilësi zyrtare. Të garantojnë se autoriteti kompetent gjyqësor, administrativ ose ligjdhënës ose çdo autoritetet tjetër kompetent në bazë të legjislacionit të shtetit do të përcaktojë të drejtat e

këtij personi që shfrytëzon mjetet juridike si dhe të zhvillojnë mundësitë për mjete juridike gjyqësore.

Tërësia e Parimeve Për Mbrojtjen e të Gjithë Personave në Çfarëdo Forme të Paraburgimit ose Burgosjes, përcakton që personi i paraburgosur ose i burgosur apo avokati i tij, do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë ose ankesë, në lidhje me trajtimin e të burgosurit, veçanërisht në raste të torturës ose formave të tjera të trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor apo degradues, te autoritetet përgjegjëse për administrimin e burgut ose te autoritetet më të larta dhe në rast se është e nevojshme te autoritetet përkatëse të cilëve u janë dhënë fuqi për rishikim ose për mjete të posaçme juridike”.

Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve, përcaktojnë se i burgosuri duhet të ketë të drejtën, në çdo ditë pune, t’i parashtojë kërkesa dhe ankesa drejtorit të institucionit ose nëpunësit që është autorizuar ta përfaqësojë atë dhe që kërkesat mund t’i parashtrohen edhe inspektorit të burgjeve gjatë një inspektimi. I burgosuri mund të bisedoj me inspektorin ose me çdo nëpunës tjetër të ngarkuar me inspektimin pa praninë e drejtorit ose të anëtarëve të tjerë të personelit të institucionit. Inspektorë të kualifikuar dhe me përvojë, të caktuar nga një organ kompetent, duhet të kryejnë inspektime të rregullta në burgjet dhe shërbimet në to. Ata duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë që këto institucione të administrohen në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe me qëllim që të arrihen objektivat e shërbimeve penitenciare dhe korrektuese.

Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues, përcakton që të themelohet Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor apo Degradues “Komiteti”. Komiteti, përmes vizitave do të kontrollojë trajtimin e personave të privuar nga liria, me qëllim që nëse është e nevojshme të forcojë mbrojtjen e personave të tillë nga tortura dhe trajtimin ose dënimin çnjerëzor apo degradues. Çdo shtet palë në përputhje me këtë Konventë, do të lejojë vizita në çdo vend, brenda juridiksionit, ku mbahen personat e privuar prej autoritetit publik”.

Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve të njohura si “Udhëzimet e Riadit”, përcaktojnë se “ duhet marr parasysh themelimi i një zyre të Ombudsmanit apo të ndonjë organi të pavarur, i cili do të siguronte përkrahjen e statusit, të drejtave dhe interesave të të rinjve dhe referimin e duhur për shërbimet që janë në dispozicion. Ombudsmani apo ndonjë organ tjetër i caktuar po ashtu do të mbikëqyrnin implementimin e Udhëzimeve të Riadit, të Rregullave të Pekinit dhe Rregullave për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria. Ombudsmani apo ndonjë organ tjetër në

intervale të rregullta kohore, do ta publikonin një raport për progresin që është bërë dhe për vështirësitë të cilat janë hasur gjatë implementimit të dokumenteve ligjore dhe duhet krijuen shërbime për mbrojtjen e fëmijëve”.

Rregullat e KB për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, përcaktojnë “Inspektorët e kualifikuar ose një autoritet tjetër ekuivalent, i themeluar në mënyrë të rregullt, që nuk i takon administratës së objektit, duhet të autorizohet për të kryer inspektime të rregullta dhe për të ndërmarr inspektime të paparalajmëruara sipas nismës së vet. Këta duhet të gëzojnë garanci të plotë të pavarësisë në ushtrimin e funksionit të kësaj detyre. Inspektorët duhet të kenë qasje të pakufizuar në të gjithë personat e punësuar ose që punojnë në objektin ku të miturve u është hequr liria ose mund t’u hiqet liria, në të gjitha të dhënat e objekteve të tilla. Duhet bërë përpjekje për hapjen e një zyre të pavarur (Ombudspersoni) për të pranuar dhe hetuar ankesa të cilat i bëjnë të miturit e privuar nga liria dhe për të ndihmuar në arritjen e zgjidhjeve të drejta”.

Legjislacioni ndërkombëtar dhe ai vendor obligon ligjërisht krijimin dhe funksionimin e sistemit të monitorimit, inspektimit dhe mbikëqyrjes së institucioneve penitenciare. Krijimi, funksionimi dhe avancimi i këtyre mekanizmave është përgjegjësi e institucioneve publike shtetërore. Ekzistimi dhe funksionimi i mekanizmave të lartpërmendur është preventiv dhe mbrojtje si për respektimin e të drejtave të njeriut, për trajtimin e ankesave të burgosurve ashtu është edhe mbrojtje për personelin e burgjeve i cili mund të bjerë pre e akuzave të pabaza.

Nëpërmjet inspektimit dhe monitorimit të institucioneve penitenciare (qendra të ndalimit në polici, qendra të paraburgimit apo burgje, qendra psikiatrike, qendra të shëndetit mental, qendra të azileve, qendra të mbajtjes së të miturve), realizohen qëllimet e vizitave të rregullta, të cilat janë shumë me rëndësi për trajtimin human të personave të privuar nga liria dhe për menaxhimin më efikas të sistemit penenciar brenda sistemit juridik të shtetit.

Burgjet për nga natyra janë institucione të mbyllura dhe si të tilla duhet t’i nënshtrohen inspektimeve dhe monitorimeve të rregullta dhe ad hoc. Krijimi i procedurave dhe i mekanizmave të përshtatshëm dhe efektiv për të hetuar ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut brenda në institucionet penitenciare janë të domosdoshme.

Si inspektimet ashtu edhe monitorimet janë procedura që duhet të jenë të inkorporuara në sistemet juridike të shtetit si dhe duhet krijuar mekanizmat për t’i funksionalizuar këto procedura, siç mund të jenë njësi të inspektimit që mund të jenë autoritete publike qeveritare, organizata të pavarura të monitorimit,

organizata, borde, trupa të ndryshëm të pavarura si edhe organizata joqeveritare.

Dy procedurat e lartpërmendura inspektimet dhe monitorimet në institucionet penitenciare mund të jenë të natyrës: parandaluese dhe reaguese.

Mekanizmat që monitorojnë dhe inspektojnë që janë të natyrës parandaluese, kanë për qëllim që nëpërmjet monitorimeve periodike dhe ad hoc bërë institucioneve penitenciare të ndikojnë në përmirësimin e mëtejshëm të kushteve dhe të drejtave të personave të privuar nga liria.

Mekanizma të natyrës reaguese zakonisht janë ato organizma që kanë për qëllim që në kuadër të konkluzioneve të nxjerra të veprojnë duke pasuar me procedura të mëtejshme në kuadër të sistemit juridik të shtetit.

Në Republikën e Kosovës, mekanizmi reagues i cili fushë veprimtari e ka inspektimin e burgjeve është krijuar Inspektorati për Shërbimin Korrektues, i cili është krijuar me vendim të Ministrisë të Drejtësisë⁶.

Me krijimin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe inspektoratit sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, krijohen premisa për funksionalizimin e një sistemi efektiv të avancimit, respektimit, mbrojtjes dhe sigurimit të drejtave të personit të privuar nga liria në sistemin penenciar në Republikën e Kosovës.

Ndërsa sa i përket monitorimeve në institucionet penitenciare situata është ndryshe, më e avancuar, kemi një numër të madh të institucioneve, organizatave joqeveritare dhe ndërkombëtare që në kuadër të fushë veprimtarisë së tyre kanë edhe monitorimet në burgje si p.sh. Kryqi i Kuq Ndërkombëtar (KKN), Human Right Watch, Amnesty International, Institucioni i Avokatit të Popullit (Avokati i Popullit), Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim të Evropës (OSBE)⁷, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRMT).

Përfundim

Duke qene se fusha e ekzekutimit te sanksioneve penale është mjaftë e gjerë dhe komplekse, zyrtaret e zbatimit te ligjit ne veprimet e tyre përveç qe duhet të jetë profesionale, humane duhet të jenë edhe ligjshme. Profesionalizmi,

⁶ www.md-ks.org - faqja elektronike zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë.

⁷ www.osce.org/sq/kosovo OSBE- kushtet në qendrat e parburgimit në Kosovë, dhjetor 2010.

humanizmi dhe ligjshmëria janë thelbësore ne arritjen e objektivave gjate ekzekutimit te sanksioneve penale. Andaj, administrimi i sistemit të drejtësisë penale - ekzekutimi i sanksioneve penale kërkon që, përveç krijimit dhe ekzistimit të instituteve të lartpërmendura dhe përmbushjes së standardeve ndërkombëtare gjatë ekzekutimit të sanksioneve penale apo masave të tjera, legjislacioni dhe institutet e lartpërmendura si monitorimi dhe inspektimi të mos jenë një dekor i bukur në mozaikun e ligjeve, por të njëjtat të jenë të prekshme për sistemin e drejtësisë penale, respektivisht për personat e privuar nga liria dhe të gjejnë zbatim praktik në sundimin e shtetit të së drejtës. Me funksionalizimin e instituteve të lartpërmendura, krijimin e mekanizmave adekuat, shihen qartazi avancime të evoluimit të sistemit të drejtësisë penale të vendit tonë ndaj realitetit shoqëror, njohurive të reja dhe trendëve të demokratizimit dhe humanizmit të politikës penale të shtetit.

BIBLIOGRAFIA

I. Literatura:

Halili, Ragip: Penologjia, 2005, 2002.

Morris, Norval dhe Rothman, David J. The Oxford History of the Prison, the practice of punishment in Western Society, New York- Oxford, 1998.

Nowicki, A, Marek Rreth Konventës Evropiane, Tiranë, 2003. Rzhempinski, Andrej Monitorimi i kushteve të burgimit, 1997. Sufaj, Fehmi Historia e burgjeve ne Shqipëri, Tiranë, 2000.

Sadiku, Isuf Ekzekutimi i sanksioneve penale në dritën e akteve më të reja ndërkombëtare, Prishtinë, 2010.

Manual i gjykimit të drejt, Amnesty International, 1998.

Preventing torture, OSCE and ODIHR, 1st Edition, Warshava, 1999.

Prison overcrowding and prison population inflation, Council of Europe, 2000.

Human Rights Monitoring, Helsinki Foundation for Human Rights, Warshava 2004.

Raportë të Komitetit Evropian për parandalimin e torturës dhe të dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore dhe poshtëruese (KPT).

Të drejtat e njeriut dhe burgjet, Përmbledhje instrumentesh ndërkombëtarë për te drejtat e njeriut lidhur me administrimin e drejtësisë, programi mbështetës për të drejtat e njeriut në Kosovë, FINNISH-OHCHR.

II. Aktet juridike:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, 2010, 2013. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2013.

Kodi i Procedurës Penale, 2013.

Ligji për Avokatin e Popullit Nr. 03/L195. Kodi i Drejtësisë për të Mitur, 2010.

Rregullat Evropiane të Burgjeve (2006/2),

Protokolli Opcional i Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese (2002).

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve.

Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor ose Degradues.

Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve. Rregullat e KB për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.

III. faqet elektronike të konsultuara:

www.md-ks.org – faqja elektronike zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë. www.ombudspersonkosovo.org faqja elektronike zyrtare e Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës.

www.echr.coe.int - faqja elektronike e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. www.osce.org - faqja elektronike zyrtare e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, OSBE-së.

www.coe.int - faqja elektronike zyrtare e Këshillit të Evropës.

www.cpt.coe.int - faqja elektronike zyrtare e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës.

Ma Sc. Isa Shala

PËRMBARIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE DHE TË DOKUMENTEVE TJERA QE PËRMBAJNË DETYRIM

ABSTRAKT

Përmes hulumtimeve në punim do të paraqes zhvillimet në vitet e fundit të sistemit të përmbarimeve si dhe fillimin e privatizimit të shërbimeve të përmbarimit në Kosovë duke bërë krahasime me sistemet në vendet në rajon.

Reforma e sistemit të përmbarimit të vendimeve të gjykatës dhe të dokumenteve tjera të detyrueshme është më e rëndësishmja në kuadër të reformës së drejtësisë. Shteti ynë ka bërë hapa të rëndësishëm në reformimin e sistemeve ligjore dhe gjyqësore si rrjedhojë e procesit të anëtarësimit në BE duke paraparë që legjislacioni, procedurat dhe praktikat të harmonizohen me standardet ndërkombëtarisht të pranueshme, siç janë rekomandimet e Këshillit të Evropës.

Raporti i progresit të Komisionit Evropian vëren se sistemet përmbarimore ekzistuese në Kosovë dhe shtetet në rajon nuk përmbushin më kërkesat e së sotmes. Gjykatat kanë numër të madhe të lëndëve të mbetura kryesisht lëndë të përmbarimit. Mundësia e tepërt e përdorimit të mjeteve juridike, shkakton procedura të gjata dhe të panevojshme nëpër gjykata.

Duhet të identifikohen disa shkaqe që lidhen me kornizën legjislative, ku ligjet kanë pasur shkallë të lartë të mbrojtjes së debitorit në lëndët e përmbarimit. Performanca dhe standardet e larta të llogaridhënies, vlerësimit dhe performancës janë absolutisht me rëndësi kritike për arritjen e një sistemi të përmirësuar të përmbarimit.

Fjalët kyqe; Detyrueshme, performanca, standardet, përmbarimi, llogaridhënie

1. Hyrje

Në shoqëritë e organizuara në shtete, vetëgjyqësia parimisht është e ndaluar dhe e dënuar. Shteti është ai që u jep mbrojtje juridike subjekteve të së drejtës për të drejtat subjektive që u janë shkëlur nga të tjerët. Shteti e bënë këtë me anë të organeve të cilat veprojnë në bazë të ligjeve.¹ Mbrojtja e të drejtave

* Autori i këtij shkrimi, Ma. Sc Isa Shala, është gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, dega në Skënderaj

¹Brestovci, Faik E drejta Procedurale Civile II, Prishtine 1997 faqe 17.

subjektive të shkelura bëhet në procedurë që zhvillohet në gjykatat e rregullta, në organet administrative apo përmes agjencioneve private të specializuara të përbarimit. Detyrimi i shtetit në mbrojtjen juridike të subjekteve nuk përfundon vetëm me marrjen e vendimit, apo konstatimin e shkeljeve të të drejtave subjektive dhe detyrimin e palës së kundërt për të kryer veprimin e caktuar, apo për tu përmbajtur në veprime të caktuara.

Në qoftë se pala e cila ka detyrim nuk e përmbush detyrimin në mënyrë vullnetare atëherë pala tjetër për realizimin e kësaj të drejtë duhet tu drejtohet gjykatave kompetente apo përmbauesve privat.

Përbarimi efikas, i shpejt dhe efektiv i aktgjykimeve është çelës për besimin publik në gjykata, përderisa përbarimi i suksesshëm i aktgjykimeve krijon dhe ruan kredibilitetin e gjykatave. Sistemet efektive për përbarimin e vendimeve gjyqësore paraqesin elementin jetësorë për rritje ekonomike, krijimin e vendeve të punës, investime të huaja dhe rritjen e prosperitetit.

Viteve të fundit, shumë shtete në rajon, po edhe më gjerë, kanë bërë përpjekje dhe kanë paraqitur zgjidhje më efektive lidhur me këto procese jo efektive të përbarimit, edhe vendi ynë ka qene pjesë e këtyre proceseve.

Vonesat e mëdha në përbarimin e vendimeve gjyqësore në Kosovë dëmtojnë rëndë të drejtën për gjykim korrekt brenda kohës së arsyeshme duke dëmtuar në përgjithësi sundimin e ligjit.

Rastet më problematike paraqiten kur kemi të bëjmë me përbarimin e vendimeve në bazë të dokumenteve të besueshme siç janë faturat e kompensimeve publike për shkak të numrit të madhe të lëndëve dhe rastet kur debitor janë organet shtetërore si komunat apo ministrinë.

Thomas Hammarberg, Komisionar për të Drejtat e Njeriut pran Këshillit të Evropës në vitin 2009 kishte thënë: “përbarimi i mangët i vendimeve përfundimtare gjyqësore duhet të shihet si refuzim për të pranuar sundimin e ligjit dhe është një problem serioz për të drejtat e njeriut”.²

Komisioni Evropian lidhur me Raportin e progresit për Kosovën për vitin 2010 thekson “aktgjykimet e pa ekzekutuara kanë shkelur besimin e publikut, në

² Thomas Hammarberg, Komisionar për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Evropës Zbatimi me të meta i vendimeve gjyqësore zbeh besimin në drejtësinë e shtetit” 31 gusht 2009. Në dispozicion në internet përmes faqes http://www.coe.int/t/commissiner/viewpoints//090831_en.asp. e qasur në internet me 27 shtator 2011.

aftësinë, profesionalizmin dhe korrektësinë e gjyqësorit duke kufizuar në këtë mënyrë qasjen efektive në drejtësi.³

2. Zbatimi i akteve ndërkombëtare në përmbartimin e vendimeve gjyqësore

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila gjykon çështjet ligjore që dalin nga rastet vendore dhe që përfshijnë çështjet penale dhe civile, ka gjetur se procedurat përmbartimore duhet të shihen si pjesë integruese e gjykimit për qëllime të nenit 6 të konventës.

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut është shumë e qartë në interpretimin e kësaj dispozite: “Do të ishte e pa konceptueshme që neni 6 paragrafi 1 të përshkruajë në detaje garancitë procedurale që i akordohen palëve në procedurë që të jenë të drejta, publike dhe ekspeditive, nëse nuk mbrohet zbatimi i aktvendimeve gjyqësore. Nëse interpretohet neni 6 se ka të bëjë vetëm me qasjen në gjykatë dhe kryerjen e procedurave, kjo do të çojë në situatë të papërputhshme me parimin e sundimit të ligjit që është marrë përsipër nga shtetet kontraktuese e që duhet respektuar gjatë ratifikimit të konventës. Përmbartimi i aktvendimit të nxjerrë nga cilado gjykatë duhet të shihet si pjesë integrale e “gjykimit” për qëllime të nenit 6, dhe gjykata tanimë ka pranuar këtë parim në rastet në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës.”⁴

Ne çështjen Delcourt kundër Belgjikës, gjykata deklaroi se: “në një shoqëri demokratike brenda kuptimit të konventës, e drejta për një ushtrim të drejtë të drejtësisë në një vend kaq të rëndësishëm sa një interpretim i kufizuar i nenit 6(1) nuk do të korrespondojë synimit dhe qëllimit të asaj dispozite.”⁵

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 22 parasheh “Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kane prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike”.⁶

Në bazë të kësaj, mund të përmendet në veçanti neni 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili ka të bëjë edhe me çështjet civile.

³Komisioni Evropian, Raporti i progresit për Kosovën për vitin 2010, Bruksel 9 nëntor 2010.

⁴Raporti i OSBE-së, Vonesat ne ekzekutimin e vendimeve përfundimtare gjyqësore paraqesin shkelje te ligjit vendor dhe te drejtën për një gjykim korrekt, shtator 2007 faqe 3-4. E qasesh me ne internet përmes faqes <http://www.osce.org/sq/kosovo/28298> (e qasur 25 korrik 2011).

⁵Nuola Mole dhe Catharina Harby, Manualet e të drejtave të njeriut, nr.3.

⁶Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet,

Vendi ynë gjatë reformimit të sistemit të drejtësisë ka bërë harmonizimin e ligjeve me ato të BE-së dhe në kuadër të kësaj në Ligjin për procedurën përmbartimore nr.04/L-139 ka marrë për bazë rekomandimet e Këshillit të Evropës për përmbartimin, duke parapare ndryshime organizative, duke ofruar mekanizma me efikas të përmbartimit, zhvillim gradual të infrastrukturës ligjore dhe logjistike, duke besuar se standardet e llogaridhënës, vlerësimit dhe performances janë te një rëndësie jetike për një sistem efikas të përmbartimit.

Më 17 dhjetor 2009, Komisioni Evropian për efikasitet CEPEJ ka botuar një udhëzues për zbatim më të mirë të rekomandimit të Këshillit të Evropës për përmbartimin.⁷

Rekomandimi (dhe udhëzimet) bazohet në efikasitet, transparencë dhe kuptim të lehtë të tij. Por ai nuk përshkruan sistemin ideal. Nuk ekziston sistemi ideal për përmbartim. Por ajo çka është e mundshme, është parashikimi i bazës dhe parimeve të përmbartimit. Si të tilla, këto rekomandime dhe udhëzime mund të shfrytëzohen për të vlerësuar procedurat dhe praktikat e përmbartimit. Është e qartë se rekomandimi REC(2003)17 dhe udhëzimet nuk kanë forcë obliguese. Megjithatë ai mund të merret si pikë referente për përkufizimin e mëtejshëm të një sistemi efektiv dhe efikas të përmbartimit. Rekomandimi dhe udhëzimet parashkruajnë një numër të parimeve udhëzuese në lidhje me përmbartimin. Më veçanërisht, ai parashkruan disa parime dhe standarde në lidhje me përkufizimin, gamën ligjore të aplikimit të rekomandimit, procedurën e përmbartimit dhe zyrtarët përmbartimor.

Ndoshta rekomandimet dhe udhëzimet mund të konsiderohen si “Rregullore” apo udhëzues. Sistemet kombëtare janë aq te ndryshme sa që është shumë vështirë për të krijuar një sistem ideal përmbartimor apo zyrtar ideal përmbartimor.

në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

⁷ Udhëzimet për zbatim më të mirë të rekomandimit ekzistues të Këshillit të Evropës për përmbartim, Komisionit evropian për efikasitet të drejtësisë (CEPEJ), CEPEJ (2009) rishikimi i 11-të, në tekstin e mëtejshëm CEPEJ (2009) rishikimi i 11-të (shih shtojcën).

Por çfarë është sistemi adekuat i përmbarimit? Si funksionon ai? A kemi sistemi ideal? A ekziston sistemi ideal për përmbarim? Nuk ka ende përgjigje. Kjo është utopi. Megjithatë, përmes rekomandimeve dhe udhëzimeve, mund të jetë e mundshme që të zbatohen bazat dhe parimet e caktuara në një sistem.⁸ Në rezolutën nr. 3 të Konferencës së 24-të të Ministrave të drejtësisë në Moskë (4 dhe 5 tetor 2001) është theksuar se “përmbarimi i duhur, efektiv dhe efikas i aktvendimeve të gjykatës është i rëndësishëm kapitale për shtetet me qëllim që të krijojnë, zbatojnë dhe zhvillojnë një sistem të fortë dhe të respektuar gjyqësor”. Në bazë të këtij përfundimi, Komisioni i ministrave të Këshillit të Evropës ka miratuar rekomandimin për përmbarim.⁹

3. Përmbarimi i vendimeve gjyqësore nga organet gjyqësore

Ne praktiken gjyqësore sa i përket kompetencës ka pasur interpretime të ndryshme, se me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për procedurë përmbarimore nr. 04/L-139 kreditorët a kanë të drejtë që për të gjitha çështjet prape ti drejtohen gjykatës.

Në nenin 5 paragrafi 2 të këtij ligji citohet “Gjykata kompetente ka kompetencë lëndore për të urdhëruar dhe për të kryer përmbarimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës në pajtim me dispozitat e këtij Ligji përveç nëse gjykatat dhe autoritetet tjera përmbaruese kanë juridiksionin për të urdhëruar dhe për të kryer përmbarimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës.

Ndërsa në nenin 5, paragrafi 6, citohet “Gjykata është kompetente të vendos në procedurën e përmbarimit dhe të zbatoj përmbarimin e vendimeve gjyqësore lidhur me:

- të gjitha çështjet nga e drejta familjare
- kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera

Kjo dispozite është dispozitë përjashtuese, që gjykata të vendos në çështje tjera përveç nëse është parapare që me ligj të vendose për çështje si p.sh. për të

⁸ Agjenti përmbarimor në Evropë: Utopi apo realitet, Kluwer 2004, faqe 313, në mars të vitit 2004 në Utrecht të Holandës u mbajt një Konferencë ndërkombëtare e titulluar: “Agjenti përmbarimor në Evropë: Utopi apo realitet?”. Agjenti përmbarimor Douwe Strikma, një nga folësit, kishte thënë: “Kur agjentët përmbarimor në Evropë mund të punojnë në bazë të modelit të njëjtë të punës, mund të arrihet një sistem adekuat përmbarimor në mënyrë ligjërish të shëndoshë dhe pragmatike”.

⁹ Rekomandimi 17/2003, i miratuar më 09 shtator 2003.

vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbarese sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përmbaresi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik.

Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit. Nëse debitori nuk ka vendbanim të përkohshëm ose seli në Kosovë, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e se cilës gjinden sendet e luajtshme dhe të paluajtshme e të cilat janë objekt përmbarimi¹⁰.

Sa i përket çështjes se vendosjes ku ne procedurën e përmbarimit në shkallë të parë e udhëheqë dhe për të vendosë përmbaresi privat, ndërsa përjashtimisht gjyqtari individual (i vetëm) kur me këtë Ligj është caktuar se përmbarimin e cakton dhe zbaton gjykata (organi i shkallës së parë), është përcaktuar edhe një afat ku organi përmbarese vendosë për propozimin e përmbarimit brenda afatit prej 7 ditëve pas pranimit të propozimit.¹¹

Sipas dispozitës se lartcekur “në shkallën e dytë vendimet i nxjerrë gjyqtari individual”, që nuk ka qenë praktikë e deri tashme kur dihet se në shkallën e dytë vendos kolegji për shqyrtimin e ankesës.

4. Përmbarimi i vendimit për kthimin në vendin e punës dhe dorëzimin e fëmiut

Çështjet me te rëndësishme dhe me te ndjeshme kane mbetur ne kompetencë të gjykatës. Gjykata ka kompetenca ekskluzive për përmbarimin e vendimeve lidhur me kthimin e punëtorit dhe shërbyesve civil në punë.

Për vendosje për propozimin për përmbarim në bazë të dokumentit përmbarese, me të cilin punëdhënësi është urdhëruar që punëtorin ta kthejë në punë, apo që ta sistemoj në vendin përkatës të punës dhe për zbatimin e përmbarimit, e kompetencës territoriale është Gjykata në territorin e së cilës është krijuar marrëdhënia e punës.¹²

Propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit përmbarimor për kthim në

¹⁰ Shih nenin 5 par.5 i LPP-es nr.04/L-139

¹¹ Shih nenin 3 par.1 i LPP-së nr.04/L-139

¹² Shih nenin 312 i LPP-së nr.04/L-139

vendin e punës, me të cilin punëdhënësi është urdhëruar që punëtorin ta kthejë në punë, mund të paraqitet brenda afatit prej nëntëdhjete (90) ditësh, nga dita kur vendimi është bërë i formës së prerë.

Përmbartimi në bazë të dokumentit përmbartues sipas të cilit punëdhënësi është i detyruar që punëtorin ta kthejë në punë, apo që ta sistemoj në vendin përkatës të punës, zbatohet me anë të caktimit të gjobave në të holla kundër punëdhënësit dhe personit përgjegjës në të.

Dënimi me të holla caktohet sipas dispozitave të nenit 15 dhe 16 të këtij ligji dhe dispozitave për përmbartimin me qëllim të realizimit të kredisë për veprimin të cilin mund ta kryejë vetëm debitori.¹³

Sipas nenit 317 te LPP-es propozuesi i përmbartimit rezervon të drejtën e tij për pagesë ose kompensimin e pagave mujore ose pagesave tjera përderisa ka qenë i papunësuar për shkak të një vendimi të paligjshëm të punëdhënësit për largimin e tij nga puna dhe mund të kërkojë që rasti i tij të trajtohet në procedurë kontestimore.

Në qoftë se Gjykata përmbartimore vetëm pjesërisht e ka miratuar kërkesën për pagimin e pagave mujore, atëherë ajo do ta udhëzojë kreditorin e përmbartimit që pjesën tjetër të kërkesës ta realizojë në procedurën gjyqësore kontestimore.¹⁴

Te instituti sa i përket dorëzimit dhe marrjes së fëmijut këto dispozita pershtatshmerisht zbatohen edhe në rastet e kontaktit të fëmijut sepse në praktikë gjykata vepron sipas këtyre propozimeve.

Për të vendosur për propozimin për përmbartimin e vendimit të Gjykatës me të cilin urdhërohet dorëzimi i fëmijës prindit, apo personit tjetër, respektivisht institucionit të cilit i është besuar fëmija në ruajtje dhe edukim, është kompetente Gjykata e cila është e kompetencës së përgjithshme territoriale për palën që e kërkon përmbartimin, por edhe Gjykata në territorin e së cilës ndodhet fëmija. Për zbatimin e përmbartimit, kompetente në pikëpamje territoriale është Gjykata në territorin e së cilës ndodhet fëmija në kohën e përmbartimit.¹⁵

Propozimin për përmbartimin e vendimit mund ta paraqesë prindi, apo personi tjetër të cilit fëmija i është besuar në ruajtje dhe edukim, si dhe

¹³ Shih nenin 314 i LPP-së nr.04/L-139

¹⁴ Shih nenin 317 paragrafi 2 i LPP-së nr.04/L-139

¹⁵ Shih nenin 318 i LPP-së nr.04/L-139

organi i kujdestarisë. Rendësi e posaçme i është kushtuar mënyrës se zbatimit të përmbartimit ku gjykata kujdeset për nevojën që të mbrohen interesat e fëmijës në masën më të madhe të mundshme.

5. Roli i Gjyqtarëve dhe zyrtarëve përmbartimor

Ne sistemin tonë është kompetence e gjyqtarit që ta lejojë përmbartimin por kjo nuk do të thotë se edhe në këtë fazë të procedurës të mos ketë ndihmën e zyrtarit përmbartues sidomos në rastet që nuk janë të ndërlikuara.

Gjyqtari ka përgjegjësi sipas ligjit për këto veprime përmbartimore:

- Të bëjë verifikimin e propozimit për përmbartim,
- Të vendos mbi kundërshtimin dhe ankesat dhe mbi kontestet që dalin gjatë procedurës përmbartimore,¹⁶
- Si dhe punë tjera të përcaktuara me ligj që janë në kompetence të gjyqtarit përmbartues p.sh. dorëzimi i fëmijës.

Zyrtari i përmbartimit përveç që ka detyra administrative të cilat përfshin:

- Mbajtjen e regjistrave të përmbartimit,
- Procedimin e njoftimeve për palët
- Si dhe përpilimin e procesverbaleve sa i përket regjistrimit dhe sekuestrimit të sendeve të luajtshme, sekuestrimin e pengut, zbrazjen dhe dorëzimin e palujtshmërise.

Obligimet të gjyqtarit dhe zyrtarit të përmbartimit janë:

- Respektimi i dinjitetit të debitorit,
- Procedimi me kohë i propozimeve për përmbartim dhe sipas radhës së pranimit të tyre.

Në procedurën e përmbartimit gjykata ka për detyrë të veprojë me ngutshmëri.¹⁷Gjykata ka për detyrë që lëndët t'i marrë në procedim sipas radhës me të cilën i kanë ardhur propozimet për përmbartim, përpos kur natyra e kredisë ose rrethanat e posaçme kërkojnë që gjykata të veprojë ndryshe.

Ligji nuk ka përcaktuar qarte se cilat janë këto rrethana te posaqë por gjykata do të veprojë duke vlerësuar secilin rast veç e veç, përveç rasteve kur janë me

¹⁶ Neni 73 i Ligjit të Procedurës Përmbartimore Nr.04/L-139.

¹⁷ Neni 6 i Ligjit të Procedurës Përmbartimore Nr.04/L-139.

prioritet si në çështjet familjare apo te kthimi i punëtorit në vendin e punës.

6. Detyrimet e personave tjerë në proces

Roli i personave të tretë në procedurë është veçanërisht dhënia e informacioneve të ndryshme p.sh. shërbimi kadastral, qendra e regjistrimit civil, qendra për regjistrimin e automjeteve, Shërbimi Policor i Kosovës.

Një tjetër kategori e personave të tretë në procedurë janë debitorët e debitorëve ku në raste praktike janë të shumta sidomos sa i përket procedurës përmbarimore të sekuestrimit të kolateralit. Palë të treta mund të jenë bankat komerciale ku në shumtën e rasteve debitorët kanë llogari të hapura në banka ku marrin të ardhura personale përmes këtyre llogarive bankare, apo veprimtari të ndryshme të biznesit ku pagesat e ndryshme kryhen përmes llogarive bankare.

Rol të rëndësishëm për zhvillimin e procedurës përmbarimore ka Shërbimi Kadastral, do të ishte e pamundur të zhvillohet një procedurë përmbarimore sa i përket palujtshmërisë pa ndihmën e këtyre shërbimeve në dhënie e informacioneve të nevojshme. Të njëjtën vlerë për identifikimin e personave, adresave të ndryshme ka shërbimi i regjistrimit civil. Për sigurinë e gjyqtarëve dhe personelit tjetër nëse është e nevojshme kërkohet asistencë nga Policia e Kosovës.¹⁸

7. Përmbarimi i vendimeve nga përmbaruesi privat

Sipas Ligjit të Procedurës Përmbarimore Nr.04/L-139 Kosova si edhe vendet tjera të rajonit nga viti 2014 ka funksionalizuar sistemin privat të përmbarimit. Ky sistem përmes agjentëve privat të përmbarimit pritet të ofrojë zgjidhje për të gjitha problemet tashmë që ekzistojnë në Kosovë. Agjentët privat të përmbarimit kanë tendencë të jenë tejet të motivuar dhe profesionist në punën e tyre, dhe ofrojnë nivel të lartë të shërbimeve për të siguruar suksesin e tyre konkurrues. Ata kanë kontroll të drejtpërdrejtë në menaxhimin e zyrave që i udhëheqin dhe përfitojnë personalisht nga performanca e tyre, duke sjellë një nivel të lartë të përgjegjësisë për çështjet siç janë: angazhimi dhe largimi, buxhetimi, sistemet e teknologjisë informative për të mbështetur punën e tyre dhe menaxhimin e zyrës.¹⁹

¹⁸ Neni 53.3 i LPP-se citon "Gjatë procedurës së përmbarimit organet e policisë kanë për detyrë që personit zyrtar të gjykatës t'i japin ndihmën e duhur për kryerjen e veprimeve të përmbarimit. Personi zyrtar i gjykatës, në rast nevojë mund ta urdhërojë marrjen e masave përkatëse ndaj personit që e pengon kryerjen e veprimeve të përmbarimit. 53.4 Me rastin e veprimit të organeve të policisë sipas urdhrit të personit zyrtar të gjykatës, në mënyrë të përshtatur aplikohen dispozitat e ligjit për punët e brendshme respektivisht të policisë gjyqësore.

¹⁹ Shih Programi sistemi i përmbarimit të marrëveshjeve dhe vendimeve në Kosovë (SEAD), Shtimi i efikasitetit të përmbarimit të kontratave, 30 prill 2010 faqe 34.

Përveç kësaj, për shkak se procesi i përmbarimit bëhet biznes privat në vend të funksionit publik, shpenzimet e furnizimit dhe mirëmbajtjes së zyrave të përmbarimit dhe të trajnimeve të agjentëve dhe punonjësve të tyre janë hequr krejtësisht nga buxheti i shtetit edhe pse shteti mbanë shumicën prej shpenzimeve të monitorimit të agjentëve të përmbarimit për të siguruar ligjshmërinë e funksionimeve të tyre, dhe disponueshmërinë e tyre atëherë kur kërkohet.²⁰ Sistemi privat i përmbarimit ka gjithashtu përparësinë e heqjes se përgjegjësisë së menaxhimit të procesit të përmbarimit nga gjyqtaret dhe zyrtarët përmbarues të gjykatave. Këto përgjegjësi i kalojnë agjentëve privat. Roli i gjykatave mbetet mjaftë i rëndësishëm sepse çështjet më të ndjeshme siç janë çështjet familjare mbesin kompetencë ekskluzive e gjykatave, po ashtu mjetet juridike mbesin në vendosje të gjykatave si dhe funksion tjetër i rëndësishëm është mbikëqyrja sepse palët të cilët mendojnë se agjenti privat ka shkelur ndonjë të drejtë të tyre mund ti drejtohen gjykatës.²¹

Megjithatë përfshirja e përditshme e drejtpërdrejtë e gjyqtarëve në procesin e përmbarimit mbaron duke i lënë gjyqtaret me përgjegjësi të tyre themelore të gjykimit të konteksteve gjyqësore mes palëve dhe duke ua hequr atyre barrën e disa përgjegjësive menaxhuese që shpesh marrin një pjesë të rëndësishme të kohës së tyre.

Për këto arsye sistemet e përmbarimit të bazuar rreth agjentëve privat të përmbarimit janë bërë standarde në pjesën më të madhe të Evropës Perëndimore dhe në shtetet ish socialiste dhe në Evropën Qendrore si dhe Evropën Lindore. Është po ashtu e drejtë të thuhet se edhe Shtetet e Bashkuara si dhe shumë shtete që zbatojnë ligjin zakonor kanë sistem të përmbarimit privat edhe pse të paktën në SHBA është i strukturuar shumë më ndryshe se në sistemet e Shteteve Ballkanike.²²

Profesioni i agjentit privat nuk është profesion i rehatshëm por shumë i rëndësishëm. Se sa i rëndësishëm është ky profesion tregon fakti se në disa shtete si është Bullgaria përmbaruesi i parë privat është emëruar ish Ministri i Drejtësisë, ndërsa në Belgjikë numri i përmbaruesve është i kufizuar dhe për t'u emëruar në këtë pozitë duhet të presësh shumë vite, ndërsa procedura është shumë e veçantë sepse emërimet bëhen nga mbreti.

²⁰ Shih Programi sistemi i përmbarimit të marrëveshjeve dhe vendimeve në Kosovë (SEAD), Shtimi i efikasitetit të përmbarimit të kontratave, 30 prill 2010 faqe 34.

²¹ Shih nenin 5, parag.5 I LPP-es, nr 04/L-139.

²² Shih Programi sistemi i përmbarimit të marrëveshjeve dhe vendimeve në Kosovë (SEAD), Shtimi i efikasitetit të përmbarimit të kontratave, 30 prill 2010 faqe 23.

LPP i vitit 2012 ka paraparë kritere të rrepta për emërimin e përmbauesve privat që në dukje janë identike me kriteret që kërkohen për emërimet për gjyqtar duke i dhënë një rëndësi dhe tretman të posaçëm këtij profesioni.²³ Vetëm Kosova në rajon ka paraparë në ligj që përmbauesit privat të kenë të kryer edhe provimin e jurisprudencës. Përmbauesi privat në Kosovë nuk guxon që të refuzoj kërkesat për përmbaerim, vetëm nëse plotësohen kriteret për përjashtim e që zbatohen përshtatshëmrisht dispozitat që vlejné edhe për përjashtimin e gjyqtarëve.²⁴

Përmbauesi privat në Kosovë, nuk ka të drejtë të kryej veprime tjera shtesë gjatë ushtrimit të profesionit²⁵ si në disa vende tjera, p.sh në Holandë përmbauesi privat ka të drejtë të kryej edhe rolin e avokatit për kreditorin nëse shuma e cila duhet të realizohet nuk kalon 5000 euro e që është duke u diskutuar qe ai të kryej rolin e avokatit edhe për rastet ku shuma është deri në 25000 euro, ndërsa në Belgjike përmbauesit mund të bëjnë edhe vlerësimin e objekteve para se të behet shitblerja e tyre, apo vlerësimi objekteve afër rrugëve të cilat do të ndërtohen.

Disa studiues besojné së një treg konkurrues në shërbimet profesioniste siç është përmbaerimi, funksionon më mirë se një strukturë qeveritare për ofrimin e atij qëllimi, por me kujdes të mjaftueshëm ai mund të funksionoi mjaft mirë.

Ligji i Procedurës Përmbaerimore ka pas për qëllim që përmbaerimi të jetë më efikas, mirëpo ende ekzistojné shumë pengesa për një përmbaerim më efektiv. Është e domosdoshme për të potencuar që nuk mund të arrihet deri te

²³ Neni 326 i LPP 2012 parasheh kushtet për emërimin e përmbauesit privat

1. Përmbaues privat mund te emërohet personi i cili plotëson kushtet si në vijim:

1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar, dhe duhet të jetë i aftë në aspektin shëndetësor;

1.3. të jetë jurist i diplomuar në fakultetin juridik, apo të ndonjë fakulteti juridik të ndonjë vendi tjetër, pas nostrifikimit të diplomës në Republikën e Kosovës;

1.4. të ketë të kryer provimin e jurisprudencës;

1.5. të ketë së paku tri (3) vjet përvojë pune juridike;

1.6. të ketë dhënë provimin për përmbaues;

1.7. që kundër tij nuk zhvillohet procedurë hetimore për veper penale, përkatësisht që nuk është i dënuar për veper penale me dënim me burg e cila veper është e dënueshme më së paku gjashtë (6) muaj, apo për veper penale e cila e bënë të padenjë në ushtrimin e punës së përmbauesit;

1.8. të paraqes deklaratë te noteri për gjendjen e tij material, me të gjitha pasojat nga dhënia e deklaratës së rejshme.

2. Në qoftë se kundër kandidatit që ka dorëzuar kërkesë për emërim për përmbaues është duke u zhvilluar procedurë penale, vendimi për emërim shtyhet deri sa të arrihet vendimi në procedurën penale.

²⁴ Neni 325 i LPP-së (2012) Dispozitat e ligjit të procedurës kontestimore për përjashtimin e gjyqtarëve vlejné përshtatshëmrisht edhe për përjashtimin e përmbauesve privat.

²⁵ Shih nenin 341 të LPP-së nr.04/L-139

përmbartimi efikas vetëm me ligjet e procedurës përmbartimore. Pas analizës së bërë në fushën e përmbartimeve është konstatuar se domosdosmërisht duhet të merren parasysh edhe:

- ligji për gjykatat nr.03/L-199
- ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nr.03/L-154
- ligji mbi hipotekën 2002/4
- ligji për marrëdhëniet e detyrimeve 04/L-077
- ligji mbi regjistrat e gjendjes civile nr.2004/46
- ligji për procedurën kontestimore 2009/03-L-006
- ligji për procedurën kontestimore – ndryshimet dhe plotësimet 2012/04-L-118
- ligji për procedurën jokontestimore 2008/03-L-007
- ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës 2010/03-L-209
- ligji për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme 2012/04-L-083
- ligji për arbitrazhin nr.02/L-75,²⁶
- ligji për ndërmjetësimin nr.03/L-057,²⁷
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut

8. Vendimet e organit përmbartues

Nga 1 janari 2014, vendimet në procedurën e përmbartimit organi përmbartues i nxjerrë në formë të aktvendimit ose urdhrin për përmbartim. Ligji këtu ka bërë një dallim në terminologjinë e vendimeve duke përcaktuar se si titullohet vendimi i gjykatës dhe si ai i përmbartuesit privat, por në esencë ka dhënë sqarime të mjaftueshme se çka kuptohet me këto vendime dhe çka duhet të përmbajnë këto vendime. Urdhri për përmbartim është vendimi i përmbartuesit privat me të cilin pranohet plotësisht apo pjesërisht propozimi për kryerjen e përmbartimit.²⁸

Aktvendimi për përmbartim është vendimi i Gjykatës përmes së cilit propozimi për përmbartim pranohet plotësisht apo pjesërisht apo përmbartimi urdhërohet sipas detyrës zyrtare.

²⁶ neni 38 i ligjit të arbitrazhit” Vendimi i arbitrazhit i cili është nxjerrë nga një tribunal i arbitrazhit brenda Kosovës ekzekutohet pasi që të shpallet i ekzekutueshëm nga gjykata. Kërkesa që vendimi i arbitrazhit të shpallet i ekzekutueshëm hidhet poshtë nëse gjykata konstaton se ekzistojnë një ose më shumë arsye për anulimin e vendimit sipas nenit 36. Kërkesës për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit i bashkëngjitet vendimi i tribunalit të arbitrazhit ose një kopje e vërtetuar e tij.

²⁷ neni 14.4 i ligjit për ndërmjetësimin lidhur me përmbartimin gjyqësor të vendimeve të ndërmjetësimit parasheh “pajtimi i arritur në procedurën e ndërmjetësimit kur është aprovuar nga gjykata apo vërtetuar nga organi kompetent .

²⁸ Shih nenin 2, par.1 nenp.1.12 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

Përmbartuesi i Gjykatës është i punësuar në sistemin gjyqësor i cili drejtpërdrejt kryen veprime përmbartuese të caktuara, ndërsa Përmbartuesi privat është personi fizik i emëruar nga Ministri i Drejtësisë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, i cili në kryerjen e autorizimeve publike të besuara sipas këtij ligji, vendos për veprimet nga kompetenca e tij në zbatimin e përmbartimit të lejuar dhe ndërmerr veprime për përmbartim.²⁹ Si urdhri për përmbartim po ashtu edhe aktvendimi duhet të kenë përmbajtje të njëjtë.

9. Lëndët e papërfunduara në gjykata

Nëse në tërësi, në Gjykatat në Kosovë presin rreth 200,000 lëndë për tu zgjidhur të të gjitha natyrave, atëherë gjysma prej tyre janë në procedurën përmbartimore. Nga kjo rrjedhë se gjykatat në Kosovë ende nuk janë efikase, sepse është shqetësuese që vetëm për 3 muaj rritet numri i lëndëve të pazgjidhura mbi 500 lëndë.

Gjykata Themelore në Prishtinë në tremujorin e tretë të vitit 2012 ka pranuar 457 lëndë në bazë të dokumentit përmbartimor, në fillim të kësaj periudhe raportuese kishte 24861 lëndë të pazgjidhura ndërsa në fund të periudhës raportuese kishte 24895 lëndë të pazgjidhura, ndërsa lëndë në bazë të dokumentit të besueshëm, në fillim të kësaj periudhe raportuese kishte 6915 lëndë të pazgjidhura ndërsa në fund të periudhës raportuese kishte 6988 lëndë të pazgjidhura, kurse kishte pranuar 661 lëndë. Nga këto të dhëna rezulton se numri i lëndëve të pazgjidhura është në rritje. Kjo gjykatë për këtë periudhe kohore ka kryer 554 lëndë të të gjitha natyrave.³⁰

Ndërsa nëse e shikojmë raportin e ish Gjykatës Ekonomike atëherë të dhënat janë shumë shqetësuese sepse gjatë tremujorit të tretë 2012 kjo gjykate ka pranuar 211 lëndë ndërsa ka zgjidhur 88 dhe kane mbetur 2603 lëndë pa zgjidhur.³¹

10. Sfidat në zgjidhjen e lëndëve të mbetura

Rritja e numrit të lëndëve të grumbulluara në baze të dokumenteve përmbartimore dhe autentike mori hov nga mesi i viteve të dekadës së fundit.³² Por pavarësisht rritjes së numrit të lëndëve të grumbulluara në ato vite, si dhe akumulimi i vazhdueshëm gjatë këtyre viteve, sot është e qartë se ekzistojnë disa faktor që

²⁹ Shih nenin 2 par.1 nenp.1.10 dhe nenp.1.11 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

³⁰ Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, statistika e gjykatave të rregullta tremujori -III- 2012, fq. 34.

³¹ Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, statistika e gjykatave të rregullta tremujori -III- 2012, fq. 8.

³² Programi sistemi i përmbartimit të marrëveshjeve dhe vendimeve në Kosovë (SEAD), 30 prill 2010 fq. 14.

vështirësojnë përfundimin e lëndëve të mbetura dhe zgjidhjen e rasteve të reja.

Në vijim janë paraqitur pengesat që kontribuan në ekzistimin e lëndëve të grumbulluara të parashtruara në bazë të dokumenteve përmbare dhe autentike në Kosovë.

11. Resurset e pamjaftueshme

Tani është shumë e qartë se ka resurse të pa mjaftueshme në zyrat e përmbaremit në Gjykatat Themelore në Kosove për të bërë shqyrtimin e rasteve të grumbulluara në baze të këtyre dokumenteve. Bazuar në legjislacionin në fuqi ka shumë raste të tjera në zyrat e përmbaremit që janë caktuar si prioritete më të rëndësishme sesa rastet civile të përmbaremit, të cilat konsumojnë një përqindje të madhe të kohës në dispozicion të zyrtarëve të përmbaremit.³³

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës që është gjykata me numrin më të madhe të lëndëve në Kosovë punojnë dy gjyqtar përmbare dhe shtate zyrtar përmbare. Në zyrën e përmbaremit në vit arrijnë përafërsisht 10.000 lëndë të reja, ndërsa as gjysma e tyre nuk mund të përmbarehen gjate vitit.

Si në këtë gjykatë po ashtu edhe në gjykatat tjera nga numri i lëndëve të reja, një numër i tyre janë lëndë me prioritet dhe se duhet të procedohen menjëherë siç janë lëndët lidhur me dorëzimin e fëmijëve, kthimin e punëtorit në pune, alimentacion, pengim posedimi dhe në këtë mënyrë shumë lëndë të vjetra për shkak numrit të vogël të përmbareuesve nuk mund të procedohen e numri i tyre vetëm rritet.

Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale ka paraparë që për ekzekutimin e dënimit me gjobë të zbatohen dispozitat e ligjit të procedurës përmbare.³⁴ Dënimi me gjobë është prioritet dhe se për shkak të afatit të parashkrimit gjykata duhet urgjentisht të merret me këto lende. Koha e punës së zyrtarëve të përmbaremit konsumohet plotësisht nga këto raste me prioritet dhe ata thjeshte nuk kanë kohë që të merren me përmbaremit në çështje civile. Në këtë mënyrë lëndët e reja civile i shtohen grumbullit të lëndëve tjera, duke përfshirë të gjitha lëndët e reja nga dokumentet autentike.³⁵

³³ Programi sistemi i përmbaremit të marrëveshjeve dhe vendimeve në Kosovë (SEAD), 30 prill 2010 fq 14.

³⁴ Në nenin 143 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale parashihet „ dispozitat e ligjit të procedurës përmbare në fuqi zbatohen për kompetencën dhe procedurën e ekzekutimit të dënimit me gjobë, përveç nëse me këtë ligj parashihet ndryshe.

³⁵ Programi sistemi i përmbaremit të marrëveshjeve dhe vendimeve në Kosove (SEAD), 30 prill 2010 fq. 15.

12. Problemet lidhur me sigurimin e adresave të debitorëve

Njëra ndër arsyet për grumbullimin e lëndëve është edhe sigurimi i adresave të sakta për debitorët. Zyrtaret e përmbarimit gjatë procedimit lidhur me këto lëndë, për të dërguar njoftimet për përmbarim hasin ne adresa të pa sakta. Për shkak të numrit të madhë të rasteve që paraqiten, ata procedojnë për njoftime lidhur me rastet që janë paraqitur për afërsisht para tri viteve, prandaj nuk është e çuditshme nëse adresat kanë ndryshuar dhe natyrisht gjatë kësaj dekade ka pasur lëvizje të mëdha të popullsisë në drejtim të zonave urbane dhe se palët në procedurë nuk banojnë aty ku kane banuar në kohën kur janë paditur.³⁶

Gjykata e as kreditori nuk kanë ndonjë metodë të lehte për ti gjetur ata. Regjistri i gjendjes civile, të cilin gjykata mund të kontaktoj është i vetmi burim i informatave në dispozicion për verifikimin e adresave të debitorëve. Në fakt ky nuk përmban informacionet për adresat aktuale të individëve, edhe pse kërkesat për këto të dhëna shpesh i dërgohen Regjistrisë Civile, ku zyrtaret vendor përgjegjës për mbajtjen e regjistrisë ka raste kur edhe nuk i pranojnë kërkesat e gjykatës për dhënien e informacioneve, ose i pranojnë por nuk kthejnë kurrë përgjigjeje.³⁷

Mund të konstatojmë se Regjistria Civile në Kosovë nuk ofron asnjë ndihmë lidhur me këtë problem. Regjistria Civile është më sa duket duke bërë projekte për të rregulluar këtë çështje dhe thuhet se ndoshta do të jenë në gjendje që të japin informacione rreth adresave në këtë vit. Në disa raste si justifikim i shpesh të mungesë të suksesit të zyrtarëve të përmbarimit në përmbarimin e rasteve nga dokumentet autentike është se debitorët kanë lëvizur dhe nuk mund të gjenden.

13. Mungesa e sendeve që ligji lejon të sekuestrohen

Arsye tjetër që lëndët e grumbulluara për përmbarim nuk janë përmbaruar me sukses është mungesa e sendeve të debitorët që do të ishin objekt përmbarimi ashtu si e kërkon ligji. Në shumicën e rasteve ku është lejuar përmbarimi në bazë të dokumenteve të besueshme-faturave nuk ka asgjë për të sekuestruar sepse te debitori nuk gjenden sende, nëse përdorim shprehjen e SHBA-ve, debitori është rezistent ndaj aktvendimit.³⁸

Ky problem është evident në një vend si Kosova që ka shkallë të lartë të papunësisë dhe varfërisë. Dispozitat e Ligjit aktual mbi Procedurën e

³⁶ Programi sistemi i përmbarimit të marrëveshjeve dhe vendimeve në Kosovë (SEAD), 30 prill 2010, fq.17.

³⁷ Programi sistemi i përmbarimit të marrëveshjeve dhe vendimeve në Kosovë (SEAD), 30 prill 2010 fq 17.

³⁸ Programi sistemi i përmbarimit të marrëveshjeve dhe vendimeve në Kosovë (SEAD), 30 prill 2010 fq 17.

Përmbartimit, nuk ndryshojnë shumë nga ligjet e mëhershme të vitit 1978 dhe 2008, ku i kanë dhënë një mbrojtje të tepruar debitorit duke parashikuar shumë sende që nuk mund të jenë lëndë të përmbartimit që në fakt vetëm e kanë vështirësuar përmbartimin.³⁹

Mjetet e lëvizshme si automobilat, lehtë mund të transferohen për të shmangur sekuestrimin dhe Kosova nuk ka mjete efektive për të lehtësuar zbulimin dhe sekuestrimin e tyre.⁴⁰

14. Përfundim

Reforma e sistemit të përmbartimit të vendimeve të gjykatës dhe të dokumenteve të tjera të detyrueshme është me e rëndësishmja, në kuadër të reformës së drejtësisë. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut thekson “ të drejtat e njohura për një proces gjyqësor janë iluzione nëse sistemi juridik i vendit lejon që vendimi detyrues gjyqësor i formës së prerë të mbetet jofunksional në dëm të palës.

Kosova si dhe shtetet tjera në rajon synojnë që të bëhen anëtare të Bashkimit Evropian. Disa kanë bërë hapa të rëndësishëm në reformimin e sistemeve ligjore dhe gjyqësore si rrjedhojë e procesit të anëtarësimit në BE.

Në bazë të raporteve të progresit nga ana e Komisionit Evropian konstatohet se sistemet përmbartimore gjyqësore në Kosove nuk përmbushin më kërkesat e së sotmes. Gjykatat kanë numër të madhe të lëndëve të shumta të mbetura kryesisht lëndë të përmbartimit. Mundësia e tepërt e përdorimit të mjeteve juridike në procedurën e përmbartimit shkakton procedura të gjata dhe të panevojshme nëpër gjykata.

Në disa shtete mund të identifikohen disa shkaqe që kanë sjellë vonesa si ato që lidhen me kornizën legjislative ku ligjet kanë pasur shkallë të lartë të mbrojtjes së debitorit në lëndët e përmbartimit.

Privatizimi është bërë tepër i suksesshëm në disa vende përkundër alternativave të shumta në sektorin publik. Ne rast se respektohen parimet e definimit dhe përforcimit të një kornizë të qartë ligjore, që përcakton kompetencat, të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve, palëve t’iu mundësohet që të kuptojnë në

³⁹ Shih nenin 85 të Ligji për Procedurën Përmbartimore i vitit 2012.

⁴⁰ Programi sistemi i përmbartimit të marrëveshjeve dhe vendimeve në Kosove (SEAD), 30 prill 2010 fq 18.

mënyrë më efektive rolet e tyre dhe t'u përmbahen përgjegjësive të tyre që të bashkëpunojnë si duhet në procesin përbarimor atëherë do të ndalohej keqpërdorimi dhe abuzimi i procedurave përbarimore nga palët, kjo është paraparë me Rekomandimet e Këshillit të Evropës për përbarimin 17/2003.

Kur Kosova të bëjë përmirësime, atëherë do të jetë e qartë që është e preferuar që të ecet në hapin tjetër, dhe të përvetësohet një sistem privat i përbarimit si pjesë e këtij procesi të plotë reformues.

Ndryshimet organizative në Kosovë të planifikuara mirë, prezantimi i mekanizmave të rinj, efikas të përbarimit dhe zhvillimi gradual i infrastrukturës dhe ndërgjeshmërisë së nevojshme do të prodhojnë përmirësime në sistemin e përbarimit.

Po ashtu rekomandohet që Banka Qendrore e Kosovës duhet të themelojë një Departament të veçantë për përbarimin e vendimeve gjyqësore, duke përfshirë një bazë të dhënash të llogarive bankare, në të cilën llogaritë identifikohen dhe janë të kërkueshme nga numrat personal të identifikimit, ose për personat juridikë në bazë të numrit të regjistrimit të biznesit.

Legjislacioni ynë duhet të përkufizojë qartë titujt ekzekutiv si dhe mënyrën e dërgimit të dokumenteve.

Është paraparë që përbaruesit privat duhet të posedoi standardet morale dhe njohurit ligjore në të drejtën dhe procedurë.

Legjislacioni në përgjithësi duhet të ofroi sigurinë dhe transparencën ligjore të procesit duke vendosur balancimin e interesave të kreditorit, debitorit dhe palëve të treta.

Rekomandohet që gjykatat të krijojnë një mekanizëm për të kërkuar informacion drejtpërdrejt prej administratës tatimore, Fondit për Pensione dhe agjencive tjera (duke përfshirë qendrën për regjistrimin e bizneseve, kadastrën dhe departamentin për regjistrimin e automjeteve dhe patentë-shoferëve) që kanë informacione të dobishme për procedimin e rasteve.

Gjate procesit të përbarimit duhet të respektohet edhe parimi mbrojtjes së debitorit dhe përbarimi duhet të arrihet vetëm kur debitori i ka mjetet apo mundësinë për të përmbushur detyrimin.

BIBLIOGRAFIA

I. Literatura

Brestovci, Faik - E drejta procedurale civile I, Prishtine, 2006
Brestovci, Faik - E drejta procedurale civile II, 1997, Prishtine
Uitdehaag, Jos-Standardet ndërkombëtare të përmbartimit civil
Autheman Violaine, Shah Angana, Henderson Keith, Ekzekutimi i vendimeve civile ne Kosove, 2003.

II. Akte juridike dhe burime tjera

Doracaku për Zbatimin në Praktike të Procedurës Përmbartimore, nëntor 2007
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave te Njeriut
Kushtetuta e Republikës së Kosovës
Ligji mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore Ligji për Bankën Qendrore të Kosovës nr.03/L-209
Ligji i Procedurës Përmbartimore te Republikës se Kosovës nr.04/L-139, 20.12
2012 Ligji për Procedurën Kontestimore
Ligji për Procedurën Jokontestimore
Programi Sistemi i Përmbartimit te Marrëveshjeve dhe vendimeve ne Kosove (SEAD) 30 prill 2010
Rekomandimi i Këshillit te Evropës rec(2003)17 nga Këshilli i Ministrave Shteteve anëtare për përmbartimin, 09.09.2003

Mr. sc. Ramadan Gashi¹

TË QENIT I BARABARTË PARA LIGJIT DHE GARANCITË QË OFRON GJYQËSORI

ABSTRAKT

Barazia e individëve para ligjit dhe garancia e realizimit të të drejtave dhe të lirive të garantuara me akte të brendshme juridike të shtetit si dhe me standarde ndërkombëtare, përbën vlerën më të lartë demokratike të një vendi. Trajtimi i barabartë dhe procedimet e barabarta, jo vetëm që janë të ndryshme në vetvete, por pasqyrojnë metoda që shprehin divergjenca të thella të cilat janë të ndërlidhura thellësisht me zbatimin e ligjit në praktikë nga institucionet përkatëse. Në këtë drejtim, domosdoshmëria e mirëfunksionimit të institucioneve, veçanërisht gjyqësorit, përbën shtyllën kryesore të shtetit ligjor, që funksionon në formë dhe mënyrë të atillë duke pasur për objekt mbrojtjen e barabartë të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe përcaktimin e përgjegjësisë të të gjithëve dhe të secilit. Në kuadër të këtij punimi, do të bëjë përpjekje që sadopak t'i lëvroj çështjet më të ndjeshme të sistemit gjyqësor, duke analizuar çështjet më problematike me qëllim që t'i jap karakteristikat fenomenologjike të problemit.

Fjalja çelës: Barazia para ligjit, trajtimi i barabartë, gjyqësori.

Hyrje

Ky punim do të shqyrtojë në mënyrë përmbajtësore çështjen e respektimit të sundimit të ligjit dhe trajtimit të barabartë të qytetarëve para ligjit nga institucionet shtetërore. Fillimisht, do ta analizoj çështjen e sundimit të ligjit dhe së drejtës, si dhe sigurinë juridike si element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës. Është në interes të shoqërisë që shteti i së drejtës dhe sundimi i ligjit të garantohet duke i zbatuar ligjet në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme për të gjithë në barabarësi të plotë, varësisht se në cilën situatë faktike ndodhet individi.

Drejtësia kërkon që çdo person të ketë të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe objektiv nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, që do të ushtrojë funksionin e vet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe në bazë të provave. Nuk mund të krijohen gjykata që nuk zbatojnë procedurat

¹ Autori i këtij shkrimi, Mr. sc. Ramadan Gashi është trajnues i përhershëm në IGJK (në tekst e ka me fusnotën 1 por duhet unifikuar njëjtë si të tjerat)

e vendosura rregullisht në bazë të ligjit dhe që kanë për qëllim t'ua heqin kompetencën gjykatave të zakonshme. Gjyqtarët kanë për obligim që të sigurohen në vazhdimësi, se drejtësia është ajo që do të shërbehet më në fund duke i marrë në konsideratë të gjitha elementet komplekse të të gjitha çështjeve për të cilat do të vendosë gjykata. Po të veprojnë ndryshe, do ta rrezikojnë kualitetin e drejtësisë që është aq prioritet për shoqërinë dhe shtetin, sa që do ta bënte lirinë dhe sigurinë e qytetarëve më të pasigurt dhe shtetin ligjor më pak funksional.

1. Çështja e sundimit të ligjit dhe së drejtës si dhe siguria juridike si element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës

Çështja e sundimit të ligjit i ka rrënjët e saj qysh në Anglinë mesjetare. Që në vitin 1066, Uilliam Pushtuesi (William the Conqueror) kishte vendosur një pushtet qendror. Edhe pse mbreti e vuri në jetë pushtetin qendror qeveritar, legjislativ dhe gjyqësor, ai vetvetiu nuk qëndroi mbi ligjin— ishte ligji ai që e bëri atë mbret. Nga kuptimi i tillë, gjykatat e së drejtës zakonore dhe parlamenti së bashku me feudalët, forcuan ndikimin e tyre në sistemin vendor, duke ndërtuar kështu monarkinë e parë parlamentare në Evropë. Bazat e zhvillimit të sundimit të ligjit ishin, Magna Charta Libertatum (1215), e cila u ofronte feudalëve disa të drejta dhe Habeas Corpus Act (1679), i cili u jepte njerëzve në arrest të drejtën e pamohueshme për t'u njoftuar për arsyet e kufizimit të lirisë së tyre. Në kontinentin e Evropës, parimi i sundimit të ligjit fitoi rëndësinë e tij gjatë shekullit XVII dhe XVIII. Siguria juridike nënkupton mos cenim i të drejtave të fituara dhe i pritshmërisë të ligjshme që garantojnë aktet juridike në fuqi brenda një shteti duke përfshirë kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare. Si standard formal kryesorë konsiderohet saktësia, qartësia, dhe qëndrueshmëria në tërësi e të gjithë rendit juridik të një shteti të caktuar. Jo vetëm normat e veçanta, por i gjithë rendi juridik kërkohet të jetë i kuptueshëm, i parashikueshëm, i lehtë i zbatueshëm dhe jo kontradiktor.

Në këtë mënyrë, vlerësohet se krijohet edhe besimi i qytetarëve në qëndrueshmërinë e këtij rendi si dhe bindja e tyre në nevojën e respektimit dhe zbatimit të tij në jetën e përditshme. Në të njëjtën kohë, mbi këtë bazë, “qytetarët përcaktojnë edhe hapësirën e lirisë apo mënyrën e sjelljes së tyre në shtet dhe shoqëri”.² Standardet që kërkohet të respektohen nga të gjithë mekanizmat dhe institucionet shtetërore, veçanërisht nga organet qendrore të

² Bross S., Reflectionson the importance and the positionof a Constitutional Court in a modern democratic state under the rule oflaw—Takingin to account the position of the Federal Constitutional Court of the Federal Republic of Germany, Centeron Constitutional Justice, Council of Europe.

tre degëve kryesore të pushtetit shtetëror. Siguria juridike ngërthen në veti, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara dhe zbatimi i tyre në mënyrë të barabartë për të gjithë pa përjashtim pa marrë parasysh dallimet. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Në këndvështrim të interesave të individit si dhe besimit të tij në rendin juridik, konsiderohet me rëndësi të veçantë edhe urdhërimi për ndalimin e fuqisë prapavepruese të normave juridike. Padyshim që në këtë rast bëhet fjalë për normat juridike që parashikojnë dënime, vendosin detyrime apo rregulla të reja sjelljeje për individin. Normat me karakter lehtësues apo favorizues për individin, sigurisht që në përputhje me parimin e sigurisë juridike, rast pas rasti mund të shtrijnë efektin e tyre edhe për një periudhë të mëparshme.

Si elemente i sigurisë juridike mund të konsiderohen edhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, arsyetimi i vendimeve gjyqësore, e të tjerë. Megjithatë, edhe në rast të kundërt, vetëkuptohet se në kuptim të përgjithshëm ai gjen hapësirën e duhur për t'u njohur e respektuar në praktikë edhe në kuadër të parimit të shtetit të së drejtës. I Standarde të veçanta të tij gjejnë pasqyrim në mjaft dispozita të tjera të Kushtetutës si dhe në Kodet apo legjisllacionin e miratuar në bazë dhe për zbatim të saj. Kështu për shembull, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës theksohet se “Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit”.³

Për të konsideruar se me të vërtetë kemi siguri juridike, ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme dhe lehtësisht të zbatueshme në praktikë. Sigurisht që ato nuk mund të parashikojnë çdo rast që mund dhe duhet të lindë nga njohja dhe zbatimi i tyre në praktikë. Prandaj, në radhë të parë është detyrë e gjykatave që mangësi të caktuara të një ligji t'i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit të tij në praktikë që do të jenë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare (instrumentet ndërkombëtare). Por që të realizohet një gjë e tillë, para së gjithash ligji duhet kuptuar saktë dhe drejtë. Si në fushat e tjera të së drejtës, edhe në të drejtën penale, parim i përgjithshëm është ai i ndalimit

³Neni 33 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 2008

të fuqisë prapavepruese të ligjit. Një gjë e tillë diktohet, para se gjithash, për shkak të domosdoshmërisë së garantimit të stabilitetit dhe të sigurisë së marrëdhënieve juridike që vendosen ndërmjet subjekteve të ndryshme të së drejtës.

Në rastin e ligjit penal, i cili si rregull kufizon lirinë individuale, është shumë e nevojshme që çdo qytetar të dijë paraprakisht kufijtë e lirisë së tij si dhe sanksionet që mund t'i vijnë për shkak të kapërcimit të këtyre kufijve. Ai nuk duhet të ndjejë për asnjë çast rrezikun që një ligj i ri penal që mund të parashikojë si të dënueshëm një veprim apo mosveprim të caktuar ose që mund të rëndojë pozitën e tij si i pandehur, do të ketë në të ardhmen fuqi prapavepruese. Përfundimi që bëhet nga rregulli i përgjithshëm, duke i dhënë fuqi prapavepruese vetëm ligjit penal që favorizon pozitën e të pandehurit, synon t'i përgjigjet në mënyrë sa më të shpejtë, por duhet pasur parasysh se ligji më i butë duhet të zbatohet nga gjykatat si për sa i përket përcaktimit të veprës penale, ashtu edhe sanksioneve të parashikuara prej saj.

Mbi bazën e argumenteve të mësipërme mund të konstatohet se fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues duhet respektuar menjëherë nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Siguria juridike presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme.

Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që të sigurojnë vijimësinë e tyre. Si rregull nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive. Vlerësimi dhe arsyetimi nga ana e gjykatave lidhur me vendimin gjyqësor të paraqitur si provë nga ana e kërkuesit ka rëndësi edhe në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Siguria juridike nënkupton ndërmjet të tjerave, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin në bazë të kompetencave që kanë.

Sot, parimi i sundimit të ligjit është parim bazë i institucioneve vendore, regjionale dhe ndërkombëtare në gjithë botën. Sundimi i ligjit është mënjanimi i arbitraritetit të pushtetit i cilit do qoftë (legjislativ, ekzekutiv apo gjyqësor). Me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike për të gjithë njerëzit pa marrë parasysh dallimet që mund t'i kenë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. Siguria e sundimit të ligjit nuk mbështetet vetëm në një hartim të saktë të ligjeve, apo vetëm në faktin se ligjet ekzistojnë me shkrim por, në sigurinë se sa do të jenë të zbatueshme në praktik dhe sa do ta kenë jetëgjatësinë. Në kuadër të kësaj, “një rend ligjor është ligjor pikërisht sepse lejon që njerëzit t’iu drejtohen normave ligjore për të planifikuar rrugët e jetës dhe për të gjetur një paralajmërim se ku ndodhen dritat jeshile dhe të kuqe”.⁴

Ligji është “akt me të cilin shteti formulon një normë të së drejtës objektive”.⁵ Andaj, sundimi i ligjit, në radhë të parë do të thotë ekzistimi i ligjeve të njohura për qytetarët. Për nga përmbajtja këto janë ligje jo diskriminuese dhe në përputhje me aktin më të lartë politiko-juridik (kushtetutën).

Ligjet e qëndrueshme i përkasin kushtetutës dhe kanë bazë në të dhe janë lehtë të zbatueshme në praktik nga ana e institucioneve përkatëse. Jemi të vetëdijshëm se jeta e jonë rregullohet tani ligjërisht. Ligji tani arrin në jetën e secilit, duke prekur çështjet e natyrave të ndryshme, vetëm e vetëm që qytetari të përfitojë garanci ligjore dhe të realizojë të drejtat e garantuara.

Ligji është pikërisht ajo forcë që bënë të mundur lirinë dhe progresin në demokracinë bashkëkohore. Është pikërisht ligji që ua jep njerëzve sigurinë juridike. Ligji, në të vërtetë, “rregullon një marrëdhënie shoqërore të caktuar”.⁶ Nisur nga kjo, ligjet nuk janë njësoj në të gjitha shoqëritë edhe pse rregullojnë raporte të njëjta shoqërore, ngase kushtet e jetës janë të ndryshme dhe raportet shoqërore diku janë më të zhvilluara, diku më pak të zhvilluara. Ligjet pozitive që i ka vendosur shoqëria duhet respektuar. Këto kanë për qëllim që të sigurojnë mirëqenien e qytetarit dhe t'i begatojnë vlerat sublime të njeriut që do të vlejnjë për të gjithë njësoj.

⁴ Giovanni Sartori, Edhe një herë për teorinë e demokracisë, Tiranë, 1993, fq.341

⁵ Luan Omari, Parime dhe institucione të së drejtës publike, Tiranë, 1999, fq. 283

⁶ Akademik Esat Stavileci, Hyrja në shkencat administrative, Prishtinë, 1997, fq.50

Dhe, me të drejtë Ciceroni thoshte se “qëllimi i ligjeve është që t’i sigurojnë shtetasit, integritetin e shtetit dhe jetën e shtetasve ta bëjnë të lumtur dhe paqësor”. Vetëm ekzistimi i thjeshtë i tyre nuk do të thotë asgjë, nëse ato ligje nuk zbatohen në mënyrë të përpiktë dhe të barabartë për të gjithë njerëzit duke respektuar procedurat e përcaktuara ligjore. Nuk do të ketë sundim të ligjit atje ku dikush vihet mbi ligjin, të gjithë duhet t’i binden ligjeve dhe akteve tjera juridike, askush nuk ka të drejtë që të bishtnojë ato, e aq më pak të veprojë në emër të tyre për qëllime tjera.

Historia na ofron mjaft shembuj kur ligjet kanë qenë vetëm dekor juridik. Është e vërtetë se, “ka pak ligje jodemokratike, por ka mjaft praktikë jodemokratike”.⁷ Prandaj, një vend (shtet) duhet të krijojë institucione që e mbikëqyrin sistemin ligjor, duke përfshirë gjykatat, prokurori, polici dhe institucione tjera relevante, të cilat, si pikësynim kanë funksionimin sa më të përpiktë dhe konsekuent të tij. Sundimi i ligjit është esencial për mbajtjen e sigurisë së rregullit shoqëror dhe të lirive qytetare dhe të drejtave të njeriut. Respektimi i sundimit të ligjit nuk obligon vetëm individët e një shteti por i obligon edhe organet shtetërore dhe personat që ushtrojnë funksione publike pranë këtyre organeve. Edhe pse sundimi i ligjit është gur themel i shoqërisë demokratike, nuk ekziston një konsensus i plotë mbi atë se, cilat janë të gjitha elementet e tij përbërëse.

Sidoqoftë, mese kontrovers duket fakti se, njerëzit mbrohen nga veprimet arbitrare të autoriteteve publike, vetëm atëherë kur të drejtat e tyre janë të parapara me ligj. Është e evidente, se ushtrimi i pushtetit shtetëror duhet të bazohet në ligje të cilat janë nxjerr në pajtim me kushtetutën dhe që kanë për objektiv sigurimin e lirisë, drejtësisë dhe sigurisë juridike të qytetarëve.

Qytetarët duhet të jenë në gjendje të kenë të dhëna që janë të përshtatshme për rrethanat, për normat juridike të zbatueshme në një çështje të dhënë. Këto norma juridike nuk mund të konsiderohen si ligje nëse vetëm janë bërë të plotfuqishme, por është shumë e rëndësishme që këto ligje të zbatohen dhe interpretohen në mënyrë strikte për të gjithë. Ligji duhet të tregojë dhënien e çdo kompetence të tillë autoriteteve përkatëse si dhe mënyrën e ushtrimit të saj me qartësi të mjaftueshme, me qëllim që qytetarëve t’u sigurohen garancitë e duhura ligjore. “qytetarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe legjislacioni duhet të ketë kufizime kushtetuese”.⁸ Shteti ligjor është i sigurt, vetëm në qoftë se i ka rrënjët te normat shoqërore. Vendimet juridike veprojnë plotësisht dhe për një kohë të gjatë, vetëm në qoftë se mbështeten mbi traditën

⁷ Ismet Salihu, E drejta penale (pjesa e përgjithshme), Prishtinë, 2008, fq.139.

⁸ Raino Malnes /Knut Midgaard, Filozofia Politike, Oslo, 2003, fq. 273.

politike. Njerëzit i arrijnë qëllimet e tyre, në atë shkallë që, “vendimet dhe veprimet drejtohen nga rregulla që kanë dalë nga një proces revolucionar, prandaj mbështeten mbi përvojën e brezave”.⁹ Ligjet nuk janë dhe nuk mund të jenë të hartuara për të pasur parasysh personin, pra nuk kanë dhe s’mund të kenë parasysh dallimet midis njerëzve.

Andaj, sa më të përsosura të jenë ligjet aq më e sigurt do të jetë mirëqenia dhe lumturia e njeriut. Ligjet duhet të jenë të thjeshta, të qarta dhe të arritshme. Këto hartohen në përputhje me kushtet dhe gjendjen aktuale të shoqërisë, mirëpo, në momentin kur ndryshohen këto raporte, atëherë këto ligje do të shkaktojnë pasoja të dëmshme juridike. Shteti ka për detyrë që të krijojë mekanizma të nevojshëm për të mbrojtur individin ndaj sjelljes arbitrare të autoriteteve të cilat ushtrojnë funksionet e besuara shtetërore, dhe t’i ndëshkojë të gjithë ata që janë përfshirë në shpërdorimin e mundshëm të pushtetit. *Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe e gëzojnë njësojë të drejtën për të qenë të mbrojtur prej tij.*

Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut në Vjenë, e vitit 1993, riafirmoi lidhjen e pandashme mes parimit të sundimit të ligjit, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Gjatë konferencës u pranua se mungesa e sundimit të ligjit është një nga pengesat më të mëdha për implementimin e të drejtave të njeriut. Sundimi i ligjit siguron bazën për menaxhim të drejtë mes popujve dhe, në këtë mënyrë përkrah diversitetin, hap shtigjet e një afirmimi të përgjithshëm dhe të sigurisë juridike të qytetarëve.

Siç ka deklaruar Roger Warren, kryetar i pensionuar i Qendrës Kombëtare për Gjykatat Shtetërore “sundimi i ligjit është një shpatë me dy tehe” sepse jo vetëm që siguron mbrojtjen e të drejtave, por, po ashtu edhe zbaton përgjegjësitë. Sundimi i ligjit i mban zyrtarët nën përgjegjësi ndaj qytetarëve për të parandaluar keqpërdorimin apo neglizhencën gjatë ushtrimit të funksioneve të besuara publike.

Këta kanë për detyrë morale, etike dhe ligjore që të mbështetin dhe t’i përparojnë parimet e sundimit të ligjit dhe të shtetit ligjor në sferën e veprimit ose të ndikimit të tyre cilado qoftë ajo. Këta duhet ta përmbushin këtë detyrim dhe kompetencë çdo herë dhe në çdo çështje që duhet të vendoset prej tyre qoftë individualisht apo në grup. Përgjegjësia e tyre si qytetar dhe si zyrtar, që ushtrojnë njëren nga tri funksionet e pushtetit është, që detyrat t’i ushtojnë në të mirën e shoqërisë dhe të prosperitetit ligjor. Tek këta duhet të ekzistojë sensi

⁹ Friedrich A. Von Hayek, *Law, Legislation and Liberty*, London: Routledge –KeganPaul, 1982, fq.18.

i patundur i ndërgjegjësimit ndaj punës dhe gatishmëria që të veprojnë ndaj të gjithë personave për t'i mbrojtur interesat e tyre civile, private dhe publike. S'do mend se këta duhet të luajnë rol aktiv në përpunimin dhe realizimin e një sistemi efikas dhe koherent të sundimit të ligjit.

Sundimi i ligjit është një koncept dinamik i ndërlidhur ngushtë me shumë faktor, qofshin ata shoqërorë, ekonomikë, juridikë dhe politikë. Me të bëhet kufizimi juridik i arbitraritetit të pushtetit përmes garancive ligjore, sigurisë dhe të lirisë së njeriut. Sipas këtij parimi, organet shtetërore i nënshtrohen ligjit, dhe me të drejtë mund të konstatojmë se ligji është ai i cili qëndron mbi të gjithë dhe për të gjithë. Zbatimi konsistent, i paanshëm dhe i patundur i shtetit të së drejtës synon që të mbrojë njerëzit nga shkelja e të drejtave të njeriut, në masën që ato njihen dhe respektohen nga shteti i së drejtës që zbatohet në vend të veçantë. Çdo shoqëri demokratike që synon nxitjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si parim fundamental, duhet ta njohë supremacinë e ligjit ndaj qytetarëve dhe ndaj vet shtetit që qëllim fundamental ka garantimin dhe pacenueshmërinë e lirive dhe të drejtave të njeriut, dhe të shtetasit në njërën anë, dhe në anën tjetër, kufizimin juridik të arbitraritetit të pushtetit nëpërmjet garancive ligjore.

Mbizotërimi i së drejtës nuk është vetëm një mjet, me ndihmën e të cilit shteti mund të përdor ose keqpërdor fuqinë e vet. Me të synohet që, “të përcaktohen parimet, të cilat kufizojnë mundësinë e shtetit dhe obligojnë që të veprojnë në pajtim me një seri rregullash të parashikuara dhe përgjithësisht të njohura”.¹⁰ Siguria juridike mund të ekzistojë vetëm atje, ku qytetarët janë plotësisht në dijeni se çka guxon të bëjë shteti dhe çfarë kërkohet prej tij, çfarë i ndalohet të bëjë dhe si duhet të veprojnë për respektimin rigoroz të ligjit apo normave të tjera juridike, me një fjalë për çka janë vet përgjegjës.

Sundimi i ligjit është mbisundimi dhe mbizotërimi i shtetit dhe së drejtës në respektimin e vlerave, të cilat kanë të bëjnë me demokracinë dhe legalitetin, si dhe në funksionalitetin e mekanizmave shtetërorë në të gjitha poret e jetës. Ky është kusht i domosdoshëm për ekzistimin e një shoqërie të lirë dhe bazë e fortë për ekzistimin e shtetit ligjor dhe shtyllë e procesit demokratik. Këtu bën pjesë parimi themelor i shtetit juridik, sipas së cilit askush nuk guxon të trajtohet apo të jetë i trajtuar pa bazë ligjore. Me këtë, përgjithësisht nënkuptohet respektimi rigoroz nga ana e pushtetit të një sërë kërkesave me karakter juridik, të cilat në tërësinë e tyre i krijojnë qytetarit siguri juridike. Qytetarët kanë të drejtë që, për realizimin e të drejtave të veta, të kërkojnë mbrojtjen gjyqësore dhe t'i

¹⁰ Neil J. Kritz, *The Rule of Law in the Postconflict Phase: Building a Stable Peace*, in *Manging Global Chaos Sources of and Responses to International Conflict*, 1996, fq. 587-588.

përdorin mjetet juridike kundër vendimeve, kur vlerësojnë se u janë mohuar apo kufizuar të drejtat, apo janë dëmtuar interesat e tyre. Sundimi i ligjit siguron përgjegjësinë dhe kontrollin ligjor ndaj ushtruesve të funksioneve publike, e po ashtu prek fusha të ndryshme të politikave duke përfshirë çështje politike, kushtetuese, ligjore, si dhe çështje të të drejtave të njeriut, sepse mirëqenia dhe lumturia e njeriut varet nga ligjet e përsosura dhe nga zbatimi i patundur dhe i drejtë i tyre.

Siguria juridike dhe pavarësia e gjykatave përbëjnë elementet bazë, të cilat kanë ndikim të fuqishëm në funksionimin e shtetit juridik. Ai bazohet në parimin e përgjithshëm, sipas të cilit i gjithë aktiviteti shtetëror është i matshëm, i për llogaritshëm dhe i përgjegjshëm për dështimet që mund të ndodhin qoftë me qëllim apo edhe pa qëllim. Nga pikëpamja institucionale, përveç organeve të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, edhe pushteti gjyqësor ka vend dhe rol të veçantë në garantimin e sigurisë juridike të qytetarëve. Respektimi i procedurave dhe afateve ligjore, dhënia e vendimeve të plota e të bazuara në ligj, zbatimi me kohë dhe me korrektësi i vendimeve të dhëna nga gjykatat etj, ndikojnë fuqishëm në krijimin e sigurisë juridike të qytetarëve në shtet dhe shoqëri.

Në bazë të kësaj, shteti duhet t'i sigurojë pushtetit gjyqësor zbatimin e përpiktë të vendimeve gjyqësore, por në anën tjetër, është detyrë e organeve gjyqësore të ndjekin zbatimin dhe zhvillimin e rregullt të procedurave. Megjithëse, nga një vend në tjetrin, ka ndryshime, mundësia për t'iu drejtuar drejtësisë, e barabartë për të gjithë pa dallim, është thelbësore për respektimin e parimit të sundimit të ligjit që fokusohet jo vetëm në atë se çfarë bëhet, por se si bëhet.

Për rrjedhojë, gjatë ushtrimit të pushtetit gjyqësor nga gjykatat, është e domosdoshme që t'u jepet një ndihmë juridike e përshtatshme të gjithë atyre që, duke pasur në rrezik jetën, lirinë, pasurinë ose reputacionin e tyre, nuk janë në gjendje të përballojnë shërbimet e një avokati. Shteti ka detyrim që t'i përmbahet këtyre rregullave juridike në tërësi, të cilat vet i ka nxjerr.

Aktualisht, pjesa dërmuese e shteteve i ka siguruar më mirë proceset penale se sa proceset civile. Shteti dhe shoqëria kanë, nga ana e tyre, detyrim që të ndihmojnë profesionet juridike në përmbushjen e kësaj detyre.

Ne jetojmë në një epokë përparimesh të mëdha demokratike, dhe përkushtimi ynë duhet të jetë ndërmarrja e një sërë iniciativash për ta ngritur sa më lart ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë e të gjithëve, për respektimin dhe përparimin e sundimit të ligjit, me çka do të hapen të gjitha shtigjet e përparimit të lirive dhe të drejtave të njeriut duke respektuar paraprakisht dinjitetin njerëzor.

Institucionet shtetërore duhet t'i marrin të gjitha masat e duhura, qofshin ato të përgjithshme apo të veçanta, për të siguruar përmbushjen e objektivave për një sundim efikas të ligjit dhe së drejtës, sipas së cilës, të gjitha organet shtetërore i nënshtrohen kushtetutës, ligjit dhe akteve ndërkombëtare të adaptuara në një vend. Njëkohësisht, me rëndësi është fakti se bindja ndaj ligjit është tregues i qartë dhe frymëzues se po respektohen vlerat më të larta shoqërore, është një udhërrëfyes se ushtrimi i pushteteve është duke funksionuar në bazë të ligjit, me çka shihet qartë se të gjitha liritë dhe të drejtat e qytetarit janë duke u respektuar në shkallën më të lartë të mundshme.

Sundimi i ligjit është çështje kryesore për demokracinë dhe shtyllë kryesore e shoqërisë, është një fushë që do përkushtim të madh për të gjitha institucionet dhe për individët që janë pjesë e atyre institucioneve. Sundimi i ligjit paraqet gurë themelin e çdo shoqërie që synon demokracinë, pavarësisht nga statusi politik që e gëzon. Sundimi i ligjit nuk do të thotë vetëm rend, paqe dhe rregull por gjithashtu edhe liri. Ne jemi të mendimit, se sundimi i ligjit, është në qendër të themeleve të demokracisë, ky kërkon fuqizimin e mekanizmave ndërveprues në avancimin dhe respektimin e vlerave më të larta njerëzore, të cilat janë të garantuara nga shteti. Këto vlera do të minohen dhe dëmtohen kur statusi kryesor në këtë politikë kaq jetike vihet në pikëpyetje, ose injorohet rregullisht.

Mbizotërimi i sundimit të ligjit në një shtet nuk do të thotë vetëm ligjshmëri formale, e cila siguron rregullimin dhe konsekuencën në arritjen dhe aplikimin e rendit demokratik, por njëkohësisht, është element i drejtësisë, i cili bazohet në njohjen dhe pranimin e plotë të vlerave sublime të personalitetit të njeriut, të cilat garantohen nga ligji dhe i zbatojnë institucionet përkatëse, të cilat e sigurojnë kornizën e zbatimit konsekuent të normave dhe të vlerave të mirëfillta.

Kushti i ekzistimit të shtetit modern demokratik, është pikërisht mbrojtja e të drejtave të njeriut. Këtë e konfirmojnë edhe më shumë standarde ndërkombëtare , kurse ekzistimi i të drejtave pa mekanizma për mbrojtjen e tyre, do të jetë një çështje e pavlerë. Sundimi i ligjit do të ishte absolutisht i dështuar, nëse në një shtet nuk funksionojnë gjykatat e pavarura (neni 10 i Deklaratës Universale dhe neni 6 i Konventës Evropiane). Pushteti arbitrar dhe i pandërgjegjshëm i gjyqtarëve, prokurorëve, zyrtarëve qeveritar, policisë .etj, nuk mund të ekzistojë në një shtet juridik, prandaj, mund të themi se këta janë “ndërgjegjja e ligjshmërisë dhe e kushtetutshmërisë”.¹¹

¹¹ Ralf Crawshaw, Barrz Devlin, Tom Williamson, Human Rights and Policing Klouwer Law International, 1998, fq.44.

Sundimi i ligjit ka një rol të rëndësishëm në fuqizimin e kohezionit shoqëror, duke garantuar një nivel të mjaftueshëm të funksionimit të efektshëm të drejtësisë, duke ndikuar fuqishëm në jetën e qytetarëve për të frymuar çdo gjë sipas rregullave ligjore, duke argumentuar se ligji është ai i cili do të dominojë për të gjithë pa marrë parasysh përkatësinë etnike, gjininë, racën, pikëpamjen politike, gjuhën, kulturën, pozitën shoqërore, etj. Shteti ka detyrim që të promovojë, inkurajojë forcimin universal të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të jetë promotor në mbrojtjen dhe eliminimin e të gjitha pengesave që mund të shfaqen në jetën e përditshme.

2. Të qenit i barabartë para ligjit dhe pushtetit gjyqësor

Me të kryesisht kuptojmë barazinë juridike të qytetarëve dhe përjashtimin e çdo diskriminimi të tyre para ligjit dhe në konsumimin e lirive dhe të drejtave të garantuara me aktin më të lartë juridik. Kjo e drejtë duhet të sigurohet ndaj të gjithë qytetarëve. Në kushtetutat e shumë shteteve të botës, kjo e drejtë është e garantuar nëpërmjet normave kushtetuese, si p.sh. “Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”.¹² Apo, “të gjithë gëzojnë mbrojtjen e barabartë para ligjit”.¹³ Më konkretisht, të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe e gëzojnë njësoj të drejtën për të qenë të mbrojtur prej tij. Andaj, “ligji është një akt me karakter të përgjithshëm”.¹⁴

Çështja e barabarësisë para ligjit është normuar po ashtu me akte ndërkombëtare siç është Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut sipas së cilës “ Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe gëzojnë pa asnjë diskriminim të drejtën për t’u mbrojtur në mënyrë të barabartë nga ligji. Të gjithë e gëzojnë të drejtën të mbrohen njësoj ndaj çdo diskriminimi”.¹⁵ Trajtimi i barabartë dhe rrjedhimet e barabarta, jo vetëm që janë të ndryshme në vetvete, por edhe pasqyrojnë metoda që shprehin divergjenca të thella.

Në konspiracion me të, qëllimet dhe vizionet janë të njëjta në parandalimin dhe në luftimin e diskriminimit në njërin anë dhe, në anën tjetër, në ngritjen e shkallës së barazisë efektive dhe realizimin e trajtimit të barabartë të qytetarëve para ligjit. Barazia e qytetarëve para ligjit dhe garancia e realizimit të të drejtave, nuk do të ishin efektive nëse qytetarët nuk do t’i njihnin mjaftueshëm me ligjet në fuqi. Pra, publikimi i ligjeve është element thelbësor që do të vendos një

¹² Neni 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 2008.

¹³ Luan Omari, Shteti i së drejtës, Tiranë, 2004, fq. 124.

¹⁴ Kurtesh Saliu, E drejta kushtetuese, Libri I, Prishtinë, 1998, fq.151.

¹⁵ Neni 7 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948.

lidhje të drejtpërdrejt ndërmjet shtetit dhe qytetarëve.

Një shtet që nuk publikon ligjet, nuk mund të quhet vend i së drejtës. Transparenca e ligjeve i vendos qytetarët në një situatë barazie para ligjit. Andaj, vetëm nëpërmjet transparencës së normave do të ndërtohet dhe forcohet një sistem i qëndrueshëm juridik, që paraqet një nga themelet e demokracisë. Kjo transparencë lejon që ato të ekspozohen, dhe në këtë mënyrë do t'i nënshtrohen gjykimit të qytetarëve dhe mundësisë së shfrytëzimit efikas të të drejtave të garantuara po me këto ligje. Janë dy arsye të cilat e justifikojnë ekzistimin e një ligji dhe ato janë:

- Së pari, qytetari duhet të ketë të dhëna që janë të përshtatshme për rrethanat, për normat uridike të zbatueshme në një çështje të dhënë;
- Së dyti, një normë nuk mund të konsiderohet si ligj, përveçse kur ajo është formuluar me saktësi të mjaftueshme që t'i japë mundësi qytetarit të rregullojë sjelljen e vet. Prandaj, që një veprim apo masë të konsiderohet se është i ligjshëm, në përputhje me ligjin, duhet të jetë në të njëjtën kohë i aksesueshëm dhe i parashikueshëm;

E drejta për barazi para ligjit nënkupton që ligji nuk duhet të jetë diskriminues, si dhe të gjithë ata që ushtrojnë funksione publike në kuadër të përgjegjësisë, nuk duhet të veprojnë në mënyrë diskriminuese gjatë zbatimit të tij. Asnjë privilegj nuk mund t'i epët një individ, familje, grupi etnik apo klase gjatë aplikimit dhe zbatimit të ligjit. Në të gjitha procedurat organet shtetërore, gjyqësori dhe autoritetet administrative duhet të veprojnë në përputhje me parimin e barazisë përpara ligjit. Barazia u jep në mënyrë të vazhdueshme të gjithë njerëzve shumë gëzime të vogla. Dhe me të drejtë Rees thotë se “barazia apo të qenit i barabartë d.m.th. të trajtohet secili rigorozisht në të njëjtën mënyrë në çdo aspekt”.¹⁶ Andaj, ne mbajmë përgjegjësi individuale për të gjitha veprimet dhe mosveprimet tona. Të gjitha vendimet, veprimet dhe mosveprimet tona tërheqin pasoja pas veti. Ne duhet t'i trajtojmë të tjerët, ashtu siç dëshirojmë të trajtohemi prej tyre. Ne jemi të detyruar të respektojmë lirinë, jetën, dinjitetin, individualitetin dhe dallueshmërinë e të gjithëve, në mënyrë që çdo njeri të trajtohet në mënyrë njerëzore, pa përjashtime dhe pa paragjykime.

E drejta e barazisë përpara ligjit, ose siç thuhet shpesh, mbrojtja e njëllajtë nga ligji, përbën themelin e një shoqërie të drejtë e demokratike. Thelbi i administrimit të përditshëm gjyqësor, konsiston në premtimin për një drejtësi

¹⁶ John Rees, *Equality*, New York –Praeger, 1971, fq. 98.

të barabartë përpara ligjit dhe në garantitë kushtetuese të mbrojtjes për proces ligjor të rregullt. Barazia apo të qenit i barabartë është simbol dhe nxitje që njerëzit të trajtohen në mënyrë të barabartë, pa privilegje të kristalizuara. Me të drejtë Breneto Latini ka thënë, duke qenë i përkrahur edhe nga disa autorë të tjerë se, “ashtu si drejtësia që është diçka e barabartë, po ashtu padrejtësia është diçka e pabarabartë. Pra ai që dëshiron të vendosë drejtësi përpiket t’i barazojë gjërat që nuk janë të barabarta”. Barazia dhe të qenit i barabartë me të tjerët është një fenomen që varet dhe mund të vijë vetëm si rezultat i veprimit të njeriut. Barazia qëndron në faktin që ligji është i barabartë për të gjithë, pavarësisht nëse mbron apo ndëshkon.

E drejta për mbrojtje të barabartë nga ligji ”ndalon diskriminimin në ligj apo në praktikë në çdo fushë që rregullohet dhe mbrohet nga autoritetet publike”.¹⁷ Andaj, duke marrë parasysh se, diskriminimi është i llojllojshëm dhe prezent jo vetëm në strukturat shtetërore dhe publike, por gjithashtu edhe në shoqërinë civile, kjo është forma më e shpeshtë e trajtimit të pabarabartë, e cila mund të prekë njerëz me prejardhje të ndryshme raciale, etnike, kombëtare apo sociale. E njëjta po ashtu mund të jetë drejtuar kundër njerëzve të kulturës, gjuhës apo prejardhjes së ndryshme religjioze, personave me aftësi të kufizuara, njerëzve në moshë, personave të cilët janë të infektuar me ndonjë sëmundje po ashtu mohimi i meritave dhe nënvlerësimi i të arriturave profesionale duke përfshirë çdo formë tjetër të trajtimit jo korrekt gjatë vlerësimit të ndonjë çështjeje e cila do qoftë paraqet bazë të mjaftueshme për trajtim diskriminues.

Sidoqoftë, kjo nuk i bën diskriminuese të gjitha diferencat e trajtimit diskriminues, por vetëm ato që nuk bazohen në kritere të arsyeshme dhe objektive. Andaj, me të drejtë mund të konstatojmë se, nuk mund të nxirret asnjë ligj apo akt tjetër që ka për qëllim që të prishë me prapa veprim një vendim gjyqësor të caktuar ose të ndryshojë përbërjen e gjykatës për të ndikuar mbi vendimin.

Të ndërlidhur ngushtë me barazinë para ligjit njëkohësisht, është trajtimi i barabartë para gjykatës, që nënkupton që, pavarësisht përkatësia etnike, gjinia, raca apo statusi financiar i dikujt, çdo person që paraqitet para një gjykate ka të drejtë të mos diskriminohet as gjatë procedurave, e as në mënyrën se si zbatohet ligji ndaj personit në fjalë. Të drejtat duhet të sigurohen për çdo person në mënyrë të barabartë, si për personat që dyshohen për vepra të vogla penale, e po ashtu edhe për ata që dyshohen për krime serioze, apo për ndonjë çështje civile, administrative, komerciale, etj.

¹⁷ Broeksv.the Netherlands, (172-1984) Komenti i të Drejtave të Njeriut, 9 prill 1987, Sel.Dec 196.

Andaj në vazhden e kësaj, administrimi gjyqësor i vërtetë kërkon mbrojtjen e të drejtave private përmes administrimit të rregullt, që është në përputhje me format, proceset dhe rregullat e parashikuara. Ky është procesi i rregullt. Elementet e procesit të rregullt në të drejtën penale dhe civile përfshijnë njoftimin, zbulimin, të drejtën e lirisë me kusht, këshillimin, procesin e rregullt dhe ligjor, ballafaqimin, pyetjen e dëshmitarit, të drejtën për të thirrur dëshmitarë, privilegjin kundër vet inkriminimit dhe, midis të tjerave, vendimin publik të dhënë në kohën e duhur dhe të drejtën për të apeluar atë vendim në shkallën më të lartë. Gjithsecili duhet të gëzojë të drejtën që të trajtohet i barabartë në gjykatë dhe të mos e ndien vetën të diskriminuar, çoftë në një proces gjyqësor civil apo penal, dhe mos të ketë perceptime se çështja nuk do të vlerësohet drejtë, sepse “pa pushtetin e gjykimit, shteti juridik nuk mund të paramendohet”.¹⁸ Autoritetet gjyqësore kanë për detyrë që pa zvarritje dhe me efikasitet të veprojnë sipas procedurave të parapara ligjore, duke respektuar dinjitetin e secilës palë në procedurë. Gjykata në ushtrimin e punës së vet, “do të tregohet e përsosur profesionalisht, e pavarur, e paanshme, si dhe e përgjegjshme në respektimin e ligjit në shqyrtimin dhe vlerësimin e drejtë dhe objektiv të provave duke vendosur në mënyrën më të drejtë të mundshme”.¹⁹ Dinjiteti i qytetarit ruhet dhe mbrohet nga gjykata. Asgjë nuk mund të jetë bazë për cenimin e tij. Trajtimi i barabartë para gjykatave, ofron garanci gjatë të gjitha fazave të gjykimit, në atë mënyrë që, secili person i dyshuar apo i akuzuar të ketë të drejtë që të mos jetë i diskriminuar përmes mënyrës së hetimeve, gjykimeve apo përmes zbatimit të ligjit ndaj tyre. Paraprakisht, barazia para gjykatave do të sigurojë se çdo qenie njerëzore duhet të ketë qasje të barabartë në gjykatë, me qëllim që të kërkojë të drejtat e saj/tij. Një kujdes, po ashtu të rëndësishëm, duhet t’i kushtohet asaj se të gjithë duhet të kenë qasje të barabartë në gjykata, me qëllim që të kërkojnë të drejtat e veta, pa marrë parasysh a është burrë, grua apo fëmijë.

Sundimi i ligjit, mbrojtja e barabartë dhe një proces i rregullt kanë implikime praktikisht të thella në shoqëri. Këto implikime diktojnë se qëllimi i administrimit gjyqësor nuk është as autonomia, as pavarësia gjyqësore, por liria, rendi shoqëror, sundimi i ligjit, mbrojtja e barabartë dhe procesi i rregullt i ndershëm gjyqësor. Rol qendror në këtë aspekt ka funksionimi i drejtësisë dhe ligjit duke respektuar garancitë e dhëna për qytetarët, duke përfshirë qasje të barabartë në drejtësi dhe promovimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve që zbatojnë ligjin dhe rendin.

¹⁸ Basta – Posavec, L., *Pravna Deržava i konstitucionalna demokratija, Anali Pravnog Fakulteta u Beogradu*, 1993 Nr.1-2. fq. 26-31

¹⁹ Ramadan Gashi, *E drejta për gjykim publik dhe publiciteti i gjykimit*, Prishtinë, 2014 fq. 24.

Gjykata, prokuroria dhe avokatura duhet ta luajnë rolin kyç në rregullimin e këtyre situatave dhe sigurimin që mosndëshkimi i akteve diskriminuese të mos tolerohet, që aktet e tilla të hetohen, të dënohen, po ashtu paraprkasht edhe viktimat të kenë në dispozicion mjete ligjore efektive për t'i realizuar të drejtat e tyre dhe mbrojtjen adekuatë.

Në përputhje me atë që u tha më lart, mund të konstatojmë se barazia ka për qëllim që:

- Secilit t'i njihen të drejtat e garantuara ligjore dhe, në anën tjetër, secili të ketë mundësi ligjore për të kundërshtuar vendimet që janë nxjerrë në bazë të ligjit;
- Të gjithë qytetarët të kenë të njëjtën rëndësi shoqërore dhe publike dhe të janë në gjendje të kundërshtojnë diskriminimin;
- Secilit t'i jepen mundësi të barabarta për t'u ngritur dhe promovuar meritat;

3. Gjykimi i drejtë dhe siguria qytetare

Siguria qytetare nuk mund të realizohet pa sundimin e ligjit dhe pa gjykimin e drejtë. Që në Virginia Bill of Rights të vitit 1776 ofrohen garanci për gjykim të drejtë ku, në mes tjerash, theksohet se “në të gjitha rastet e padive të rënda apo kriminale, secili ka të drejtë të njihet me arsyet dhe llojin e padisë kundër tij, të vihet ballë për ballë me paditësit dhe dëshmitarët, të ftojë dëshmitarët e tij dhe të kërkojë hetimin e shpejtë nga një gjykatë e pavarur, e përbërë nga 12 burra nga rrethi i tij, pa miratimin unanimit të së cilës ai nuk mund të shpallet fajtor; ai gjithashtu nuk mund të detyrohet të shprehet kundër vetvetes; askush tjetër përveç ligjeve të vendit apo vendimit të tyre nuk mund t'ia heqë lirinë”.²⁰

Parimi i sundimit të ligjit kontribuon në sigurinë personale të njeriut. Ashtu siç garantojnë se askush nuk do të persekutohet ose arrestohet në mënyrë arbitrare, gjithkush ka të drejtë për dëgjim të drejtë dhe gjykim të pavarur e të paanshëm. Përderisa këto të drejta njihen dhe respektohen, pushteti gjyqësor mund të luajë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e tyre, sa herë që bëhen përpjekje të fuqishme për t'i cunguar ato në një mënyrë arbitrare ose ad hoc. E drejta për gjykim të drejtë është një e drejtë njerëzore bazë. Kjo e drejtë është një prej parimeve të zbatueshme botërisht që njihet edhe në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, miratuar nga qeveritë botës, ku në mes tjerash thuhet se, “njohja e dinjitetit të qenësishëm dhe të drejtat e barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore, janë themeli i lirisë i drejtësisë dhe i paqes në botë”.²¹

²⁰ Neni 8 i Deklaratës për të Drejta të Virgjinisë e 12 qershor 1776 (Virginia Bill of Rights).

²¹ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948.

Çdokush që ka qasje në gjykatë i nënshtrohet procedurave para saj, andaj nga ana e saj kërkohet që gjithsecili duhet të trajtohet me respektin më të lartë, të ruhet dinjiteti, jeta private dhe personaliteti i gjithsecilit. E njëjta garantohet edhe në Republikën e Kosovës ku ligji për gjykatat garanton se “Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik katë drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor”.²² Më konkretisht, “të gjithë njerëzit duhet të jenë të barabartë përpara gjykatave dhe trupave gjykues”.²³ Ky parim i përgjithshëm i shtetit ligjor nënkupton që çdokush duhet të ketë njëlloj mundësi të barabartë për gjykatë, si dhe trajtim të barabartë nga ajo gjykatë.

Proceset gjyqësore dhe zbatimi i ligjit mbi faktet në çështjet individuale duhet të, jenë të qëndrueshme dhe të parashikueshme, apo më mirë të themi që ndaj secilit individ të vepohet me drejtësi në bazë të rregullave dhe procedurave, të ekzistojë kujdesi permanent që secili të merr dhe të japë atë që i takon, ose atë që ai-ajo ka të drejtë të marrë. Prosesi gjyqësor është një tërësi normash formale që përcaktojnë mënyrën në të cilën sistemi gjyqësor duhet t’i prodhojë vendimet e veta dhe t’i organizojë ndërveprimet midis aktorëve të shumtë siç janë: gjyqtari, palët, avokatët që përfaqësojnë, dëshmitarët, ekspertët dhe personeli tjetër që sipas ligjit përkatës duhet të marrin pjesë në procedurë. Pra, bëhet fjalë për rregulla që, synojnë të përcaktojnë, jo aq përmbajtjet, sesa modelin e veprimit, të përvijojnë një kuadër detyrimesh dhe mundësish, të japin kompetenca për nisma dhe zhvillim procedural.

Veçoria kryesore e një procesi gjyqësor është se gjatë procesit do të mbisundojë fryma e një dueli provash nga akteret që marrin pjesë në procedurë, me qëllim që ta bindin gjykatën përmes këtyre provave të cilat do t’i vlerësojë gjykata. Gjykatës i mbetet roli i drejtimit të procesit dhe i arbitrit. Nuk mjafton të ketë vetëm proces gjyqësor, por e rëndësishme është që procesi të zhvillohet realisht në mënyrë efektive, dhe të dobishme dhe të japë pasqyrim të qartë se procesi do t’i përmbahet rregullave të parapara ligjore. Me fjalë të tjera, “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij”.²⁴ Për të sqaruar këtë çështje, është e dobishme të kihet parasysh fakti se procedura e caktuar çon në vendim që nuk është përcaktuar në mënyrë të rreptë dhe nuk ndjek një ecuri të njëjtë. Ecuria e procesit shpesh parashikon alternativat dhe është e hapur ndaj opsioneve të vendimeve

²² Neni 7.1 Ligji për Gjykatat (Ligji Nr. 03/L-199) 2010.

²³ Neni 14 paragrafi 1 i Konventës për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit të Gruas, 1979.

²⁴ Neni 6(1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 1950.

subjektive dhe strategjive të aktorëve, që marrin pjesë në të. Mirëpo, në caqet e detyrimeve të caktuara nga normat, “ rruga që ndiqet konkretisht varet edhe nga zgjidhjet e kryera nga aktorët proceduralë dhe natyrisht, nga fuqia që zotërojnë këta akterë për të kontrolluar zhvillimin e procesit ”.²⁵

Në radhë të parë duhet të shqyrtohet nyja vendimmarrëse që i jep nismën procesit, pra rregullat, të cilat përcaktojnë se cilët akterë mund të marrin pjesë në një çështje konkrete. Në pjesën dërrmuese, të gjitha sistemeve të gjyqësisë ia njohin të ashtuquajturin “legjitimim për të vepruar” subjekteve individuale që kanë një interes të drejtpërdrejtë dhe personal. Fjala është, “për një filtër që pritet t’ua mbyll grupeve rrugën e hyrjes në drejtësi dhe që artikulon kërkesa me të cilat synohet të nxiten apo të mbrohen interesat kolektive”.²⁶ Procesi gjyqësor është një çështje thelbësore dhe një shprehje e baraspeshës që duhet të ekzistojë në mes palëve në proces. Inferioriteti i ndonjërës palë nuk guxon të ekzistojë por, njëkohësisht, as palët në mes tyre nuk do t’i lejojë në asnjë mënyrë të dominojnë njëra ndaj tjetrës, përveç forcës së provave për të cilat vendos gjykata. Procesi gjyqësor duhet të jetë publik, përveç atyre çështjeve të cilave me ligj u është garantuar që gjykimi të jetë i mbyllur për publikun.

Në pjesën dërrmuese të shteteve demokratike procesi gjyqësor është i ndarë në dy faza. Faza paraprake, që ka funksionin ta përgatisë çështjen, t’i saktësojë kërkesat e palëve dhe t’i grumbullojë mjetet provuese, me qëllim të hapjes së rrugës në fazën e mëtejshme. Gjate procesit gjyqësor palët kanë të drejtë të paraqesin provat dhe t’i kundërshtojnë ato ndërmjet tyre. E rëndësishme është nëse ka kundërshtim të deklaratave, apo ndodh e kundërta, t’i mbështesin deklaratat me prova dokumentare.

Sidomos në sistemet, ku gjykimi në apel apo shkallë të dytë janë të shpeshta, detyrimi i palëve për të respektuar vendimin, shpeshherë parashikohet vetëm pas një vendimi përfundimtar, d.m.th. kur janë shterur të gjitha mjetet e ankimit. Në sistemet e veçanta, shpërndarja e kompetencave që lejojnë të kontrollohet dhe zhvillohet çështja është e ndryshme.

Në pjesën dërrmuese, në çështjet penale, një hetim zyrtar kryhet dhe mbikëqyret nga një ushtrues i një funksioni publik (prokuror apo gjyqtar hetues), të cilit, me dispozita ligjore, i sigurohet dhe i legjitimohet një rol aktiv.

Një faktor me rëndësi është shpërndarja e ndryshme e kompetencave midis gjykatësit dhe palëve.

²⁵ Damaska M.R, Structure of Authority and Comperative Criminal Procedure, in The Yale Law Jurnal, LXXXIV, Bolgona, 1975, fq.480-545.

²⁶ Komesar N.K, Imperfect Alternatives. Choosing Institutions in Law,Economics and Public Policy, The University of Chicago Press, Chicago–London,1994, fq. 24.

a) Realizimi i të drejtave të individëve në procesin gjyqësor civil

Zakonisht, në procesin gjyqësor civil marrin pjesë dy palë kundërshtare për shkak të mosmarrëveshjes që kanë midis tyre. Njëra palë (*paditësi*) pretendon se i është shkelur një e drejtë subjektive nga pala tjetër, ndërsa kjo e fundit (*i padituri*) e mohon qenien e së drejtës së pretenduar për një arsye ose tjetër. Ky quhet procesi gjyqësor me palë kundërshtare – *juridictiocontentiosa*. Padia mund të ngrihet bashkërisht nga shumë paditës ose kundër shumë të paditurve (bashkëndërgjyqesia). Prosesi juridiko-civil lind midis dy ose më shumë personave të cilët vihen përballë njëri-tjetrit para një subjekti të veçantë të ngarkuar në zgjidhjen e një çështje civile (*gjykatës*). Gjykata si organ shtetëror në këtë proces ka një pozitë të veçantë dhe ai është i vetmi organ që shqyrton një çështje civile dhe jep vendimin përfundimtar. Gjyqtarët caktohen pavarësisht nga vullneti i palëve. Gjykata është në raport të ngushtë me momentin e dërgimit të padisë palës së paditur nga ana e saj, që emërtohet si gjyq varësia. Kjo për faktin, se pikërisht në momentin e dërgimit të padisë, palës së paditur krijohet kontest varësia, kurse në momentin e dërgimit të padisë në gjykatë krijohet gjyq varësia. Krahas subjekteve të mësipërme pa të cilët nuk ka proces gjyqësor, në të mund të marrin pjesë edhe subjekte të tjerë (*persona të tretë*) që mund të vijnë vetë ose të thirren në proces për të mbrojtur interesat e veta apo të palës me të cilën bashkohet, apo interesat shtetërore ose shoqërore.

Gjithë këta pjesëmarrës, në kuptimin e gjerë kryejnë veprime procedurale. Këto veprime përbëjnë përmbajtjen e procesit civil. *Këta pjesëmarrës kanë si qëllim zgjidhjen e çështjes dhe realizimin e të drejtave të tyre, për të cilat pretendohet se janë shkelur*. Palët dhe subjektet e tjera që marrin pjesë për të mbrojtur interesat e tyre kryejnë veprime procedurale me qëllim që gjykata t'i zgjidhë mosmarrëveshjet midis tyre. Nga kryerja ose moskryerja e këtyre veprimeve rrjedhin pasojat procedurale të caktuara siç janë: *lindja, ndryshimi ose shuarja e marrëdhënieve procedurale, p.sh. rrëzimi i padisë, pushimi i gjykimit, sjellja e provave etj.*

Subjektet nuk mund t'i kryejnë veprimet procedurale, sipas dëshirës së tyre, por janë të diktuar nga ligji, d.m.th. në marrëdhëniet e tyre procedurale në procesin gjyqësor civil ato do të kryejnë vetëm ato veprime që parashikohen dhe lejohen nga ligji i procedurës kontestimore, apo urdhërohen nga Gjykata, për zgjidhjen e çështjes. Ajo ka detyrë zgjidhjen përfundimtare të çështjes së ngritur dhe të kryejë veprime procedurale të caktuara për zgjidhjen e çështjes, të cilat janë të detyrueshme për pjesëmarrësit në procesin gjyqësor.

b) Procesi gjyqësor penal dhe garancitë që ofron gjykata për të gjithë ata që përballen me ligjin

Në çështjet penale çështja qëndron më ndryshe, sepse këtu kemi të bëjmë me interes shoqëror– shtetëror edhe pse palët në procedurë janë të barabarta, në këto procese mbizotëron interesi kolektiv (nga shkaku se element i veprës penale paraqitet rrezikshmëria shoqërore). Prandaj çështja mund të jetë obligative, të jetë çështje shtetërore, pra të marrë një karakter që synon të vendosë dhe të rivendosë një rend juridik i cili është cenuar nga dikush. Të gjitha këto çështje u janë besuar një personi, gjyqtarit apo, trupit gjykues. Në mbështetje të kësaj, vlerat që e orientojnë veprimin e shtetit japin një pasqyrim të dukshëm se faktor kyç në procesin gjyqësor është gjykatësi.

Andaj, do të jetë mase e logjikshme që, në këtë aspekt gjyqtari të ketë detyrën kryesore që të administrojë një proces të orientuar mirë gjyqësor që në thelb ka zgjidhjen e konflikteve që ndodhin në shoqëri. Nëse marrim si shembull një procedim penal në SHBA dhe në Angli vende që karakterizohen me sistem anglosakson, procesi si i tillë i afrohet morfologjisë kundërshtare, ndërsa sa i përket procesit civil, i jep herë-herë gjykatësit të drejta në ndërhyrje mjaft të theksuara në fazën përgatitore. Mirëpo, ekzistojnë edhe raste kur një çështje penale e natyrës së lehtë mund të zgjidhet pa proces gjyqësor por me ndërmjetësim si një formë mjaftë e suksesshme e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Kur një individ del në gjyq penal, ai përballohet me gjithë mekanizmat e shtetit. Mënyra se si trajtohet individi kur akuzohet për një krim, reflekton një tregues konkret se deri në ç’shkallë shteti respekton të drejtat individuale të njeriut. Shtrohet pyetja: kur ekziston rreziku i shkeljes së të drejtave të njeriut? Përgjigja është se rreziku ekziston që nga çasti kur organet kompetente ngrënë dyshimin ndaj një personi nga momenti i arrestimit, ndalimit gjatë fazave të sigurimit e të pranisë së të pandehurit, gjatë gjykimit, ankimit, deri në fazën e ekzekutimit të dënimit si dhe gjatë tërë fazës së ekzekutimit deri në integrimin e plotë në shoqëri.

Dhe me të drejtë mund të themi se, nuk mjafton vetëm të ketë procese gjyqësore, por me rëndësi është që procesi të kalojë duke u respektuar denjësisht procedura dhe “pa vonesë të paarsyeshme” të respektohet koha në të cilën duhet të përfundojë dhe të shpallet gjykimi, me çka do të demonstron qartë se gjykata ka vepruar me efektivitet të lartë dhe me alternim realisht të drejtë, në mënyrë të dobishme dhe meritore.

E drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm është riprodhuar dhe përpunuar në mënyrë koherente në çdo shoqëri e cila ka pikësynim respektimin e standardeve

të përcaktuara ndërkombëtare. Kjo e drejtë jo vetëm që është specifikuar dhe kodifikuar në shumë traktate ndërkombëtare si dhe nga organizma rajonale dhe ndërqeveritare, por kjo çështje fundamentale duhet të sigurohet edhe me akte të brendshme juridike siç është kushtetuta dhe ligjet e një vendi. Këto standarde të të drejtave të njeriut janë të përpiluara për t'i zbatuar të gjitha sistemet ligjore në botë dhe për ta pasur parasysh ndryshueshmërinë e larmishme të procedurave ligjore, që përcaktojnë garancitë minimale që duhet të sigurohen nga të gjitha sistemet. Të drejtat tona janë garancia më e mirë e lirisë dhe sigurisë sonë. Përmes respektimit të tyre, edhe kur është shumë vështirë për të bërë një gjë të tillë, ne vetë bëhemi mbrojtësit më të mëdhenj të lirisë dhe shërbëtorë të idealeve tona më të larta për drejtësi.²⁷

Kërkesat e trajtimit të barabartë në gjykata në çështjet që janë objekt shqyrtimi, ngërthejnë në vete dy aspekte të rëndësishme. Në njërën anë është parimi bazë që mbrojtja dhe padia duhet të trajtohen në atë mënyrë që të garantohet se palët në procedurë kanë mundësi të barabarta për të përgatitur dhe për të paraqitur çështjen e tyre gjatë zhvillimit të procedurave dhe aspekti tjetër është që, çdo person i akuzuar duhet të trajtohet i barabartë me qytetarët tjerë të vënë nën akuzë të ngjashme, pa diskriminim dhe pa degradim të personalitetit.

Jemi të vetëdijshëm se shkalla e lirisë së pushtetit të veprimit të gjykatës është e një niveli absolut që do të thotë nuk i nënshtrohet asnjë pushteti tjetër, pushteti si i tillë duhet të ushtrohet brenda kufijve të ligjit dhe t'i nënshtrohet shqyrtimit të pavarur gjyqësor të provave. Kjo shpie deri te konstatimi se në fushën e së drejtës penale, sundimi i ligjit kërkon që askush të mos ndëshkohet, përveç rasteve të krimeve që janë të përcaktuara me ligj, të drejtat nuk duhet të shkelen përmes legjislacionit të së kaluarës dhe qasja në drejtësi nuk duhet të jetë tepër e ngadalshme ose tepër e shtrenjtë.²⁸

Procesi gjyqësor duhet të zhvillohet jashtë çdo ndërhyrjeje të jashtme dhe të pajustificueshme dhe, çdo tentim për ndërhyrje nuk guxon të ndikojë në proces. Sipas nenit 14 (1)KNDCP ” të gjithë personat janë të barabartë para gjykatës”.²⁹ Njëkohësisht, po me nenin 2(1) të marrëveshjes, interpretuar lidhur me nenin 14 (1), garantojnë të drejtat e çdo individi për një gjykim të drejtë, pa ndonjë dallim çfarëdo qoftë, duke mos marrë parasysh racën, ngjyrën, gjuhën, fenë, bindjen politike ose ndonjë bindje tjetër, origjinë kombëtare ose sociale, mënyra, pozita ose rrethana tjera. Një garanci të tillë e ofron edhe Konventa evropiane e të Drejtave të Njeriut e 4 nëntorit 1950, e cila siguron

²⁷ David J. Boden hamer, *Our Rights, The Right to a fair trial*, Oxford University Press, 2006, fq. 106.

²⁸ William Wade/ Christopher Forsyth: *Administrative Law*, Oxford, 2004, fq. 24.

²⁹ Konventa Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike, 1966.

minimumin e garancive të cilat, shtetet anëtare të Konventës, janë të detyruara që t'i sigurojnë për qytetarët e tyre.

Sipas Konventës “çdo person ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij. Vendimi shpallet publikisht, por prania në sallën e gjyqit për përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe për publikun, mund të ndalohet kur një gjë të tillë e kërkon interesi i ruajtjes së moralit, rendit publik ose sigurimit kombëtar në një shoqëri demokratike, kur e kërkojnë interesat e të miturve, mbrojtja e jetës private të palëve në gjykim, tërësisht ose në atë masë kur gjykata mendon se është plotësisht e nevojshme në rrethana të veçanta kur publiciteti do të paragjykonte interesat e drejtësisë”.³⁰

Në një vështrim të detajuar, respektimi i këtyre garancive që përbën neni 6 KEDNJ siguron këto të drejta për të gjithë personat, kur kemi të bëjmë si për rastet penale po ashtu dhe për çështje civile, çka do të thotë se secili person gëzon të drejtën për të bërë çdo lloj pretendimi në lidhje me të drejtat e tij civile dhe detyrimet përpara një gjykate. Në vështrim të kësaj obligimet e një gjykate të një shteti janë që të respektoj denjësisht këto të drejta për të gjithë personat në barabarësi të plotë.

Të drejtat e të pandehurit në çështjen penale dhe realizimi i tyre në gjykatë:

- Gjykata do të respektojë në çdo fazë të procedurës të drejtën për barazi para ligjit dhe trajtim të barabartë i palëve;
- Gjykata në vazhdimësi do të respektojë me përkushtim të drejtën për t'u trajtuar në mënyrë njerëzore, pa përrjashtim, të gjitha palët, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, kulturore, racore, fetare, dhe çdo statusi tjetër që gëzon në shoqëri;
- Gjykata në vazhdimësi do të respektojë të drejtën e secilit person i cili dyshohet ose që akuzohet për veprë penale që të konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës;³¹
- Askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për veprë penale nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës (*Ne Bis in Idem*);

³⁰ Neni 6 i Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 1950.

³¹ Neni 3.1 Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, 2013.

- Gjykata në vazhdimësi do të respektojë parimin e barazisë së armëve, për të gjitha palët, që nënkupton detyrimin për t'i ofruar secilës palë mundësinë për të paraqitur çështjen e saj në kushte që nuk e vënë në disavantazh me palën tjetër;
- Gjykata me qëllim të respektimit të të drejtave të palëve, do t'i kushtojë rëndësi që palët të informohen brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që e kuptojnë në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
- Të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë. Realizimi i së drejtës së mbrojtjes s'mund të bëhet veçse nëpërmjet një procedure të tillë. Në të njëjtën kohë, s'mund të kemi një proces të drejtë dhe të paanshëm nëse e drejta e mbrojtjes nuk respektohet;
- Gjykatat kanë obligim për secilin individ, pa dallim, të respektojnë të drejtën për të qenë prezent në gjykim;³²
- Askujt nuk mund t'i shqiptohet sanksioni penal, ose masa e trajtimit të detyrueshëm për një vepër, nëse para kryerjes së saj nuk është përcaktuar me ligj si vepër penale dhe nuk është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për atë vepër;³³
- Të respektohet e drejta për gjykim publik,³⁴ me qëllim të garantimit të së drejtës për gjykim të drejtë (përfundimisht për rastet e parapara me Kod kur gjykimi duhet të mbahet i mbyllur);³⁵
- Të respektohet e drejta për të heshtur,³⁶ e drejta e të akuzuari për të heshtur gjatë gjykimit nuk mund të konsiderohet se i akuzuari po i pranon akuzat që janë ngritur ndaj tij. Përkundrazi, kjo e drejtë nuk guxon të nëpërkëmbet nga ana e gjykatës. Sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, një gjykatë mund të nxjerrë përfundime negative nga fakti që i akuzuari nuk shpjegon praninë e tij në vendndodhjen e krimit gjatë marrjes në pyetje në gjyq, pa shkelur prezumimin e pafajësisë ose të drejtës ose të drejtës koresponduese për të mos u detyruar që të dëshmojë në seancë gjyqësore. Andaj, si rrjedhojë e kësaj, gjyqtari gëzon liri veprimi për të nxjerrë përfundime ose jo, të cilat duhet të mbështeten në logjikën e shëndoshë të tij.
- Gjykata do t'i garantojë secilit person që ndaj tij zhvillohet procedura penale, ta gëzojë të drejta për komunikim të privilegjuar me avokatin;

³² Eur. Court HR, Brozicek Cae , Italy, judgment of 19 December 1989 Series A, No 167, fq. 19 paragr.57.

³³ Neni 2.2 Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Kodi Nr. 04/L-082), 2013.

³⁴ Eur. Court HR, Case of Weber v. Switzerland, judgment of 22 May 1990, Series A, No 177, fq. 20 paragr.30.

³⁵ Eur. Court HR, Case of Prettoand OTHERS V. Italy, judgment of 8 December 1983, Series A, No 71, paragr.27.

³⁶ Eur. Court HR, Case Marry v. United Kingdom, 8 February 1996 paragr. 45.

- Gjatë zhvillimit të procesit penal, gjykata do t'i kushtojë rëndësi të drejtës së pandehurit që i pandehuri të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
- Çdo proces i rregullt ligjor nënkupton edhe respektimin e një afati kohor të arsyeshëm dhe të drejtën për një seancë gjyqësore të hapur dhe të shpalljes publikisht të vendimit edhe në procesin penal;
- Të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq;
- Të drejtën për të mos kontribuar në vetë inkriminimin;
- Të drejtën për tu konsideruar i pafajshëm;
- Të drejtën për një gjykim në një kohë të arsyeshme;
- Të drejtën për seancë gjyqësore me palë kundërshtare;
- Gjyqtari ka përgjegjësinë që të vërtetojë nëse i pandehuri që duket i keqtrajtuar, a është keqtrajtuar derisa ishte në paraburgim;
- Gjyqtari ka përgjegjësinë për të përcaktuar pranueshmërinë e provave;

Këto standarde kanë për qëllim që secila gjykatë t'i respektoj dhe në asnjë moment të mos i anashkaloj këto garanci. Këto garanci synojnë dhe përcaktojnë se nëse respektohen nga një gjykatë e një shteti atëherë mund të vlerësohet se kemi të bëjmë me gjykim të drejtë, ndërsa nëse minohen njëra nga këto garanci atëherë shteti në kuadër të së cilit funksionon gjykata është përgjegjëse për shkelje dhe cenim të standardeve për gjykim të drejtë.

Neni 6 i mbulon edhe procedurat pas seancës gjyqësore, të tilla siç është ekzekutimi i një vendimi, pra, mbulon procedimet e marra si tërësi. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të drejtës procedurale dhe materiale.³⁷ Çdo gjyqtar, në fillim të një seance, duhet të ketë parasysh përgjegjësinë për të siguruar garancitë e më sipërme dhe në përfundim të çdo seance të kontrollojë nëse ai-ajo e ka kryer detyrën me përpikëri.

Gjykimet duhen të behen publikisht të hapura, me përjashtime të kufizuara, siç janë rastet që prekin të rinjtë, jeta private e të cilëve duhet mbrojtur, ato të mosmarrëveshjeve martesore dhe rastet e ruajtjes së fëmijëve. Gjykimi është publik kur ai shqiptohet me gojë në një seancë gjyqësore e cila është e hapur për publikun, ose kur vendimi botohet me shkrim.

E drejta për gjykim publik shkelet kur gjykimet bëhen vetëm për një grup të caktuar njerëzish, ose kur vetëm disa njerëzve, që kanë interesa specifike,

³⁷ Eur. Court HR Case Garcia Ruiz , Spain , Nb. 30544/96.

u lejonet të inspektojnë gjykimin. Çështjes së gjykimit publik i ka kushtuar kujdes dhe vëmendje edhe Konventa Amerikane e cila kërkon që, “procedurat penale të jenë publike me përjashtim për atë sa është e domosdoshme për të ruajtur interesat e drejtësisë”.³⁸

Qëllimi kryesor i gjykimit publik është që të sigurohet se administrimi i drejtësisë është publik dhe i hapur për mbikëqyrje publike. Prandaj, gjykimi publik është imperativ dhe mund të kërkohej nga cilido, përfshirë edhe njerëzit që nuk janë palë në procedura. Ekskluzivisht, gjykata ka mundësi që, në disa raste të arsyeshme, gjykimin ta mbajë në seancë të mbyllur, njëkohësisht ta përjashtojë publikun nga shqyrtimi dhe të shqiptojë sanksione ndaj atyre të cilët nuk e respektojnë rendin në gjykatore.

c) Të drejtat e të dëmtuarit që ka qenë viktimë e krimit

Me Kodin Penal në rend të parë mbrohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Kushdo që i cenon i dëmton apo i rrezikon këto vlera, Kodi Penal ka paraparë sanksione penale. I dëmtuar apo viktimë e veprës penale është çdo person fizik apo juridik të cilit ndonjë e mirë apo e drejtë i është rrezikuar me anë të veprës penale, ose i është shkelur apo dëmtuar dhe asgjësuar³⁹. Viktima e krimit në procedurën penale edhe më tutje është objekt. Viktimizimi së këndejmi është procesi i pësimi apo i vuajtjes së viktimës. Ajo është e qëllimshme dhe e paqëllimshme sikurse edhe e vetëdijshme dhe e pavetëdijshme. Viktimizimi shpesh është dukuri individuale, por mund të marrë edhe përmasa të viktimizimit kolektiv.⁴⁰

Sipas Deklaratës së KB-së, viktimat nënkuptojnë personat të cilët, individualisht apo në mënyrë kolektive, kanë pësuar lëndime, duke përfshirë këtu edhe lëndimet fizike apo mentale, pësimet emocionale, humbjet ekonomike apo keqësimin substancial të të drejtave të tyre themelore, nëpërmjet kryerjes së veprimeve apo moskryerjes së tyre, të cilat paraqesin shkelje të ligjeve penale duke përfshirë edhe ligjet të cilat ndikojnë në keqpërdorimin e pushtetit.⁴¹ Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, i dëmtuar ose viktimë është personi të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar me veprën penale.⁴²

³⁸ Neni 8.5 i Konventës e Amerikane për të Drejtat e Njeriut e vitit 1969.

³⁹ Zvonimir Šeparović, Viktimologjia – studija o žrtvama, Informator, Zagreb, 1998, fq.71.

⁴⁰ Ramljak A. Alija, Halilović Haris, Viktimologjia, Fakultet kriminalističkih nauka u Sarajevu, 2004. fq.22.

⁴¹ Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Themelore të Viktimave të Krimit dhe Keqpërdorimit të Pushtetit, e vitit 1985.

⁴² Neni 19 paragrafi 1.7 Kodi Nr. 04/L-123.

Të drejtat e të dëmtuarit të cilat gjykata është e obliguar t'ia njeh:

- E drejta për të qenë pjesëmarrës aktiv në shqyrtim gjyqësor d.m.th ka cilësinë e palës në procedurën penale⁴³ me që i dëmtuari ka paraqitur deklaratën e dëmit⁴⁴ pranë gjykatës;
- E drejta për t'u thirrë (njoftuar) për të marrë pjesë në shqyrtimin gjyqësor,⁴⁵ dhe të ketë përkthim nëse nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura;
- I dëmtuari, mund të kërkojë formalisht apo jo formalisht nga prokurori i shtetit që të kërkojë vazhdimin e paraburgimit për të akuzuarin⁴⁶;
- I dëmtuari, në cilësinë e dëshmitarit, ka të drejtë që të trajtohet në mënyrë të barabartë si palët tjera, ashtu siç kërkojnë dispozitat ligjore për pozitën e tij si i dëmtuar, pa marr parasysh përkatësinë nacionale, fetare, racore apo gjinore;
- Gëzon të drejtë që të mos përgjigjet në pyetje konkrete kur ka gjasa se më këtë e vë veten ose ndonjë person të afërm të tij, para turpit të rëndë, dëmit të konsiderueshëm material ose ndjekjes penale dhe gjykata është e detyruar që për këtë të drejtë ta njoftojë të dëmtuarin si dëshmitar;
- E drejta për t'u trajtuar me respekt nga gjykata gjatë gjithë procedurës penale;
- I dëmtuari ka të drejtë të paraqesë kërkesë për masë mbrojtëse apo anonimitet;⁴⁷
- E drejta të marrë në pyetje dëshmitarin përmes pyetjeve të drejtpërdrejta, të tërthorta apo rimarrja në pyetje e dëshmitarit;⁴⁸
- Gëzon të drejtën që të kundërshtojë kualifikimet apo paragjykimet e ekspertit;
- Pas prokurorit të shtetit, i dëmtuari ka të drejta të barabarta në fjalën hyrëse në shqyrtimin gjyqësor;
- I dëmtuari ka të drejtë që t'i respektohet plotësisht dinjiteti i tij, në mënyrë që të mos ndihet si i ri viktimizuar gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- I dëmtuari mund të propozojë shqyrtimin e fakteve të reja, mbledhjen e provave të reja dhe të përsërisin propozimet të cilat gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues më herët i ka refuzuar;⁴⁹

⁴³ Neni 62 paragr.1. 1.3 Kodi Nr. 04/L-123.

⁴⁴ Neni 218 Kodi Nr. 04/L-123.

⁴⁵ Neni 287 paragr.1 Kodi Nr. 04/L-123.

⁴⁶ Neni 191 paragr.1 Kodi Nr. 04/L-123.

⁴⁷ Neni 221 paragr.1 Kodi Nr. 04/L-123.

⁴⁸ Neni 331 paragr.1 Kodi Nr. 04/L-123.

⁴⁹ Neni 329 paragr.3 Kodi Nr. 04/L-123 .

- I dëmtuari mund të merr në pyetje të akuzuarin (me qëllim që të konfirmojë ose të mohojë një fakt, të shqyrtojë besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit apo paragjykimet lidhur me dëshminë e tij);
- I dëmtuari ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, në fjalën e tij përfundimtare mund të shpjegojë kërkesën e tij pasurore juridike dhe t'i potencojë provat që ndërlidhen me përgjegjësinë penale të të akuzuarit;⁵⁰
- I dëmtuari gëzon të drejtën për t'u kompensuar. I dëmtuari mund të përfaqësohet në procedurë penale nga anëtari i Odës së Avokatëve. Përveç anëtarit të Odës së Avokatëve, i dëmtuari mund të përfaqësohet edhe nga mbrojtësi i viktimave dhe nga vetë i dëmtuari;
- I dëmtuari mund të paraqesë një deklaratë të thjeshtë të dëmit të shkaktuar nga vepra penale. Mbrojtësi i viktimave mund të ndihmojë të dëmtuarin në paraqitjen e deklaratës së dëmit;

Një rol i tillë më aktiv në procedurë dukshëm fuqizon të drejtat e viktimave dhe është kërkesë që rrjedh edhe nga vendimet kornizë të BE-së. Roli i mbrojtësit të viktimave është zgjeruar. Sidoqoftë, nëse viktimat nuk ka avokat të vetin për ta përfaqësuar atë, mbrojtësi i viktimave mund t'i përfaqësojë interesat e viktimës edhe në gjykatë. Ky, në fakt, nuk është ndonjë rol i ri i mbrojtësit të viktimave, pasi që ata kanë bërë një gjë të tillë me vite në rastet e viktimave të trafikimit dhe viktimave të dhunës në familje.

ç) Realizimi i të drejtave të qytetarëve në gjykatë në rastet kur kanë hapur proces gjyqësor kur organet administrative kanë vendosur për të drejtat e tyre

Me anë të këtij procesi gjyqësor, synohet krijimi i kushteve të përshtatshme për një shqyrtim efektiv duke vënë në vend të drejtat e cenuara nga veprimet apo aktet administrative të nxjerra nga organet publike, të cilat kanë zbatuar procedurat përkatëse. Shqyrtimi gjyqësor i vendimeve administrative në këtë proces gjyqësor është një veprim procedural i gjykatës demokratik i pranuar dhe i pranishëm në praktikën kryesore evropiane për të siguruar rendin, veçanërisht për të mbrojtur të drejtat individuale përballë vendimeve të cilat i nxjerrin organet administrative.

Për më tepër, vendimet administrative luajnë një rol vendimtar për zhvillimin ekonomik të një vendi. Pothuajse të gjitha vendimet për investime apo projekte për infrastrukturën, duhet të kalojnë përmes një procesi licencimi, i cili mund të bëhet subjekt i një shqyrtimi ligjor nga gjykata në kuadër të departamentit përkatës. Funksionimi efikas i këtij departament rritë gjithashtu transparencën

⁵⁰ Neni 354 Kodi Nr. 04/L-123.

e vendimeve administrative dhe mund të luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit. Në ditët e sotme, një shtet ligjor nuk mund të mendohet pa akses për të gjithë qytetarët tek një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar në bazë të ligjit dhe e aftë për të përmbushur kërkesat e zhvillimit të një gjykimi të drejtë.

Gjatë këtij procesi gjyqësor do të vendoset për ligjshmërinë e akteve administrative me të cilat është vendosur për të drejtat dhe obligimet e personave të bazuara në ligj, për të cilën ka vendosur një organ administrativ. Zakonisht, këto procese fillojnë me konflikt administrativ⁵¹ në gjykatë, që në shumë vende të botës emërohen si gjykata administrative ndërsa në Kosovë funksionon Departamenti për Çështje Administrative pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë. Këto garanci vihen në mbrojtje të personave fizikë dhe juridikë, sepse u mundëson atyre që të drejtat, liritë dhe interesat që u janë cenuar edhe në procedurat administrative apo edhe me vendimet administrative, mund t'i kërkojnë organit të administratës publike kompetent për revokimin ose shfuqizimin e vendimit ose aktit administrativ përkatës, që të vendosin pezullimin e zbatimit të aktit administrativ të kundërshtuar, në mënyrë që të mbrohen të drejtat dhe interesat e tyre.

d) E drejta në ankesë kundër vendimit gjyqësor

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën për mjete juridike, duke parashikuar konkretisht se “secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.⁵² Këto garanci vihen në mbrojtje të personave fizikë dhe juridikë, sepse ju mundëson atyre që të drejtat, liritë dhe interesat e të cilëve u janë cenuar edhe në procedurat administrative apo edhe me vendimet administrative, mund t'i kërkojnë organit të administratës publike kompetent për revokimin ose shfuqizimin e vendimit ose aktit administrativ përkatës, që të vendosin pezullimin e zbatimit të aktit administrativ të kundërshtuar në mënyrë që të mbrohen të drejtat dhe interesat e tyre.⁵³ Prandaj, ankesa është formë institucionale e mbrojtjes së drejtave dhe lirive themelore e parashikuar me dispozita kushtetuese dhe ligjore jo vetëm në procedurën gjyqësore, por edhe në procedurë administrative.

Kundër çdo aktgjykimi apo aktvendimi, palët e pakënaqura kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë brenda afatit ligjor. Qëllimi kryesor i apelimit është që palët të

⁵¹ Neni 13 Ligji Nr. 03/I-202 për Konfliktet Administrative, 2010.

⁵² Neni 32 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 2008.

⁵³ Neni 126 Ligji Nr. 2/L-28, për Procedurën Administrative.

kërkojnë rishikim të çështjes nga një gjykatë më e lartë e cila duhet të shqyrtojë jo vetëm nëse është respektuar apo jo një proces i drejtë gjyqësor gjatë gjithë seancave gjyqësore, por ato duhet t'i shqyrtojnë edhe shkaqet për apel. E drejta e apelit në çështjet penale është e garantuar për çdo person të shpallur fajtor për një vepër penale nga një gjykatë dhe ka të drejtë ta paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimit. Nga kjo e drejtë mund të ketë përjashtime për vepra të lehta penale, siç përcaktohen meligj, ose kur i interesuari ka qenë gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, ose shpallur fajtor dhe dënuar në vijim të një apeli kundër pafajësisë së tij.⁵⁴

E drejta e ankimit është garantuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se “nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit” ose, “nuk ka të drejtë ankimi pa pasur një të drejtë”. E drejta e ankimit përbën një nga të drejtat themelore të njeriut dhe ajo parashikohet edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në Protokollet e saj shtesë. Të njëjtën siguri juridike e ofron edhe ligji për gjykatat, ku thuhet se çdo person ka të drejtë të përdor mjetet juridike kundër një vendimi gjyqësor apo administrativ që cenon të drejtën apo interesat e tij në mënyrën e caktuar me ligj.⁵⁵

Kjo shënon një standard më të lartë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut se sa ai i “*ankimit efektiv*” që përcaktohet në nenin 13 të Konventës, nen që pranon si respektim të standardeve të Konventës lejimin e ankimit efektiv në një instancë më të lartë pa e kushtëzuar domosdoshmërisht këtë ankimin me ankimin në instancat e tjera gjyqësore. E drejta e ankimit duhet kuptuar si mundësi e çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar në një gjykatë më të lartë vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët. Me fjalë tjera, cenimi i kësaj të drejte parqet cenim të gjykimit të drejtë e të paanshëm.

4. Përfundim

Jemi të vetëdijshëm se mes njerëzve ekzistojnë dallime si në pamjen e jashtme, gjinisë, racës, përkatësisë etnike, statusit civil, ngritjes profesionale, apo në aftësi tjera prandaj duhet ta kuptojmë një fakt se çdo njeri është i veçantë dhe i papërsëritshëm. Ky është fakt i rëndësishëm, sepse pikërisht veçantia ose dallueshmëria është esenca e shoqërisë njerëzore dhe ekzistencës së saj. Barazia

⁵⁴ Protokollin Nr. 7 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Amenduar me Protokollin Nr.11, Strasburg, 22. XI. 1984.

⁵⁵ Neni 7.3 Ligji nr. 03/1-199.

nuk do të thotë se jemi identikisht të njëjtë, por trajtimi të jetë i barabartë përball institucioneve shtetërorë të cilit do nivel qoftë (legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor).

Sundimi i ligjit ka për qëllim mënjanimin e arbitraritetit të pushtetit të besuar me pikësynim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike për të gjithë personat, pa dallime. Siguria juridike, përfshin qartësinë, kuptueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit normativ.

Është fakt i pamohueshëm se gjyqësori kontribuon në avancimin dhe realizimin e të drejtave të qytetarëve, duke e pasur parasysh se ky ka vepruar në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Në ushtrimin e përgjegjësive të tyre gjyqësore, gjyqtarët duhet ta shmangin çdo anshmëri apo diskriminim në lidhje me ndonjë çështje të parëndësishme dhe duhet t'i trajtojnë të gjitha palët me respekt, me mirësjellje dhe në mënyrë të barabartë.

Gjyqtaret duhet të ushtrojnë të gjitha përgjegjësitë në mënyrë të paanshme dhe duhet të sigurohen që kjo paanshmëri të vërehet në të gjitha veprimet. Gjyqtari duhet të veprojë në mënyrë të paanshme dhe të pavarur në të gjitha rastet i lirë nga çfarëdo ndikimi nga jashtë, dhe kryen detyra gjyqësore në bazë të fakteve dhe ligjit të aplikueshëm në secilin rast, pa asnjë kufizim, ndikim të pavend, nxitje, presion, kërcënime për ndërhyrje, qofshin ato të drejtpërdrejta apo të tërthorta, nga çfarëdo qarqesh. Gjyqtarët kanë për obligim që të sigurohen në vazhdimësi, se drejtësia është ajo që do të shërbehet më në fund duke i marrë në konsideratë të gjitha elementet komplekse të të gjitha çështjeve për të cilat do të vendosë gjykata. Po të veprojnë ndryshe, do ta rrezikojnë kredibilitetin e drejtësisë që është aq prioritar për shoqërinë dhe shtetin, sa që do ta bënte lirinë dhe sigurinë e qytetarëve më të pasigurt dhe shtetin ligjor më pak funksional.

Gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor, gjyqtari ka për obligim që të kujdeset që ligji dhe standardet ndërkombëtare janë duke u zbatuar në përpikëri dhe, se çështja në gjykatë do të trajtohet me drejtësi të plotë duke evituar çdo formë të diskriminimit ndaj palëve, d.m.th. që trajtimi do të jetë i barabartë pa marrë parasysh, gjininë, fenë, racën, moshën, orientimin politik, gjuhën, kombin, statusin pronësor, nivelin edukativ, apo ndonjë status tjetër.

Aktiviteti i gjyqtarit konsiston në faktin se ky është aktori i vetëm dhe kryesor i cili do ta bëjë, vërtetimin e gjendjes faktike, që shërben si bazë për gjykimin, është pra një detyrë më e ndërlikuar më e rëndë dhe më me përgjegjësi.

Provat dhe ligji do të jenë shtytja e vetme që do të ndikojnë tek gjyqtari me rastin e zgjidhjes së çështjes së caktuar duke qenë i obliguar të respektojë

dinjitetin, individualitetin dhe privatësinë e njeriut, njëkohësisht do të ruajë dinjitetin e gjykatës si dhe do të jetë një interpretues i drejtë i normës juridike, duke e materializuar atë me vendim gjyqësor të drejtë. Asnjë gjyqtar nuk mund të marrë urdhra a udhëzime për mënyrën e gjykimit dhe veçanërisht për vendimin që duhet të japë në një çështje të caktuar.

Gjyqësori në një vend është një prej shtyllave kryesore të shtetit të së drejtës dhe garantuesi kryesor i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Të drejtat e njeriut shtrojnë kërkesën për drejtësi si ideal. Ato janë të domosdoshme në jetën e përditshme edhe për ata që nuk e respektojnë ose që e injorojnë barazinë ndërmjet njerëzve dhe mohojnë lirinë e të tjerëve. Të drejtat e njeriut janë universale. Ato u përkasin të gjithë individëve dhe duhet të gëzohen në mënyrë të barabartë nga të gjithë.

Këto institucione shtetërore, të pavarura nga institucionet tjera, karakterizohen në atë, që procesi dhe veprimet të imponojnë në zgjerimin, fuqizimin dhe garantimin e të drejtave njerëzore, të cilat çdo ditë e më shumë zgjerohen siç janë: liria e fjalës, liria e fesë, mbrojtja nga diskriminimi, e drejta e jetës private, e drejta për proces të drejtë, trajtim të barabartë. etj.

Trajtimi i barabartë në gjykim nuk do të thotë edhe trajtim identik. Kjo do të thotë se, kur faktet objektive janë të ngjashme, edhe sistemi gjyqësor është i ngjashëm. Procedurat e rregullta gjyqësore e sjellin drejtësinë dhe besimin e qytetarëve brenda një juridiksioni të caktuar.

Gjykatat do ta garantojnë barazinë e qytetarëve para ligjit dhe mos diskriminimin, të drejtën e jetës, lirinë e shprehjes, të drejtën e lirisë dhe mbrojtjen nga arresti arbitrar, mbrojtjen nga ndëshkimi, trajtimi poshtërues dhe degradues, të drejtën për proces të rregullt gjyqësor, dhe garantimin e një gjykimi të drejtë publik brenda një afati të arsyeshëm.

Gjykatat duhet të jenë të ndërgjegjshme për përgjegjësinë që kanë në bazë të Kushtetutës, por po ashtu edhe gjyqtarët, në radhë të parë si qytetarë e pastaj në funksionin që e ushtrojnë, duhet t'i mendojnë edhe pasojat që mund të sjellin vendimet e tyre. Natyrisht, është detyrim i gjyqtarëve që ta shmangin çdo lloj subjektivizmi, me qëllim që vendimet t'i japim mbi kritere të mirëfillta juridike dhe në bazë të fakteve të vërtetuara sipas bindjes së lirë dhe të drejtë. Atmosfera që rrethon gjykatat dhe ngjarjet që ndodhin në to, janë formale dhe të pazakonta për shkak se gjykatat janë unike. Ato zgjidhin konflikte duke zbatuar ligjin mbi faktet e çështjeve të veçanta, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Në veprimtarinë e vet gjykatat janë plotësisht të pavarura dhe vetëm gjykatat e larta kanë kompetencë të ndikojnë në punën e gjykatave të ulëta, në rastet kur palët janë të pakënaqura me vendimet e shkallës së parë. Andaj, veprimtaria e tyre është shumë e rëndësishme dhe realisht e pazëvendësueshme në luftimin

e kriminalitetit. Gjykata është i vetmi organ i autorizuar në bazë të ligjit që të vendosë për zbatimin e dhunës ndaj të gjithë qytetarëve, e sidomos, nëse është në pyetje jeta, liritë, cenimi i personalitetit të njeriut, rendit shtetëror, pasurisë, etj.

Gjykata është institucioni i vetëm publik, i cili do të vlerësojë dhe do t'i peshojë gjërat, duke vendosur për themelësinë e çështjes me vendim gjyqësor të arsyetuar thellësisht, për të gjitha ato çështje që hyjnë në kuadër të kompetencës së saj.

Andaj, funksioni gjyqësor nënkupton shkallë krijimtarie, e cila e materializon ligjin dhe i vendos çështjet në binarë normal dhe të qëndrueshëm, duke i mbyllur të gjitha dyert për vetëgjyqësi.

Si rezultat i saj, përveçse gjykata që duhet të jetë e pavarur, profesionale, eficientë, kredibilë dhe me integritet, gjykata duhet të jetë edhe e besueshme për qytetaret. Andaj, gjykatat duhet të jenë të orientuara në ushtrimin e veprimtarisë së tyre me transparencë të plotë kundrejt publikut, në mënyrë që të shërbejë si model i ushtrimit të autoritetit dhe kontribues në forcimin e shtetit ligjor për të cilën ka aq nevojë shoqëria e jonë.

BIBLIOGRAFIA

I. Literatura:

Brever – Carrias, Allan R., “Constitutional Courts as Positive Legislators” – A Comparative Law Study, 2006.

Constitutional Court’s interference with the Legislator or existing legislation, Boston, 2008. Esat Stavileci, Hyrja në shkencat administrative, Prishtinë, 1997.

Eser A. Hundert Jahre deutscher Strafgesetzbuch: in AA.VV Criminal Law in Action . An Overview of Current Issues in Western Societies, Kluwer, Deventer, 1988.

Finer S.E. Bogdanor V., Riddren B.: Comparing Constitutions, Clarendon Press, Oxford 1995.

Feely M.M e Rubin E.L. Judicial Policy Making and the Modern State, Cambridge University Press, Cambridge, 1998.

Damaska M.R, Structure of Authority and Comparative Criminal Procedure, in The Yale Law Journal, LXXXIV, Bologna, 1975.

- D.Krapac, Kazнено procesno pravo, Institucije, knjiga I, Narodne novine, II. izdanje, Zagreb, viti 2003.
- Friedrich A. Hayek, The Constitution of Liberty, The University of Chicago, 1960. Komesar N.K, Imperfect Alternatives. Choosing Institutions in Law, Economics and Public Policy, The University of Chicago Press, Chicago – London, 1994.
- Luigi de Ruggiero, L'incidente probatorio, Roma, 2006. Luan Omari, Shteti i së Drejtës, Tiranë, 2004.
- Kurtesh Saliu, E drejta kushtetuese, Libri I, Prishtinë, 1998. Kristaq Traja, Drejtësia Kushtetuese, Tiranë, 2000.
- Milan Milutinović, Politika Kriminale, Beograd, 1984.
- Neil J. Kritz, The Rule of Law in the Postconflict Phase: Building a Stable Peace, in Manging Global Chaos Sources of and Responses to International Conflic, 1996.
- Hashim Qollaku, Prokurori Publik në Procedurën Penale, viti 2010.
- Heather Strang dhe Lawrence W.Sherman, Restorative Justice to Reduce Victimiacion, in Brandon C.Welsh dhe Divid P.Farrington, Preventing Crime: What for children , Offenders , Viktims and Places, New Zork, 2007.
- Gerrard.Lopez, S. Bornestein, Victomologie Clinikque, Paris, 1995.
- Manfred Nowak, U.N. Covenant on Civil and Political Rights. CCPR, Commentary, NP Engel, 1993.
- Moméilo Grubaš, Krivičo procesno pravo: Tok krivičnog postupka, Novi Sad, 1996. Mihajlo Ačimović, Psihologija zločina i suđenja, Beograd, 1988.
- Ismet Salihu, E drejta penale(pjesa e përgjithshme), Prishtinë, 2008.
- Ramadan Gashi, E drejta për gjykim publik dhe publiciteti i gjykimit, Prishtinë, 2014. Ragip Halili, Viktimologjia, Prishtinë, 2007.
- Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2005.
- Radoloviç Aldo, Zashtita prava na suđenje u razumnom roku, Zbornik pravnog fakulteta Sveučilishte u Rijeci, br.1 2008.
- R.B.Lillich, "Civil Richt" në T.Meron, ed. Human Richts in International Law, 1984. Stven M.cox, Jennifer M.Allen, Robert D.Hanser dhe John J. Conrad, Juvenile Justice, A Guide to Theory, Policy, and Praktice , Los Angeles/ Sage Publications, 2008.
- Stven M.cox, Jennifer M.Allen, Robert D.Hanser dhe John J. Conrad, Juvenile Justice, A Guide to Theory , Policy, and Praktice, Los Angeles/ Sage Publications, 2008.
- Sheryl Riechmann-Hruska, Deffeences in Learning, Boston, 2003. Vesel Latifi, Teknika Kriminalistike, Prishtinë, 2001.
- Vesana Rakiq - Vodineliq, Pravosudno organizaciono pravo, Beograd, 1994.
- William Wade/ Christopher Forsyth: Administrative Law, Oxford, 2004.

II. Akte juridike të brendshme dhe ndërkombëtare:

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948.

Deklarata e Pekinit për Parimet e Pavarësisë së Gjyqësorit e vitit 1995.
Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

Kodi Penal, 2013, Kodi Nr. 04/L-082.

Kodi i Procedurës Penale, 2013, Kodi Nr. 04/L-123.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike, 1946 . Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut e 4 nëntorit 1950.

Konventa e Amerikane për të Drejtat e Njeriut, 1969.

Parimi i Primeve Themelore të Pavarësisë së Gjyqtarëve, viti 1985.

Rregullat e Pekinit, Miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/33 e datës 29 nëntor 1985.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Kodi Nr. 03/L-193, 2010. Ligji për Gjykatat, Ligji Nr. 03/L-199/2013.

Indexi i Reformës Gjyqësore, Kosovë, vëllimi III, Gusht 2007,

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja *Le Compte, Van Leuven e De Meyere kundër Belgjikës*, viti 1981.

Vendimit për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit nxjerr nga Këshilli i lartë i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë i datës 01.01. 2009. Communication No. 215/1986, *G.A. van Meurs v. The Netherlands* (Views adopted on 13 July 1990), në UN doc GAOR, A/45 /40 (vol. II), fq. 60, parag. 6.2).

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja *Le Compte , Van Leuven e De Meyere kundër Belgjikës*, viti 1981.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja “*Van Meurs kundër Holandës*” (215/1986), 13 korrik 1990 Raporti i Komitetit të Drejtave të njeriut (A/95/40)190 parg.6.2.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja ,*König kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut, 28 qershor 1978 .

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja “*Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*”, GjEDNj, 13 korrik 1983.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja *Guincho kundër Portugalisë*”, GjEDNj, 10 korrik 1984.

Case of John Murray v. the United Kingdom, judgment of 8 February 1996.

Court HR, Kotovski Case v, the Netherlands, judgment of 20 November 1989.

Rasti ”Garcia Ruiz” kundër Spanjës nr. 30544/96.

Court HR, Brozicek Cae , Italy, judgment of 19 December 1989 Series A, No 167.

Eur. Court HR, Case of Weber v. Switzerland, judgment of 22 May 1990, Series A, No 177. *Eur. Court HR, Case of Pretto and OTHERS V. Italy*, judgment of

8 December 1983.

Eur. Court HR, Case Marry v. United Kingdom, 8 February 1996.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja “Melin kundër Francës”, GJEDNJ, 22 qershor 1993.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja Hadjanastassiou kundër Greqisë, 16 dhjetor 1992.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja, Albina kundër Romanisë, 25 prill 2005.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja, Van der Hurk kundër Holandës, 19 prill 1994.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja “Maanell dhe Moris kundër Mbretërisë së Bashkuar”, 2 mars 1987.

Court HR, Kotovski Case v, the Netherlands, judgment of 20 November 1989, Series A, No. 166.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja “Gjonboçari kundër Shqipërisë”, 31 mars 2005 dhe 31.3.2008.

Court HR, Case of Pretto and OTHERS V. Italy, judgment of 8 December 1983, Series A, No 71, paragr.27.

Eur. Court HR, Case Marry v. United Kingdom, 8 February 1996 paragr. 45 Komisioni Evropian për Efektshmërinë e Drejtësisë, viti 2006.

Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, 10 korrik 1991.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja, Ludi, kundër Zvicrës, datë 15.06.1992.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja, Unterpertinger, kundër Italisë, datë 24.11.1986.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja, Serves kundër Francës datë 20.10.1997.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja, Suparescu kundër Gjermanisë, datë 01.09.2006

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja, Hadjanastassiou kundër Greqisë, 16 dhjetor 1992,

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja, Albina kundër Romanisë, 25 prill 2005.

Vendimi i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Çështja, Van der Hurk kundër Holandës, 19 prill 1994.